

Marrëveshja e Zbatimit¹

Ndërmjet

Republikës së Kosovës
e cila vepron përmes **Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik**

dhe

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.

**HUNTON &
WILLIAMS**

John J. Beardsworth, Jr.
951 E. Byrd St.
Richmond, VA 23219
Telefon: +1 804 788 8637
jbeardsworth@hunton.com

¹ Kjo marrëveshje është përkthyer në shqip nga origjinali në Anglisht

US-DOCS\86271257.15

Përmbajtja

Faqe

Neni 1	Përkufizimet; Interpretimi	2
1.1	Përkufizimet	2
1.2	Interpretimi.....	22
Neni 2	Data e Hyrjes në Fuqi; Afati	23
2.1	Hyrja në Fuqi; Afati	23
Neni 3	Zbatimi i Projektit Kosova e Re	23
3.1	Zbatimi i Projektit Kosova e Re	23
3.2	Asnjë Diskriminim, Asnjë Shpronësim.....	23
3.3	Tenderi (Impianti) për Kontraktorin e IPN-së dhe Kontraktorin e MAGJ-së.....	24
3.4	Financimi	24
3.5	Blerja e Tokës	26
3.6	Zhvendosja	27
3.7	Kontabiliteti i Ndarë	27
3.8	Asnjë Sipërmarrje Tjetër Biznesore	27
3.9	Emërimi i Inxhinierit të Pavarur të Emëruar nga QK-ja	28
3.10	Emërimi i Konsulentit të Pavarur të MS-së	28
3.11	Prokurimi i Mallrave dhe Shërbimeve	29
3.12	Ko-gjenerimi; Furnizimi me Nxehësi	29
3.13	Pjesëmarrja në Administrimin e Kushteve të Caktuara të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit.....	30
Neni 4	Pëlqimet	31
4.1	Pëlqimet e GenCo-së	31
4.2	Aplikimet nga GenCo-ja për Pëlqime.....	32
4.3	Statusi i Aplikimeve për Pëlqim	32
4.4	Përkrahja e QK-së për Marrjen e Pëlqimeve.....	32
4.5	Kushtet e Pëlqimeve	32
Neni 5	Ndërtimi, Operimi, Mirëmbajtja dhe Personeli; Të Drejtat e QK-së në Rastin e Ndalimit të Operacioneve	33
5.1	Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Objekteve; Emërimi i Kontraktorëve.....	33
5.2	Ndalja e Operimit të Objektivit të TCKR-së	35
Neni 6	Dekomisionimi i Objektivit të TCKR-së	38
6.1	Dekomisionimi i Objektivit të TCKR-së	38
Neni 7	Transferimi i Fondeve	38
7.1	Transferimi i Fondeve	38
7.2	Mirëmbajtja e Llogarive	38
Neni 8	Mjedisi dhe Siguria	38
8.1	Pajtueshmëria me Standardet Mjedisore, Standardet Sociale dhe Standardet e Shëndetit dhe Sigurisë të Kosovës	38
8.2	Dëmshpërblimi për Standardet Mjedisore	39
8.3	Dëmshpërblimi për Pajtueshmërinë me Standardet e Zbatueshme	39
8.4	Prokurimi i GenCo-së	39
8.5	Pajtueshmëria me Standardet e Zbatueshme në Lidhje me Objektet e Asociuara	40
Neni 9	Garancia e Qeverisë; Marrëveshja për Mbështetjen e Sponsorit	41
9.1	Garancia e Qeverisë	41
9.2	Marrëveshja për Mbështetjen e Sponsorit	41
9.3	Dëmshpërblimi për Tarifat e Garancisë	41
Neni 10	Fondi për Zhvillim të Komunitetit; Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit; Zhvillimi i Komunitetit	
	Procedurat	41
10.1	Fondi për Zhvillim të Komunitetit	41
10.2	Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit	41
10.3	Detyrat e Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit; Kufizimi i Kompetencave	42

10.4	Procedurat për Zhvillim të Komunitetit	43
Neni 11	Tatimet dhe Kontrolltet e Importit	44
11.1	Tatimet e Aplikueshme për GenCo-në	44
11.2	Tatimet e Aplikueshme për Sponsorin HoldCo dhe Investitorët.....	44
11.3	Stimujt dhe Koncesionet e Aplikueshme Tatimore.....	44
11.4	E drejta për Import; Detyrimet Doganore	44
11.5	Ri-eksportimi i Artikujve të Pakonsumuar	44
Neni 12	Kontrollet e Imigracionit	45
12.1	Kontrollet e Imigracionit.....	45
Neni 13	Punësimi, Trajnimi dhe Resurset Kosovare	45
13.1	Punësimi i Kosovarëve	45
13.2	Standardet e Punësimit	45
13.3	Trajnimi	45
13.4	Resurset Kosovare	45
Neni 14	Raportet për QK-në; Auditimi Vjetor	46
14.1	Raportet për QK-në	46
14.2	Auditimi Vjetor	46
Neni 15	Sigurimet	47
15.1	Sigurimet.....	47
Neni 16	Tarifat e Këshilltarëve dhe Inxhinierëve Para dhe Pas Mbylljes Financiare	47
16.1	Tarifat e Këshilltarëve dhe Inxhinierëve Para Mbylljes Financiare.....	47
16.2	Tarifat e Këshilltarëve dhe Inxhinierëve mes Mbylljes Financiare dhe Datës së Tërheqjes Përfundimtare.....	48
Neni 17	Përfaqësimet dhe Garancitë	50
17.1	Përfaqësimet dhe Garancitë e GenCo-së	50
17.2	Përfaqësimet dhe Garancitë e QK-së	51
17.3	Riafirmimi i Përfaqësimeve dhe Garancive	51
Neni 18	Kufizimi i Përgjegjësisë dhe Dëmshpërblimi në Lidhje me Pagesat e Paligjshme	51
18.1	Kufizimi i Përgjegjësisë	51
18.2	Dëmshpërblimi dhe Informacioni në Lidhje me Pagesat e Paligjshme	52
Neni 19	Mospërmbushja; Ndërprerja	52
19.1	Ngjarjet e Mospërmbushjes nga GenCo-ja	52
19.2	Ngjarjet e Mospërmbushjes nga QK-ja.....	54
19.3	Njoftimi për Ndërprerje	57
19.4	Ndërprerja për shkak Ngjarjes së Forcës Madhore Politike ose Ndryshimit të Ligjit.....	57
19.5	Detyrimet pas Njoftimit për Ndërprerje të Kontestuar	57
19.6	Mjetet e Tjera Juridike	58
Neni 20	Të drejtat dhe Detyrimet pas Ndërprerjes; Kompensimi	58
20.1	Ngjarja e Mospërmbushjes nga GenCo-ja	58
20.2	Ngjarja e Mospërmbushjes nga QK-ja	58
20.3	Ndërprerja pas Ngjarjes së Forcës Madhore Politike, Ndryshimit të Ligjit, Ngjarjes së Forcës Madhore të Ujit të Papërpunuar, ose Ndryshimit në Cilësinë e Ujit të Papërpunuar	58
20.4	Ndërprerja pas Ngjarjes Tjetër të Forcës Madhore	59
20.5	Ndërprerja pas Zgjedhjes Në Lidhje me Sanimin Mjedisor.....	59
20.6	Skadimi i Afatit	59
20.7	Auditimi Përpara Skadimit të Afatit	59
20.8	Detyrimet në Pritje të Datës së Blerjes	60
20.9	E Drejta për Ndërprerje për Shkak të Dështimit të Arritjes së Datës së Bartjes; Kompensimi	60
20.10	Detyrimi për Ndërprerje pas Ndërprerjes së Marrëveshjeve të Projektit të Lidhura me Gjenerimin	61
Neni 21	Forca Madhore	62
21.1	Forca Madhore	62
21.2	Detyrimet e Njoftimit	63
21.3	Detyra për Zbutje	64
21.4	Dështimet ose Vonesat e Shkaktuara nga Forca Madhore	64

Neni 22	Zgjidhja e Kontesteve	64
22.1	Njoftimi i Kontestit	64
22.2	Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve	65
22.3	Kontestet Teknike	65
22.4	Kontestet për Pagesa	67
22.5	Arbitrazhi	68
22.6	Kontestet e Lidhura	70
22.7	Vazhdimi i Detyrimeve	70
22.8	Aktet Komerciale	70
22.9	Imuniteti Sovran; Juridiksioni	70
Neni 23	Të ndryshme	71
23.1	Njoftimet	71
23.2	Plotësim-ndryshimi	73
23.3	Mbijetesa.....	73
23.4	Përfituesit Palë të Treta	73
23.5	Asnjë Heqje Dorë	73
23.6	Marrëdhënia e Palëve	73
23.7	Shpenzimet e Palëve	73
23.8	Pëlqimi	74
23.9	Gjuha	74
23.10	Ligji Drejtues	74
23.11	Statusi i Marrëveshjeve të Projektit	74
23.12	Plotësia	74
23.13	Caktimi	74
23.14	Kontraktimi	74
23.15	Konfidencialiteti	75
23.16	Asnjë Përgjegjësi për Shqyrtim	76
23.17	Mjetet Juridike të Ekuitetit	76
23.18	Auditimi nga Grupi i Bankës Botërore	76
23.19	Homologët.....	76
23.20	Sigurime të Mëtejshme	76
23.21	Shkëputshmëria	76
23.22	Pavlefshmëria e Pjesshme	76
23.23	Borxhi Shtesë	77
23.24	Afirmimi	77

Kalendari 1	Stimujt dhe Koncesionet Fiskale
Kalendari 2	Forma e Garancisë së Qeverisë
Kalendari 3	Shumat e Kompensimit të Blerjes
Kalendari 4	Marrëveshjet e Blerjes
Kalendari 5	Forma e Marrëveshjes së Qiradhënies
Kalendari 6	Pëlqime të Specifikuara
Kalendari 7	Forma e Certifikatës së Pajtueshmërisë
Kalendari 8	Forma e Certifikatës së Pagesës
Kalendari 9	Lista e Ekspertëve
Kalendari 10	Lista e Konsulentëve

KJO MARRËVESHJE E ZBATIMIT (kjo "**Marrëveshje**") është lidhur më ____ janar , 2018 ("**Data e Ekzekutimit**") nga dhe ndërmjet:

- (1) Republikës së Kosovës ("**QK**") e cila vepron përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik; dhe
- (2) ContourGlobal Terra 6 S.à r.l. ("**GenCo**"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (société à responsabilité limitée) e organizuar sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut, me zyrën e vet të regjistruar në 35-37 Avenue de la Liberté, L-1931 Luksemburg, Dukati i Madh i Luksemburgut, dhe e regjistruar në Regjistrin e Tregtisë dhe Kompanive të Luksemburgut me numër B 195.738.

Veçmas, QK-ja dhe GenCo janë të referuara më poshtë si "**Pala**" dhe, së bashku si "**Palët**".

RECITALET

- A. QK-ja ka njohur nevojën për kapacitete shtesë të termocentralit për t'u dhënë zgjidhje shqetësimeve të pranishme në Kosovë rreth sigurisë afatgjatë të furnizimit.
- B. QK-ja ka për qëllim të përfshijë sektorin privat në një projekt të infrastrukturës që përfshin zhvillimin, projektimin, ndërtimin, financimin, pronësinë, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Objektivit të TCKR-së (siç përcaktohet më poshtë) dhe rehabilitimin e Lokacionit (siç përcaktohet më poshtë) nga GenCo-ja ("**Projekti Kosova e Re**");
- C. QK-ja është duke lidhur këtë Marrëveshje për të inkurajuar investimet private në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë;
- D. GenCo-ja ka për qëllim të formojë një entitet të ri të organizuar sipas ligjeve të Kosovës ("**CG Kosova**") dhe pas formimit të CG Kosova, GenCo-ja ka për qëllim t'ia caktojë CG Kosovës të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin e vet dhe t'ia delegojë obligimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe QK-ja e njeh dhe e pranon këtë aktim;
- E. Në lidhje me Projektin Kosova e Re, GenCo-ja u përzgjedh në bazë të një procesi konkurrues për të zhvilluar, projektuar, ndërtuar, financuar, poseduar, operuar dhe mirëmbajtur objektin e prodhimit të energjisë elektrike me linjit që do të gjendet në Lokacionin në Obiliq, Kosovë, të gjitha në përputhje me Standardet Mjedisore (siç përcaktohen më poshtë);
- E. QK-ja e ka njohur nevojën për një marrëveshje blerjeje afatgjatë të energjisë si e vetmja zgjidhje e përballeshme financiarisht për Kosovën për të tërhequr investimet e sektorit privat që janë të nevojshme për të zgjidhur shqetësimet afatgjata mjedisore dhe sigurinë e furnizimit të pranishme në vend;
- G. Në të njëjtën kohë me lidhjen nga QK-ja dhe GenCo-ja të kësaj Marrëveshjeje, GenCo është duke lidhur Marrëveshjen për Blerje të Energjisë me KEKR me qëllim të sigurimit të kapacitetit dhe energjisë elektrike të Objektivit të TCKR-së për furnizuesin publik dhe njëkohësisht duke lidhur Marrëveshjen për Blerje të Njëpasnjëshme të Energjisë në bazë kalimi për të zbatuar qëllimin e sigurimit të kapacitetit dhe energjisë të Objektivit të TCKR-së që të jetë në dispozicion të furnizuesit publik, me efektin e kombinuar të mundësisimit që furnizuesi publik të përfitojë nga një marrëveshje afatgjatë për blerje të energjisë; dhe
- H. Në të njëjtën kohë me lidhjen nga QK-ja dhe GenCo të kësaj Marrëveshjeje, ekzekutohen Marrëveshjet e tjera të Projektit.

TANI, PRANDAJ, për dhe në konsideratë të premtimeve dhe marrëveshjeve të ndërsjella të përmbajtura në këtë dokument, dhe që synojnë të jenë detyruese ligjërish, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizimet; Interpretimi

1.1 Përkufizimet

Sa herë që termat me shkronjë të madhe në vijim shfaqen në këtë Marrëveshje, Kalendarët ose Anekset, ato do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Ekuiteti Aktual” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë. “Prona Shtesë” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Qiradhënies.

“Filiali” - Në lidhje me çdo Person, çdo Person tjetër që, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nëpërmjet një ose më shumë ndërmjetësve, kontrollon, kontrollohet ose është nën kontroll të përbashkët me Personin e tillë; me kusht që “Filiali” në asnjë rast (përveçse në lidhje me detyrimin e konfidencialitetit dhe shpalosjen e lejueshme të përcaktuar në Seksionin 23.15(c)(i) nuk do të përfshijë asnjë Person që ka një interes ekuiteti të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në Sponsorin Sipëror. Për qëllime të këtij përkufizimi, “kontroll” (duke përfshirë me kuptime korrelative, termat “kontrollues”, “nën kontroll të përbashkët me” dhe “kontrolluar nga”), siç përdoret në lidhje me cilindo Person, nënkupton posedimin, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të kompetencës për të drejtuar ose për të shkaktuar drejtimin e menaxhimit ose të politikave të Personit të tillë, qoftë përmes pronësisë së aksioneve votuese ose interesave të tjerë të ekuitetit, me kontratë ose në ndonjë mënyrë tjetër. Për qëllime të këtij përkufizimi, çdo NP e Specifikuar do të jetë “Filial” i QK-së.

“Tabela e Ndërprerjes së Dakorduar” - Tabela e shumave të pagesës së ndërprerjes të përcaktuara në fletën e titulluar “Tabela e Ndërprerjes” të Modelit Financiar të Rastit Bazë (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë), siç përditësohet një tabelë e tillë si vijon:

- (a) data e supozuar e Mbylljes Financiare e treguar në Fletën H18 të “Supozimeve” të Modelit Financiar të Rastit Bazë do të përditësohet për të pasqyruar datën aktuale të Mbylljes Financiare, Data e supozuar e Operacioneve Komerciale e paraqitur në Qelizën H20 të “Supozimeve” të Modelit Financiar të Rastit Bazë do të përditësohet për të reflektuar fundin aktual të Periudhës së Ndërtimit, dhe fundi i periudhës së operacioneve i paraqitura në Qelizën H22 të “Supozimeve” të Modelit Financiar të Rastit Bazë do të përditësohet për të pasqyruar fundin aktual të Vitit të fundit i Marrëveshjes (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë); dhe
- (b) shuma e injektiveve të Ekuitetit Aktual (minus Ekuiteti Aktual i shoqëruar me Përrjashtimet Tarifore), në secilën periudhë gjysmë-vjetore të paraqitur në Rreshtin 204 të fletës “Model” të Modelit Financiar të Rastit Bazë duhet të përditësohet për të pasqyruar shumën e injektiveve të Ekuitetit Aktual (minus Ekuiteti Aktual i shoqëruar me Përrjashtimet Tarifore) në çdo periudhë gjysmë-vjetore nga fillimi i Periudhës së Ndërtimit deri në Datën e Tërheqjes Përfundimtare dhe numri i periudhave që përbëjnë një periudhë të tillë do të përditësohen për të pasqyruar periudhat aktuale të injektimit të Ekuitetit Aktual, si dhe çdo rregullim i ardhshëm i zbatueshëm si rezultat i zbatimit në Llogarinë e Rezervës së Shërbimit të Borxhit të shumave të çdo llogarie tjetër të ngjashme të rezervës në përputhje me Kalendarin 1 (*Tarifat*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; dhe
- (c) nuk do të bëhen ndryshime të tjera në Tabelën e Ndërprerjes së Dakorduar.

“Marrëveshje” - Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Ligjet Kundër Ryshfetit” - (i) ligjet që ndalojnë ryshfetin dhe/ose parimet e përshkruara në Konventën mbi Luftimin e Ryshfetit të Zyrtarëve të Huaj Publikë në Transaksionet Ndërkombëtare të Biznesit (zakonisht të referuara si Konventa e OECD-së kundër Korrupsionit), nënshkruar në Paris më 17 dhjetor 1997, e cila hyri në fuqi më 15 shkurt 1999 dhe (ii) ligjet që ndalojnë ryshfetin në vendet e themelimit të një Pale ose një Personi, vendin kryesor të biznesit dhe/ose vendin e regjistrimit si një emetues i letrave me vlerë, dhe/ose në vendet e themelimit të kompanisë sipërore amë të një Pale ose të një Personi të tillë, vendin kryesor të biznesit dhe/ose vendin e regjistrimit si emetues i letrave me vlerë.

"Periudha e Zbatueshme e Kurës së Homologut" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë, Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsi, Marrëveshjen për Furnizim me Linjit, ose Marrëveshjen për Furnizim me Ujë, siç mund të jetë rasti.

"Standardet e Zbatueshme" - Në mënyrë kolektive,

- (a) Standardet Mjedisore;
- (b) Standardet e Shëndetit dhe Sigurisë;
- (c) Standardet e Zhvendosjes;
- (d) Standardet Sociale; dhe
- (e) në masën që nuk është përshkruar më sipër, çdo ligj tjetër të Kosovës dhe çdo pëlqim që përcakton standardet në lidhje me rreziqet mjedisore, sociale, të punës, shëndetin dhe sigurinë ose të sigurisë të tipit të parashikuar nga Standardet e IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale ose që imponon përgjegjësi për shkelje e tyre.

"Kusht Arkeologjik" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"Marrëveshja për Deponimin e Hirit dhe Gipsit" - Marrëveshja me atë emër ndërmjet Mihjes së KEK-ut dhe GenCo-së me Datën e Ekzekutimit si datë të saj.

"Kreditet e Disponueshmërisë" - Kreditet për Disponueshmërinë Bazë (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) "Pagesa e Disponueshmërisë" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"Marrëveshja për Blerje të Njëpasnjëshme të Energjisë" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"Dita e Punës" - Çdo Ditë tjetër përveç një të Shtune, të Diele ose një Dite në të cilën bankat komerciale në Prishtinë, Kosovë, legalisht lejohen të mbyllen për biznes.

"Blerja" - Blerja e TCKR-së nga QK-ja në përputhje me Nenin 20 dhe Kalendarin 4. "Shumat e Kompensimit të Blerjes" - Shumat e kompensimit të përcaktuara në Kalendarin 3.

"Data e Blerjes" - Ka kuptimin e dhënë në Kalendarin 4. "CG Kosova" - Ka kuptimin e dhënë në recitale.

"Ndryshimi në Ligj" -

- (a) Miratimi, shpallja, shfuqizimi, modifikimi ose riinterpretimi pas Datës së Ekzekutimit nga çdo Autoritet Publik i çdo ligji të Kosovës, duke përfshirë çdo Ndryshim në Tatime (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë);
- (b) miratimi, shpallja, shfuqizimi, modifikimi ose riinterpretimi pas Datës së Ekzekutimit të Kodit të Rrjetit ose Kodit të Njehsimit në masën e zbatueshme për GenCo, duke përfshirë çdo ndryshim që i bën Rregullat e Tregut të zbatueshme për GenCo përveç aderimit vullnetar nga GenCo me shkrim;
- (c) vendosja nga Autoriteti Publik i çdo kushti ose afati material në lidhje me lëshimin, ripërtëritjen, zgjerimin, zëvendësimin ose modifikimin pas Datës së Ekzekutimit të çdo Pëlqimi të GenCo-së;
- (d) vendosja nga Autoriteti Publik i çdo Pëlqimi shtesë të GenCo-së; ose
- (e) ndonjë nga të mësipërmet që ndodh në lidhje me ndonjë homolog tjetër të ndonjë Marrëveshjeje të Projektit, Kontratës së Ndërtimit/Mirëmbajtjes, ose Dokumentit Financiar,

që në çdo rast të tillë

- (i) përcakton çdo kërkesë që ndikon në zhvillimin, projektimin, ndërtimin, financimin, pronësinë, operacionin ose mirëmbajtjen që ka të bëjë me Projektin Kosova e Re që ndryshon nga kërkesat ose ndikon në fitimet, kostot ose rreziqet që lidhen me të njëjtën
 - (A) në fuqi prej Datën së Ekzekutimit,
 - (B) të specifikuar në çdo aplikim ose dokumente të tjera të parashtruara në lidhje me këto aplikime, për çdo Pëlqim të GenCo të parashtruar nga GenCo, ose
 - (C) të dakorduar në ndonjë nga Marrëveshjet e Projektit ose Kontratat e Ndërtimit/Mirëmbajtjes; dhe
- (ii) ka një Efekt Material tek GenCo.

“Ndryshim në Cilësinë e Ujit të Papërpunuar” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë. “Dokumentet Statutore” - Sa i përket ndonjë subjekti të veçantë:

- (a) të gjitha dokumentet organizative dhe qeverisëse, duke përfshirë të gjitha dokumentet e aprovuara ose të paraqitura në lidhje me krijimin, formimin ose organizimin e një subjekti të tillë;
- (b) të gjitha marrëveshjet e aksionarëve, marrëveshjet e votimit, marrëveshjet e besimit të votimit, marrëveshjet e kompanive, marrëveshjet operative, marrëveshjet e sipërmarrjeve të përbashkëta, marrëveshjet për të drejtat e regjistrimit ose marrëveshjet të ngjashme; dhe
- (c) çdo ndryshim ose shtesë në ndonjë nga të mësipërmet.

“Sistemi i Kontrollimit të Njehsimit” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Praktikë Shtrenguese” – Pengimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të penguar ose dëmtuar drejtpërdrejt ose tërthorazi çdo Person ose pronë të Personit për të ndikuar në mënyrë të parregullt në veprimet e një Personi;

“Praktikë Konspirative” – Çdo marrëveshje ndërmjet dy (2) ose më shumë Personave e hartuar për të arritur një qëllim të pahijshëm, duke përfshirë ndikimin e pahijshëm në veprimet e një pale tjetër;

“Data e Operacioneve Komerciale” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë. “Fondi për Zhvillim të Komunitetit” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 10.1.

“Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit” - Paneli i përbërë nga përfaqësues të QK-së dhe GenCo që përzgjedh projektet e zhvillimit që do të financohen nga Fondi për Zhvillim të Komunitetit, dhe kontrollon Fondin për Zhvillim të Komunitetit dhe aktivitetet e lidhura në kuadër të Procedurave për Zhvillim të Komunitetit. QK-ja mund të ftojë përfaqësues të qeverive lokale dhe organizatave joqeveritare që të vëzhgojnë aktivitetet e panelit.

“Procedurat për Zhvillim të Komunitetit” - Procedurat për operimin e Fondit për Zhvillim të Komunitetit që duhet të dakordohen ose finalizohen sipas Seksionit 10.4.

“Marrëveshja e Kyçjes” - Marrëveshja me atë emër ndërmjet GenCo-së dhe KOSTT-it që mban datën e Datës së Ekzekutimit (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Kyçjes).

“Fusha e Kyçjes” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 3.5.1(b)(i).

“Pika e Kyçjes” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Pëlqimi” - Të gjitha aprovimet, pëlqimet, autorizimet, njoftimet, koncesionet, pranimet, licencat, lejet, vendimet ose gjërat e ngjashme që kërkohen nga çdo Autoritet Publik me juridiksion mbi Projektin Kosova e Re sipas çdo ligji të Kosovës për secilin ose të gjithë nga GenCo, Huadhënësit, Sponsori HoldCo, Sponsori Sipëror dhe Kontraktorët e GenCo-së në lidhje me Projektin Kosova e Re.

“Periudha e Ndërtimit” - Periudha që fillon në datën e Mbylljes Financiare dhe mbaron në Datën e

Operacioneve Komercale.

"Data e Fillimit të Ndërtimit" - Data e lëshimit të "njoftimit të plotë për procedim" nga GenCo tek Kontraktori i IPN-së dhe përmbushja e të gjitha kushteve të tjera që paraprijnë detyrimin e Kontraktorit të IPN-së për të filluar ndërtimin e Objektivit të TCKR-së.

"Kontratat e Ndërtimit/Mirëmbajtjes" - Kontrata e IPN-së, Marrëveshja e MAGJ-së, Kontrata e OM-së, Kontrata e Punimeve të Kyçjes së GenCo-së, Kontrata e Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara dhe Marrëveshja e Shërbimeve Administrative (siç përcaktohen në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë), kolektivisht.

"Kontraktorët" - Kontraktorët e drejtpërdrejtë të secilës prej Palëve dhe cilido prej nënkontraktorëve të tyre të drejtpërdrejtë, në secilin rast, që janë të përfshirë në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, një Kontrate të Ndërtimit/Mirëmbajtjes ose ndonjë aktiviteti që lidhet me Projektin Kosova e Re.

"Praktikë Korruptive" – Ofrimi, premtimi, aprovimi, dhënia, marrja ose kërkimi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, i çdo gjëje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të parregullt në veprimet e një pale tjetër;

"Doganat" - Agjencia e QK-së përgjegjëse për grumbullimin e Detyrimeve Doganore dhe lirim të makinerive dhe pajisjeve të impiantit pas importit në ose para eksportit jashtë Kosovës.

"Detyrimet Doganore" - Të gjitha Tatimet (përveç tatimit mbi vlerën e shtuar) në lidhje me importin në ose eksportin nga Kosova të mallrave, të vendosura nga ndonjë Autoritet Publik.

"Dita" - Një periudhë prej njëzet e katër (24) orësh, duke filluar në orën 00:00 të çdo dite, dhe "Ditore" do të interpretohet njësoj.

"Llogaria e Rezervës së Shërbimit të Borxhit" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë. "Ngjarje e Konsideruar e Kurdisjes së GenCo-së" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit. "Ngjarje e Konsideruar e Kurdisjes së QK-së" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit.

"Kostot e Zhvillimit" - Nënkupton kostot dhe shpenzimet (me përjashtim të Përrjashtimeve Tarifore) nga dhe pas 1 janarit 2016, të shkaktuara ose të rimbursuara nga GenCo, Sponsorin HoldCo, Sponsorin Sipëror ose ndonjë nga Filialet e tyre në lidhje me zhvillimin ose menaxhimin e projektit të Objektivit të TCKR-së (përfshirë Asetet e Kyçjes së GenCo-së) deri në Mbylljen Financiare, përfshirë këtu:

- (a) tarifatat dhe shpenzimet e këshilltarëve dhe konsulentëve dhe kontraktorëve të tjerë për GenCo, Sponsorin HoldCo, Sponsorin Sipëror, ose ndonjë nga Filialet e tyre, të lidhura me të gjitha dokumentet e projektit, korporatën dhe Dokumentet e Financimit, përfshirë Marrëveshjet e Projektit, Kontratat e Ndërtimit/Mirëmbajtjes, dhe Dokumentet e Financimit;
- (b) tarifatat dhe shpenzimet e firmave inxhinierike të punësuar nga GenCo, Sponsorin HoldCo, Sponsorin Sipëror ose ndonjë nga Filialet e tyre në lidhje me zhvillimin e Objektivit të TCKR-së dhe Aseteve të Kyçjes së GenCo;
- (c) kostot dhe shpenzimet që lidhen me administrimin e Tenderit (Impianti) dhe prokurimin e Kontratave të Ndërtimit/Mirëmbajtjes;
- (d) kostot dhe shpenzimet e bëra për prokurimin e Pëlqimeve të GenCo-së;
- (e) kostot dhe shpenzimet që lidhen me zhvillimin e Politikës së Tenderit të Amoniakut, Derivatit të Naftës dhe Gurit Gëlqeror (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë);
- (f) kostot dhe shpenzimet që lidhen me zhvillimin e Modelit të Kërkesës për Derivat;
- (g) kostot dhe shpenzimet që lidhen me dorëzimin e analizës së potencialit për ko-gjenerim në Objektivin e TCKR-së në pajtim me Nenin 17 të Ligjit për Energji, 2016;

- (h) kostot dhe shpenzimet që lidhen me zhvillimin e Raportit për Blerjen e Tokës;
- (i) çdo kosto dhe shpenzim për kryerjen e studimeve të kërkuara nga Kodi i Rrjetit ose Marrëveshja e Kyçjes ose përndryshe në lidhje me kyçjen e Objektivit të TCKR-së në Rrjetin e KOSTT;
- (j) kostot dhe shpenzimet e menaxhimit të ndërtimit;
- (k) dizajnimin dhe zbatimin e programit të marrëdhënieve me publikun të GenCo-së dhe menaxhimin e marrëdhënieve me Autoritetet Publike;
- (l) dizajnimin, zbatimin dhe vlerësimin e çdo trajnimi për shëndetin dhe sigurinë;
- (m) prokurimin dhe instalimin e çdo mobiljeje zyre dhe dekorimeve të brendshme;
- (n) të gjitha kostot dhe shpenzimet e tjera të menaxhimit të projektit, duke përfshirë çdo kosto për shërbimet administrative të ofruara nga GenCo ose ndonjë nga Filialet e veta në lidhje me Projektin Kosova e Re, të cilat janë të zakonshme për GenCo-në ose Filialin e vet në lidhje projekte të ngjashme me Projektin Kosova e Re;
- (o) kostot e lëshimit të Sigurimit të Financimit (dhe bono e ofertës e lëshuar para Datës së Ekzekutimit);
- (p) kostot e shkaktuara për përgatitjen e VNMS (GenCo);
- (q) kostot e punës (duke përfshirë përfitimet) për secilin nga këto, por duke mos përfshirë shpenzimet e përgjithshme të alokuara ose shpenzimet e zyrës në shtëpi;
- (r) pagesat e financimit, zotimit dhe letrës së kredisë në lidhje me Sigurimin e Ndërtimit (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) që duhet të paguhet tek Huamarrësit në përputhje me Dokumentet e Financimit dhe çdo tarifë dhe shpenzim tjetër të ngjashëm të bërë sipas Dokumenteve të Financimit, duke përfshirë çdo Tarifë të Para-Financimit;
- (t) kostot nga xhepi dhe shpenzimet e Huadhënësve (përfshirë këshilltarët e tyre ligjorë, financiarë dhe teknikë);
- (t) të gjitha pagesat që duhet t'i paguhet KOSTT-it në pajtim me Marrëveshjen e Kyçjes;
- (u) fondet e depozituara nga Sponsorit HoldCo (ose Pala e Sponsorit HoldCo) në Fondin për Zhvillim të Komunitetit sipas Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit dhe nga GenCo në pajtim me Seksionin 10.1;
- (v) Kostot e Blerjes së Tokës (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë);
- (w) çdo kosto, tarifë dhe shpenzim që lidhet me një garanci të lëshuar nga një anëtar i Grupit të Bankës Botërore në lidhje me Projektin Kosova e Re;
- (x) çdo prim të sigurimit të pagueshëm në lidhje me një policë të sigurimit të rrezikut politik të lëshuar nga Agjencia e Garancisë të Investimeve Shumëpalëshe (ose ndonjë policë tjetër e sigurimit të rrezikut politik e aprovuar nga KEKR dhe QK-ja);
- (y) të gjitha tarifat, kostot dhe shpenzimet që lidhen me regjistrimin e Marrëveshjes së Qiradhënies;
- (z) të gjitha kostot, tarifat dhe shpenzimet që lidhen me dhënien efekt të të drejtave të KEKR-së në lidhje me të Drejtat e Reduktimit të Emetimeve (siç përcaktohen në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë), në përputhje me Marrëveshjen për Blerje të Energjisë;
- (aa) të gjitha kostot dhe shpenzimet që rrjedhin nga bashkëpunimi ose ofrimi i shërbimeve të konsulencës ose asistencës së ngjashme të GenCo-së për QK-në ose Mihjen e KEK-ut në lidhje me përpjekjet e QK-së ose Mihjes së KEK-ut për të ndërmarrë ndonjë veprim korigjues në lidhje me pajtueshmërinë e Mihjes së KEK-ut me Standardet e Zbatueshme në lidhje me pronësinë e Mihjes së KEK-ut, zhvillimin (duke përfshirë edhe zhvendosjen) dhe operimi i Fushës Jugore të Mihjes në Sibovc dhe i Aseteve të Mihjes; dhe

(bb) Kostot Zhvillimore të Para-aprovuara të Fazës së Hershme (siç përcaktohen në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë),

me kusht që, sidoqoftë, Kostot e Zhvillimit të mos përfshijnë Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së ose ndonjë kosto ose shpenzim që janë Përfshirje Tarifore.

“Kufiri i Kostove të Zhvillimit” - Do të thotë nëntëmbëdhjetë milionë e shtatëqind mijë euro (19,700,000.00 Euro) ose shuma të tjera të tilla që mund të pranohen reciprokisht nga Palët.

“Marrëveshje e Drejtëpërdrejtë” - Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe agjentëve ose administratorëve të Huadhënësve që përfshijnë kushtet dhe afatet e përcaktuara në Seksionin 3.4.3(a).

“Kontest” - Çdo kontest, mosmarrëveshje, kundërtënie ose dallim ndërmjet Palëve që rrjedhin nga, ose në lidhje me këtë Marrëveshje, duke përfshirë çdo kontest, mosmarrëveshje, kundërtënie ose ndryshim në lidhje me ekzistencën, ligjshmërinë, vlefshmërinë ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje ose performancën apo shkeljen nga një Palë sipas ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje, dhe gjithashtu duke përfshirë çdo kontest, mosmarrëveshje, kundërtënie ose dallim ndërmjet Palëve, çdo NP-je të Specifikuar, Sponsorit HoldCo ose Sponsorit Sipëror në lidhje me detyrimet jo kontraktuale që lindin nën, nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje.

“Plani i Menaxhimit të MS-së” - Çdo plan menaxhimi mjedisor dhe social i përgatitur në përputhje me standardet e zbatueshme nga ose në emër të GenCo (ose inkorporuar nga ose në emër të GenCo nga një plan i përgatitur nga palët e tjera) sipas dhe në përputhje me VNMS-në GenCo).

“Politika Mjedisore dhe Sociale e BERZH” - Politika Mjedisore dhe Sociale e publikuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, në dispozicion në Datën e Ekzekutimit (në varësi të zhvendosjes së ardhshme) në <http://www.ebrd.com/downloads/research/policies/2008policy.pdf> ose versioni i tillë i mëvonshëm që kërkohet të plotësohet nga çdo Huadhënës sipas Dokumenteve të Financimit.

“Data e Hyrjes në Fuqi” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 2.1.

“Barra” - Çdo kredi hipotekare, zotim, interes i sigurisë, barrë, ngarkesë, kërkesë, kusht, interes ekuiteti, opSION, e drejtë e rrugës, leje shërbimesh, qiramarrje, përdorim, servitut, kufizim, e drejtë e opSIONIT të parë, e drejtë e refuzimit të parë, ose ndonjë barrë ose kufizim tjetër i çfarëdo lloji, ose ndonjë kontratë me shitje të kushtëzuar, kontratë për mbajtjen e titullit, ose kontratë tjetër që zbaton ndonjë nga këto.

“

“Çmimi i Blerjes në Fund të Afatit” - Ka kuptimin e dhënë në Kalendarin 3.

“Kusht Arkeologjik/Mjedisor” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Kusht Mjedisor” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Periudha e Dëmshtëpërblimit Mjedisor” - Mjetet, (a) në lidhje me çdo papajtueshmëri me Standardet Mjedisore në lidhje me Kushtet e Specifikuara Mjedisore/Arkeologjike (siç përcaktohen në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) ose Kushtet Ekzistuese Mjedisore/Arkeologjike të renditura në Kalendarin 8 (*Kushtet e Njohura Ekzistuese Mjedisore/Arkeologjike dhe Kushte të Tjera Potenciale Ekzistuese Mjedisore/Arkeologjike*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë (në masën që lidhet me kushtet e përshkruara në një kalendar të tillë si *Kushtet e Njohura Ekzistuese Mjedisore/Arkeologjike*), periudha nga Data e Bartjes deri në tri (3) Vite të Marrëveshjes (siç është përcaktuar në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) nga Data e Bartjes ose (b) në lidhje me çdo papajtueshmëri me Standardet Mjedisore në lidhje me Kushtet e tjera Mjedisore/Arkeologjike (përfshirë kushtet e përshkruara në Kalendarin 8 (*Kushtet e Njohura Ekzistuese Mjedisore/Arkeologjike dhe Kushte të Tjera Potenciale Ekzistuese Mjedisore/Arkeologjike*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, si Kushte potenciale Ekzistuese Mjedisore/Arkeologjike), tri (3) Vite të Marrëveshjes (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) nga fundi i Vitit të Marrëveshjes (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) në të cilën u zbulua Kushti i tillë Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik dhe masat e tjera të sanimit ose kurimit duhej

të ndërmerreshin sipas Standardeve të Zbatueshme Mjedisore dhe në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; me kusht që, sidoqoftë, në rast se papajtueshmëria e tillë nuk mund të zgjidhet në mënyrë të arsyeshme, ose nuk është e nevojshme të zgjidhet në pajtim me Standardet e Zbatueshme Mjedisore dhe përndryshe në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, brenda tri (3) Viteve të Marrëveshjes nga Data e Bartjes ose zbulimi i papajtueshmërisë së tillë, siç mund të jetë rasti, atëherë periudha e tillë do të zgjatet siç do të jetë e arsyeshme dhe e nevojshme për të ndërmarrë dhe kompletuar masat sanuese ose kuruese të tjera që kërkohen të ndërmerren në përputhje me Standardet e Zbatueshme Mjedisore dhe në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë.

“Standarde Mjedisore” - Lidhur me çdo Palë, kolektivisht, në lidhje me pjesëmarrjen e Palës së tillë në Projektin Kosova e Re dhe vetëm në masën e zbatueshme për atë Palë ose Projektin Kosova e Re,

- (a) komponentët mjedisorë të Planit të Menaxhimit të MS-së;
- (b) standardet mjedisore të përcaktuara në Politikat e Masave Mbrojtëse Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore;
- (c) standardet mjedisore të përcaktuara në Udhëzimet e MSHS-së së Grupit të Bankës Botërore;
- (d) standardet mjedisore të përcaktuara në Standardet e IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale;
- (e) standardet mjedisore të përcaktuara në Politikën e MIGA-s mbi Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore;
- (f) standardet mjedisore të përcaktuara në Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it; dhe
- (g) kërkesat e vendosura nga çdo ligj i Kosovës në lidhje me mjedisin dhe mbrojtjen dhe ruajtjen e tij,

me përjashtim të masës që dispozitat e parashtruara në dy ose më shumë nga të mësipërme janë të tilla që një Palë e tillë nuk mund të jetë në pajtim në të njëjtën kohë me dispozitat e tilla, dhe në këtë rast rendi i standardeve të renditura më lart është rendi i përparësisë, dhe dispozitat përkatëse të standardit përkatës më të ulët (ose standardeve, nëse është e nevojshme) nuk do të zbatohen në masën e nevojshme për të mundësuar që kjo Palë të jetë në pajtim me standardin më të lartë. Për shmangien e dyshimit, asgjë këtu nuk do të zvogëlojë detyrimin e një Pale për të përmbushur standardet më të rrepta të mësipërme.

“Çmimi i Blerjes i Ndërprerjes Mjedisore” - Ka kuptimin e dhënë në Kalendarin 3.

“Kontrata e IPN-së” - Marrëveshja me çelësa në dorë dhe çmim fiks e lidhur ose që do të lidhet ndërmjet GenCo dhe Kontraktorit të IPN-së për projektimin, inxhinierinë, prokurimin, ndërtimin, kompletimin, ndezjen, testimin dhe komisionimin e Objektivit të TCKR-së nga Kontraktori i IPN-së, siç mund të ndryshohet nga Palët kohë pas kohe.

“Kontraktori i IPN-së” - Kontraktori ose Kontraktorët e caktuar nga GenCo për kryerjen e Punimeve të IPN-së sipas Tenderit (Impianti) dhe çdo pasardhës të tij.

“Punimet e IPN-së” - Projektimi, inxhinieria, prokurimi, ndërtimi, instalimi dhe kompletimi i Objektivit të TCKR-së, dhe ndezja, testi dhe komisionimi (siç përcaktohen në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) i Objektivit të TCKR-së.

“ZRRE” - Zyra e Rregullatorit për Energji, dhe çdo agjenci rregullatore pasardhëse ose zëvendësuese me autorizim dhe juridiksion mbi sektorin e energjisë në Kosovë.

“VNMS (GenCo)” - Një vlerësim i ndikimit mjedisor dhe social që ka të bëjë me Projektin Kosova e Re, i kryer nga ose në emër të GenCo në përputhje me Ligjet e Kosovës, Standardet e Zbatueshme dhe kërkesat e Huadhënësve.

“Euro” ose “€” - Monedha e vetme e shteteve anëtare pjesëmarrëse të Bashkimit Evropian. “Data e Ekzekutimit” - Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Data e Tërheqjes Përfundimtare” - Ka kuptimin e dhënë Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Mbyllja Financiare” - Në lidhje me Financimin Fillestar, ekzekutimin dhe dorëzimin e Dokumenteve të Financimit dhe përmbushjen e të gjitha kushteve paraprake për disponueshmërinë fillestare të fondeve sipas Dokumenteve të Financimit (përveç rastit të Datës së Bartjes sipas Marrëveshjes së Bartjes së Lokacionit), duke përfshirë të gjitha kushtet paraprake që kërkojnë prova të angazhimeve për një ekuitet të tillë siç kërkohet nga GenCo për të përmbushur kërkesat e Huadhënësve.

“Dokumentet të Financimit” - Marrëveshjet e huasë dhe të gjitha shënimet përkatëse, indenturat, marrëveshjet e sigurisë, garancitë, marrëveshjet ose instrumente të tjera që ofrojnë siguri për Huadhënësit (duke përfshirë pëlqimet dhe pranimet e caktimit dhe marrëveshjet e drejtpërdrejta në lidhje me dokumentet e dhëna si garanci për Huadhënësit), të gjitha marrëveshjet e lidhura me garancinë e Grupit të Bankës Botërore ose të lidhura me sigurimet, marrëveshjet e shkëmbimit të normave të interesit që kanë të bëjnë me financimin e Projektit Kosova e Re dhe dokumentet e tjera të nënshkruara nga GenCo dhe ndonjë nga Filialet e tij në lidhje me financimin e Projektit Kosova e Re ose ndonjë pjesë materiale të tij, duke përfshirë çdo linjë të mbështetjes së kredisë ose Linjë të Kapitalit Punues (dhe nëse ndonjë nga të ardhurat e marrëveshjeve të huasë ose dokumente të tjera që lidhen me "Dokumentet e Financimit" janë në huazim nga një Filial i GenCo për GenCo në lidhje me Projektin Kosova e Re, duke përfshirë çdo dokument të tillë të lidhur nga huamarrësi dhe GenCo), siç mund të ndryshohen herë pas here marrëveshja, instrumentet, garancitë dhe dokumentet e tilla. Për shmangien e dyshimit, Dokumentet e Financimit përfshijnë Dokumentet e Financimit të lidhura për Financimin Fillestar dhe çdo Rifinancim, por nuk përfshijnë asnjë Kredi Aksionare.

“Siguria e Financimit” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit.

“Ngjarje e Forcës Madhore” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 21.1.1.

“Ndërprerja e Detyruar ose Ndërprerja e Pjesshme e Detyruar” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Sponsor i Huaj” - Çdo Person me Interes Pronësie në GenCo, herë pas here, që nuk është i organizuar dhe me banim në Kosovë.

“Praktikë Mashtruese” – çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë keqpërfaqësimin, që me vetëdije ose pakujdesi mashtron ose përpiqet të mashtrtojë një Person për të marrë përfitime financiare ose përfitime të tjera ose për të shmangur një detyrim.

“Modeli i Kërkesës për Derivat” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Raporti i Plotë i Sanimit Mjedisor” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“GenCo” - Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Veprimi ose Mosveprimi i GenCo-së” - Veprimi ose mosveprimi i GenCo-së ose i ndonjë Pale të GenCo-së, i cili si veprim ose mosveprim përbën një shkelje materiale ose mospërmbushje të detyrimeve të GenCo-së sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë Marrëveshjeje të Projektit në të cilën ajo është palë, ose përbën një shkelje materiale të Ligjeve të Kosovës nga GenCo ose ndonjë Palë e GenCo-së dhe që si veprim apo mosveprim ka një efekt material negativ ndaj QK-së ose në ndonjë aftësi të NP-së të Specifikuar për të përmbushur detyrimet e veta ose për të ushtruar të drejtat e veta sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë Marrëveshjeje të Projektit; me kusht që, sidoqoftë, asnjë veprim ose mosveprim i tillë nuk do të konsiderohet një veprim ose mosveprim i GenCo-së nëse veprimi ose mosveprimi i tillë është shkaktuar pjesërisht ose për një pjesë të rëndësishme nga një Veprim apo Mosveprim i një NP-je të Specifikuar.

“Përfaqësimi dhe Garancia e Pajtuëshmërisë së GenCo-së” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 17.1.

“Asetet e Kyçjes së GenCo-së” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Punimet e Kycjes së GenCo-së” - Ato punime dhe aktivitete të përshkruara në Marrëveshjen e Kycjes që do të ndërmerren nga ose në emër të GenCo për projektimin, inxhinierinë, ndërtimin, instalimin dhe komisionimin e Aseteve të Kycjes së GenCo, Aseteve të Kycjes së Re të KOSTT-it ose Aseteve për Përforcimin e Infrastrukturës.

“Kontrata e IPN-së e Punimeve të Kycjes së GenCo-së” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Kontraktori i IPN-së i Punimeve të Kycjes së GenCo-së” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Pëlqimet e GenCo-së” - Të gjitha Pëlqimet (duke përfshirë Licencën e Gjenerimit) që GenCo apo ndonjë nga Kontraktorët e GenCo-së duhet ta marrë (përveç nga KEKR) dhe më pas ta ruajë për të përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje; me kusht që, sidoqoftë, në asnjë rast Pëlqimet e GenCo-së nuk do të përfshijnë ndonjë lëshim ose përjashtim nga Ligjet e Kosovës, përveç nëse ato janë dhënë shprehimisht në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje ose nga një Autoritet tjetër Publik në përputhje me Ligjet e Kosovës.

“Kontraktori i GenCo-së” - Kontraktori i IPN-së, Kontraktori i MAGJ-së, Kontraktori i OM-së, Kontraktori i IPN-së i Punimeve të Kycjes së GenCo-së, Kontraktori i Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Kontraktori i Shërbimeve Administrative (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) dhe cilido nga Kontraktorët e tjerë të GenCo-së të përfshirë në Projektin Kosova e Re, duke përjashtuar ndonjë NP të Specifikuar.

“Çmimi i Blerjes i Mospërmbushjes nga GenCo-ja” - Ka kuptimin e dhënë në Kalendarin 3. “Ngjarje e Mospërmbushjes nga GenCo-ja” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 19.1.

“Deponia Ekskluzive e Hirit e GenCo-së” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsit.

“Deponia Ekskluzive e Gipsit e GenCo-së” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Deponimit të Hirit dhe Gipsit.

“Pala e GenCo-së” - Një aksionar, drejtor, zyrtar, punonjës, Kontraktor i GenCo-së, përfaqësues, agjent, anëtar, menaxher, ose Filial i GenCo-së.

“Licenca e Gjenerimit” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“QK” – Ka kuptimin e dhënë në paragrafin hyrës.

“Kufiri i Tarifës për Këshilltarin e QK-së” - Për shpenzimet e bartura:

- (a) ndërmjet Datës së Ekzekutimit dhe Mbylljes Financiare, tetë milion euro (8,000,000.00 €); dhe
- (b) ndërmjet Datës së Ekzekutimit dhe më të hershmes mes (i) datës që është dymbëdhjetë (12) Muaj pas Datës së Tërheqjes Përfundimtare dhe (ii) datës që Krediti përfundimtar i Disponueshmërisë Bazë (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) për periudhën e parë ½ Vjetore të Vitit të parë të Marrëveshjes (siç përcaktohen termat e tillë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) përcaktohet në përputhje me afatet e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, dymbëdhjetë milionë euro (12,000,000.00 Euro),

që në çdo rast do të shërbejë si kufiri për Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së.

“Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja” - Firma (ose firmat) e konsulentëve inxhinierikë që do të emërohen nga QK-ja në përputhje me Seksionin 3.9.

“Përfaqësimi dhe Garancia e Pajtueshmërisë së QK-së” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 17.2.

“Çmimi i Blerjes i Mospërmbushjes nga QK-ja” - Ka kuptimin e dhënë në Kalendarin 3.

“Ngjarje e Mospërmbushjes nga QK-ja” – Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 19.2.

“Interesat e Linjtit të QK-së” - i referohet kolektivisht interesave të QK-së në Marrëveshjen për Furnizim me Linjit, të përshkruar në Seksionin 3.13.1.

“Pala e QK-së” - Një punonjës, përfaqësues, agjent ose zyrtar i QK-së.

“Garancia e Qeverisë” - Garancia e lëshuar në favor të GenCo-së në formën e Kalendarit 2.

“Kodi i Rrjetit” – Kodi i rrjetit i përgatitur nga KOSTT dhe aprovuar nga ZRRE në fuqi në Datën e Ekzekutimit, në dispozicion në http://www.kostt.com/website/index.php?option=com_content&view=article&id=543&Itemid=481&lang=en.

“Detyrimet e Garantuara” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 1.1(b) të Kalendarit 2.

“Materiale të Rrezikshme” - Çdo material kontaminues, mbetje të ngurta, produkt hidrokarburesh, substancë ose mbetje toksike ose të rrezikshme, çdo material i ndezshëm, eksploziv ose radioaktiv i rregulluar sipas, ose subjekt i çdo Standardi Mjedisor.

“Standardet e Shëndetit dhe Sigurisë” - Në mënyrë kolektive, në lidhje me pjesëmarrjen e GenCo-së në Projektin Kosova e Re, vetëm dhe në masën e zbatueshme për Projektin Kosova e Re, kërkesat e vendosura nga:

- (c) standardet e shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara në Udhëzimet e MSHS-së së Grupit të Bankës Botërore;
- (b) standardet e shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara në Standardet e IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale;
- (c) standardet e shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara në Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it; dhe
- (d) çdo ligj i Kosovës në lidhje me sigurinë dhe shëndetin në punë,

me përjashtim të masës që dispozitat e parashtruara në dy ose më shumë nga të mësipërme janë të tilla që GenCo nuk mund të jetë në pajtim në të njëjtën kohë me dispozitat e tilla, dhe në këtë rast rendi i standardeve të renditura më lart është rendi i përparësisë, dhe dispozitat përkatëse të standardit përkatës më të ulët (ose standardeve, nëse është e nevojshme) nuk do të zbatohen në masën e nevojshme për të mundësuar që kjo Palë të jetë në pajtim me standardin më të lartë. Për shmangien e dyshimit, asgjë këtu nuk do të zvogëlojë detyrimin e një Pale për të përmbushur standardet më të rrepta të mësipërme.

“HMT” - Thesari i Madhërisë së Saj (i Mbretërisë së Bashkuar).

“Rregullat e IBA-s” - Rregullat e IBA-s për Marrjen e Dëshmime në Arbitrazhin Ndërkombëtar (2010), siç mund të ndryshohen ose plotësohen herë pas here.

“Rregullat e ICC-së” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 22.5(c).

“ICSID” - Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve. “Konventa e ICSID-së” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 22.5(a). “Rregullat e ICSID-së” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 22.5(a).

“Standardet e IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale” - Standardet e IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale të publikuara nga Korporata Financiare Ndërkombëtare, të disponueshme në Datën e Ekzekutimit (në varësi të zhvendosjes së ardhshme) në http://www1.ifc.org/wps/wcm/connect/c8f524004a73daeca09afdf998895a12/IFC_Performance_Standards.pdf?MOD=AJPERES ose versioni i tillë i mëvonshëm që kërkohet të plotësohet nga çdo Huadhënës sipas Dokumenteve të Financimit.

“Pranimi i Dëmshpërblimit” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 5.4.1(c) të Kalendarit 5. “Njoftim për Dëmshpërblim” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 5.4.1(a) të Kalendarit 5.

“Shporta e Dëmshpërblimit” - Nënkupton (i) në lidhje me GenCo ose Palët e GenCo ose Sponsorin HoldCo ose Palët e Sponsorit HoldCo dhe Sponsorin Sipëror ose Palët e Sponsorit Sipëror, shumë e Humbjeve të barabartë me 250,000 € si një shumë e kombinuar e zbatueshme për të gjitha palët e tilla në lidhje me të gjitha Marrëveshjet e Projektit; dhe (ii) në lidhje me QK-në ose Palët e QK-së dhe KEKR ose Palët e KEKR dhe Gjenerimin e KEK-ut ose Palët e Gjenerimit të KEK-ut dhe Mihja e KEK-ut ose Palët e Mihjes së KEK-ut dhe Furnizuesi i Ujit ose Palët e Furnizuesit të Ujit dhe çdo NP e Specifikuar ose Palë të saja të lidhura, shumë e Humbjeve të barabartë me 250,000 € si një shumë e kombinuar e zbatueshme për të gjitha palët e tilla në lidhje me të gjitha Marrëveshjet e Projektit.

“Konsulent i Pavarur i MS-së” - Një konsulent mjedisor dhe social i punësuar sipas Seksionit 3.10 të Marrëveshjes së Zbatimit dhe me detyrat e përcaktuara në Seksionin 4.3 (*Detyrat e Konsulentit të Pavarur të MS-së*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë.

“Asetet për Përforcimin e Infrastrukturës” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Kyçjes.

“Financimi Fillestar” - Do të thotë borxhi financiar i bartur nga GenCo ose filialet e veta në datën e Mbylljes Financiare në lidhje me Projektin Kosova e Re.

“Prona Fillestare” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Qiradhënies.

“Gjenerimi i KEK-ut” - Korporata Energjetike e Kosovës, SH.A., një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me zyrën e vet kryesore në Nënë Tereza nr. 36, Prishtinë, Kosovë, dhe numër regjistrimi të biznesit 70325399, që vepron përmes njësisë së saj të biznesit përgjegjëse për kapacitetin gjenerues.

“Pala e Gjenerimit të KEK-ut” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit.

“Mihja e KEK-ut” - Korporata Energjetike e Kosovës, SH.A., një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me zyrën e vet kryesore në Nënë Tereza nr. 36, Prishtinë, Kosovë, dhe numër regjistrimi të biznesit 70325399, që vepron përmes njësisë së saj të biznesit përgjegjëse për mihjen.

“Pala e Mihjes së KEK-ut” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Furnizim me Linjit.

“KESCO” - Kompania Kosovare e Furnizimit me Energji Elektrike SH.A., një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me zyrën e vet kryesore në Bulevardi Bill Clinton Nr. 3, Prishtinë, Kosovë, dhe numër regjistrimi të biznesit 70606119.

“Kosova” – Republika e Kosovës.

“Projekti Kosova e Re” - Ka kuptimin e dhënë në recitale.

“KOSTT” - "OPERATOR SISTEMI, TRANSMISIONI DHE TREGU - KOSTT" SH.A., një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me zyrën e vet kryesore në Rr. Isa Boletini Nr. 39 1000, Prishtinë, Kosovë, dhe numrin e regjistrimit të biznesit 70325350, ose pasardhësi i tij në interes në rast se KOSTT pushon të kryejë ndonjë nga funksionet e OSTT (siç përcaktohet ky term në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) sipas Kodit të Rrjetit.

“Rrjeti i KOSTT-it” – Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Kyçjes.

“Objekti i TCKR-së” - Objekti i gjenerimit të energjisë elektrike me linjit që do të vendoset në Obiliq, Kosovë, siç përshkruhet më shumë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Raporti i Blerjes së Tokës” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 3.5.1(b)(i). “Skadimi i Pëlqimit” - Çdo Pëlqim i GenCo:

- (a) që nuk është lëshuar, ripërtërirë, zëvendësuar ose, pasi ka skaduar, nuk është ripërtërirë ose zëvendësuar (brenda një periudhe të caktuar nëse kërkohet sipas ligjeve të Kosovës ose përndryshe brenda në periudhe të arsyeshme kohore) pas aplikimit të duhur, në kohë dhe të zbatuar me zell nga GenCo për atë Pëlqim që do të lëshohet, ripërtërihet ose zëvendësohet, sipas rastit, dhe si rezultat i kësaj, aftësia e GenCo-së për të realizuar detyrimet e veta sipas Marrëveshjeve të Projektit ose Kontratave të Ndërtimit/Mirëmbajtjes, ndikohet materialisht dhe negativisht;
- (b) që i nënshtrohet, pas ripërtëritjes, rilëshimit ose zëvendësimit, çdo termi ose kushti që ndikon materialisht dhe negativisht në aftësinë e Palës për të përmbushur detyrimet e veta sipas Marrëveshjeve të Projektit ose Kontratave të Ndërtimit/Mirëmbajtjes; ose
- (c) që tërhiqet, anulohet, modifikohet ose pezullohet ndryshe nga sa parashikohet në ligjet jodiskriminuese të Kosovës dhe për rrjedhojë aftësia e GenCo-së për të përmbushur detyrimet e veta, sipas Marrëveshjeve të Projektit ose Kontratave të Ndërtimit/Mirëmbajtjes, preket materialisht dhe negativisht,

në secilin nga rastet e mësipërme, pavarësisht nga pajtueshmëria e Palës së tillë me kërkesat procedurale dhe thelbësore të zbatueshme në mënyrë jo-diskriminuese (siç shpjegohen në Seksionin 4.2.2).

“Ligjet e Kosovës” - Ligjet e Kosovës, si dhe të gjitha statutet, traktatet, kodet, urdhëresat, urdhrat, rregullat, rregulloret, urdhrat ekzekutivë, vendimet gjyqësore, njoftimet, vendimet, rregulloret dhe aktet nënligjore, apo direktivat e tjera të ngjashme të lëshuara nga çdo Autoritet Publik në përputhje me to, në çdo rast të zbatueshme për Palët, Projektin Kosova e Re, ose në lidhje me Marrëveshjen e Projektit, një Dokument Financimi ose një Kontratë të Ndërtimit/Mirëmbajtjes, dhe siç mund të ndryshohet, plotësohet, zëvendësohet, riinterpretohet ose modifikohet secila prej tyre nga Autoriteti Publik i Kosovës, herë pas here.

“Marrëveshja e Qiradhënies” - Marrëveshja e qiradhënies së Zonës së Kyçjes ndërmjet QK-së dhe GenCo, në thelb në formën e marrëveshjes së qiradhënies të bashkëngjitur si Kalendar 5.

“Huadhënës” - Çdo institucion financiar, trust, fond apo subjekt tjetër që merr pjesë në financimin e Projektit Kosova e Re dhe çdo agjent i tyre që është palë në Dokumentet e Financimit, apo ndonjë institucion financiar, trust, fond ose subjekt tjetër pjesëmarrës në financimin e Projektit Kosova e Re ose ndonjë nga agjentët e tyre që më pas bëhet palë në Dokumentet e Financimit, së bashku me pasardhësit dhe të caktuarit e tyre përkatës.

“Linjiti” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Furnizim me Linjit.

“Çmimi i Linjtit” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Furnizim me Linjit.

“Marrëveshja për Furnizim me Linjit” - Marrëveshja me atë emër mes Mihjes së KEK-ut dhe GenCo-së datuar në ose afër Datës së Ekzekutimit.

“Sponsor Lokal” - Çdo Person me Interes Pronësie në GenCo kohë, pas kohe, i cili nuk është Sponsor i Huaj.

“Humbje” - Çdo humbje, dëmtim, përgjegjësi, pagesë ose detyrim (duke përjashtuar ndonjë humbje, dëmtim, përgjegjësi, pagesë ose detyrim të tërthortë ose konsekuencial, përveç në rast se ndonjë nga të njëjtat lind nga ndonjë neglizhencë e madhe ose sjellje e keqe e qëllimshme e Palës dëmshpërblyese) dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet (përfshirë tarifën e arsyeshme ligjore) që lidhen me to.

“Marrëveshja e MAGJ-së” ose “MMAGJ” - Marrëveshja që duhet të lidhet nga GenCo dhe Kontraktori i MAGJ-së sipas Seksionit 3.9.5 (*Tenderi për Kontraktorin e IPN-së dhe Kontraktorin e MAGJ-së; Inputet e Tenderuara të MBE-së; Zëvendësimi i Kontraktorit të Ardhshëm të MAGJ-së*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, siç mund të ndryshohet nga palët herë pas here marrëveshja e tillë.

"Kontraktori i MAGJ-së" - Kontraktori ose Kontraktorët e emëruar nga GenCo në bazë të Tenderit (Impianti) për të kryer shërbime të mirëmbajtjes afatgjatë sipas Marrëveshjes së MAGJ-së.

"Ndërprerje e Mirëmbajtjes" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"Fondi i Rezervës për Mirëmbajtje Madhore" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"Nënkontraktor Madhor" - Çdo nënkontraktor ose furnizues i ndonjë Kontraktori të GenCo, vlera e nënkontratës ose e furnizimit të së cilit në lidhje me Projektin Kosova e Re e Re tejkalon ose

- (a) një vlerë totale të kontratës prej njëzet milionë eurosh (€ 20,000,000), ose
- (b) një vlerë mesatare vjetore të kontratës prej katër milionë eurosh (€ 4,000,000) në Vit për pesë Vjet ose më shumë.

"Rregullat e Tregut" - Rregullat e tregut të përgatitura nga KOSTT dhe të aprovuara nga ZRRE në fuqi në Datën e Ekzekutimit, në dispozicion në http://www.kostt.com/website/images/stories/PO-MO-001-The_market_rules_transition_1.pdf, ose ndonjë kod, rregulla ose instrumente të ngjashme që rregullojnë funksionimin e tregut të energjisë elektrike të Kosovës, për të cilat Palët bien dakord se nuk janë të zbatueshme për GenCo ose Projektin Kosova e Re sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit.

"Efekti Material për GenCo" - Një efekt material dhe negativ për:

- (a) GenCo ose aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e veta ose për të ushtruar të drejtat e veta ose për të realizuar përfitimet e plota (ekonomike ose jo) sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit, Kontratës së Ndërtimit/Mirëmbajtjes ose Dokumentit të Financimit;
- (b) zhvillimin, projektimin, ndërtimin, financimin, përdorimin, operimin, mirëmbajtjen ose performancën e Objektivit të TCKR-së;
- (c) interesat e Sponsorit HoldCo ose Sponsorit Sipëror ose kthimi në ose i investimit të tyre në lidhje me pjesëmarrjen e GenCo në Projektin Kosova e Re; ose
- (d) aftësinë e çdo homologu të ndonjë Marrëveshjeje të Projektit, Kontratës së Ndërtimit/Mirëmbajtjes, ose Dokumentit të Financimit, për të përmbushur detyrimet e veta.

"Memorandumi i Mirëkuptimit" - Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet QK-së dhe Sponsorit Sipëror, i datës 18 dhjetor 2015.

"Kodi i Njehsimit" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"Sistemi i Njehsimit" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"Politika e MIGA-s mbi Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore" - Politikat për Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore të publikuara nga Agjencia e Garancisë të Investimeve Shumëpalëshe, e disponueshme në Datën e Ekzekutimit (në varësi të zhvendosjes së ardhshme) në http://www.miga.org/documents/environ_social_review_021507.pdf ose versioni i tillë i mëvonshëm që kërkohet të plotësohet nga çdo Huadhënës sipas Dokumenteve të Financimit.

"Asetet e Mihjes" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Furnizim me Linjit.

"Ministria e Zhvillimit Ekonomik" - Ministria e Zhvillimit Ekonomik e QK-së ose, në rast se emri ose përgjegjësia e kësaj ministrie ndryshohet, ministria ose ministritë e QK-së të ngarkuara me përgjegjësinë për minierat dhe energjinë elektrike.

"Muaji" - Një muaj kalendarik sipas kalendarit gregorian.

"Produkti Elektrik Neto" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"KEKR" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Ngjarje e Mospërmbushjes nga KEKR-ja” – Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Pala e KEKR-së” – Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Precedenti i Kushtit Pa Defekte” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit.

“Kontrata e OM-së” - Marrëveshja e operimit dhe mirëmbajtjes e lidhur ose që do të lidhet mes GenCo-së dhe Kontraktorit të OM-së sipas Seksionit 3.14 (*Kontrata e OM-së*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, siç mund të ndryshohet marrëveshja e tillë nga palët herë pas here.

“Kontraktori i OM-së” - Një Filial i GenCo dhe Sponsorit Sipëror që do të formohet, ose ndonjë entitet pasardhës.

“Praktikat Penguese” - Secila nga:

- (a) shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja me qëllim e materialeve të provave për çdo hetim, ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, për të penguar çdo hetim në pretendimet për çdo Praktikë Shtrenguese, Praktikë Konspirative, Praktikë Korruptive, Praktikë Mashtruese ose Praktikë Penguese;
- (b) kërcënimi, ngacmimi ose frikësimi i ndonjë Personi për të parandaluar Personin e tillë që të zbulojë njohuritë e tij për çështjet që lidhen me ndonjë hetim të tillë ose për të kryer ndonjë hetim të tillë; ose
- (c) veprime që synojnë të pengojnë materialisht të drejtat ligjore ose kontraktuale të çdo Personi (duke përfshirë edhe Grupin e Bankës Botërore) për qasje në informata sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit.

“OFAC” - Zyra e Kontrollit të Aseteve të Huaj të Departamentit Amerikan të Thesarit.

“Ngjarje Tjetër e Forcës Madhore” – Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 21.1.2(d).

“Çmimi i Blerjes për Forcës Tjetër Madhore” - Ka kuptimin e dhënë në Kalendarin 3.

“Të Hyra të Tjera” - A ka kuptimin e dhënë në Kalendarin 1 (*Metodologjia për Vendosjen e Çmimit të Linjtit, Sasitë e Linjtit*) të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit.

“Interesi i Pronësisë” - Në lidhje me çdo korporatë, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ortakëri ose organizatë tjetër afariste, aksionet, interesat e pronësisë ose interesa të tjera të ngjashme në një organizatë të tillë biznesi me (i) të drejta votim ose të drejta të tjera të menaxhimit dhe kontrollit, ose (ii) pjesëmarrje ekuiteti në to dhe letrat me vlerë të një organizate të tillë biznesi që janë të konvertueshme në të njëjtën me opsionin e mbajtësit.

“Pala” dhe “Palët” - Kanë kuptimet e dhëna në paragrafin hyrës.

“Kusht Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Kontesti i Pagesës” - Kontest që lidhet me ndonjë detyrim të pagesës aktuale ose kontingjente (përveç atyre që lindin drejtpërdrejt nga një ndërprerje e kësaj Marrëveshjeje) që mund të lindin ndërmjet Palëve të lidhura me këtë Marrëveshje, që në çdo rast është lloji i problemit ose çështjes që është në mënyrë të arsyeshme e ndjeshme ndaj shqyrtimit dhe zgjidhjes nga një ekspert me përvojë përkatëse.

“Barrat e lejuara (GenCo)” - Nënkupton:

- (a) Barrat Ligjore për Tatimet ose ngarkesat e tjera qeveritare ose vlerësimet që nuk janë ende të pagueshme ose me vonesë ose vlefshmëria e të cilave po kontestohet në mirëbesim me procedura të përshtatshme;
- (b) zonimi, të drejtat, kufizimet mjedisore ose të konservimit dhe përdorime të tjera të tokës dhe rregulloret mjedisore të vendosura në Lokacion që ose janë në fuqi në Mbylljen Financiare ose nuk përbëjnë ose nuk kanë gjasa të arsyeshme të kenë një efekt material në secilën Palë ose QK-në;

- (c) izmentet e regjistruara ose të paregjistruara, të drejtat e rrugës, kufizimet, konventat, e drejta e përdorimit, licencat dhe çështje të tjera që prekin Lokacionin e parashikuar në Marrëveshjet e Projektit;
- (d) marrëveshjet dhe kufizimet e përcaktuara në çdo Marrëveshje të Projektit;
- (e) çdo Barrë në favor të një Autoriteti Publik që lind në rrjedhën e zakonshme të biznesit me veprimin e Ligjeve të Kosovës në lidhje me një detyrim që nuk është ende i pagueshëm ose që kontestohet në mirëbesim që janë (i) shënime publike ose të shpalosura për GenCo me shkrim nga QK-ja para Mbylljes Financiare, ose (ii) nuk përbëjnë ose nuk kanë gjasa të arsyeshme të kenë një efekt material në secilën Palë ose QK-në; dhe
- (f) ato papërsosmëritë e vogla të titullit dhe Barrave që në tërësi nuk janë substanciale në shumë, nuk e zvogëlojnë vlerën e pronës që i nënshtrohet atyre, ose dëmtojnë Lokacionin ose operacionet që janë të listuara në Kalendarin 2 të Marrëveshjes së Bartjes së Lokacionit, as nuk përbëjnë ose nuk kanë gjasa të arsyeshme të kenë një efekt material në QK-në.

“Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së” - Do të thotë pagesa të arsyeshme dhe të matura dhe shpenzime të caktuara të Inxhinierit të Pavarur të Emëruar nga QK-ja, ose të këshilltarëve teknikë, ligjorë, financiarë ose të transaksioneve të QK-së, sipas rastit, të shkaktuara ose të rimbursuara nga QK-ja në lidhje me zhvillimin, ndërtim, ose çështje të tjera në lidhje me Objektivin e TCKR-së, duke përfshirë negocimin e çdo ndryshimi në Marrëveshjet e Projektit të kërkuar nga GenCo-ja; me kusht që Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së nuk përfshijnë ndonjë nga këto që vijojnë: (i) çdo kosto dhe shpenzim që përndryshe do të përbëjë Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së nëse shumat e të gjitha pagesave të tilla sipas Nenit 16 të kësaj Marrëveshjeje ka arritur Kufirin e aplikueshëm të Tarifës për Këshilltarin e QK-së, (ii) çdo tarifë ose shpenzim që lind në përfaqësimin e QK-së ose të një NP-je të Specifikuar në lidhje me një kontest që është në arbitrazh sipas ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit, (iii) çdo shpenzim për dhurata ose zbavitje, ose (iv) çdo shpenzim për udhëtime, qëndrim apo ushqim që nuk është para-aprovuar me shkrim nga GenCo.

“Personi” - Çdo individ, korporatë, partneritet, sipërmarrje e përbashkët, asociacion, trust biznesi, organizatë e pa inkorporuar, Autoritet Publik, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose subjekt tjetër.

“Ngjarje e Forcës Madhore Politike” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 21.1.2(a).

“Marrëveshja për Blerje të Energjisë” - Marrëveshja me atë emër mes KEKR-së dhe GenCo-së datuar në ose afër Datës së Ekzekutimit.

“Padi për Procesin e Përzgjedhjes së Partnerëve të PPP-së” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 8.4.1 (a).

“Tarifat e Para-Financimit” - Do të thotë çdo tarifë e paguar nga GenCo ose nga Filialet e veta, siç është rënë dakord nga KEKR, për të eksportuar agjencitë e kreditit ose Huadhënësit e ngjashëm para Mbylljes Financiare, në lidhje me financimin e Projektit Kosova e Re.

“VNMS Paraprake (QK)” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Tarifa e Paraparë e Pëlqimit” - Sa i përket çdo Pëlqimi, ngarkesat ose tarifat, nëse ka, të përcaktuara nga Ligjet e Kosovës.

“Formulari i Paraparë i Pëlqimit” - Në lidhje me çdo Pëlqim, formulari, nëse ka (përfshirë të gjitha informatat dhe detajet), e përcaktuar nga Ligjet e Kosovës për aplikimin ose ripërtëritjen e Pëlqimit të tillë.

“Marrëveshjet e Projektit” - Kjo Marrëveshje, Marrëveshja për Mbështetjen e Sponsorit, Garancia e Qeverisë, Marrëveshja për Blerjen e Energjisë, Marrëveshja e Kyçjes, Marrëveshja për Furnizim me Linjit, Marrëveshja për Furnizim me Ujë, Garancia e Sponsorit Sipëror, Marrëveshja për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, së bashku me çdo marrëveshje novacionesh në lidhje me ndonjë nga marrëveshjet e mësipërme dhe çdo marrëveshje tjetër e lidhur nga QK-ja ose NP-ja e specifikuar me GenCo-në ose Sponsorin HoldCo ose

Sponsorin Sipëror në lidhje me Projektin Kosova e Re, siç mund të ndryshohen këto marrëveshje kohë pas kohe (sipas Seksionit 23.2) nga palët e tyre.

"Plotësim-ndryshim Material i Propozuar" - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 5.1.2(c).

"Asetet e Mbrojtura" - avionët e QK-së dhe asetet e tjera të mbrojtjes ose asete të mbrojtura nga dispozitat e privilegjeve diplomatike dhe konsullore të legjislacionit të Kosovës (nëse ka) ose të së drejtës ndërkombëtare.

"Praktikat Prudente Minerare" - Ato praktika, metoda dhe procedura që përputhen me kërkesat e sigurisë dhe ligjore që arrihen duke ushtruar atë shkallë aftësie, zelli, maturie dhe parashikimi që do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme nga një kompani e aftë dhe e kualifikuar minerare e angazhuar në të njëjtën ose në një lloj ndërmarrjeje ose aktiviteti të njëjtë ose të ngjashëm me rrethanat dhe kushtet e ngjashme me ato që i përkasin Kosovës dhe duke përmbyshur standardet e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit të kompanive të njohura ndërkombëtare të mihjes. Praktikat Prudente Minerare nuk janë të kufizuara në praktikat, metodat , ose aktet optimale duke përjashtuar të tjerat, por janë një spektër praktikash, metodash dhe aktesh të mundshme që mund të ishin pritur për të arritur rezultatin e dëshiruar me kosto të arsyeshme në përputhje me besueshmërinë dhe sigurinë.

"Praktikat Prudente të Shërbimeve Publike" - Ato praktika, metoda dhe procedura që përputhen me kërkesat e sigurisë dhe ligjore që arrihen duke ushtruar atë shkallë aftësie, zelli, maturie dhe parashikimi që do të pritej në mënyrë të arsyeshme dhe të zakonshme nga një gjenerator i aftë dhe i kualifikuar i energjisë elektrike i angazhuar në të njëjtën ose në një lloj ndërmarrjeje ose aktiviteti të njëjtë ose të ngjashëm me rrethanat dhe kushtet e ngjashme me ato që i përkasin Kosovës dhe duke përmbyshur standardet e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit të kompanive të njohura ndërkombëtare të gjenerimit të energjisë elektrike. Praktikat Prudente të Shërbimeve Publike nuk janë të kufizuara në praktikat, metodat , ose aktet optimale duke përjashtuar të tjerat, por janë një spektër praktikash, metodash dhe aktesh të mundshme që mund të ishin pritur për të arritur rezultatin e dëshiruar me kosto të arsyeshme në përputhje me besueshmërinë dhe sigurinë.

"Autoriteti Publik" - Secili nga të mëposhtmit me juridiksion mbi GenCo, Projektin Kosova e Re, ose ndonjë pjesë të tij:

- (a) QK, çdo nënndarje e saj, ose ndonjë autoritet i pushtetit lokal;
- (b) çdo departament, autoritet, instrument, agjenci ose organ gjyqësor i ndonjë Autoriteti Publik të përshkruar në Seksionin (a) më lart;
- (c) gjykatat dhe tribunalet në Kosovë;
- (d) çdo agjenci e pavarur rregullatore që ka juridiksion mbi GenCo, KEKR, Projektin Kosova e Re, ose ndonjë pjesë të tij; ose
- (e) çdo autoritet kombëtar, qyteti, provincial, komunal, lokal ose rajonal, departament, organ, zyrë, instrument, komision, korporatë, degë, drejtori, agjenci, ministri, gjykatë, tribunal, autoritetet gjyqësore, organet legjislative, organet e administratës, organet rregullatore, organet administrative, organet rregullatore, subjekte autonome ose kuazi-autonome ose autoritete tatimore ose ndonjë departament, komunë ose nënndarje të tjera politike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, çdo Person (qoftë autonom apo jo) që ushtron funksionet ekzekutive, legjislative, gjyqësore, rregullatore ose administrative të ndonjë e subjekteve të lartpërmendura ose që kanë të bëjnë me të.

"Ndërmarrje Publike"– Një "ndërmarrje publike", siç përcaktohet në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, 2008, ndryshuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike (nr. 05/L-009).

"Banka e Kualifikuar" - Një bankë komerciale me obligacione borxhi të pasiguruar senior afatgjatë dhe të emetuara në euro, e cila vlerësohet me A ose më shumë nga S&P ose me ekuivalentin e këtij vlerësimi nga një institucion tjetër i njohur ndërkombëtarisht për vlerësimin e kreditit dhe që, (i) në diskrecionin e vetëm

të QK-së, nuk do të binte ndesh me interesat e sigurisë kombëtare të Kosovës dhe (ii) nuk është e përfshirë në asnjë proces gjyqësor me QK-në ose ndonjë Autoritet Publik.

"Ngjarje e Forcës Madhore e Ujit të Papërpunuar" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë. "Rifinancimi" – Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"Plani i Veprimit i Zhvendosjes" - Një plan për të adresuar ndikimin e zhvendosjes së pavullnetshme të popullsisë së prekur nga Projekti Kosova e Re, dhe ky plan është:

- (a) zhvilluar në përputhje me ligjet e Kosovës, Kornizën e Politikave të Zhvendosjes dhe Standardet e Zhvendosjes;
- (b) dorëzuar tek dhe aprovuar nga QK-ja; dhe
- (c) zhvilluara për të zbutur ndikimet negative të zhvendosjes, për të identifikuar mundësitë e zhvillimit, për të zhvillojnë një buxhet të zhvendosjes dhe për të caktuar të drejtat e të gjitha kategorive të personave të prekur (duke përfshirë komunitetet pritëse aty ku është e aplikueshme).

"Korniza e Politikës së Zhvendosjes" - Korniza e politikës së zhvendosjes në lidhje me Projektin Kosova e Re, e miratuar nga QK-ja në përputhje me Procedurën e Operimit të Grupit të Bankës Botërore/Procedurën 4.12 të Bankës dhe Standardet e zbatueshme të IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale dhe Politika e Zbatueshme e MIGA-s mbi Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore.

"Standardet e Zhvendosjes" - Në mënyrë kolektive, në lidhje me Projektin Kosova e Re dhe vetëm në masën e zbatueshme për Projektin Kosova e Re:

- (a) standardet e zhvendosjes të përcaktuara në Politikën e Masave Mbrojtëse Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore;
- (b) standardet e zhvendosjes të përcaktuara në Standardet e IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale;
- (c) standardet e zhvendosjes të përcaktuara në Politikën e MIGA-s mbi Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore;
- (d) standardet e zhvendosjes të përcaktuara në Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it; dhe
- (e) kërkesat e vendosura nga ndonjë ligj i Kosovës në lidhje me zhvendosjen e pavullnetshme,

me përjashtim të masës që dispozitat e parashtruara në dy ose më shumë nga të mësipërme janë të tilla që Personi që kryen zhvendosjen e tillë nuk mund të jetë në pajtim në të njëjtën kohë me dispozitat e tilla, dhe në këtë rast rendi i standardeve të renditura më lart është rendi i përparësisë, dhe dispozitat përkatëse të standardit përkatës më të ulët (ose standardeve, nëse është e nevojshme) nuk do të zbatohen në masën e nevojshme për të mundësuar që ky Person të jetë në pajtim me standardin më të lartë. Për shmangien e dyshimit, asgjë këtu nuk do të zvogëlojë detyrimin e një Pale për të përmbushur standardet më të rrepta të mësipërme.

"Palë e Kufizuar" - Një person që është:

- (a) i listuara në ndonjë Listë të Sanksioneve;
- (b) me një vend kryesor të biznesit, të inkuorporuar ose të organizuar sipas ligjeve të një vendi ose territori që është objekt i Sanksioneve të gjera në nivel vendi ose territori; ose
- (c) përndryshe cak i sanksioneve ("cak i sanksioneve" nënkupton një person me të cilin një person i Shteteve të Bashkuara ose një shtetasi tjetër i një Autoriteti të Sanksioneve, do ta kishte të ndaluar ose do të kufizohej me ligj nga angazhimi në tregti, biznes ose aktivitete të tjera).

"Sanksionet" - Sanksionet ekonomike, ligjet, rregulloret, embargot ose masat kufizuese të administruara, të

aprovuara ose të zbatuara nga çdo Autoritet Sanksionues.

"Autoritetet Sanksionuese" - Secili nga:

- (a) qeveria e Shteteve të Bashkuara;
- (b) Kombet e Bashkuara;
- (c) Bashkimi Evropian;
- (d) Mbretëria e Bashkuar;
- (e) Franca;
- (f) Japonia; ose
- (g) institucionet përkatëse qeveritare dhe agjencitë e cilësdo nga sa më sipër, duke përfshirë, pa kufizime, OFAC, Departamentin e Shtetit të Shteteve të Bashkuara dhe/ose Thesarin e Madhërisë së Saj.

"Lista e Sanksioneve" - 'Listën e Shtetasve Veçanërisht të Përcaktuar dhe Personave të Blllokua' e mbajtur nga OFAC, Lista e Konsoliduar e Caqeve të Sanksioneve Financiare dhe Lista e Ndalimit të Investimeve të mbajtura nga HMT, ose ndonjë listë të ngjashme ose shpallje publike të sanksioneve nga secili prej Autoriteteve Sanksionuese

"Ndërprerje e Programuar" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"Kredi të Aksionarëve" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"Fusha Jugore e Mihjes në Sibovc" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Furnizim me Linjit.

"Lokacioni" - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

"Marrëveshja e Bartjes së Lokacionit" - Marrëveshja me atë emër ndërmjet Gjenerimit të KEK-ut dhe GenCo datuar në ose afër Datës së Ekzekutimit.

"Standardet Sociale" - Në mënyrë kolektive, në lidhje me pjesëmarrjen e GenCo-së në Projektin Kosova e Re dhe vetëm në masën e zbatueshme për GenCo ose Projektin Kosova e Re,

- (a) komponentët socialë të Planit të Menaxhimit të MS-së;
- (b) standardet sociale të përcaktuara në Politikën e Masave Mbrojtëse Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore;
- (c) standardet sociale të përcaktuara në Standardet e IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale;
- (d) standardet sociale të përcaktuara në Politikën e MIGA mbi Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore;
- (e) standardet sociale të përcaktuara në Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it; dhe
- (f) kërkesat e vendosura nga ndonjë ligj i Kosovës në lidhje me masat mbrojtëse dhe qëndrueshmërinë sociale,

me përjashtim të masës që dispozitat e parashtruara në dy ose më shumë nga të mësipërme janë të tilla që GenCo nuk mund të jetë në pajtim në të njëjtën kohë me dispozitat e tilla, dhe në këtë rast rendi i standardeve të renditura më lart është rendi i përparësisë, dhe dispozitat përkatëse të standardit përkatës më të ulët (ose standardeve, nëse është e nevojshme) nuk do të zbatohen në masën e nevojshme për të mundësuar që kjo Palë të jetë në pajtim me standardin më të lartë. Për shmangien e dyshimit, asgjë këtu nuk do të zvogëlojë detyrimin e një Pale për të përmbushur standardet më të rrepta të mësipërme.

“Njoftimi i Posaçëm i Mospërmbushjes për QK-në” - A ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë, Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, Marrëveshjen për Furnizim me Linjit, ose Marrëveshjen për Furnizim me Ujë, sipas rastit.

“Sanimi i Kushteve Mjedisore të Specifikuara” - Veprimet e nevojshme për vlerësimin, kontrollin, adresimin, sanimin dhe heqjen e Kushteve Mjedisore/Arkeologjike të Specifikuara.

“Kontrata e Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Kontraktori i Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“NP-ja e Specifikuar” dhe “NP-të e Specifikuara” - Secila ose të gjitha prej Mihjes së KEK-ut, Gjenerimit të KEK-ut, KEKR-së, KOSTT-it, Furnizuesit të Ujit dhe çdo Ndërmarrje tjetër Publike që është palë në Marrëveshjen e Projektit, siç kërkon konteksti. Pavarësisht nga çdo gjë që është në kundërshtim me këtë, çdo Person që nuk është Ndërmarrje Publike, që suksedon në interesin e një NP-je të Specifikuar sipas Marrëveshjes së Projektit, do të konsiderohet si NP e Specifikuar.

“Veprim ose mosveprim i NP-së së Specifikuar” - Veprimi ose mosveprimi i ndonjë NP-je të Specifikuar, përveç një Ndryshimi në Ligj, dhe ky veprim ose mosveprim përbën një shkelje materiale ose mospërmbushje të detyrimeve përkatëse të NP-së së Specifikuar sipas ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit në të cilën NP-ja e Specifikuar është palë, ose përbën shkelje materiale të ligjeve të Kosovës, dhe ky veprim ose mosveprim i NP-së së tillë të Specifikuar ka një efekt material tek GenCo; me kusht që, sidoqoftë, asnjë veprim ose mosveprim i tillë nuk do të konsiderohet Veprimi apo Mosveprimi i NP-së të Specifikuar në qoftë se veprimi ose mosveprimi i tillë është shkaktuar tërësisht ose në pjesë të rëndësishme nga një veprim ose mosveprim i GenCo.

“Ngjarje e Forcës Madhore e NP-së të Specifikuar” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Sponsori HoldCo” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit. “Pala e Sponsorit HoldCo” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit.

“Marrëveshja për Mbështetjen e Sponsorit” - Marrëveshja me atë emër ndërmjet QK-së, Sponsorit HoldCo dhe GenCo, datuar në ose afër Datës së Ekzekutimit.

“Përrjashtim Tarifor” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Tatim” - Çdo taksë, ngarkesë, detyrim, tarifë bazë për vlerësimin e tatimeve (duke përfshirë normat ose periudhat për amortizimin e aseteve për qëllime të vlerësimit tatimor), koncesion fiskal ose kompensim, përfshirë çdo tatim korporativ, tatimin mbi vlerën e shtuar, taksën e shitjes, taksën e ujit ose të mjedisit ose energjisë, detyrimet doganore, tatimin në burim, akcizën, tatimin mbi transaksionet në valutë ose tatimin në pronë. Termi "Tatim" nuk do të përfshijë asnjë tarifë ose pagesë që duhet t'i paguhet një Autoriteti Publik si shpërblim për mallrat ose shërbimet e ofruara nga Autoriteti i tillë Publik në lidhje me një aktivitet komercial të kryer nga Autoriteti i tillë Publik.

“Traktate Tatimore” - Një ose më shumë konventa ose traktate të lidhura ndërmjet Kosovës dhe vendeve të tjera për shmangien e tatimit të dyfishtë.

“Kontest Teknike” - Kontest që ka të bëjë me një çështje teknike, inxhinierike, operationale ose të kontabilitetit ose çështje që ka të bëjë me këtë Marrëveshje, që në çdo rast është lloji i problemit ose çështjes që mund të shtrohet në mënyrë të arsyeshme ndaj shqyrtimit dhe zgjidhjes nga një ekspert në fushën ose fushat përkatëse

“Tenderi (Kycja)” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Tenderi (Mjedisi)” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Tender (Impianti)” – Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Afat” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 2.1).

“Njoftimi i Ndërprerjes” – Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 19.3.

“Termokos” - Ngrohitorja Banesore Termokos, SH.A., një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës.

“Data e Bartjes” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit.

“Sponsori Sipëror” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit.

“Garancia e Sponsorit Sipëror” - Garancia me atë emër mes Sponsorit Sipëror dhe Republikës së Kosovës e datuar në ose para Datës së Hyrjes në Fuqi.

“Pala e Sponsorit Sipëror” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Ngjarje e Pasigurueshme” - Një rrezik i një Ngjarjeje Tjetër të Forcës Madhore për të cilën: (1) sigurimi për një rrezik të tillë nuk është në përgjithësi i disponueshëm në tregun e sigurimeve nga ofruesi i kualifikuar në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë dhe GenCo ka ofruar të gjithë dokumentacionin në lidhje me mos-disponueshmërinë e tillë siç kërkohet sipas Seksionit 21.1.2 (*Përjashtimet nga Kërkesat e Sigurimeve*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; (2) GenCo-së nuk i kërkohet të marrë një sigurim të tillë në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; (3) sigurimi për një rrezik të tillë është i disponueshëm dhe do të kërkohet nga GenCo ta marrë një sigurim të tillë në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, por KEKR dhe QK-ja kanë rënë dakord me GenCo me shkrim se GenCo-së nuk do t’i kërkohet të sigurohet për një rrezik të tillë; me kusht që, sidoqoftë, asnjë Ngjarje Tjetër e Forcës Madhore nuk do të jetë një Ngjarje e Pasigurueshme në masën që mbulimi i sigurimit nuk është i disponueshëm si rezultat i ndonjë nga të mëposhtmet: (i) sigurimi nuk arrin të përgjigjet për shkak të neglizhencës ose shkeljes së kushteve të policës nga ana e GenCo-së; ose (ii) dështimi nga GenCo për të përmbushur detyrimet e veta sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë ose ndonjë Marrëveshjeje tjetër të Projektit.

“Furnizuesi me Ujë” - HN Ibër-Lepenc SH.A., një shoqëri aksionare e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me zyrën e vet kryesore në Bulevardin Bill Clinton Nr. 3, Prishtinë, Kosovë, dhe numër regjistrimi të biznesit 70465157, Kosovë.

“Pala e Furnizuesit me Ujë” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Furnizim me Ujë.

“Marrëveshja për Furnizim me Ujë” - Marrëveshja me atë emër mes Furnizuesit me Ujë dhe GenCo-së, datuar në ose afër Datës së Ekzekutimit.

“Banka Botërore” - Do të thotë institucioni financiar ndërkombëtar që ofron kredi për vendet në zhvillim për programet kapitale dhe përbëhet nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Asociacioni Ndërkombëtar për Zhvillim.

“Kërkesat e Instrumentit të Asociuar të Bankës Botërore” - Kërkesat e Bankës Botërore në lidhje me Fushën Jugore të Mihjes në Sibovc, të cilat janë si më poshtë:

- (a) të ndërmerren rekomandimet e parashtruara në Planin e veprimit korrektues të Panelit të Inspektimit të Bankës Botërore në lidhje me pronësinë, zhvillimin (duke përfshirë çdo zhvendosje të popullsisë dhe trashëgimisë) dhe funksionimin e Fushës Jugore të Mihjes në Sibovc dhe Aseteve të Mihjes;
- (b) të përfundohet një vlerësim i ndikimit mjedisor dhe social për zhvillimin e Fushës Jugore të Mihjes në Sibovc në përputhje me Ligjet e Kosovës dhe Standardet e IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale;
- (c) të vendoset një sistem i menaxhimit mjedisor dhe social në përputhje me Standardet e IFC-së për

Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale për të zbatuar dhe monitoruar veprimin e zbutjes mjedisore dhe sociale të përcaktuar në vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social për zhvillimin e Fushës Jugore të Mihjes në Sibovc; dhe

- (d) të punësohet një konsulent i pavarur për të monitoruar pajtueshmërinë e zhvillimit të Fushës Jugore të Mihjes në Sibovc me ligjet e Kosovës, Standardet e IFC-së për Qëndrueshmërinë Mjedisore dhe Sociale dhe veprimet zbutëse për vlerësimin e ndikimit mjedisor dhe social.

“Politikat e Masave Mbrojtëse Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore” - Politikat e Masave Mbrojtëse Mjedisore dhe Sociale të botuara nga Banka Botërore, të disponueshme në Datën e Ekzekutimit (në varësi të zhvendosjes së ardhshme) në <http://go.worldbank.org/WTA1ODE7T0> ose versioni i tillë i mëvonshëm që kërkohet të plotësohet nga çdo Huadhënës sipas Dokumenteve të Financimit.

“Grupi i Bankës Botërore ” - Do të thotë inkorporimi i Bankës Botërore, Korporatës Financiare Ndërkombëtare, Agjencisë për Garantimin e Investimeve Shumëpalëshe dhe Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimeve, të cilat në mënyrë kolektive punojnë për reduktimin e varfërisë.

“ Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për MSHS ” - Udhëzimet e Grupit të Bankës Botërore për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë, të disponueshme Datën e Ekzekutimit (në varësi të zhvendosjes së ardhshme) në <http://www.ifc.org/ehsguidelines/> ose versioni i mëvonshëm i kërkuar që duhet të plotësohet nga çdo Huadhënës në bazë të Dokumenteve të Financimit, duke përfshirë seksionet e aplikueshme të: (i)

Udhëzimet e Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë për Termocentralet (2008), Minierat (2007) dhe Objektet e Menaxhimit të Mbeturinave (2007), dhe (ii) Seksioni 2.0 i Udhëzimeve të Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurisë (MSHS) Shëndeti dhe Siguria në Punë (30 prill 2007).

“Shuma e Kapitalit Punues” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Instrumenti i Kapitalit Punues” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Llogaria e Rezervës së Kapitalit Punues” - Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Viti” - Çdo periudhë dymbëdhjetë (12) Mujore që fillon më 1 janar dhe vazhdon deri në fund të këtij viti kalendarik.

1.2 Interpretimi

- (a) Në këtë Marrëveshje, përveç nëse shfaqet një synim i qartë kundërtë:
- (i) numri njëjës përfshin numrin shumës, dhe anasjelltas;
 - (ii) llogaritjet e tjera nga çmimet të kërkuara që të bëhen në vijim do të shprehen me saktësi deri në katër shifra pas presjes dhjetore;
 - (iii) referenca ndaj çdo Personi përfshin trashëgimtarët dhe të caktuarit e lejuar të atij Personi, por, nëse është e aplikueshme, vetëm nëse trashëgimtarët dhe të caktuarit e tillë nuk janë të ndaluar nga kjo Marrëveshje dhe referimi ndaj një Personi në një cilësi të veçantë e përjashton Personin e tillë në çdo kapacitet tjetër ose individualisht;
 - (iv) referenca për çdo gjini përfshin çdo gjini tjetër;
 - (v) referenca për çdo marrëveshje, dokument ose instrument nënkupton marrëveshjen, dokumentin ose instrumentin e ndryshuar ose të modifikuar dhe në fuqi herë pas here në përputhje me kushtet e veta; me kusht që, sidoqoftë, referimi ndaj Standardeve të Zbatueshme (përveç Ligjeve të Kosovës) nënkupton Standardet e Zbatueshme (përveç Ligjeve të Kosovës) në fuqi në Datën e Ekzekutimit dhe, pas ekzekutimit të Dokumenteve të Financimit, versionet e Standardeve të Zbatueshme (përveç Ligjeve të Kosovës) që kërkohet të përmbushen nga çdo Huadhënës sipas Dokumenteve të Financimit;
 - (vi) referencat ndaj ndonjë legjislacioni ose dispozite legjislative përfshijnë referenca për çdo modifikim ligjor ose rivendosjen e një legjislacioni ose dispozitave të tilla ligjore dhe çdo

legjislacion ose dispozitë legjislative që zëvendëson atë legjislacion ose dispozitë ligjore, me kusht që asgjë në këtë Seksion 1.2(a)(vi) nuk do ta parandalojë një Palë që të kërkojë lehtësim për një Ndryshim në Ligj siç parashikohet në çdo Marrëveshje të Projektit;

- (vii) “si më poshtë”, “si këtu”, “këtu” dhe fjalë të ngjashme dhe do të konsiderohen si referenca në këtë Marrëveshje si tërësi dhe jo në ndonjë Seksion, Kalendar ose dispozitë tjetër, përveç nëse është shprehur ndryshe;
 - (viii) “duke përfshirë” (dhe me kuptimin korrelativ “përfshiu” ose “përfshin”) do të thotë duke përfshirë pa kufizuar përgjithësinë e ndonjë përshkrim që paraprin termin e tillë;
 - (ix) një letër, dokument, ose instrument tjetër që parashikon që QK-ja nuk ka “asnjë kundërshtim” (ose “nuk kundërshton” ose fjalë të tjera të ngjashme) në lidhje me një çështje të veçantë do të konsiderohet pëlqim i QK-së në lidhje me këtë çështje;
 - (x) në lidhje me përcaktimin e çdo periudhe kohore, “nga” do të thotë “nga dhe duke përfshirë” dhe “deri” do të thotë “deri por duke përjashtuar”;
 - (xi) referencat ndaj dokumenteve, instrumenteve ose marrëveshjeve do të konsiderohet se u referohen edhe në të gjitha shtojcave, eksponateve, kalendarëve ose ndryshimeve të tyre; dhe
 - (xii) referencat për një Palë që bëhet e vetëdijshme ose që ka njohuri për një ngjarje ose rrethana, do të konsiderohen t’i referohen personelit të një Pale të tillë që ka përgjegjësi për çështjet që kanë të bëjnë me një ngjarje ose rrethana të tillë, ose ndonjë drejtues ose zyrtar aktual ose i shkuar që bëhet i vetëdijshëm ose që ka njohuri.
- (b) Emërtimet dhe titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm referencë dhe nuk përbëjnë një pjesë të përmbajtjes së kësaj Marrëveshjeje dhe nuk do të merren parasysh në interpretimin e kësaj Marrëveshjeje.
 - (c) Referencat në trupin e kësaj Marrëveshjeje për Nenet, Seksionet dhe Kalendarët (dhe Anekset e tyre) janë për Nenet dhe Seksionet dhe Seksionet (dhe Anekset e tyre) të kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse përcaktohet ndryshe. Referencat në çdo Kalendar për Nene, Seksione dhe Anekse janë referenca për Nenet, Seksionet dhe Anekset e atij Kalendari, nëse nuk shprehet ndryshe. Referencat në çdo Kalendar (ose Aneksin e tij) për Nene dhe Seksione të Marrëveshjes janë referenca për trupin e kësaj Marrëveshjeje, nëse nuk shprehet ndryshe.
 - (d) Gjatë kryerjes së obligimeve dhe detyrave të veta, si dhe në sigurimin e vlerësimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, secila Palë do të ketë një detyrim të nënkuptuar të mirëbesimit.
 - (e) Me përjashtim të rasteve kur tregohet ndryshe në këtë Marrëveshje, referencat për kohën janë referencat për orën standarde të Evropës Qendrore ose Ora Verore e Evropës Qendrore, siç është e aplikueshme në Lokacion.
 - (f) Kjo Marrëveshje u negociua nga Palët përmes përfaqësimit ligjor dhe, në përputhje me rrethanat, çdo rregull ndërtimi ose interpretimi që kërkon që kjo Marrëveshje të ndërtohet ose interpretohet kundër çdo Pale si palë hartuese, nuk zbatohet për asnjë ndërtim ose interpretim të tyre.
 - (g) Në masën që ekziston një konflikt ndërmjet ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje dhe çdo Kalendari ose Aneksi, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të mbizotërojnë por mungesa e një dispozite në një Kalendar ose Aneks ose në këtë Marrëveshje (sipas rastit) nuk do të përbëjë një konflikt.

Neni 2

Data e Hyrjes në Fuqi; Afati

2.1 Hyrja në Fuqi; Afati

Kjo Marrëveshje do të fillojë dhe do të hyjë në fuqi në më të sprasmen nga (a) Data e Ekzekutimit dhe (b) data në të cilën Marrëveshja për Blerje të Energjisë do të hyjë në fuqi në përputhje me Seksionin 2.1 (*Hyrja në Fuqi; Afati*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë (dhe kjo datë e hyrjes në fuqi është "**Data e Hyrjes në Fuqi**"). Kjo Marrëveshje do të ndërpritet me skadimin ose ndërprerjen e hershme të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë Elektrike (periudha e tillë, "**Afati**"), përveç nëse nuk ndërpritet ndryshe më herët në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Zbatimi i Projektit Kosova e Re

3.1 Zbatimi Projekti Kosova e Re

GenCo do të zhvillojë, dizajnojë, ndërtojë, financojë, posedojë, operojë dhe mirëmbajë Objektin e TCKR-së në pajtim me ligjet e Kosovës, Standardet e Zbatueshme, Pëlqimet e GenCo-së, këtë Marrëveshje dhe Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

3.2 Asnjë Diskriminim, Asnjë Shpronësim

- (a) QK-ja nuk do të ndërmarrë dhe do të sigurojë që asnjë Autoritet Publik nuk do të ndërmarrë ndonjë veprim që do të ndikonte materialisht dhe negativisht në GenCo ose aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjeve të Projektit ose Dokumenteve të Financimit ose Kontratave të Ndërtimit/Mirëmbajtjes bazuar në arsyet e pronësisë apo të kontrollit të huaj të GenCo-së në përputhje me Ligjin për Investimet e Huaja 2013 (nr. 04/L-220), dhe QK-ja do ta trajtojë, dhe do të sigurojë që Autoritetet e tjera Publike do ta trajtojnë GenCo-në në formë jo më pak të favorshme seç trajton çdo subjekt tjetër që bën biznes të ngjashme në Kosovë, në përputhje me dispozitat e Neneve 24 dhe 119 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Investime të Huaja, 2013 (Nr. 04/L-220).
- (b) As QK-ja, as ndonjë Autoritet Publik nuk do të shpronësojnë, shtetëzojnë, ose, përveç siç parashihet më poshtë në Marrëveshjet e Projektit, detyrimisht të marrë (ose të ndërmarrë ose lejojë përndryshe çdo veprim ose seri veprimesh që, të vetme ose kur merren së bashku, kanë në thelb të njëjtat efekte si ndonjë nga të mësipërmet) çdo pjesë materiale të Projektit Kosova e Re, Interesat e Pronësisë në GenCo, ose ndonjë nga asetet, të drejtat ose interesat e veta, qoftë tërësisht ose pjesërisht; me kusht që, sidoqoftë, sa më lart të mos ndalojë ndonjë veprim të ndërmarrë nga QK-ja, ndonjë Autoritet Publik ose ndonjë NP e Specifikuar në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse që rrjedhin nga kjo Marrëveshje ose Marrëveshjet e Projektit.

3.3 Tenderi (Impianti) për Kontraktorin e IPN-së dhe Kontraktorin e MAGJ-së

Dispozitat e Seksionit 3.9 (*Tenderi për Kontraktorin e IPN-së dhe Kontraktorin e MAGJ-së; Inputet e tenderuara të MBE-së; Zëvendësimi i Kontraktorit të Ardhshëm të MAGJ-së*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë janë përfshirë këtu nëpërmjet referencës, mutatis mutandis.

3.4 Financimi

3.4.1 Aprovimi i QK-së i Kërkuar në lidhje me Financimin dhe Rifinancimin

- (a) Dispozitat e Seksionit 3.13 (*Aranzhimet e Financimit*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë janë përfshirë këtu nëpërmjet referencës, *mutatis mutandis*.
- (b) GenCo do t'i dërgojë QK-së një kopje (i) të të gjitha Dokumenteve të Financimit të ekzekutuara nga GenCo menjëherë pas çdo Rifinancimi, ose nëse ekzekutohen pas mbylljes së Rifinancimit, menjëherë pas ekzekutimit të tyre, dhe në çdo rast jo më shumë se dhjetë (10) Ditë Pune pasi kopjet e të gjitha dokumenteve të tilla janë dorëzuar tek Huadhënësit relevantë, por në çdo rast jo më shumë se dyzetë e pesë (45) ditë pas mbylljes së Rifinancimit të tillë.
- (c) GenCo, pa pëlqimin paraprak me shkrim të QK-së, nuk do të lidhë asnjë Rifinancim ose nuk do të nënshkruajë asnjë ndryshim material të Dokumenteve të Financimit, në qoftë se Rifinancimi ose

ndryshimi i tillë i Dokumenteve të Financimit do të rriste materialisht Shumat e Kompensimit të Blerjes ose përndryshe do të rriste materialisht detyrimet e QK-së sipas kësaj Marrëveshjeje ose do të dëmtonte materialisht të drejtat e QK-së, duke përfshirë edhe blerjen e Objektivit të TCKR-së të lirë nga të gjitha Barrat, përveç Barrave të Lejuara (GenCo), me pagesën e Shumës së aplikueshme të Blerjes nga QK-ja.

- (d) GenCo mund të lidhë çdo Rifinancim ose të nënshkruajë ndonjë ndryshim në Dokumentet e Financimit që nuk kanë efektet e përshkruara në Seksionin 3.4.1(c) pa pëlqimin e QK-së.
- (e) Sipas Seksionit 3.4.1(c), GenCo do të ndërmarrë Rifinancimet vetëm në përputhje me Seksionin 16.6 (*Rifinancimi i Objektivit të TCKR-së*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë.

3.4.2 Mbështetja e Financimit

Sipas Seksionit 3.4.1 dhe të drejtave të veta sipas Marrëveshjeve të Projektit, QK0ja bie dakord:

- (a) të bashkëpunojë në mënyrë të arsyeshme dhe të shkaktojë që NP-të e Specifikuara të bashkëpunojnë në mënyrë të arsyeshme, me përpjekjet e GenCo-së për të marrë dhe mbajtur ndonjë financim ose rifinancim për Projektin Kosova e Re; dhe
- (b) të sigurojë mbështetje të arsyeshme për parashtrimet rregullatore dhe garanci të tjera të arsyeshme dhe të përshtatshme për Huadhënësit, siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga GenCo për të zbatuar sa më lart.

3.4.3 Pëlqimi për Caktimin e Kolateralit

(a) QK-ja pajtohet:

- (i) të ekzekutojë dhe dorëzojë tek Huadhënësit e identifikuar nga GenCo një Marrëveshje të Drejtpërdrejtë të arsyeshme dhe zakonore me Huadhënësit, duke përfshirë
 - (A) pëlqimin dhe njohjen e caktimit të kolateralit të kësaj Marrëveshjeje dhe secilës prej Marrëveshjeve të Projekteve në të cilat QK-ja është palë, dhe Garancisë Qeveritare dhe sigurimeve të tjera të arsyeshme dhe të zakonshme për Huadhënësit në përputhje me Dokumentin Financiar në fuqi,
 - (B) një detyrim për të bërë pagesa në llogaritë siç njoftohet nga GenCo herë pas here (në masën që, nëse ka ndonjë, pagesat e tilla janë të pagueshme nga QK-ja sipas kësaj Marrëveshjeje);
 - (C) një detyrim për të njoftuar Huadhënësit për çdo Ngjarje të Mospërmbushjes nga GenCo-ja ose ndonjë ngjarje tjetër që mund të rezultojë në ndërprerjen ose pezullimin e kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit në të cilën QK-ja është palë,
 - (D) të drejtën e Huadhënësve të kenë Periudhën e Aplikueshme të Kurës së Homologut pas marrjes së njoftimit për Ngjarjen e Mospërmbushjes nga GenCo-ja ose për ndonjë ngjarje tjetër që mund të rezultojë në ndërprerjen ose pezullimin e ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit në të cilën QK-ja është palë, gjatë së cilës do të bëjë çdo pagesë ose do të kryejë çdo veprim të kërkuar nga KEKR-ja në vijim për të kuruar Ngjarjen e Mospërmbushjes nga KEKR-ja, me të njëjtin efekt sikur kjo pagesë ose veprim të ishte bërë ose kryer nga KEKR-ja,
 - (E) të drejtën e Huadhënësve për të emëruar një Person për të marrë të drejtat dhe detyrimet e GenCo-së sipas Marrëveshjeve të Projektit gjatë periudhës së kurës së Huadhënësit të përshkruar më sipër dhe më pas, si dhe detyrimin për të lidhur Marrëveshjet zëvendësuese të Projektit me Personin e tillë nëse Marrëveshjet e Projektit nuk janë më efektive për shkak të falimentimit apo paaftësisë tjetër të GenCo-së,

- (F) një detyrim që pëlqimi i Huadhënësve të merret përpara një caktimi të një Marrëveshjeje të Projektit nga QK-ja ose NP-ja e Specifikuar, me përjashtim të rasteve kur nuk kërkohet aprovimi i një caktimi të tillë nga GenCo-ja sipas Marrëveshjes së Projektit,
 - (G) një detyrim për të paguar pagesat e Blerjes në lidhje me shumat e detyruara sipas Dokumenteve të Financimit direkt tek Huadhënësi i aplikueshëm, dhe
 - (H) lidhjen e një marrëveshjeje zëvendësuese me një subjekt të përzgjedhur si pasardhës i të drejtave të GenCo-së, dhe
 - (I) terma të tjera të arsyeshme dhe të zakonshme të kërkuara nga Huadhënësit.
- (ii) të ekzekutojë dhe dorëzojë çdo dokument tjetër të arsyeshëm dhe të zakonshëm të letrave me vlerë që GenCo ose Huadhënësit mund të kërkojnë nga QK-ja që t'i ekzekutojë në mënyrë që të lehtësojnë krijimin ose përsosjen e interesave të lartpërmendura të letrave me vlerë, me kusht që, sidoqoftë, QK-ja nuk është e detyruar të ekzekutojë ndonjë dokument ose instrument të tillë nëse ose në atë masë që ekzekutimi i një dokumenti ose instrumenti të tillë do të ndikonte materialisht në pozicionin ekonomik të QK-së ose rreziqet që do të barten nga QK-ja; dhe me kusht që, më tutje, QK-ja do të ketë marrë kopjet e dokumenteve ose instrumenteve që kërkohet të ekzekutojë dhe të gjitha dokumentet dhe instrumentet e arsyeshme dhe të nevojshme për një kuptim të plotë dhe të kompletuar të të drejtave dhe detyrimeve të palëve në Marrëveshjen e Drejtpërdrejtë me Huadhënësit në mënyrë të arsyeshme para kohës që pritet të negociojë formën e ekzekutimit të Marrëveshjes së Drejtpërdrejtë.
- (b) QK-ja pajtohet të modifikojë ose qartësojë dispozitat e kësaj Marrëveshjeje siç kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Huadhënësit; me kusht që, sidoqoftë, QK-ja të mos ketë detyrim të bëjë modifikime apo sqarime që ndikojnë materialisht në pozitën ekonomike të QK-së ose rreziqet që duhet të përballohen nga QK-ja.
- (c) QK do të bëjë që NP-të e Specifikuara të ekzekutojnë dhe t'i dorëzojnë çdo Huadhënësi të identifikuar nga GenCo-ja një marrëveshje të arsyeshme dhe të zakonshme të drejtpërdrejtë, në thelb të ngjashme me atë të përshkruar në Seksionin 3.4.3(a), *mutatis mutandis*, dhe dokumente të tilla të arsyeshme dhe të zakonshme, në thelb të ngjashme në atë që përshkruhet në Seksionin 3.4.3(a)(ii), *mutatis mutandis*, dhe të modifikojnë ose sqarojnë dispozitat e Marrëveshjeve të Projektit siç kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga Huadhënësit, duke iu nënshtruar në secilin rast kufizimeve të përcaktuara në Seksionin 3.4.3(a) dhe Seksionin 3.4.3(b).

3.5 Blerja e Tokës

3.5.1 Toka për Zonën e Kycjes

- (a) Palët pranojnë se do të jetë e nevojshme që GenCo të marrë qira të mjaftueshme ose të drejta të tjera pronësore mbi tokën që do të përdoren për punën e interkoneksionit. GenCo ka të drejtën e marrjes së këtyre të drejtave pronësore në pajtim me këtë Seksion 3.5.1 dhe do të heqë dorë nga çfarëdo të drejtash sipas ligjeve të Kosovës (duke përfshirë Nenin 27 të Ligjit për Energjinë, 2016 (Nr.5/L-081) për të marrë të drejta të tilla pronësore. Në varësi të Seksionit 19.2, blerja e tokës do të kompletohet në përputhje me Standardet e Zbatueshme.
- (b) GenCo-ja:
- (i) jo më vonë se Data e Blerjes, do t'i japë QK-së një njoftim ("**Raporti i Blerjes së Tokës**") mbi të drejtat e pronës së patundshme që GenCo pret me arsye se do të jenë të nevojshme për të mundësuar që GenCo të ndërmarrë veprat e interkoneksionit të GenCo-së ("**Zona e Kycjes**") në mënyrë që të përmbushë detyrimet e veta sipas Marrëveshjeve të Projektit dhe Kontratave të Ndërtimit/Mirëmbajtjes;

- (ii) do të përfshijë në Raportin e Blerjes së Tokës parcelat specifike dhe të drejtat pronësore të cilat GenCo kërkon në mënyrë të arsyeshme dhe datën e parashikuar në të cilën GenCo pret që të fitohen këto të drejta pronësore; dhe
 - (iii) do të njoftojë menjëherë QK-në në rast të ndonjë rishikimi të nevojshëm të Raportit për Blerjen e Tokës.
- (c) QK-ja do të bëjë njëzën nga më poshtë:
- (i) në masën që QK-ja posedon të gjithë ose një pjesë të të drejtave të pronës së patundshme të përshkruara në Raportin e Blerjes së Tokës (duke marrë parasysh kërkesat e QK-së për të drejtat e pronësisë), QK-ja do t'ia japë GenCo-së me qira këto prona të patundshme në pajtim me Seksionin 3.5.1(d);
 - (ii) në masën që një NP e specifikuar që është një Ndërmarrje Publike posedon të gjithë ose një pjesë të të drejtave të pronës së patundshme të përshkruara në Raportin e Blerjes së Tokës (duke marrë parasysh kërkesat e NP-ve të Specifikuara për të drejtat e pronësisë), QK-ja do të bëjë që NP-ja e Specifikuar t'i bartë të drejtat e tilla të pronës së paluajtshme tek QK-ja dhe QK-ja do t'ia japë me qira GenCo-së pronën e patundshme që i nënshtrohet këtyre të drejtave, në përputhje me Seksionin 3.5.1(d); ose
 - (iii) në rast se as QK-ja, as ndonjë NP e Specifikuar që është Ndërmarrje Publike, individualisht ose kolektivisht, nuk i posedojnë të drejtat e pronës së paluajtshme të përcaktuara në mënyrë të arsyeshme sipas nevojës në Raportin e Blerjes së Tokës, atëherë QK-ja do të blejë (pa asnjë përgjegjësi ndaj GenCo), me marrëveshje me pronarët e tokave private ose me shpronësime në pajtim me Ligjin për Shpronësimin e Pronave të Paluajtshme, 2009 (03/L-139), dhe Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Shpronësimin e Pronave të Paluajtshme (Nr.03/L-205), të drejtat e tilla të pronës së patundshme dhe do t'ia japin me qira GenCo-së pronën e tillë të patundshme në përputhje me Seksionin 3.5.1(d), dhe me kusht që QK-ja të ketë marrë njoftim paraprak së paku dymbëdhjetë (12) Muaj përpara për nevojën që GenCo të marrë të drejtat e tilla të pronës së patundshme në një Raport të Blerjes së Tokës, do të ndërmarrin detyrime të tilla në mënyrë që të mundësojë që GenCo të marrë në posedim pronën e tillë të paluajtshme deri në datën e specifikuar në Raportin e Blerjes së Tokës.
- (d) Çdo qiradhënie e pronës së paluajtshme (dhe/ose instrumentet e tjera të transferimit dhe bartjes në pajtim me ligjet e Kosovës) nga QK në GenCo në pajtim me Seksionin 3.5.1 (c) do të bëhet sipas sa më poshtë vijon:
- (i) që të realizohet qiradhënia e pronës fillestare që do të jepet me qira nga QK tek GenCo, QK-ja dhe GenCo do të lidhin Marrëveshjen e Qiradhënies (me një pronë të tillë që është Prona Fillestare (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Qiradhënies);
 - (ii) që të realizohet qiradhënia e çdo prone të mëvonshme që do të jetë e dhënë me qira nga QK tek GenCo, QK-ja dhe GenCo do të zbatojnë një shtojcë të Marrëveshjes së Qiradhënies për të përfshirë pronën e tillë shtesë (dhe kjo pronë është Prona Shtesë që është përcaktuar në Marrëveshjen e Qiradhënies).

3.6 Zhvendosja

3.6.1 Detyrimet e GenCo-së

GenCo: (a) do të bashkëpunojë me QK-në dhe do t'i sigurojë të gjitha ndihmat e arsyeshme të nevojshme për të mundësuar që QK-ja të përmbushë detyrimet e veta sipas Seksionit 3.6.2, dhe (b) do të rimburojë menjëherë QK-në për çdo kosto dhe shpenzim të arsyeshëm dhe të dokumentuar të palës së tretë të bërë

nga QK-ja përpara Datës së Tërheqjes Përfundimtare në lidhje me ndonjë Plan Veprimi për Zhvendosje për Zonën e Kycjes sipas Seksionit 3.6.2; me kusht që, sidoqoftë, GenCo të ketë të drejtën për rimbursim të plotë për një Kosto të Blerjes të Tokës (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) në bazë të Kalendarit 1 (*Tarifa*) të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë; me kusht që, më tej, kostot dhe shpenzimet e tilla që rimburohen nga QK-ja për GenCo në përputhje me këtë Seksion 3.6.1 do të kufizohen në një milion euro (1,000,000 €); me kusht që, më tej, GenCo do të ketë të drejtën, në diskrecionin e vet, të refuzojë pagesën e çdo kosto ose shpenzimi të tillë në lidhje me ndonjë palë të tretë që është nën hetime ose është akuzuar, në çdo rast nga një Autoritet Publik, për një shkelje të Ligjeve Kundër Ryshfetit, ose ndonjë kërkesë pajtueshmërie sipas Seksionit 23.24.

3.6.2 Detyrimet e QK-së

QK-ja duhet të ndjekë me zell zbatimin e një ose më shumë Planeve të Veprimit të Zhvendosjes për Zonën e Kycjes.

3.7 Kontabiliteti i Ndarë

GenCo do të sigurojë që të gjitha kostot e Projektit Kosova e Re dhe çdo aktivitet tjetër ose biznesi tjetër të Projektit Kosova e Re të jenë të kontabilizuara veçmas, përveç siç është aprovuar nga QK-ja (vetëm për qëllimet e interesave të veta sipas Marrëveshjeve të Projektit) ose ZRRE (në pajtim me autoritetin e vet rregullator).

3.8 Asnjë Sipërmarrje Tjetër Biznesore

(a) Sipas Seksionit 3.8 (b), pa pëlqimin paraprak me shkrim të QK-së GenCo nuk:

- (i) do të formojnë, blejnë ose të ketë interes në ndonjë filial ose sipërmarrje të përbashkët;
- (ii) do të marrë ose huazojë ndonjë pjesë të kapitalit, ose ndonjë sigurim, apo ndonjë investim apo interes tjetër në ndonjë Person tjetër;
- (iii) do të lidhë ndonjë marrëveshje fitimi ose rentiere ose marrëveshje tjetër të ngjashme me të cilën të hyrat ose fitimet e GenCo-së ndahen ose mund të ndahen me çdo Person tjetër (përveç (i) Sponsorit HoldCo, mbajtësve të ekuitetit në Sponsorin HoldCo, (ii) në pajtim me Marrëveshjet e Projektit dhe Kontratave të Ndërtimit/Mirëmbajtjes që sigurojnë ndarjen e të hyrave ose fitimit të GenCo-së) ose të lidhë ndonjë kontratë menaxhimi ose marrëveshje të ngjashme me të cilën biznesi ose operacionet e GenCo-së menaxhohen nga çdo Person tjetër (përveç atyre të parashikuar në Marrëveshjet e Projektit); ose
- (iv) do të angazhohet në ndonjë biznes ose veprimtari, të lidhë ndonjë partneritet ose sipërmarrje të përbashkët ose marrëdhënie të ngjashme me ndonjë Person tjetër;

në secilin rast përveç:

- (A) siç parashikohet shprehimisht në dhe në përputhje me Marrëveshjet e Projektit, Dokumentet e Financimit dhe Kontratave të Ndërtimit/Mirëmbajtjes; ose
 - (B) deri në masën që është e arsyeshme në lidhje me ndërmarrjen e detyrimeve të GenCo-së sipas Marrëveshjeve të Projektit, Dokumenteve të Financimit dhe Kontratave të Ndërtimit/Mirëmbajtjes ose në lidhje me Projektin Kosova e Re.
- (b) Pavarësisht nga Seksioni 3.8(a), GenCo do të lejohet të lidhë marrëveshje për dhe të angazhohet në shitjen e nënprodukteve incidentale në Projektin Kosova e Re, duke përfshirë hirin dhe gipsin, me kusht që të ardhurat prej tyre të pasqyrohen në Kreditet e Disponueshmërisë siç parashikohet në Kalendarin 1 (*Tarifat*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë.

3.9 Emërimi i Inxhinierit të Pavarur të Emëruar nga QK-ja

QK-ja do të përdorë përpjekje të arsyeshme komerciale për të emëruar Inxhinierin e Pavarur të Emëruar nga QK-ja nga lista e konsulentëve të paraqitur në Kalendarin 10 në vijim, jo më vonë se gjashtëdhjetë

(60) Ditë pas Datës së Hyrjes në Fuqi. Në masën që QK-ja nuk është në gjendje për ndonjë arsye të emërojë Inxhinierin e Pavarur të Emëruar nga QK-ja nga ata të renditur në Kalendarin 10, atëherë QK-ja do ta emërojë Inxhinierin e Pavarur të Emëruar nga QK-ja pa marrë parasysh listën e konsulentëve të përcaktuar në Kalendarin 10 në vijim, dhe ky Inxhinier i Pavarur i Emëruar nga QK-ja do të jetë i pranueshëm në mënyrë të arsyeshme për GenCo-në (dhe, për aq sa Palët nuk mund të bien dakord jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) Ditë para asaj date në të cilën pritet të ndodhë në mënyrë të arsyeshme Data e Bartjes, atëherë Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja do të caktohet nga Qendra Ndërkombëtare për Ekspertizë e ICC-së për procedim ad hoc në përputhje me Rregullat e ICC-së për Ekspertizë për procedurat ad hoc), për të kryer detyrat e Inxhinierit të Pavarur të Emëruar nga QK-ja të specifikuar në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë dhe Marrëveshjen për Furnizim me Ujë. Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja do të veprojë në mënyrë të pavarur në përmbushjen e funksioneve të tij. Palët bien dakord dhe pranojnë që Inxhinieri i zgjedhur i Pavarur i Emëruar nga QK-ja, duhet të shërbejë, në varësi të aprovimit të Huadhënësve, si inxhinieri i pavarur i mbajtur për të mbështetur kujdesin e duhur të Huadhënësit në lidhje me Projektin Kosova e Re.

3.10 Emërimi i Konsulentit të Pavarur të MS-së

QK-ja do të përdorë përpjekje të arsyeshme komerciale për të emëruar Konsulentin e Pavarur të MS-së nga lista e konsulentëve të paraqitur në Kalendarin 10 në vijim, jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) Ditë pas Datës së Hyrjes në Fuqi. Në masën që QK-ja nuk është në gjendje për ndonjë arsye të emërojë Konsulentin e Pavarur të MS-së nga ata të renditur në Kalendarin 10, atëherë QK-ja do ta emërojë Konsulentin e Pavarur të MS-së pa marrë parasysh listën e konsulentëve të përcaktuar në Kalendarin 10 në vijim, dhe ky Konsulent i Pavarur i MS-së do të jetë i pranueshëm në mënyrë të arsyeshme për GenCo-në (dhe, për aq sa Palët nuk mund të bien dakord jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) Ditë para asaj date në të cilën pritet të ndodhë në mënyrë të arsyeshme Data e Bartjes, atëherë Konsulenti i Pavarur i MS-së do të caktohet nga Qendra Ndërkombëtare për Ekspertizë e ICC-së për procedim ad hoc në përputhje me Rregullat e ICC-së për Ekspertizë për procedurat ad hoc), për të kryer detyrat e Konsulentit të Pavarur të MS-së të specifikuar në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë. Konsulenti i Pavarur i MS-së do të veprojë në mënyrë të pavarur në përmbushjen e funksioneve të tij. Palët bien dakord dhe pranojnë që Konsulenti i zgjedhur i Pavarur i MS-së, duhet të shërbejë, në varësi të aprovimit të Huadhënësve, si konsulent i pavarur mjedisor dhe social i mbajtur për të mbështetur kujdesin e duhur të Huadhënësit në lidhje me Projektin Kosova e Re.

3.11 Prokurimi i Mallrave dhe Shërbimeve

- (a) Përveç në masën e parashikuar ndryshe në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë ose në ndonjë Marrëveshje tjetër të Projektit, GenCo, kur të blejë mallra dhe shërbime që do të ndikojnë në shumën e pagueshme nga KEKR sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, do të përdorë metoda dhe procedura prudente të prokurimit, të cilat do të jenë në përputhje me kërkesat e prokurimit të përcaktuara qartë në Marrëveshjet e Projektit.
- (b) GenCo do të bashkëpunojë me ZRRE-në në çdo hetim nga ZRRE-ja për koston e mallrave dhe shërbimeve që do të ndikojnë në shumën e pagueshme nga KEKR sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë. Bashkëpunimi i tillë do të përfshijë vënien në dispozicion të ZRRE-së të të gjitha regjistrave dhe shënimeve të GenCo që janë në posedim ose nën kontrollin e vet dhe që kanë të bëjnë me prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të tilla, pas njoftimit paraprak me shkrim të paktën pesë (5) Ditë Pune përpara, gjatë orëve të zakonshme të punës dhe në Objektivin e TCKR-së ose lokacionin tjetër të përcaktuar nga GenCo ku ndodhen regjistrat dhe shënimet e tilla.
- (c) Për qëllimet e Seksionit 3.11(a) dhe 3.11(b), kostoja e mallrave dhe shërbimeve do të ketë ndikim në shumën e pagueshme nga KEKR sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë nëse kostoja e këtyre mallrave dhe shërbimeve do të përbëjë bazën, ose do të shkaktojë një rregullim, të shumave të pagueshme nga KEKR në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje për Blerje të Energjisë.

3.12 Ko-gjenerimi; Furnizimi me Nxehtësi

- (a) Sipas Seksionit 3.12(b), pas dorëzimit të njoftimit nga QK-ja tek GenCo që e kërkon një gjë të tillë, GenCo brenda gjashtë (6) Muajve së bashku me KEKR-në menjëherë hyjnë në negociata dhe negocionë në mirëbesim për furnizimin e nxehtësisë nga GenCo për KEKR (me qëllim që KEKR t'ia shesë Termokosit në diskrecionin e vet) sipas një ndryshimi në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë që i lë Palët materialisht në një gjendje të njëjtë ekonomike dhe është në përputhje me:
- (i) çdo ndryshim i tillë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë do të sigurojë neutralitet të të ardhurave dhe fitimit për GenCo, në mënyrë që të ardhurat neto të GenCo nga furnizimi i nxehtësisë dhe reduktimi i kapacitetit gjenerues elektrik për KEKR të jenë jo më pak se të ardhurat dhe fitimet neto të GenCo sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, dhe duke marrë parasysh të gjitha kostot kapitale (nëse ka) ose kostot e ndërlidhura me ndërprerjet e shtuara që rezultojnë nga gjenerimi dhe shitja e energjisë termike dhe interkoneksionet përkatëse dhe të gjitha kostot transaksionale të bëra nga GenCo dhe Huadhënësit (përfshirë rimbursimin e kostove në rast se një amendament i tillë nuk realizohet përfundimisht) në lidhje me negociimin dhe miratimin e një amendamenti të tillë të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë që do t'i rimburohet GenCo-së ose Huadhënësve, sipas rastit; me kusht që, sidoqoftë, të gjitha kostot e tilla të bartura nga GenCo duhet të bëhen në mirëbesim;
 - (ii) asnjë ndryshim i tillë i Marrëveshjes për Blerje të Energjisë nuk mund të hyjë në fuqi dhe nuk do të hyjë në fuqi derisa të aprovohet nga ZRRE dhe të jetë marrë çdo pëlqim ose marrëveshje tjetër që kërkohet nga çdo palë tjetër për të lejuar shitjen e nxehtësisë nga GenCo nga Objekti i TCKR-së për KEKR; dhe
 - (iii) ekzekutimi, dorëzimi dhe kryerja e një ndryshimi të tillë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë dhe modifikimet në Marrëveshjet e Projektit të kërkuara në lidhje me to nuk do të kenë Efekt Material tek GenCo.
- (b) Dokumentet e Financimit mund të parashikojnë që pëlqimi i Huadhënësve do të kërkohet për një ndryshim të tillë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë në pajtim me Seksionin 3.12(a).
- (c) Pavarësisht nga Seksioni 3.12(a), GenCo nuk ka asnjë detyrim të nënshkruajë ndonjë ndryshim të tillë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë në atë masë që kërkohet të marrë pëlqimin e Huadhënësit dhe pëlqimi i tillë nuk jepet, kushtëzohet ose shtyhet pavarësisht nga përpjekjet e arsyeshme komerciale të GenCo-së për të marrë një pëlqim të tillë.

3.13 Pjesëmarrja në Administrimin e Kushteve të Caktuara të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit

3.13.1 Interesat e Linjtit të QK-së

Palët pranojnë dhe pajtohen që QK-ja ka një interes thelbësor për:

- (a) Çmimin e Linjtit dhe pagesa e çdo shume parash sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit;
- (b) çdo veprimtari afariste që mund të rezultojë në Të Hyra të Tjera sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit;
- (c) matjen, marrjen e mostrave dhe analizën e Linjtit të furnizuar sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit;
- (d) kufizimet për çdo angazhim që Mihja e KEK-ut mund të ketë për të furnizuar blerësit e Linjtit përveç GenCo sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit;
- (e) çdo ndryshim ose modifikim të parametrave të cilësisë së linjtit sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit në lidhje me ndonjë ndryshim në ligj;
- (f) çdo kusht tjetër të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit, administrimi i të cilit mund të ketë një efekt material në:

- (i) pagesat që kërkohet të bëhen nga KEKR tek GenCo në pajtim me këtë Marrëveshje;
- (ii) disponueshmërinë e kapacitetit të Objektivit të TCKR-së;
- (iii) furnizimin e besueshëm nga GenCo të Produktit Elektrik Neto të gjeneruar nga Objekti i TCKR-së; ose
- (iv) përmbushjen nga GenCo të çdo afati material të kësaj Marrëveshjeje.

3.13.2 Çmimi i linjtit

GenCo nuk do të ndërmarrë përcaktimin fillestar të Çmimit të Linjtit, as ndonjë rregullim ose ndryshim në Çmimin e Linjtit, as vazhdimësinë e zbatueshmërisë së Çmimit të Linjtit përtej periudhës kohore të parashikuar në Nenin 8 (*Çmimi*) të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit, dhe as nuk do të lejojë të hyjë në fuqi (ose të mbetet, sipas rastit) sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit, përveç dhe derisa Palët dhe Mihja e KEK-ut të kenë rënë dakord me shkrim për sa i përket përcaktimit fillestar, përshtatjes ose ndryshimit, ose vazhdimësinë e zbatueshmërisë së Çmimit të Linjtit në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Furnizim me Linjit.

3.13.3 Ndryshimet në Marrëveshjet ndërmjet GenCo dhe Mihjes së KEK-ut

GenCo pajtohet që, pa pëlqimin paraprak me shkrim të QK-së, nuk do të pajtohet ose të lejojë:

- (a) çdo ndryshim material të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit ose ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet GenCo dhe Mihjes së KEK-ut që mund të ndikojë në Çmimin e Linjtit; ose
- (b) çdo refuzim, shfuqizim, anulim ose pezullim të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit ose ndonjë marrëveshjeje tjetër ndërmjet GenCo dhe Mihjes së KEK-ut që mund të ndikojë në Çmimin e Linjtit (pa kufizuar të drejtën për ndërprerje në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Furnizim me Linjit).

3.13.4 Zbatimi i Marrëveshjeve ndërmjet GenCo dhe Mihjes së KEK-ut

- (a) GenCo do të zbatojë kushtet e Marrëveshjes për Furnizim me Linjit dhe të çdo marrëveshjeje tjetër midis GenCo-së dhe Mihjes së KEK-ut që mund të ndikojnë në Çmimin e Linjtit në një mënyrë që përputhet me Praktikën Prudente të Shërbimeve Publike dhe Praktikën Prudente Minerare, sipas rastit.
- (b) Në rast se GenCo nuk zbaton kushtet e Marrëveshjes për Furnizim me Linjit ose të ndonjë marrëveshjeje tjetër ndërmjet GenCo-së dhe Mihjes së KEK-ut që mund të ndikojnë në Çmimin e Linjtit, pastaj pasi QK-ja e njofton me shkrim GenCo-në për dështimin dhe sipas Seksionit 3.13.7, zgjidhja e çdo kontesti mes Palëve, QK-ja do të ketë të drejtën të ndërhyjë për qëllime të zbatimit nga GenCo të çfarëdo dispozite të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit ose të ndonjë marrëveshjeje tjetër ndërmjet GenCo-së dhe Mihjes së KEK-ut që mund të ndikojnë në çmimin e Linjtit, siç mund të jetë rasti, që lidhet në ndonjë mënyrë me ndonjë nga Interesat e Linjtit të QK-së.

3.13.5 Gjenerimi i të Hyrave të Tjera

- (a) Qeveria mund të marrë pjesë në negociatat në lidhje me çdo aktivitet të biznesit të GenCo që mund të rezultojë në të Hyra të Tjera prej më shumë se 750,000.00 euro në vit ose 2,000,000.00 euro në total.
- (b) GenCo nuk do të ndërmarrë asnjë veprimtari afariste që mund të rezultojë në të Hyra të Tjera sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit prej më shumë se € 750,000.00 në vit ose € 2,000,000.00 në total pa pëlqimin paraprak me shkrim të QK-së, dhe pëlqimi i tillë të mos privohet në mënyrë të paarsyeshme.

3.13.6 Blerjet e tjera të Mihjes së KEK-ut nga GenCo

- (a) QK-ja, sipas zgjedhjes së vet, mund të marrë pjesë në negociatat lidhur me blerjen nga Mihja e KEK-ut të çdo malli apo shërbimi të GenCo që mund të ndikojë në Çmimin e Linjtit.
- (b) GenCo nuk do të lidhë ndonjë marrëveshje me Mihjen e KEK-ut për blerjen nga Mihja e KEK-ut të ndonjë malli ose shërbimi të GenCo që mund të ndikojë në Çmimin e Linjtit pa pëlqimin paraprak me shkrim të QK-së, dhe pëlqimi i tillë të mos privohet në mënyrë të paarsyeshme.

3.13.7 E drejta për Kontest

Në rast se GenCo nuk zbaton ndonjë dispozitë të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit ose ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet GenCo-së dhe Mihjes së KEK-ut që mund të ndikojnë në Çmimin e Linjtit që prek një nga më Interesat në Linjit të QK-së, atëherë, pas një kërkesë me shkrim nga QK-ja për zbatimin e një dispozite të tillë në përputhje me Seksionin 3.13.4, QK-ja ka të drejtë:

- (a) të bashkohet me çdo procedim të arbitrazhit të iniciuar nga GenCo, sipas rastit, sipas Nenit 20 (*Zgjidhja e Kontesteve*) të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit ose sipas dispozitave të zgjidhjes së kontesteve të çfarëdo marrëveshjeje midis GenCo dhe Mihjes së KEK-ut që mund të ndikojë në Çmimin e Linjtit; ose
- (b) të fillojë procedimet, në emër të vet dhe kundër Mihjes së KEK-ut, sipas Nenit 20 (*Zgjidhja e Kontesteve*) të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit ose sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër midis GenCo dhe Mihjes së KEK-ut që mund të ndikojë në Çmimin e Linjtit.

3.13.8 Njoftimet

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera të kërkuara ose të lejuara për t'u dhënë nga GenCo sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit (përfshirë çdo faturë të kërkuar ose të lejuar për t'u dorëzuar sipas saj, dhe rezultatet e çdo testimi ose analize të Linjtit të furnizuar) do të dërgohen si kopje në QK në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtën kohë kur një njoftim i tillë i jepet Mihjes së KEK-ut, dhe Marrëveshja për Furnizimin me Linjit do të kërkojë të njëjtën gjë nga Mihja e KEK-ut.

Neni 4 Pëlqimet

4.1 Pëlqimet e GenCo-së

Që nga data e hyrjes në fuqi, GenCo do të aplikojë për, do të ndjekë me zell, do të përdorë përpjekje të arsyeshme komerciale për të siguruar dhe, pas marrjes, do të përdorë përpjekje të arsyeshme komerciale për të ruajtur (dhe, aty ku është e aplikueshme, do të bëjë që Kontraktorët e GenCo-së të përdorin përpjekje të arsyeshme komerciale për prokurimin dhe mirëmbajtjen) të gjitha pëlqimet e GenCo-së.

4.2 Aplikimet nga GenCo-ja për Pëlqime

4.2.1 Parashtrimi i Aplikimeve nga GenCo

GenCo do të bëjë ose do të shkaktojë që të bëhen, në kohën e duhur, të gjitha aplikimet (nëse janë aplikimet fillestare ose rinovuese) për Pëlqimet e GenCo-së në Formularin e Paraparë të Pëlqimit dhe me Tarifën e Paraparë të Pëlqimit për Autoritetin përkatës Publik dhe duhet të ndjekë të gjitha kërkesat e tilla.

4.2.2 Mosdiskriminimi

Përdorimi i termit "jodiskriminues" ose "diskriminues" në këtë Marrëveshje nuk ka për qëllim të ndalojë ose kufizojë në asnjë mënyrë QK-në ose ndonjë Autoritet Publik që të bëjë dallime racionale ndërmjet palëve ose të përdorë masa, të vendosë kushte ose të zbatojë kërkesave që janë, në çdo rast, të destinuara ose të dizajnuara për të avancuar qëllimet e programit që zbatohet nga QK-ja ose Autoriteti Publik ose të një Pëlqimi. Megjithatë, ka për qëllim të ndalojë përdorimin e Autoritetit Publik, mbi pëlqimet e GenCo-së, ndër të tjera, për të privuar GenCo nga përfitimet e kësaj Marrëveshjeje ose të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë me aplikimin e një standardi më të lartë ose të ndryshëm për GenCo (vetëm ose së bashku me të tjerë në një klasë të vogël) krahasuar me të tjerët në pozitë të ngjashme ose në krahasim me praktikën e pranuar ndërkombëtare.

4.3 Statusi i Aplikimeve për Pëlqim

- (a) GenCo do të dorëzojë në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, të paktën çdo tremujor, raporte që tregojnë statusin e çdo aplikimi të Pëlqimit të GenCo atëherë të pazgjidhur, njoftimet për dhënien ose mohimin e çdo Pëlqimi të GenCo ose për rinovimin e Pëlqimi të GenCo-së dhe njoftimet për çdo shkelje të ndonjë Pëlqimi të GenCo-së.
- (b) Çdo raport duhet të përfshijë kopjet e të gjitha aplikimeve dhe njoftimeve të diskutuara në raport që nuk janë ofruar me një raport të mëparshëm. Seksioni i parë i secilit raport gjithashtu do të përmbledhë çdo problem që atëherë njihet nga GenCo lidhur me çdo Pëlqim material të GenCo-së ose aplikim për Pëlqim të GenCo-së që mund të ndikojë në performancën e GenCo sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes për Blerje të Energjisë.
- (c) Në rast të ndonjë Skadimi të Pëlqimit, GenCo do të dorëzojë në QK një raport sipas këtij Seksioni 4.3 brenda tre (3) Ditëve të Punës pasi të jetë bërë i vetëdijshëm për të.

4.4 Përkrahja e QK-së për Marrjen e Pëlqimeve

- (a) Me kërkesën e GenCo, QK do të përkrahë dhe do të shkaktojë NP-të e Specifikuara (në masën që ato janë Ndërmarrje Publike) të përkrahin dhe të përdorin të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të përshpejtuar shqyrtimin e kërkesave të GenCo për Pëlqimet ose ri-lëshimet e parashtresave në bazë të Seksionit 4.1, dhe lëshimin e tyre në kohë ose ri-lëshimin e një Pëlqimi që i nënshtrohet Skadimit të Pëlqimit nga çdo Autoritet Publik.
- (b) Çdo kërkesë për përkrahje sipas këtij Seksioni 4.4 do të bëhet nga GenCo dhe do të shoqërohet me kopje të aplikimit për Pëlqimin, çdo njoftim që lëshimi ose ri-lëshimi i Pëlqimit është mohuar ose shtyrë, dhe një deklaratë e përpjekjeve të GenCo-së për marrjen e lëshimit ose ri-lëshimit të Pëlqimit deri më atë datë.

4.5 Kushtet e Pëlqimeve

QK-ja ose ndonjë Autoritet Publik mund të vendosë terma dhe kushte të arsyeshme jodiskriminuese për dhënien ose përtëritjen e cilitdo Pëlqimi të GenCo-së, siç janë në pajtim me ligjet e Kosovës dhe siç zbatohen për objekte të tilla si ato të operuara nga GenCo në mirëbesim dhe në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtarisht, dhe vendosja e këtyre termave dhe kushteve nuk përbën në vetvete një shkelje të kësaj Marrëveshjeje nga QK-ja, një Ngjarje të Forcës Madhore sipas Nenit 21 (përveç nëse përbën një Ndryshim në Ligj ose është diskriminues), ose një Ngjarje të Mospërbushjes nga QK-ja sipas Seksionit 19.2. GenCo do të respektojë të gjitha këto terma dhe kushte. Nëse GenCo nuk i përmbahet ndonjë termi ose kushti të ndonjë Pëlqimi, atëherë QK-ja ose ndonjë Autoritet Publik mund të ushtrojë çdo kompetencë sipas ligjeve të Kosovës në lidhje me këtë dështim dhe ushtrimi i tillë nuk përbën në vetvete një shkelje të kësaj Marrëveshjeje nga QK-ja, një Ngjarje të Forcës Madhore në bazë të Seksionit 21, ose një Ngjarje të Mospërbushjes nga QK-ja sipas Seksionit 19.2; me kusht që, sidoqoftë, në lidhje me të gjitha Pëlqimet e tilla të GenCo-së lëshuara nga QK-ja apo ndonjë Autoritet Publik, QK-ja nuk do ndërpresë, dhe QK-ja do të sigurohet (me kusht që QK-ja ka autoritet të tillë sipas ligjeve të Kosovës) që asnjë Autoritet i tillë Publik nuk do të ndërpresë para datës së skadimit ose ta revokojë Pëlqimin e tillë të GenCo-së më herët se më e sprasmja nga:

- (a) tridhjetë (30) Ditë (me kusht që, sidoqoftë, nëse GenCo fillon marrjen e masave të duhura për të kuruar dështimin e tillë brenda periudhës së tillë prej tridhjetë (30) Ditësh, dhe më pas me zell vazhdon ta kurojë dështim të tillë, periudha e tillë do të zgjatet me nëntëdhjetë (90) Ditë shtesë) pas dorëzimit në GenCo të njoftimit me shkrim nga QK-ja ose Autoriteti i tillë Publik për një dështim të tillë; dhe
- (b) periudha kohore, nëse ka, që duhet të skadojë sipas ligjeve të Kosovës ose Pëlqimi përkatës i GenCo-së para ndërprerjes ose revokimit të parakohshëm të Pëlqimit të tillë të GenCo-së.

Neni 5

- 77 -

Ndërtimi, Operimi, Mirëmbajtja dhe Personeli; Të Drejtat e QK-së në Rastin e Ndalimit të Operacioneve

5.1 Ndërtimi, Operimi dhe Mirëmbajtja e Objekteve; Emërimi i Kontraktorëve

5.1.1 Ndërtimi, Operimi, dhe Mirëmbajtja e Objekteve

GenCo do të zhvillojë, dizajnojë, ndërtojë, financojë, posedojë, operojë dhe mirëmbajë Objektivin e TCKR-së; me kusht që, sidoqoftë, GenCo të kontraktojë me:

- (a) Kontraktorin e IPN-së, në pajtim me Tenderin (Impianti), për të zhvilluar, dizajnuar dhe ndërtuar Objektivin e TCKR-së, dhe nëse GenCo zgjedh të veçojë prokurimin e Kontraktorit të Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara në pajtim me Seksionet 3.9.5(g) dhe 15.2(a) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, me Kontraktorin e Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara që të realizojë Sanimin e Kushteve Mjedisore të Specifikuara, në pajtim me Tenderin (Mjedisor);
- (b) Kontraktori i MAGJ-së, në pajtim me Tenderin (Impianti), për të ofruar shërbim afatgjatë të mirëmbajtjes për Objektivin e TCKR-së;
- (c) Kontraktori i OM-së për të ofruar shërbimin e operimit dhe mirëmbajtjes të Objektivit të TCKR-së;
- (d) Kontraktori i Shërbimeve Administrative për të ofruar shërbime administrative;
- (e) Kontraktori i IPN-së i Punimeve të Kyçjes së GenCo-së, për inxhinierinë dhe ndërtimin e Aseteve të Kyçjes të GenCo-së, Asetet e Kyçjes së Re të KOSTT-it ose Asetet për Përforcimin e Infrastrukturrës (secili siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë)

në secilin rast në përputhje me Seksionin 23.14.

5.1.2 Kontrata e IPN-së, Kontraktori i IPN-së, Marrëveshja e MAGJ-së, dhe Kontraktori i MAGJ-së

- (a) GenCo do të njoftojë QK-në për emrin dhe shtetësinë e:
 - (i) kontraktorit të inxhinierisë, prokurimit dhe ndërtimit që synon të emërojë si Kontraktor të IPN-së, dhe çdo Nënkontraktor Madhor të një kontraktori të tillë të inxhinierisë, prokurimit dhe ndërtimit, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) Ditë pune para ekzekutimit të Kontratës së IPN-së ;
 - (ii) nëse GenCo zgjedh të veçojë prokurimin e Kontraktorit të Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara në pajtim me Seksionet 3.9.5(g) dhe 15.2(a) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, të kontraktorit të sanimit mjedisor që synon të emërojë si Kontraktor të Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara dhe të çdo Nënkontraktori Madhor të një kontraktori të tillë të sanimit të mjedisit, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) Ditë pune para ekzekutimit të Kontratës për Sanimin e Kushteve Mjedisore të Specifikuara;
 - (iii) kontraktorit të mirëmbajtjes afatgjatë që synon ta emërojë si Kontraktor të MAGJ-së dhe të çdo Nënkontraktori Madhor të një kontraktori të tillë të operimit dhe mirëmbajtjes, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune para ekzekutimit të Marrëveshjes së MAGJ-së; dhe
 - (iv) kontraktorit të inxhinierisë, prokurimit dhe ndërtimit që synon të emërojë si Kontraktor të IPN-së të Punimeve të Kyçjes së GenCo-së dhe të çdo Nënkontraktori Madhor të një kontraktori të tillë të inxhinierisë, prokurimit dhe ndërtimit, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) Ditë pune para ekzekutimit të Kontratës së IPN-së të Punimeve të Kyçjes së GenCo-së.
- (b) QK-ja mund të njoftojë GenCo-në:
 - (i) përpara datës së propozuar të ekzekutimit të Kontratës së IPN-së për të cilën kundërshton Kontraktorin e propozuar të IPN-së ose ndonjë Nënkontraktor Madhor të tij;

- (ii) para datës së propozuar të ekzekutimit të Kontratës për Sanimin e Kushteve Mjedisore të Specifikuara për të cilën kundërshton Kontraktorin e propozuar të Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara ose ndonjë Nënkontraktor Madhor të tij;
- (i) përpara datës së propozuar të ekzekutimit të Kontratës së MAGJ-së për të cilën kundërshton Kontraktorin e propozuar të MAGJ-së ose ndonjë Nënkontraktor Madhor të tij;
- (iv) përpara datës së propozuar të ekzekutimit të Kontratës së IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së për të cilën kundërshton Kontraktorin e propozuar të IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së ose ndonjë Nënkontraktor Madhor të tij,

për shkak se sipas zgjedhjes së vet, emërimi i të propozuarit si Kontraktor i IPN-së, Kontraktor i Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Kontraktor i MAGJ-së ose Kontraktor i IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së ose ndonjë Nënkontraktor Madhor të tij, sipas rastit, do të binte ndesh me interesat e sigurisë kombëtare të Kosovës; me kusht që, sidoqoftë, duke mos kundërshtuar të propozuarin si Kontraktor të IPN-së, Kontraktor të Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Kontraktor të MAGJ-së ose Kontraktor të IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së ose ndonjë Nënkontraktor Madhor të tij, siç mund të jetë rasti, QK-ja nuk do të interpretohet se e ka lehtësuar GenCo-në prej detyrimeve të veta sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes për Blerje të Energjisë. Nëse QK-ja nuk e kundërshton të propozuarin si Kontraktor të IPN-së, Kontraktor të Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Kontraktor të MAGJ-së ose Kontraktor të IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së, ose ndonjë Nënkontraktor Madhor të tij, sipas rastit, brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës pas marrjes së njoftimi i dhënë në pajtim me Seksionin 5.1.2(a), atëherë QK-ja do të konsiderohet se nuk e kundërshton identitetin ose shtetësinë e të propozuarit si Kontraktor i IPN-së, Kontraktor i Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Kontraktor i MAGJ-së ose Kontraktor i IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së ose ndonjë Nënkontraktor Madhor të tij, siç mund të jetë rasti. Pavarësisht nga sa më sipër, në lidhje me Tenderin (Impianti) ose Tenderin (Kyçja) të realizuar nga GenCo, GenCo mund të përmbushë detyrimet e veta në vijim nëse një ofertues merr para-aprovimin siç specifikohet në Seksionin 6.3.3(c) të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë, dhe GenCo ka të drejtë të këshillojë ofertuesin për arsyet e diskualifikimit të tij.

- (c) GenCo do t'i ofrojë QK-së njoftim me shkrim për çdo amendament ose ndryshim të propozuar (një "**Amendament Material i Propozuar**") në Kontratën e IPN-së, Kontratën e Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Marrëveshjen e MAGJ-së ose Kontratën e IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së që do të rezultonte në një ndryshim në Kontratën e IPN-së, Kontratën e Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Marrëveshjen e MAGJ-së ose Kontratën e IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së ose ndonjë Nënkontraktor Madhor të vet, siç mund të jetë rasti, ose ndonjë Nënkontraktor Madhor në ndonjë nga të mësipërmet në masën që ndryshimi i tillë është materialisht i lidhur me çështjet e parashtruara në këtë Seksion 5.1, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) Ditë Pune para ekzekutimit të Kontratës së ndryshuar ose të plotësuar të IPN-së, Kontratës së Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Marrëveshjes së MAGJ-së ose Kontratës së IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së, siç mund të jetë rasti, duke parashtruar ndryshimet e propozuara.
- (d) QK-ja mund të njoftojë GenCo-në para datës së propozuar të ekzekutimit të Amendamentit Material të Propozuar në Kontratën e IPN-së, Kontratën e Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Marrëveshjes së MAGJ-së ose Kontratës së IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së, sipas rastit, objekt i Amendamentit të Propozuar Material, sepse, sipas gjykimit të tij, Kontraktori i IPN-së, Kontraktori i Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Kontraktori i MAGJ-së ose Kontraktori i IPN-së i Punimeve të Kyçjes së GenCo-së, ose ndonjë Nënkontraktor Madhor i vet, siç mund të jetë rasti, bie ndesh me interesat e sigurisë kombëtare të Kosovës; me kusht që, sidoqoftë, duke mos kundërshtuar amendamentin e propozuar materiale brenda dhjetë

(10) ditëve të punës pas marrjes së njoftimit të përshkruar në fjalinë e parë të këtij seksioni 5.1.2(d), atëherë QK nuk do të interpretohet se ka aprovuar Amendamentin Material të Propozuar, Kontratën e IPN-së, Kontratën e Sanimit Mjedisor të Kushteve të Specifikuara, Marrëveshjen e MAGJ-së ose Kontratën e IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së, dhe as nuk e ka lehtësuar GenCo-në në asnjë mënyrë nga detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje ose Marrëveshjes për Blerje të Energjisë.

- (e) Brenda tridhjetë (30) Ditëve pas ekzekutimit të secilës prej Kontratës së IPN-së, Kontratës së Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Marrëveshjes së MAGJ-së, Kontratës së IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së dhe çdo Amendamenti Material të Propozuar, GenCo do t'i dorëzojë QK-së një kopje Kontratës së IPN-së, Kontratës së Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Marrëveshjes së MAGJ-së, ose Kontratës së IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së, sipas rastit, dhe secilin Amendament të tillë Material të Propozuar; me kusht që, sidoqoftë, dispozitat e konfidencialitetit të përfshira në këtë Marrëveshje do të zbatohen ndaj Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe përfaqësuesit të saj në lidhje me çdo informacion konfidencial ose të pronarit të shqyrtuar në Kontratën e IPN-së, Kontratën e Sanimit të Kushteve Mjedisore të Specifikuara, Marrëveshjen e MAGJ-së dhe Kontratën e IPN-së për Punimet e Kyçjes së GenCo-së.
- (f) QK do të jetë në pajtim me dispozitat e Seksionit 3.9.3(d) (*Ndërfaqja me Konsorciumet Ofertuese të IPN-së/MAGJ-së*), Seksionit 3.9.6 (*Përzgjedhja e Konsorciumit Ofertues fitues të IPN-së/MAGJ-së*) dhe Seksionit 3.11.5(e) (*Përzgjedhja e Ofertuesit Fitues*) dhe Seksionit 6.3.5(e) (*Përzgjedhja e Ofertuesit Fitues*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, sikur këto dispozita të ishin të zbatueshme për QK dhe të ishin përcaktuar këtu.

5.2 Ndalja e Operimit të Objektivit të TCKR-së

5.2.1 *Bartja e Operacioneve-E Drejta*

- (a) Nëse, pas Datës së Operacioneve Komerciale, pa pëlqimin paraprak me shkrim të KEKR-së, GenCo do të ketë pushuar së deklaruar Kapacitetin e Disponueshëm të Deklaruar (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) ose të ketë pushuar të jetë në pajtueshmëri materiale me një Udhëzim të Programimit të një Dite Përpara, Udhëzim të Rishikuar të Programimit të një Dite Përpara, ose Udhëzim për Dispeçerimin Elektrik në Kohë Reale (në secilën siç është përcaktuar në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) për një periudhë prej pesëmbëdhjetë (15) ose më shumë Ditësh me radhë në kundërshtim me detyrimet e GenCo-së sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë dhe një mënyrë që ndikon materialisht dhe negativisht në besueshmërinë e Rrjetit të KOSTT-it ose furnizimin me energji elektrike për përdoruesit fundorë në Kosovë, përveçse për shkak të:
 - (i) ndonjë akti të KEKR-së ose QK-së që shkakton të gjithë ose ndonjë pjesë të mos-pajtueshmërisë së tillë të GenCo-së,
 - (iii) një Ndërprerje e Programuar, një Ndërprerje e Detyruar ose Ndërprerje e Pjesëshme e Detyruar, ose një Ndërprerje e Mirëmbajtjes
 - (iii) operimit të rrjetit të KOSTT-it jashtë parametrave normalë të operimit në mënyrë të tillë që të ndikojë materialisht dhe negativisht në variacionet e GenCo-së në Frekuencën e Rrjetit të KOSTT-it (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) jashtë Karakteristikave Operative të Kontraktuara (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë), variacionet në tensioni e Rrjetit të KOSTT-it jashtë Karakteristikave Operative të Kontraktuara (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë), ose faktori i energjisë në Pikën e Kyçjes është jashtë Karakteristikave Operative të Kontraktuara (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë), ose
 - (iv) ndodhjes së: (i) një Ngjarje të Mospërmbushjes nga Furnizuesi me Ujë (siç përcaktohet në

Marrëveshjen për Furnizim me Ujë) sipas Marrëveshjes për Furnizim me Ujë; (ii) një Ngjarje të Mospërmbushjes nga Mihja e KEK-ut (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Deponim të Hirit dhe Gipsit) sipas Marrëveshjes për Deponimin e Hirit dhe Gipsit ose një Ngjarje të Mospërmbushjes nga Mihja e KEK-ut (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Furnizim me Linjit) sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit; (iii) një Ngjarje të Mospërmbushjes nga KOSTT-i sipas Marrëveshjes së Kycjes; (iv) një Ngjarje të Mospërmbushjes nga KEKR-ja (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; ose (v) çdo ngjarje tjetër të mospërmbushjes nga ndonjë NP tjetër e Specifikuar sipas ndonjë marrëveshjeje tjetër të projektit, ose

(v) një Ngjarje të Forcës Madhore,

atëherë QK-ja, sipas kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Drejtpërdrejtë dhe kufizimeve të përcaktuara në këtë Seksion 5.2, ka të drejtë të hyjë në Objektivin e TCKR-së dhe ta operojë atë, ose të emërojë një operator palës të tretë për të hyrë në Objektivin e TCKR-së dhe ta operojë deri sa GenCo të demonstrojë për kënaqësinë e arsyeshme të QK-së se GenCo mund dhe do të rifillojë operimin normal të Objektivit të TCKR-së; me kusht që, sidoqoftë, nëse GenCo nuk demonstruar për kënaqësinë e arsyeshmë të QK-së se GenCo mund dhe do të rifillojë operimin normal të Objektivit të TCKR-së brenda dy (2) Muajve nga data që QK-ja ose operatori i saj palë e tretë, sipas rastit, ka hyrë në Objektivin e TCKR-së dhe ka filluar operimin e tij, QK-ja do t'i dorëzojë GenCo-së menjëherë një Njoftim për Ndërprerje në përputhje me Seksionin 19.3 dhe kjo Marrëveshje do të ndërpritet në përputhje me të (por pa kufizuar të drejtat e QK-së sipas këtij Seksioni 5.2).

(b) Asgjë në këtë Seksion 5.2.1 nuk kufizon të drejtën e GenCo-së për të vazhduar të ketë qasje të arsyeshme në Objektivin e TCKR-së gjatë çdo ndërhyrjeje nga QK-ja ose i emëruari i saj për qëllime të kurimit të ndonjë defekti në Objektivin e TCKR-së.

5.2.2 *Bartja e Operacioneve-Detyrimet*

Gjatë çdo periudhe që QK-ja ose i propozuari i saj, sipas rastit, do ta operojë Objektivin e TCKR-së në përputhje me Seksionin 5.2.1:

- (a) QK-ja ose i emëruari i saj, sipas rastit, do ta operojë Objektivin e TCKR-së sipas Karakteristikave Operative të Deklaruara (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë), Ligjeve të Kosovës, Kodit të Rrjetit, Kodit të Njehsimit, Praktikave Prudente të Shërbimeve Publike dhe Praktikave Prudente Elektrike (siç përcaktohen në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) dhe përndryshe siç kërkohet sipas Marrëveshjeve të Projektit, kërkesave operative dhe raportuese sipas Dokumenteve të Financimit që janë të zbatueshme për GenCo dhe Kontraktorët e GenCo dhe Kontratat e Ndërtimit/Mirëmbajtjes;
- (b) QK-ja do të përballojë të gjitha kostot e ushtrimit të tillë të të drejtave të ndërhyrjes dhe operimit të Objektivit të TCKR-së (duke përfshirë kostot e fikse dhe variabile të derivatit dhe kostot që lidhen me çdo policë sigurimi që merr në lidhje me periudhën e operimit të saj); dhe
- (c) QK-ja do t'i paguajë GenCo-së një shumë të llogaritur duke shumëzuar (i) "% e borxhit" siç përcaktohet në Kalendarin 1 (*Tarifa*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, me (ii) shumën e Pagesave të Disponueshmërisë që do t'i takonin GenCo-së për një periudhë të tillë sikur GenCo ta kishte operuar Objektivin e TCKR-së në nivelin e plotë të disponueshmërisë së atëhershme.

5.2.3 *Mbulimi i Sigurimeve Gjatë Bartjes së Operacioneve; Dëmshpërblimi Gjatë Bartjes së Operacioneve*

(a) Pavarësisht nga Seksioni 5.2.1 dhe Seksioni 5.2.2 i mësipërm dhe çdo dispozitë tjetër në këtë Marrëveshje për të kundërtën, nëse ndonjë mbulim sigurimi që është marrë nga GenCo dhe është përcaktuar në Kalendarin 5 (*Sigurimet*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë nuk është në fuqi gjatë gjithë kohës që QK-ja operon Objektivin e TCKR-së në pajtim me këtë Seksion 5.2 ose nuk e

mbulon një operim të tillë, atëherë QK-ja nuk do të hyjë dhe as nuk do ta operojë Objektin e TCKR-së, dhe do të ndërpresë menjëherë operimin dhe menjëherë do ta lëshojë posedimin e Objektit të TCKR-së, sipas rastit, nëse dhe deri në atë kohë që QK-ja:

- (i) siguron dhe pastaj mban vazhdimisht një sigures me "gjendjes financiare të shëndoshë", siç përshkruhet në Seksionin 21.1.1(c) (*Kërkesat e Sigurimeve*) të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë, dhe siguron dëshmi me shkrim për GenCo për prokurimin e policave të sigurimit të përcaktuara në Kalendarin 5 (*Sigurimet*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë me terma dhe kushte që në të gjitha aspektet materiale (përfshirë zbritjet, mbështetjet, kushtet për risigurim dhe letrat me vlerë në favor të Huadhënësve) janë në përputhje me termat dhe kushtet e policave të sigurimit të llojit që është prokuruar më së fundi nga GenCo; ose
 - (ii) bie dakord me shkrim për të mbrojtur, zhvendësuar dhe mbajtur të padëmtuar GenCo-në nga dhe kundër çdo humbjeje ose dëmtimi të ndodhur si rezultat i një ngjarjeje që ka ndodhur gjatë periudhës së operimit të QK-së të Objektit të TCKR-së, në masën që kjo humbje ose dëmtim do të ishte mbuluar nga sigurimi i përcaktuar në Kalendarin 5 (*Sigurimet*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë që GenCo së fundmi ka pasur në fuqi para se QK-ja ta operonte Objektin e TCKR-së, duke përfshirë, por pa u kufizuar në humbjen ose dëmtimin e Objektit të TCKR-së dhe humbjen ose dëmtimin që rezulton nga pretendimet e palëve të treta.
- (b) Në rast se QK-ja, në çdo kohë, merr sigurim sipas këtij Seksioni 5.2, GenCo dhe Huadhënësit (për sa kohë që ata kanë një interes të sigurueshëm për Objektin e TCKR-së) do të emërohen si të siguruar shtesë dhe Huadhënësit (për sa kohë që ata kanë një interes të sigurueshëm në Objektin e TCKR-së) do të emërohen si përfituesit e parë dhe të vetëm të pagesave të humbjes për çdo sigurim të tillë në masën e interesit të tyre.
 - (c) Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje, në asnjë rast QK-ja ose GenCo ose ndonjë Palë e QK-së ose ndonjë Palë e GenCo-së nuk do të dëmshpërblehen në atë masë që Humbjet janë shkaktuar nga neglizhenca e tyre ose nga sjelljet e pahijshme ose shkelja e kushteve të kësaj Marrëveshjeje ose çdo Marrëveshje të Projektit, dhe në asnjë rast QK-ja ose GenCo-ja ose ndonjë Palë e QK-së ose ndonjë Palë e GenCo-së nuk do të dëmshpërblehen për asnjë Humbje deri në masën që kjo Palë ka marrë tashmë të ardhura nga sigurimet ose të ardhurat nga një palë e tretë për këtë, ose ka marrë apo ka pasur të drejtë për pagesa nga QK-ja ose një NP e Specifikuar sipas një Marrëveshjeje tjetër të Projektit për të.
 - (d) Detyrimet e dëmshpërblimit të çdo Pale në vijim do të zvogëlohen në shumën dhe në lidhje me çdo rikuperim të sigurimeve ose rikuperime të tjera të palëve të tretë nga një Palë e dëmshpërbllyer për Humbjet e dëmshpërbllyera sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse një palë bën pagesa në përputhje me detyrimet e veta të dëmshpërblimit në lidhje me shumat për të cilat një sigures ose një palë tjetër e tretë mund të jetë ligjërisht përgjegjëse, kjo Palë do të konsiderohet, në masën e duhur, subrogati me ekuitet i Palës së dëmshpërbllyer dhe/ose i caktuari kontraktual ose ligjor në lidhje me të drejtën për të ndjekur rikuperimin e shumave të tilla nga siguresi ose pala e tretë, deri në masën e këtyre të drejtave.
 - (e) Për shmangien e dyshimit, kushtet e kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohen për të zvogëluar, dëmtuar, mohuar, modifikuar ose zëvendësuar kushtet e çdo police të sigurimit të aplikueshme që gjithashtu siguron mbulim për Humbjet e dëmshpërbllyera. Pavarësisht nga sa më sipër, zbatueshmëria e ndonjë police sigurimi ose dështimi i një siguresi për të përmbushur detyrimet e veta në lidhje me Humbjen e dëmshpërbllyer nuk do të justifikojë, shtyjë ose zvogëlojë detyrimet e Palës dëmshpërbllyese në asnjë aspekt, as nuk do të justifikojnë mospërmbushjen e detyrimeve të dëmshpërblimit të Palës së tillë; sidoqoftë, në përcaktimin e detyrimeve përkatëse ndërmjet Palës dëmshpërbllyese dhe çdo siguresi, pas pagesave të një Pale në përputhje me detyrimet e veta të

dëmshpërblimit, si dhe në lidhje me çdo kontest ndërmjet Palës së tillë dëmshpërblyese dhe siguruesit të tillë, sa i përket detyrimit të siguruesit për të rimbursuar Palën dëmshpërblyese ose përndryshe të sigurojë mbulim për Humbje të dëmshpërblyer, çdo sigurim i aplikueshëm (me përjashtim të të gjitha zbritjeve ose mbajtjeve të zbatueshme) do të konsiderohet primar ndaj detyrimeve të dëmshpërblimit të përcaktuar këtu, dhe detyrimet e dëmshpërblimit të përcaktuara këtu do të konsiderohen në mënyrë specifike si teprica nga çdo sigurim i tillë i aplikueshëm, por vetëm në masën e shumave të paguara në të vërtetë për të siguruarin sipas këtij sigurimi, dhe me kuptimin e mëtejshëm se Pala dëmshpërblyese do të jetë në të gjitha rastet përgjegjëse për humbjen e dëmshpërblyer, në masën e detyrimeve të veta të dëmshpërblimit, brenda çdo të zbritshme dhe mbajtje të aplikueshme të parashtruar në çdo sigurim të tillë të aplikueshëm.

Neni 6

Dekomisionimi i Objektivit të TCKR-së

6.1 Dekomisionimi i Objektivit të TCKR-së

- (a) Në çdo kërkesë për Licencë Gjenerimi, GenCo do të njoftojë ZRRE-në për bartjen e parashikuar të Licencës së Gjenerimit tek QK-ja ose i caktuari i saj pas ndërprerjes të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë, si dhe do të paraqesë një plan të përgjithshëm të aprovuar në mënyrë të arsyeshme nga ana e QK-së për dekomisionimin e Objektivit të TCKR-së që do të zbatohet nga mbajtësi i Licencës së Gjenerimit në fund të jetës së dobishme të Objektivit të TCKR-së, në masën që kërkohet sipas Ligjeve të Kosovës.
- (b) Pas përfundimit të jetës së dobishme të Objektivit të TCKR-së (që llogaritet të jetë përafërsisht dyzet (40) Vite nga Data e Operacioneve Komerciale), QK-ja ose mbajtësi aktual i Licencës së Gjenerimit do të dekomisionojë Objektivin e TCKR-së në përputhje me Standardet e Zbatueshme dhe Praktikrat Prudente të Shërbimeve Publike.
- (c) GenCo nuk do të ketë asnjë detyrim të paguajë kostot e dekomisionimit në lidhje me Objektivin e TCKR-së ose përndryshe në lidhje me Projektin Kosova e Re.

Neni 7

Transferimi i Fondeve

7.1 Transferimi i Fondeve

QK-ja do të lejojë bartjen e lirë të të gjitha fondeve dhe shlyerjeve financiare të nevojshme për zbatimin dhe realizimin e Projektit Kosova e Re siç parashihet me këtë Marrëveshje, Marrëveshjet e tjera të Projektit, Kontratat e Ndërtimit/Mirëmbajtjes dhe Dokumentet e Financimit (që për shmangien e dyshimit, përfshin aftësinë e Sponsorit HoldCo, ose të Sponsorit Sipëror, për të riatdhesuar çdo kapital, dividendë, shpërndarje, ose të ardhura ose pagesa të tjera nga GenCo, dhe do të sigurojë të drejta të plota, në kohë dhe pa barra për riatdhesim në lidhje me këto fonde, në çdo rast në përputhje me Ligjin për Investimet e Huaja, 2013 (Nr.04/L-220), në fuqi në Datën e Ekzekutimit.

7.2 Mirëmbajtja e Llogarive

GenCo do të lejohet të mbajë jashtë Kosovës llogaritë e kërkuara nga Marrëveshjet e Projektit, Dokumentet e Financimit, Kontratat e Ndërtimit/Mirëmbajtjes ose tjetër.

Neni 8

Mjedisi dhe Siguria

8.1 Pajtueshmëria me Standardet Mjedisore, Standardet Sociale dhe Standardet e Shëndetit dhe Sigurisë të Kosovës

Standardet

GenCo do të jetë në pajtim me detyrimet mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë të specifikuar në Nenin 14 (*Mbrojtja e Mjedisit, Shëndeti dhe Siguria*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë dhe Neni 8

(Mbrotjtja e Mjedisit, Shëndeti dhe Siguria) të Marrëveshja për Deponimin e Hirit dhe Gipsit.

8.2 Dëmshpërblimi për Standardet Mjedisore

Gjatë Periudhës së Dëmshpërblimit Mjedisor, QK-ja do të dëmshpërblejë dhe do ta mbajë të padëmtuar GenCo-në dhe çdo Palë të GenCo-së nga secila dhe të gjitha Humbjet (duke përfshirë, pavarësisht parentezës së parë që përfshihet në përkufizimin e "Humbjes", çdo humbje, dëm, detyrime, pagesa, ose obligime të tërthorta ose konsenkuenciale, përfshirë Pagesat e humbura të Disponueshmërisë (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë)) që kanë ndodhur ose kërkohet të paguhen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga GenCo ose ndonjë Palë e GenCo-së, ose që kërkohet të imponohen ndaj tij në lidhje me gjobat ose penalitetet e shqiptuara nga ndonjë Autoritet Publik, ose ndonjë veprim nga një Autoritet Publik për të mbyllur Objektin e TCKR-së ose përndryshe për të pezulluar operacionet e GenCo-së që lindin në lidhje me papajtueshmërinë e GenCo-së me standardet mjedisore në lidhje me çdo Kusht Mjedisor/Arkeologjik që ekziston në lokacion ose në ndonjë mënyrë tjetër në lidhje me Projektin Kosova e Re, në ose para Datës së Bartjes, duke përfshirë Kushtet e Specifikuara Mjedisore/Arkeologjike (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) ose Kushtet Ekzistuese Mjedisore/Arkeologjike, duke u pranuar dhe duke u dakorduar se:

- (a) çdo Kusht Mjedisor/Arkeologjik i zbuluar në Lokacion para datës tetëmbëdhjetë (18) Muaj pas Datës së Operacioneve Komerciale, do të supozohet se lidhet me kushtet që ekzistojnë në ose para Datës së Bartjes, dhe jo të ketë të bëjë me aktivitetet e GenCo-së, pa dëshmi se një Kusht i tillë Mjedisor/Arkeologjik është shkaktuar nga GenCo ose ndonjë Person nën kontrollin e GenCo-së.
- (b) Pavarësisht nga çdo gjë në të kundërtën në Seksionin 8.2(a), pas Datës së Operacioneve Komerciale, çdo Kusht Mjedisor në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo-së, në Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo-së ose në ndonjë deponi tjetër që mbahet nga GenCo, nëse ka, që është zbuluar dhe lidhet drejtpërdrejt me që janë deponuar nga GenCo, do të supozohet të lidhen me aktivitetet e GenCo-së, dhe të mos lidhet me kushtet që ekzistojnë në ose para Datës së Bartjes.
- (c) pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër që është e kundërta në ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit, (i) në asnjë rrethanë, GenCo ose ndonjë Person nën kontrollin e GenCo-së nuk mund të supozohet në çdo kohë që të ketë shkaktuar Kushte Arkeologjike në Lokacion (përfshirë Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo ose ndonjë deponi tjetër që mbahet nga GenCo), dhe (ii) çdo Kusht i tillë Arkeologjik do të konsiderohet si një Kusht Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik pavarësisht nga data në të cilën është zbuluar ndonjë kusht i tillë.

8.3 Dëmshpërblimi për Pajtueshmërinë me Standardet e Zbatueshme

QK-ja do të dëmshpërblejë dhe do ta mbajë të padëmtuar GenCo-në dhe çdo Palë të GenCo-së nga secila dhe të gjitha Humbjet (duke përfshirë, pavarësisht parentezës së parë që përfshihet në përkufizimin e "Humbjes", çdo humbje, dëm, detyrime, pagesa, ose obligime të tërthorta ose konsenkuenciale, përfshirë Pagesat e humbura të Disponueshmërisë (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë)) që kanë ndodhur ose kërkohet të paguhen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga GenCo ose ndonjë Palë e GenCo-së, ose që kërkohet të imponohen ndaj tij në lidhje me gjobat ose penalitetet e shqiptuara nga ndonjë Autoritet Publik, ose ndonjë veprim nga një Autoritet Publik për të mbyllur Objektin e TCKR-së ose përndryshe për të pezulluar operacionet e GenCo-së që lindin në lidhje me papajtueshmërinë e GenCo-së me kërkesat e ndonjë ligji të Kosovës që rezulton nga pamundësia e GenCo-së për të përmbushur njëkohësisht kërkesat e tilla të Ligjeve të Kosovës dhe kërkesat e çdo standardi më të lartë të përcaktuar në përcaktimet e ndonjë prej Standardeve të Zbatueshme.

8.4 Prokurimi i GenCo-së

8.4.1 Rimbursimi për Kostot e Zhvillimit

Në rast se:

- (a) ekziston një kërkesë, veprim, padi ose procedim i suksesshëm që pretendon të ketë defekt, pretendon të bëjë të pavlefshme ose në ndonjë mënyrë tjetër të sfidojë pajtueshmërinë me Ligjin për Partneritet Publiko Privat, 2011 (Nr. 04/L-045), Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, 2011 (Nr. 04/L-42), i ndryshuar me Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës, 2016 (Nr. 05/L-092), apo me ligjet e tjera të Kosovës në lidhje me (i) përzgjedhjen e Sponsorit Sipëror si "Ofertuesi i Preferuar" për Projektin Kosova e Re, ose (ii) dhënien e kontratës në favor të Sponsorit Sipëror që kulmon në ekzekutimin e Marrëveshjeve të Projektit në Datën e Ekzekutimit ("**Padia për Procesin e Përzgjedhjes së Partnerëve të PPP-së**");
- (b) një Padi e tillë për Procesin e Përzgjedhjes së Partnerëve të PPP-së ishte e suksesshme për arsye që nuk rezultojnë materialisht nga, ose pa kontribuar në masë të madhe në, ndonjë dështim nga ana e Sponsorit Sipëror, Sponsorit HoldCo, GenCo-së ose Filialeve të tyre për të përmbushur ose për të qenë në pajtim me kushtet e KPK-së ose KPP-së të lëshuar në lidhje me Projektin Kosova e Re ose Seksionin 6 të Dëshmisë A të Memorandumit të Mirëkuptimit në lidhje me postimin e ndonjë obligacioni të ofertës dhe/ose sigurimin e performancës, dhe
- (c) rezultati i saj është, tërësisht ose pjesërisht, dështimi ose paaftësia për të zbatuar Projektin Kosova e Re me Sponsorin Sipëror, Sponsorin HoldCo, GenCo-në dhe/ose një Filial të Sponsorit Sipëror, atëherë QK, në pajtim me Seksionin 8.4.2, i paguan GenCo-së një shumë të barabartë me (i) shumën e plotë të Kostove të Zhvillimit të paguara nga GenCo deri në Kufirin e Kostove të Zhvillimit dhe (ii) një qind për qind (100%) të të gjitha Tarifave të Lejuara të Këshilltarit të QK-së që janë paguar realisht nga GenCo.

8.4.2 Mbrojtja e Kërkesave

- (a) Secila Palë do ta njoftojë menjëherë çdo Palë tjetër për çdo Padi për Procesin e Përzgjedhjes së Partnerëve të PPP-së ose kërcënim për Padi për Procesin e Përzgjedhjes së Partnerëve të PPP-së.
- (b) GenCo do të bashkëpunojë dhe do të bëjë që Sponsorin HoldCo dhe Sponsorin Sipëror të bashkëpunojnë dhe të japin të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të nevojshëm për mbrojtjen nga çdo Padi për Procesin e Përzgjedhjes së Partnerëve të PPP-së.
- (c) Vonesa ose dështimi nga Sponsorin HoldCo, Sponsorin Sipëror ose GenCo për të siguruar njoftimin ose bashkëpunimin e kërkuar me QK-në sipas këtij Seksioni 8.4.2, nuk do ta lërojë QK-në nga çdo detyrim që mund të ketë sipas Seksionit 8.4.1, përveç në atë masë që një dështim ose vonesë e tillë ka ndikuar materialisht dhe negativisht në aftësinë e QK-së për të mbrojtur një veprim të tillë ose ka rritur shumën e detyrimit të rimbursimit.
- (d) QK-ja ka të drejtën dhe detyrimin për të marrë dhe kontrolluar mbrojtjen e çdo Padi për Procesin e Përzgjedhjes së Partnerëve të PPP-së me avokatin e përzgjedhjes së vet, dhe GenCo do të bëjë që Sponsorin HoldCo dhe Sponsorin Sipëror ta nderojnë këtë marrje të mbrojtjes.
- (e) Pas supozimit të mbrojtjes nga QK-ja, Sponsorin HoldCo, Sponsorin Sipëror dhe GenCo kanë të drejtë të punësojnë avokatin e tyre (me shpenzimet e veta) dhe avokati i tillë mund të marrë pjesë në një veprim të tillë, me aprovimin e QK-së, dhe ky aprovim nuk do të mbahet pa arsye, duke përfshirë nëse pjesëmarrja e tillë mund të ndikojë negativisht në rezultatin e procedimit.

8.5 Pajtueshmëria me Standardet e Zbatueshme në Lidhje me Objektet e Asociuara

- (a) GenCo bashkëpunon në mënyrë të arsyeshme me QK-në dhe Mihjen e KEK-ut dhe me kërkesë të QK-së do të ofrojë konsultime ose ndihma të ngjashme në lidhje me përpjekjet e QK-së ose përpjekjet e Mihjes së KEK-ut për të ndërmarrë ndonjë veprim korrigjues në lidhje me pajtueshmërinë e Mihjes së KEK-ut me Standardet e Zbatueshme në lidhje me pronësinë e vet, zhvillimin (përfshirë edhe çdo zhvendosje) dhe operimin e Fushën Jugore të Mihjes në Sibovc dhe të Aseteve Minerare; me kusht që, sidoqoftë: (i) asgjë këtu nuk do të kërkojë që GenCo të

jetë përgjegjës për ndërmarrjen e çfarëdo veprimi korrektues të tillë ose për të bërë ndonjë investim kapital për të kryer një veprim korrigjues; dhe (ii) GenCo do të ketë të drejtën e rimbursimit të plotë sipas Kalendarit 1 (*Tarifa*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë.

- (b) Me kërkesën e GenCo-së nga koha në kohë, QK-ja do të bëjë që Mihja e KEK-ut t'i ofrojë GenCo-së përditësime të rregullta në lidhje me të gjitha aktivitetet e zhvendosjes.

Neni 9

Garancia e Qeverisë; Marrëveshja për Mbështetjen e Sponsorit

9.1 Garancia e Qeverisë

Më ose para Datës së Bartjes, QK-ja do të ekzekutojë dhe dorëzojë tek GenCo Garancinë e Qeverisë.

9.2 Marrëveshja për Mbështetjen e Sponsorit

Më ose para Datës së Ekzekutimit, Sponsorit HoldCo do të ekzekutojë dhe dorëzojë Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit në QK dhe, më ose para Datës së Hyrjes në Fuqi, Sponsorit Sipëror do të ekzekutojë dhe dorëzojë Garancinë e Sponsorit Sipëror në QK.

9.3 Dëmshpërblimi për Tarifat e Garancisë

QK-ja do të dëmshpërblejë dhe do ta mbajë të padëmtuar GenCo-në dhe çdo Palë të GenCo-së nga secila dhe të gjitha shumatat e bartura ose të kërkuara që të paguhen, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga GenCo ose ndonjë Palë e GenCo-së, ose që kërkohet të imponohen ndaj tij në lidhje me ndonjë tarifë në pajtim me Ligjin për Borxhin Publik (2009) ose ndonjë Ligj të ngjashëm të Kosovës i cili vendos tarifa analoge të zbatueshme për subjektet të cilëve u janë dhëna garanci nga QK-ja. QK-ja do të bëjë që shumatat e pakontestuarra (me çdo Kontest të Pagesës që i nënshtrohet zgjidhjes siç parashikohet në këtë Marrëveshje) që i detyrohet GenCo-së në lidhje me tarifatat ose ngarkesat e tilla që duhet të paguhen në Euro në një llogari bankare të GenCo-së të emëruar nga GenCo brenda dhjetë (10) Ditëve pas dorëzimit nga GenCo në QK të një fature për shumatat që i detyrohen atij, së bashku me dokumentacionin mbështetës të arsyeshëm.

Neni 10

Fondi për Zhvillim të Komunitetit; Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit; Procedurat për Zhvillim të Komunitetit

10.1 Fondi për Zhvillim të Komunitetit

- (a) Një fond për zhvillimin e komunitetit ("**Fondi për Zhvillim të Komunitetit**") do të financohet përmes kontributeve nga Sponsorit HoldCo në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit dhe nga GenCo në përputhje me sa vijon:

- (i) në pesë (5) përvjetorët e radhës të Datës së Bartjes, në vlerë prej një milion e gjysmë euro (1.500.000 euro) (gjithsej shtatë milion e gjysmë euro (7.500.000 euro));
- (ii) në përvjetorin e gjashtë (6^{te}) të Datës së Bartjes, në vlerë prej një milion euro (€ 1,000,000),

me kusht që, sidoqoftë, Palët pranojnë dhe pajtohen që nëse kjo Marrëveshje ndërpritet për shkak të një Ngjarje të Mospërmbushjes nga QK-ja, atëherë, prej asaj date të ndërprerjes (i) GenCo nuk do të ketë detyrime ose përgjegjësi të mëtejshme për të bërë ose për të shkaktuar që të bëhet ndonjë depozitë në Fondin për Zhvillim të Komunitetit dhe (ii) bilanci që kërkohet të depozitohet në Fondin për Zhvillim të Komunitetit nga GenCo do të jetë i barabartë me zero Euro (€ 0).

10.2 Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit

10.2.1 Themelimi i Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit

Jo më vonë se gjashtë (6) Muaj para Mbylljes Financiare, Palët do të themelojnë Panelin e Fondit për Zhvillim të Komunitetit për të kryer funksionet e përcaktuara në Seksionet 10.3 dhe 10.4.

10.2.2 Qeverisja e Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit

- (a) Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit përbëhet nga katër (4) anëtarë. Çdo Palë do të ketë dy (2) anëtarë për ta përfaqësuar në Panelin e Fondit për Zhvillim të Komunitetit dhe secila Palë mund t'i heqë ose zëvendësojë anëtarët e Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit në çdo kohë, duke njoftuar Palën tjetër.
- (b) Kryesia e përhershme e Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit i përket GenCo-së. Kryesuesi do të jetë një nga anëtarët e GenCo-së dhe do të ketë të drejtën të organizojë dhe të kërkojë takime dhe të caktojë agjendën e mbledhjes (pa kufizuar të drejtat e anëtarëve të tjerë për të shtuar në agjendë).
- (c) Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit zhvillon procedurat për mbajtjen e mbledhjeve, mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve dhe emërimin dhe funksionimin e nën-paneleve.
- (d) Vendimet e Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit kërkojnë aprovimin unanim të anëtarëve të pranishëm në një mbledhje të Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit ku është i pranishëm një kuorum i anëtarëve të Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit. Kuorumi i anëtarëve të Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit do të konsiderohet i pranishëm kur dy (2) anëtarë që përfaqësojnë QK-në dhe dy (2) anëtarë që përfaqësojnë GenCo-në janë të pranishëm në këtë takim personalisht ose me telefon, video konferencë ose mjete të tjera të lejuara elektronike.
- (e) Mbledhjet e Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit do të kryhen në gjuhën angleze me përkthim simultan në gjuhën shqipe, nëse kërkohet nga ndonjë anëtar i Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit që merr pjesë në këtë takim.

10.3 Detyrat e Panelit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit; Kufizimi i Kompetencave

- (a) Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit do të jetë përgjegjës për:
 - (i) administrimin e Fondit për Zhvillim të Komunitetit; dhe
 - (ii) zbatimin e zhvillimit të projekteve të përzgjedhura nga Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit.
- (b) Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit nuk ka kompetencë ose autoritet për të ndryshuar ose modifikuar dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, për të përcaktuar të drejtat ose detyrimet e Palëve sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit ose për të ndërmarrë ndonjë veprim në kundërshtim me dispozitat e Marrëveshjeve të Projektit ose Ligjeve të Kosovës.
- (c) Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit është përgjegjës për finalizimin e Procedurave për Zhvillim të Komunitetit në pajtim me Seksionin 10.4, i cili përfshin çështjet në vijim:
 - (i) *Auditimet* - Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit do të kërkojë auditim vjetor nga auditorët e parashikuar në Seksionin 14.2; dhe
 - (ii) *Raportet vjetore* - Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit do të nxjerrë një raport vjetor në përputhje me praktikat prudente të industrisë në lidhje me raportimin për përfitimet publike të lidhura me projektet e energjisë nga subjektet në pozita të ngjashme.
- (d) Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit do të jetë përgjegjës për çështje të tjera që mund të jenë të nevojshme ose të dëshirueshme për të lehtësuar funksionimin, komunikimin, transparencën ose çështje të tjera të shqetësimit të ndërsjellë.

10.4 Procedurat për Zhvillim të Komunitetit

10.4.1 Objektivat e Procedurave për Zhvillim të Komunitetit

- (a) Brenda njëqind e njëzet (120) Ditësh pas Datës së Hyrjes në Fuqi, Palët do të bëjnë që të mblidhet Paneli i Fondit për Zhvillim të Komunitetit dhe të bëjë që anëtarët përkatës të caktuar të finalizojnë

Procedurat për Zhvillim të Komunitetit që adresojnë të gjitha ndërfaqet operationale ndërmjet QK-së dhe GenCo-së. Procedurat për Zhvillim të Komunitetit do të shkruhen në gjuhën angleze, të shoqëruar me një përkthim të pastër dhe të saktë në gjuhën shqipe.

- (b) Palët do të bëjnë që Procedurat për Zhvillim të Komunitetit të jenë në përputhje me Ligjet Kundër Ryshfetit, dhe me çdo kërkesë pajtueshmërie në Seksionin 23.24.
- (c) Çdo veprim i ndërmarrë nga çdo Palë në lidhje me Fondin për Zhvillim të Komunitetit, që nuk përputhet me Procedurat për Zhvillim të Komunitetit, do të jetë i pavlefshëm dhe nuk do të jetë i detyrueshëm për Palën tjetër, dhe Palët do të jenë përgjegjëse ndaj njëra tjetres për një veprim të tillë.

10.4.2 Zhvillimi dhe Finalizimi i Procedurave për Zhvillim të Komunitetit

Procedura për zhvillimin dhe finalizimin e Procedurave për Zhvillim të Komunitetit do të jetë si vijon:

- (a) Brenda gjashtëdhjetë (60) Ditëve pas Datës së Hyrjes në Fuqi, GenCo do t'i dorëzojë QK-së me shkrim propozimin e draftit të Procedurave për Zhvillim të Komunitetit;
- (b) QK-ja do të japë komentet me shkrim për draftin e Procedurave për Zhvillim të Komunitetit brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve nga data e dorëzimit të draftit të Procedurave për Zhvillim të Komunitetit nga GenCo tek QK-ja, dhe secila palë do ta bëjë një përfaqësues të disponueshëm për t'u takuar brenda pesë (5) Ditëve pas përfundimit të kësaj periudhe pesëmbëdhjetë (15) Ditësh për të shqyrtuar komentet e secilës Palë mbi draftin e Procedurave për Zhvillim të Komunitetit dhe mbi ndryshimet e propozuara dhe çdo kundërshtim ndaj ndryshimeve të propozuara të një Pale;
- (c) sa më shpejt të jetë e mundur pas takimit të përmendur në Seksionin 10.4.2 (b), por në çdo rast brenda dhjetë (10) Ditëve pas përfundimit të takimit të tillë, GenCo do t'i ofrojë QK-së draftin final të propozimit të Procedurave për Zhvillim të Komunitetit, duke përfshirë në masën e dakorduar secilin nga ndryshimet e propozuara të Palëve;
- (d) QK-ja do të japë komentet përfundimtare mbi draftin përfundimtar të Procedurave për Zhvillim të Komunitetit brenda pesë (5) Ditëve të Punës pas marrjes së tij nga QK-ja, dhe brenda pesë (5) Ditëve të Punës pas kërkesës nga GenCo, QK-ja do t'i bëjë përfaqësuesit e vet të disponueshëm në Prishtinë, Kosovë, për t'u takuar dhe shqyrtuar komentet dhe ndryshimet e propozuara me GenCo; dhe
- (e) GenCo do të rishikojë draftin e Procedurave për Zhvillim të Komunitetit për të inkuorporuar këto shtesa ose ndryshime të pakontestuara të kërkuara nga QK-ja dhe do të ofrojë një draft përfundimtar për QK-në sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast brenda pesë (5) Ditëve pas marrjes së komenteve dhe ndryshimeve të propozuara të QK-së në draftin e Procedurave për Zhvillim të Komunitetit.
- (f) Palët do të konsultohen me Bankën Botërore, sipas rastit, për qëllimet e zhvillimit dhe finalizimit të Procedurave për Zhvillim të Komunitetit.

10.4.3 Ndryshimet në Procedurat për Zhvillim të Komunitetit

(Pas finalizimit të Procedurave për Zhvillim të Komunitetit sipas Seksionit 10.4.2, secila Palë mund të propozojë herë pas here ndryshime në Procedurat për Zhvillim të Komunitetit, siç mund ta kërkojnë ndryshimet në ngjarje dhe rrethana. Palët do të takohen dhe do të diskutojnë ndryshimet e tilla të propozuara në mirëbesim dhe do të inkuorporojnë ndryshime të tilla siç janë pajtuar nga Palët.

Neni 11 Tatimet dhe Kontrollat e Importit

11.1 Tatimet e Aplikueshme për GenCo-në

Të gjitha tatimet aktuale dhe të ardhshme qendrore, komunale ose të tjera të ligjshme të aplikueshme për GenCo që rrjedhin nga, ose në lidhje me, të drejtat dhe detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje, do të paguhen nga GenCo si dhe kur kërkohet sipas Ligjeve të Kosovës, dhe shuma e tatimeve të tilla do të përfshihet në Tarifën e parashikuar në Kalendarin 1 (*Tarifa*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë.

11.2 Tatimet e Aplikueshme për Sponsorin HoldCo dhe Investitorët

- (a) Në pajtim me Nenin 19, Sponsorin HoldCo dhe Sponsorin Sipëror, si dhe çdo Sponsor i Huaj që mund të lindë herë pas here, do të tathohet në Kosovë në përputhje me kushtet e çdo Traktati Tatimor të zbatueshëm dhe Ligjeve të Kosovës, dhe në rast se nuk është i aplikueshëm asnjë Traktat Tatimor, në përputhje me Ligjet e Kosovës.
- (b) Çdo Sponsor Lokal, siç mund të lindë nga koha në kohë, do të tathohet sipas Ligjeve të Kosovës.

11.3 Stimujt dhe Koncesionet e Aplikueshme Tatimore

Stimujt dhe koncesionet fiskale të dhëna për GenCo janë të përshkruara në Kalendarin 1.

11.4 E drejta për Import; Detyrimet Doganore

- (a) QK-ja inkurajon GenCo-në dhe Kontraktorët e GenCo-së të inkorporojnë sa më shumë materiale, pajisje dhe furnizime të prodhuara në nivel lokal, siç është komercialisht e arsyeshme për pjesëmarrjen e GenCo-së në Projektin Kosova e Re. Megjithatë, GenCo dhe Kontraktorët e GenCo-së do të kenë të drejtë të importojnë pa kufizim makineri dhe pajisje të nevojshme për zhvillimin, projektimin, financimin, posedimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Objektivit të TCKR-së, në pajtim me çdo kufizim të vendosur nga Ligjet e Kosovës (duke përfshirë pagesën e detyrimeve doganore të zbatueshme dhe tatimin mbi vlerën e shtuar, me përjashtim të rasteve të përjashtuara sipas Kalendarit 1), me kusht që makineritë dhe pajisjet e importuara të impiantit të përdoren në lidhje me Projektin Kosova e Re.
- (b) Me kusht që Detyrimet Doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar të zbatueshëm të paguhen në kohë (përveç rasteve të përjashtuara sipas Kalendarit 1), QK-ja do të përdorë përpjekje të arsyeshme në përputhje me ligjet e Kosovës për të shkaktuar që të gjitha makineritë dhe pajisjet e impiantit të importuara për inkorporim në Objektivin e TCKR-së, ose për përdorim në Projektin Kosova e Re, të zhdoganohen nga Dogana dhe të jetë në dispozicion për largim nga GenCo ose agjentët e vet sa më shpejt të jetë e mundur, por në asnjë rast jo më vonë se tridhjetë (30) Ditë pas dorëzimit nga GenCo në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik të një njoftimi me shkrim për vonesë në zhdoganimin nga Dogana të makinerive ose pajisjeve të tilla të impiantit. GenCo mund të japë një njoftim të tillë në çdo kohë pas një vonese në zhdoganimin e makinerive ose pajisjeve të tilla të impiantit pesë (5) Ditë pas dorëzimit tek autoritetet e duhura të të gjitha dokumenteve (duke përfshirë të gjitha informatat dhe detajet) të kërkuara nga Ligjet e Kosovës për importimin e makinerive dhe pajisjeve të impiantit në Kosovë.
- (c) Në rast se ka një kërkesë për Detyrimet Doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar që tejkalon atë që kërkohet sipas ligjeve të Kosovës, dhe GenCo zgjedh t'i paguajë Detyrimet e tilla Doganore ose tatimin mbi vlerën e shtuar të kundërshtuar, me njoftimin e QK-së nga GenCo, një kontest i tillë do të zgjidhet në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe Ligjeve të Kosovës brenda nëntëdhjetë (90) Ditëve pasi GenCo të parashtojë kërkesën e rimbursimit.

11.5 Ri-eksportimi i Artikujve të Pakonsumuar

Të gjithë artikujt që nuk janë konsumuar gjatë ndërtimit të Objektivit të TCKR-së ose nuk janë inkorporuar në Objektivin e TCKR-së mund të eksportohen jashtë Kosovës nga GenCo ose Kontraktorët e GenCo-së në përputhje me ligjet e Kosovës.

Neni 12 Kontrollet e Imigracionit

12.1 Kontrollet e Imigracionit

Me kusht që GenCo dhe Kontraktorët e GenCo-së të jenë në pajtim me të gjitha ligjet e Kosovës në lidhje me kontrollet e imigracionit, QK-ja do t'i aprovojë me shpejtësi aplikimet e GenCo dhe Kontraktorëve të GenCo-së për lejet e punës, lejet e punësimit, vizat dhe lejet e tjera, sipas nevojës për individët e përfshirë në Projektin Kosova e Re. Pavarësisht nga sa më sipër, sidoqoftë, QK-ja, në çdo rast individual, mund të refuzojë të aprovojë një kërkesë ose të dëbojë një Person të pranuar më parë, për të mbrojtur interesat e sigurisë kombëtare dhe shëndetin publik dhe sigurinë e Kosovës, siç përcaktohet në mënyrë të arsyeshme nga QK-ja.

Neni 13

Punësimi, Trajnimi dhe Resurset Kosovare

13.1 Punësimi i Kosovarëve

- (a) Palët pranojnë se trajnimi i qytetarëve të Kosovës në zhvillimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Projektit Kosova e Re dhe maksimizimin e transferimit të teknologjisë janë qendrore për interesat e QK-së në Projektin Kosova e Re. Prandaj, GenCo do të përdorë përpjekje të arsyeshme komerciale për të angazhuar qytetarët e Kosovës për zhvillimin, projektimin, ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Projektit Kosova e Re në masën e arsyeshme, duke marrë parasysh disponueshmërinë, përvojën dhe shkathhtësitë e kërkuara të këtyre qytetarëve të Kosovës.
- (b) GenCo do të dorëzojë raporte vjetore për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, duke detajuar progresin e bërë drejt përbushjes së objektivave të përcaktuara në Seksionin 13.1(a).

13.2 Standardet e Punësimit

- (a) GenCo do të jetë në pajtim me të gjitha Standardet e Zbatueshme në punësimin e çdo Personi në lidhje me Projektin Kosova e Re.
- (b) GenCo do të kërkojë që Kontraktorët e GenCo-së të jenë në pajtim me të gjitha Standardet e Zbatueshme për punësimin e çdo personi në lidhje me Projektin Kosova e Re.

13.3 Trajnimi

GenCo-ja:

- (a) do të përfshijnë programe prudenete dhe të arsyeshme të trajnimit të punonjësve siç kërkohet në kryerjen normale të biznesit të tyre, dhe këto programe të trajnimit, herë pas here, përfshijnë trajnimin në shkathhtësitë e nevojshme ose të arsyeshme të përshtatshme për ndërtimin, operimin dhe mirëmbajtjen e Projektit Kosova e Re. Programet e trajnimit herë pas here do të përfshijnë çështjet teknike dhe administrative, duke përfshirë administrimin e kontratave; dhe
- (b) do të dorëzojë raporte vjetore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik duke përshkruar në detaje programet e trajnimit të punonjësve të kryera nga GenCo dhe koston e këtyre programeve të trajnimit gjatë periudhës përkatëse.

13.4 Resurset Kosovare

- (a) në varësi të kërkesave të prokurimit që i bashkëngjiten ndonjë financimi të ofruar (ose që do t'i ofrohet) GenCo-së në lidhje me Projektin Kosova e Re (ose ndonjë pjesë materiale të tij) dhe kërkesave të prokurimit të zbatueshme për GenCo në përputhje me këtë Marrëveshje ose ndonjë Marrëveshje tjetër të Projektit, duke përfshirë në lidhje me Tenderin (Impianti) dhe Tenderin (Kuçja), GenCo do t'i japë preferencë:
 - (i) blerjes së mallrave dhe materialeve Kosovare për përdorim në Projektin Kosova e Re; me kusht që, sidoqoftë, mallrat dhe materialet e tilla janë:

- (A) të një cilësie të barabartë ose më të mirë se mallra dhe materiale të ngjashme në dispozicion në tregun ndërkombëtar;
 - (B) në dispozicion në kohën e duhur në sasinë e kërkuar; dhe
 - (C) të disponueshme me kushte konkurruese dhe me çmime të barabarta ose më të ulëta se mallra dhe materiale të ngjashme të disponueshme në tregun ndërkombëtar; dhe
- (ii) punësimi i kontraktorëve Kosovarë të shërbimeve për aq sa janë financiarisht dhe teknikisht kompetentë, posedojnë përvojën dhe aftësitë e nevojshme për të kryer punën e kërkuar nga GenCo, dhe kontraktorët e tillë janë në dispozicion në kohën e duhur dhe me kushtet konkurruese (duke përfshirë normat) në krahasim me Kontraktorët që ofrojnë shërbime të ngjashme në tregun ndërkombëtar në kushte dhe rrethana të ngjashme.
- (b) GenCo do të njoftojë QK-në për çdo tender apo blerje të huaj të planifikuar përpara se të kryejë një tender apo blerje të tillë. Nëse QK-ja nuk kundërshton brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve pas dorëzimit të një njoftimi të tillë, atëherë QK-ja nuk do të ketë të drejta për të kërkuar zbatimin e Seksionit 13.4(a).
- (c) Në varësi të kërkesave të prokurimit që i bashkëngjiten ndonjë financimi të ofruar (ose që do t'i ofrohet) GenCo-së në lidhje me Projektin Kosova e Re (ose ndonjë pjesë materiale të tij) dhe kërkesave të prokurimit të zbatueshme për GenCo në përputhje me këtë Marrëveshje ose ndonjë Marrëveshje tjetër të Projektit, duke përfshirë në lidhje me Tenderin (Impianti) dhe Tenderin (Kuçja), GenCo do të vendosë procedura të përshtatshme tenderimi për mallrat, materialet dhe shërbimet Kosovare, të cilat mund të pasqyrojnë procedura të ndryshme në lidhje me mallra, materiale ose shërbime të ndryshme:
- (i) duke marrë parasysh kushtet e tregut lokal në Kosovë; dhe
 - (ii) duke u mundësuar Personave Kosovarë të ofertojnë për të furnizuar mallra dhe materiale të tilla dhe për të ofruar shërbime të tilla, sipas dhe në përputhje me këtë Seksion 13.4.

Neni 14

Raportet për QK-në; Auditimi Vjetor

14.1 Raportet për QK-në

- (a) GenCo do t'i ofrojë QK-së kopje të të gjitha raporteve dhe informacioneve që kërkohet të dorëzohen nga GenCo tek KEKR-ja në pajtim me Seksionin 4.7 (*Dorëzimi i Raporteve dhe Informatave*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; me kusht që, sidoqoftë, pa u kufizuar në dispozitat e Seksionit 23.15, QK-ja do të trajtojnë si konfidencial të gjithë informacionin e ndjeshëm komercial të përfshirë në raportet e tilla. Pavarësisht nga sa më sipër, GenCo do të ketë të drejtë të redaktojë informata konfidenciale ose komerciale të ndjeshme nga raportet e tilla deri në atë masë që raportet dhe informatat e tilla nuk mund të ndalohen ligjërisht nga publikimi dhe të mbahen konfidenciale nga QK-ja.
- (b) GenCo do të ofrojë (në format elektronik), jo më vonë se tridhjetë (30) Ditë pas Datës së Operacioneve Komerciale, një (1) kopje, siç e merr GenCo sipas Kontratës së IPN-së, të të gjitha specifikimeve të prodhuesve dhe doracakëve operativë të prodhuesve.
- (c) GenCo, me instalimin e Sistemit të Njehsimit dhe të Sistemit të Kontrollimit të Njehsimit, do të përdorë përpjekjet e arsyeshme komerciale për të marrë dhe për t'i siguruar QK-së kopje të udhëzimeve dhe manualeve të operimit për Sistemin e Njehsimit dhe Sistemin e Kontrollimit të Njehsimit, duke përfshirë për çdo komponent pjesë e Sistemit të Njehsimit dhe Sistemit të Kontrollimit të Njehsimit. Një detyrim i tillë për të siguruar kopjet e udhëzimeve dhe manualeve të operimit për QK-në nuk do të ndikojë në asnjë detyrim të GenCo-së për të siguruar informacion

për KOSTT-in sipas Kodit të Njehsimit.

14.2 Auditimi Vjetor

Jo më vonë se tridhjetë ditë pasi të jenë përfundimtare dhe në dispozicion të GenCo-së (por në çdo rast jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të çdo viti fiskal të GenCo-së), GenCo do të dorëzojë në QK pasqyrat financiare vjetore të GenCo-së për vitin fiskal që sapo ka përfunduar dhe që janë audituar nga një auditor i pavarur i licencuar për të vepruar në Kosovë; me kusht që nëse një auditor tjetër i pavarur është i pranueshëm për Huadhënësit për auditimin e pasqyrave financiare të GenCo-së që kërkohet të dorëzohen sipas Dokumenteve të Financimit, atëherë ky subjekt do të jetë i pranueshëm për qëllimet e këtij Seksioni 14.2.

Neni 15 Sigurimet

15.1 Sigurimet

GenCo do të marrë dhe mbajë sigurimin në përputhje me Marrëveshjen për Blerje të Energjisë. Nëse dhe në masën që QK-ja mund të emërohet si një i siguruar shtesë në çdo policë të sigurimit të përgjegjësisë që kërkohet sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, në lidhje me detyrimet që dalin në lidhje me Projektin Kosova e Re, QK-ja do të emërohet nga GenCo.

Neni 16 Tarifat e Këshilltarëve dhe Inxhinierëve Para dhe Pas Mbylljes Financiare

16.1 Tarifat e Këshilltarëve dhe Inxhinierëve Para Mbylljes Financiare

- (a) GenCo-ja, në Mbylljen Financiare dhe me kërkesë dhe nën drejtimin e Qeverisë së Kosovës dhe në pajtim me Seksionin 16.1 (b) - (e) më poshtë, i paguan drejtpërsëdrejti Këshilltarëve të QK-së (ose nëse kërkohet nga QK-ja rimbursion QK-në) për Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së që bëhen të pagueshme nga QK-ja në dhe pas datës në të cilën GenCo-ja ose ndonjë Filial i GenCo-së është njoftuar nga QK-ja se ishte ofertuesi i preferuar për Projektin Kosova e Re deri në Mbylljen Financiare, në varësi të kërkesave të mëposhtme:
- (i) Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja, Konsulenti i Pavarur i MS-së, ose këshilltarët teknikë, ligjorë, financiarë ose të transaksioneve të QK-së, sipas rastit, duhet të dorëzojnë faturat në QK për Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së që kërkohet të paguhen nga GenCo në pajtim me këtë Seksion 16.1;
 - (ii) QK aprovon ose nuk aprovon çdo faturë (pa shqyrtim nga GenCo) dhe përcjell udhëzime për pagesë për GenCo-në, ku përfshihen certifikatat e kërkuara nga Seksioni 16.1(a)(iii) dhe Seksioni 16.1(a)(vii);
 - (iii) Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja, Konsulenti i Pavarur i MS-së, ose këshilltarët teknikë, ligjorë, financiarë ose të transaksioneve të QK-së, sipas rastit, duhet t'i dorëzojnë QK-së certifikim sipas formës së Kalendarit 8;
 - (iv) GenCo do të paguajë Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së që kërkohet të paguhen nga GenCo sipas këtij Seksioni 16.1 në përputhje me udhëzimet e pagesave të Qeverisë së Kosovës në Mbylljen Financiare, ose do të njoftojë QK-në dhe ofruesin e aplikueshëm për arsytet që GenCo nuk beson se kostot e tilla (ose aktivitetet që shkaktojnë kostot) janë në përputhje me kërkesat për pagesë nga GenCo në pajtim me këtë Marrëveshje, që nëse kontestohet nga QK-ja do të jetë një Konteste Pagesash;
 - (v) GenCo, sipas gjykimit të vet, ka të drejtë të mbajë pagesën e Tarifave të Lejuara të Këshilltarit të QK-së në lidhje me cilindo prej Inxhinierit të Pavarur të Emëruar nga QK-ja, Konsulentit të Pavarur të MS-së, ose këshilltarët teknikë, ligjorë, financiarë ose të transaksioneve të QK-së që ai beson në mënyrë të arsyeshme, në bazë të provave objektive

ose pretendimeve specifike dhe të besueshme, se kanë shkelur Ligjet kundër Ryshfetit ose ndonjë kërkesë pajtueshmërie sipas Seksionit 23.24, ose që janë nën hetim ose janë akuzuar, në çdo rast nga një Autoritet Publik, për një shkelje të Ligjeve Kundër Ryshfetit, ose të ndonjë kërkesë pajtueshmërie sipas Seksionit 23.24;

- (vi) QK-së nuk do t'i kërkohej të ndajë me GenCo përmbajtjen e hollësishme të faturave për Tarifën e Lejuara të Këshilltarit të QK-së ose të dorëzojë kopjet e faturave të tilla tek GenCo, por duhet të vërtetojë se të gjitha këto shpenzime janë Tarifa të Lejuara të Këshilltarit të QK-së që kërkohej të paguhej nga GenCo sipas këtij Seksioni 16.1; dhe
 - (vii) Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja, Konsulenti i Pavarur i MS-së dhe këshilltarët teknikë, ligjorë, financiarë dhe të transaksioneve të QK-së, secili do të ekzekutojë, dorëzojë në GenCo dhe do të përmbushë kushtet e një certifikate pajtueshmërie në formën e bashkangjitur si Kalendarin 7.
- (b) GenCo do të bëjë të gjitha pagesat në lidhje me Tarifën e Lejuara të Këshilltarit të QK-së që kërkohej të paguhej nga GenCo sipas këtij Seksioni 16.1 dhe në përputhje me udhëzimet e pagesave të QK-së.
 - (c) Tarifën e Lejuara të Këshilltarit të QK-së të paguara sipas këtij Seksioni 16.1 do të paguhej nga borxhi i projektit dhe të ardhurat e ekuitetit të projektit nga Financimi Fillestar në një pagesë të njëhershme për GenCo në lidhje me Mbylljen Financiare (duke pranuar se GenCo do të ketë ka të drejtën ta rikuperojë pagesën e tillë në përputhje me Kalendarin 1 (*Tarifën*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë).
 - (d) Në pajtim me Seksionet 3.9 dhe 3.10, Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja, Konsulenti i Pavarur i MS-së dhe këshilltarët teknikë, ligjorë, financiarë dhe të transaksioneve të QK-së do të mbeten përfundimisht dhe këshilltarët e QK-së, dhe nuk do ketë asnjë marrëdhënie klient-këshilltar ose klient-avokat mes këshilltarëve teknikë, ligjorë, financiarë dhe të transaksioneve të GenCo-së dhe QK-së si rezultat i aranzhimeve të pagesave të përcaktuara në Seksionin 16.1(a).
 - (e) Asgjë në këtë dispozitë nuk do të pengojë që QK-ja të mbajë Inxhinierin e Pavarur të Emëruar nga QK-ja, Konsulentin e Pavarur të MS-së ose këshilltarët tjerë në dobi të çdo NP-je të Specifikuar dhe mekanizmi i tillë i angazhimit të personelit të tillë nuk do të zvogëlojë detyrimet e GenCo-së sipas këtij Seksioni 16.1.
 - (f) Në rast se GenCo kundërshton që asnjë shpenzim i tillë nuk është Tarifa e Lejuara të Këshilltarit të QK-së që kërkohej të paguhej nga GenCo në përputhje me këtë Nen 16, atëherë GenCo mund të fillojë procedurat zyrtare të zgjidhjes së kontestit sipas Nenit 22 të kësaj Marrëveshjeje, dhe kjo çështje do të kualifikohet si Kontest Teknik për qëllimet e zgjidhjes së kontestit sipas Nenit 22, dhe në atë masë që një procedim i tillë përfshin çështjen e përshkruar në Seksionin 16.1(a)(v), atëherë, pavarësisht Seksionit 16.1(a)(vi), faturat e hollësishme të dorëzuara në QK dhe produktet e lidhura me shumën e paguara nga GenCo në bazë të këtij Neni 16 gjatë 18 muajve të mëparshëm (ose ndonjë periudhe më të shkurtër të kërkuar nga GenCo) do të ofrohen dhe shqyrtohen në mënyrë konfidenciale nga eksperti i emëruar në lidhje me Kontestin Teknik; kusht që, sidogoftë, edhe në rast të kontestit, faturat dhe produktet e Korporatës Financiare Ndërkombëtare dhe Hunton & Williams LLP nuk do të jetë objekt shqyrtimi për qëllime të tilla.

16.2 Tarifën e Këshilltarëve dhe Inxhinierëve mes Mbylljes Financiare dhe Datës së Tërheqjes Përfundimtare

- (a) GenCo-ja me kërkesë dhe nën drejtimin e Qeverisë së Kosovës dhe në pajtim me Seksionin 16.1 (b) - (e) më poshtë, i paguan drejtpërsëdrejti Këshilltarëve të QK-së (ose nëse kërkohej nga QK-ja rimbursion QK-në) për Tarifën e Lejuara të Këshilltarit të QK-së që bëhen të pagueshme nga QK-ja pas Mbylljes Financiare në varësi të kërkesave të mëposhtme:
 - (i) Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja, Konsulenti i Pavarur i MS-së, ose këshilltarët

teknikë, ligjorë, financiarë ose të transaksioneve të QK-së, sipas rastit, duhet të dorëzojnë faturat në QK për Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së që kërkohet të paguhen nga GenCo në pajtim me këtë Seksion 16.2;

- (ii) QK aprovon ose nuk aprovon çdo faturë (pa shqyrtim nga GenCo) dhe përcjell udhëzime për pagesë për GenCo-në, ku përfshihen certifikatat e kërkuara nga Seksioni 16.2(a)(vii) dhe Seksioni 16.2(a)(iii);
 - (iii) Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja, Konsulenti i Pavarur i MS-së, ose këshilltarët teknikë, ligjorë, financiarë ose të transaksioneve të QK-së, sipas rastit, duhet t'i dorëzojnë QK-së certifikim sipas formës së Kalendarit 8;
 - (iv) GenCo do të paguajë Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së që kërkohet të paguhen nga GenCo sipas këtij Seksioni 16.2, në përputhje me udhëzimet e pagesave të QK-së, brenda dyzetë e pesë (45) Ditëve që GenCo merr secilin udhëzim pagese, ose do të njoftojë QK-në dhe ofruesin e aplikueshëm për arsyet që GenCo nuk beson se kostot e tilla (ose aktivitetet që shkaktojnë kostot) janë në përputhje me kërkesat për pagesë nga GenCo në pajtim me këtë Marrëveshje, që nëse kontestohet nga QK-ja do të jetë një Konteste Pagesash;
 - (v) GenCo, sipas gjykimit të vet, ka të drejtë të mbajë pagesën e Tarifave të Lejuara të Këshilltarit të QK-së në lidhje me cilindo prej Inxhinierit të Pavarur të Emëruar nga QK-ja, Konsulentit të Pavarur të MS-së, ose këshilltarët teknikë, ligjorë, financiarë ose të transaksioneve të QK-së që ai beson në mënyrë të arsyeshme, në bazë të provave objektive ose pretendimeve specifike dhe të besueshme, se kanë shkelur Ligjet kundër Ryshfetit ose ndonjë kërkesë pajtueshmërie sipas Seksionit 23.24, ose që janë nën hetim ose janë akuzuar, në çdo rast nga një Autoritet Publik, për një shkelje të Ligjeve Kundër Ryshfetit, ose të ndonjë kërkesë pajtueshmërie sipas Seksionit 23.24;
 - (vi) QK-së nuk do t'i kërkohet të ndajë me GenCo përmbajtjen e hollësishme të faturave për Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së ose të dorëzojë kopjet e faturave të tilla tek GenCo, por duhet të vërtetojë se të gjitha këto shpenzime janë Tarifa të Lejuara të Këshilltarit të QK-së që kërkohet të paguhen nga GenCo sipas këtij Seksioni 16.2; dhe
 - (vii) Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja, Konsulenti i Pavarur i MS-së dhe këshilltarët teknikë, ligjorë, financiarë dhe të transaksioneve të QK-së, secili do të ekzekutojë, dorëzojë në GenCo dhe do të përmbushë kushtet e një certifikate pajtueshmërie në formën e bashkangjitur si Kalendarit 7.
- (b) GenCo do të bëjë të gjitha pagesat në lidhje me Tarifat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së që kërkohet të paguhen nga GenCo sipas këtij Seksioni 16.2 dhe në përputhje me udhëzimet e pagesave të QK-së.
 - (c) Çdo Tarifë e Lejuar e Këshilltarit të QK-së e bartur pas Mbylljes Financiare nga GenCo do të rikuperohet në përputhje me Kalendarin 1 të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë si Ngarkesë e Lejuar e Ndryshme dhe e Vazhdueshme Operative (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë).
 - (d) Në varësi të Seksioneve 3.9 dhe 3.10, Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja. Konsulenti i Pavarur i MS-së dhe këshilltarët teknikë, ligjorë, financiarë dhe të transaksioneve të QK-së do të mbeten përfundimisht dhe këshilltarët e QK-së, dhe nuk do ketë asnjë marrëdhënie klient-këshilltar ose klient-avokat mes këshilltarëve teknikë, ligjorë, financiarë dhe të transaksioneve të GenCo-së dhe QK-së si rezultat i aranzhimeve të pagesave të përcaktuara në Seksionin 16.2.
 - (e) Asgjë në këtë dispozitë nuk do të pengojë që QK-ja të mbajë Inxhinierin e Pavarur të Emëruar nga QK-ja, Konsulentin e Pavarur të MS-së ose këshilltarët tjerë në dobi të çdo NP-je të Specifikuar dhe mekanizmi i tillë i angazhimit të personelit të tillë nuk do të zvogëlojë detyrimet e GenCo-së

sipas këtij Seksioni 16.2.

- (f) Në rast se GenCo kundërshton që asnjë shpenzim i tillë nuk është Tarifata e Lejuara të Këshilltarit të QK-së që kërkohet të paguhet nga GenCo në përputhje me këtë Nen 16, atëherë GenCo mund të fillojë procedurat zyrtare të zgjidhjes së kontestit sipas Nenit 22 të kësaj Marrëveshjeje, dhe kjo çështje do të kualifikohet si Kontest Teknik për qëllimet e zgjidhjes së kontestit sipas Nenit 22, dhe në atë masë që një procedim i tillë përfshin çështjen e përshkruar në Seksionin 16.2(a)(v), atëherë, pavarësisht Seksionit 16.2(a)(vi), faturat e hollësishme të dorëzuara në QK dhe produktet e lidhura me shumatat e paguara nga GenCo në bazë të këtij Neni 16 gjatë 18 muajve të mëparshëm (ose ndonjë periudhe më të shkurtër të kërkuar nga GenCo) do të ofrohen dhe shqyrtohen në mënyrë konfidenciale nga eksperti i emëruar në lidhje me Kontestin Teknik; kusht që, sidoqoftë, edhe në rast të kontestit, faturat dhe produktet e Korporatës Financiare Ndërkombëtare dhe Hunton & Williams LLP nuk do të jetë objekt shqyrtimi për qëllime të tilla.

Neni 17

Përfaqësimet dhe Garancitë

17.1 Përfaqësimet dhe Garancitë e GenCo-së

GenCo përfaqëson dhe i garanton QK-së se që nga Data e Ekzekutimit:

- (a) GenCo është organizuar siç duhet, ekziston në mënyrë të vlefshme dhe në gjendje të mirë sipas ligjeve të Luksemburgut; me kusht që, sidoqoftë, në riafirmimet e ofruara nga GenCo sipas Seksionit 17.3, GenCo do të përfaqësojë dhe do t'i garantojë QK-së se GenCo organizohet siç duhet, ekziston në mënyrë të vlefshme, dhe në gjendje të mirë sipas ligjeve të Kosovës;
- (b) ekzekutimi, realizimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje nga GenCo janë autorizuar siç duhet nga të gjitha veprimet e nevojshme korporative dhe GenCo ka fuqi dhe autoritet të plotë korporativ për të ekzekutuar, realizuar dhe kryer të gjitha detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (c) kjo Marrëveshje përbën detyrimin ligjor, të vlefshëm dhe të detyrueshëm të GenCo-së, i zbatueshëm kundër tij në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, me zbatueshmërinë e mjeteve juridike në varësi të kufizimeve të vendosura nga falimentimi, insolvenca, riorganizimi, moratoriumi ose ligje të tjera të ngjashme në fuqi që lidhen me ose ndikojnë në zbatimin e të drejtave të kreditorëve në përgjithësi dhe në parimet e përgjithshme të ekuitetit;
- (d) ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë dhe as nuk përbën një mospërbushje sipas asnjë indenture, kredie hipotekare ose ndonjë marrëveshjeje tjetër materiale që lidhet me GenCo, ose ndonjë urdhri të vlefshëm të ndonjë gjykate, apo të ndonjë agjencie rregullatore ose organi tjetër që ka autoritet nga i cili varet GenCo-ja;
- (e) asgjë nga ekzekutimi, dorëzimi ose realizimi nga GenCo i kësaj Marrëveshjeje, pajtueshmëria me termat dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, dhe kryerja e transaksioneve të parashikuara me këtë, nuk është në konflikte ose nuk bie ndesh, ose nuk do të rezultojë në thyerje ose shkelje të Dokumenteve Statutore të veta ose ndonjë prej termave, kushteve ose dispozitave të ndonjë ligji të Kosovës ose ndonjë lejeje, apo ndonjë urdhri, urdhërese, mase, gjykimi ose dekreti të ndonjë Autoriteti Publik kundër GenCo-së;
- (f) KEKR nuk është në mospërbushje të asnjë marrëveshjeje ose instrumenti të çfarëdo natyre në të cilën është Palë ose me të cilën është i detyruar, në çfarëdo mënyre që do të kishte një efekt material negativ në aftësinë e vet për të përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj dispozite, sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit, Dokumentit të Financimit, Kontratës së Ndërtimit/Mirëmbajtjes në të cilën është palë, ose në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje; dhe
- (G) nuk ka asnjë veprim, padi, procedim ose hetim në gjykim ose që, sipas njohurive të GenCo-së, kërcënon:
- (i) për shpërbërjen e GenCo-së; ose

(ii) përndryshe kundër GenCo-së,

që, nëse përcaktohet keq, do të kishte një efekt material negativ në aftësinë e vet për të përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj dispozite, sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit, Dokumentit të Financimit, Kontratës së Ndërtimit/Mirëmbajtjes në të cilën është palë, ose në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje; dhe

GenCo gjithashtu përfaqëson dhe i garanton QK-së se asnjë nga GenCo ose ndonjë zyrtar ose drejtues i vet, as, sipas njohurive të vetë, asnjë Person që përfaqëson këto palë nuk ka bërë, ofruar ose autorizuar dhe nuk do të bëjë, ofrojë ose nuk autorizon në lidhje me çështjet, të cilat janë objekt i kësaj Marrëveshjeje, çdo pagesë, dhuratë, premtim ose avantazh tjetër, qoftë drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësve, për ose për përdorimin e cilitdo Personi që punon drejtpërdrejt ose tërthorazi në emër të ndonjë Autoriteti Publik, kur ky premtim ose avantazh do të shkelte çdo Ligj Kundër Ryshfetit, dhe bën përfaqësimet dhe garancitë dhe premtimet e parashtruara sipas Seksionit 23.24 ("**Përfaqësimi dhe Garancia e Pajtueshmërisë së GenCo-së**").

17.2 Përfaqësimet dhe Garancitë e QK-së

QK-ja me këtë rast përfaqëson dhe i garanton GenCo-së që nga Data e Ekzekutimit:

- (c) kjo Marrëveshje është autorizuar, ekzekutuar dhe realizuar siç duhet nga QK-ja dhe përbën detyrimin ligjor, të vlefshëm dhe të detyrueshëm të QK-së, i zbatueshëm kundër saj në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, me zbatueshmërinë e mjeteve juridike në varësi të kufizimeve të vendosura nga falimentimi, insolvenca, riorganizimi, moratoriumi ose ligje të tjera të ngjashme në fuqi që lidhen me ose ndikojnë në zbatimin e të drejtave të kreditorëve në përgjithësi dhe në parimet e përgjithshme të ekuitetit;
- (b) ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj Marrëveshjeje nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë dhe as nuk përbën një mospërmbushje sipas asnjë indenture, kredie hipotekare ose ndonjë marrëveshjeje tjetër materiale që lidhet me QK-në, ose ndonjë urdhri të vlefshëm të ndonjë gjykate, apo të ndonjë agjencie rregullatore ose organi tjetër që ka autoritet nga i cili varet QK-ja;
- (e) asgjë nga ekzekutimi, dorëzimi ose realizimi nga QK-ja i kësaj Marrëveshjeje, pajtueshmëria me termat dhe dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, dhe kryerja e transaksioneve të parashikuara me këtë, nuk është në konflikte ose nuk bie ndesh, ose nuk do të rezultojë në thyerje ose shkelje të ndonjë prej termave, kushteve ose dispozitave të ndonjë ligji të Kosovës ose ndonjë lejeje, apo ndonjë urdhri, urdhërese, mase, gjykimi ose dekreti të ndonjë Autoriteti Publik kundër QK-së.
- (d) QK-ja nuk është në mospërmbushje të asnjë marrëveshjeje ose instrumenti të çfarëdo natyre në të cilën është Palë ose me të cilën është i detyruar, në çfarëdo mënyre që do të kishte një efekt material negativ në aftësinë e vet për të përmbushur detyrimet e veta në vijim, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje.

QK-ja gjithashtu përfaqëson dhe i garanton GenCo-së se as QK-ja, dhe me sa dihet asnjë person që përfaqëson QK-në nuk ka kërkuar, marrë ose autorizuar dhe nuk do të kërkojë, marrë ose autorizojë kërkimin ose marrjen, në lidhje me çështjet që janë objekt i Marrëveshjes, të çdo pagesë, dhurate, premtimi ose avantazhesh të tjera nga çdo Palë që nuk është Sponsor HoldCo, qoftë drejtpërdrejt ose përmes ndërmjetësve, për ose për përdorimin e cilitdo Personi që punon drejtpërdrejt ose tërthorazi në emër të ndonjë Autoriteti Publik, ku një pagesë, dhuratë, premtim ose avantazh i tillë do të shkelte ndonjë nga Ligjet kundër Ryshfetit ("**Përfaqësimi dhe Garancia e Pajtueshmërisë së QK-së**").

17.3 Riafirmimi i Përfaqësimeve dhe Garancive

Në secilën prej Datës së Hyrjes në Fuqi dhe Datës së Bartjes, GenCo do të dorëzojë një certifikatë në QK duke konfirmuar se përfaqësimet në Seksionin 17.1 janë të vërteta dhe të sakta në ato data, dhe QK-ja duhet të dorëzojë një certifikatë në GenCo që konfirmon se përfaqësimet dhe garancitë në Seksionin 17.2 janë të vërteta dhe të sakta në ato data.

Neni 18

Kufizimi i Përgjegjesisë dhe Dëmshpërblimi në Lidhje me Pagesat e Paligjshme

18.1 Kufizimi i Përgjegjesisë

- (a) Përveçse siç parashikohet shprehimisht në të kundërt në këtë Marrëveshje, asnjëra Palë nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Palës tjetër në kontratë, padi, përgjegjësi strikte ose ndonjë teori tjetër ligjore për çfarëdo dëmsh të tërthorta, konsekuenciale, incidentale, ndëshkues apo shembullore. Pagesat që një Palë i ka detyrim ndaj Palës së tretë do të konsiderohen si dëme të drejtpërdrejta dhe nuk do të përjashtohen nga dispozitat e mësipërme të këtij Seksioni 18.1, përveç në lidhje me kontratat (përveç Kontratës së OM-së dhe Marrëveshjeve të Shërbimeve Administrative (siç përcaktohen në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) dhe çdo Marrëveshjeje të MAGJ-së të aprovuar nga KEKR sipas Nenit 3(*Detyrimet e Para-Ndërtimit*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë ndërmjet GenCo-së si njëra palë dhe çdo Filiali të Sponsorit Sipëror si homolog i GenCo-së (që do të përjashtohet nga dispozitat e mësipërme të këtij Seksioni 18.1(a)).
- (b) Asnjëra Palë nuk do të ketë asnjë përgjegjësi ndaj Palës tjetër përveç sipas, ose për shkelje të kësaj Marrëveshjeje ose të një Marrëveshjeje Projekti në të cilën është palë; me kusht që, sidoqoftë, kjo dispozitë nuk ka për qëllim të përbëj heqje dorë nga të drejtat e një Pale kundrejt tjetrës në lidhje me çështjet që nuk kanë lidhje me këtë Marrëveshje ose ndonjë aktivitet jo të parashikuar nga kjo Marrëveshje, dhe kjo dispozitë nuk ka për qëllim të kufizojë ose t'i mohojë GenCo-së të drejtën që (i) të kërkojë dhe të rikuperojë të gjitha të ardhurat e humbura të parashikuara në mënyrë eksplicite në Nenin 20 këtu ose sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit që lejon një rikuperim të tillë, ose (ii) për dëmshpërblim dhe/ose rikuperim të kostos në lidhje me Kushtet Mjedisore/Arkeologjike, siç janë parashikuar në çfarëdo Marrëveshjeje të Projektit.
- (c) Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje, në asnjë rast, QK-ja ose ndonjë Palë e QK-së ose GenCo ose ndonjë Palë e GenCo-së ose ndonjë nga zyrtarët ose drejtorët e GenCo-së nuk do të dëmshpërblehet për ndonjë Humbje në lidhje me ndonjë shkelje apo mospërmbushje të Përfaqësimit të Pajtushmërisë dhe Garancisë së QK-së ose Përfaqësimit të Pajtushmërisë dhe Garancisë së GenCo-së në çdo shumë më të madhe sesa më poshtë:
- (i) nëse aktet që shkaktojnë shkeljen ose mospërmbushjen e Përfaqësimit të Pajtushmërisë dhe Garancisë së QK-së ose Përfaqësimit të Pajtushmërisë dhe Garancisë së GenCo-së kanë ndodhur para Datës së Bartjes dhe aktet që shkaktojnë që Data e Bartjes të mos ndodhë, përgjegjësia e palëve nuk do të kalojë Kufirin e Kostove të Zhvillimit;
- (ii) përndryshe, përgjegjësia e Palëve për to nuk do të kalojë Çmimin e Blerjes të Mospërmbushjes nga QK-ja.

18.2 Dëmshpërblimi dhe Informacioni në Lidhje me Pagesat e Paligjshme

- (a) Përveçse siç parashikohet shprehimisht tjetërkund në këtë Marrëveshje, QK-ja do të dëmshpërblejë dhe mbrojë GenCo-në dhe çdo Palë të GenCo-së, në çdo kohë, nga secila çdo dhe të gjitha Humbjet që lindin ose kërkohet që të paguhen, direkt ose indirekt, nga GenCo ose ndonjë Palë e GenCo-së lidhje me çdo shkelje ose mospërmbushje të Përfaqësimit të Pajtushmërisë dhe Garancisë së QK-së.
- (b) Përveç siç parashikohet në mënyrë specifike në këtë Marrëveshje, GenCo-ja do të dëmshpërblejë dhe mbrojë QK-në dhe çdo Palë të QK-së, në çdo kohë pas datës së kësaj Marrëveshjeje, nga secila çdo dhe të gjitha Humbjet që lindin ose kërkohet që të paguhen, direkt ose indirekt, nga QK-ja ose ndonjë Palë e QK-së lidhje me çdo shkelje ose mospërmbushje të Përfaqësimit të Pajtushmërisë dhe Garancisë së GenCo-së:

Neni 19

Mospërmbushja; Ndërprerja

19.1 Ngjarjet e Mospërbushjes nga GenCo-ja

Secila nga të mëposhtmet do të përbëjë një ngjarje të mospërbushjes nga GenCo-ja (secila ngjarje e tillë është një "Ngjarje e Mospërbushjes nga GenCo-ja"):

- (a) dështimi nga GenCo për të bërë ndonjë pagesë për çdo shumë që i takon QK-së, brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve pasi GenCo ka marrë njoftimin me shkrim nga QK-ja se pagesa e tillë është e vonuar, dhe ky njoftim do të specifikojë dështimin e pagesës në detaje të arsyeshme; me kusht që, sidoqoftë, asnjë pagesë që është e detyruar si rezultat i zgjidhjes së një Kontesti të Pagesave, një Kontesti Teknik, apo ndonjë Kontesti tjetër, do të konsiderohet si detyrim për qëllimet e këtij Seksioni 19.1(a) deri në pesëmbëdhjetë (15) Ditë të Punës pas zgjidhjes së Kontestit të tillë;
- (b) caktimi i një kujdestari, marrësi, të besuari ose likuiduesi të GenCo, ose i të gjitha apo në thelb të gjitha asetëve të GenCo, në çdo procedim të ndërmarrë nga GenCo, sipas rastit, ose caktimi i ndonjë kujdestari, marrësi, të besuari, ose likuiduesi në çdo procedurë të ndërmarrë kundër GenCo që nuk shkarkohet brenda nëntëdhjetë (90) Ditëve pas caktimit të tillë, ose nëse GenCo jep pëlqimin ose pranon caktimin e tillë;
- (c) çdo përfaqësim ose garanci e bërë nga GenCo sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo përfaqësim ose garanci e bërë nga GenCo ose Sponsorit HoldCo në Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit dëshkohet se ka qenë i pasaktë në çdo aspekt material nga data e bërë ose riafirmuar, dhe një keqpërfaqim i tillë ka ose do të pritej me arsye që të ketë një efekt material negativ në QK ose Projektin Kosova e Re, dhe një defekt i tillë nuk është e mundur të kurohet ose nuk kurohet brenda dyzetepesë (45) Ditëve pasi GenCo ka marrë njoftimin me shkrim nga QK-ja, i cili do të specifikojë keqinterpretimin në detaje të arsyeshme; me kusht që, sidoqoftë nëse GenCo fillon marrjen e masave të duhura për të kuruar defektin e tillë brenda fillon brenda periudhës dyzet e pesë (45) Ditore, dhe më pas me zell vazhdon të ndjekë kurën e tillë, periudha e kurës do të zgjatet me nëntëdhjetë (90) Ditë shtesë për aq sa një defekt i tillë mund të kurohet brenda një periudhe të tillë kuruese të zgjatur;
- (d) dështimi nga ana e GenCo-së në çdo aspekt në respektimin ose kryerjen e ndonjë detyrimi tjetër material të GenCo-së që përmbahet këtu dhe që GenCo nuk ka kuruar brenda tridhjetë (30) Ditëve pasi GenCo ka marrë njoftimin me shkrim nga QK-ja, ku specifikohet dështimi në detaje të arsyeshme dhe kërkohet që të përmirësohet; me kusht që, sidoqoftë, nëse GenCo fillon marrjen e masave të duhura për të kuruar dështimin e tillë brenda tridhjetë të tillë (30) Ditëve, dhe më pas me zell vazhdon të kurojë dështimin e tillë, periudha e kurës do të zgjatet me nëntëdhjetë (90) Ditë shtesë;
- (e) pas Datës së Fillimit të Ndërtimit, por para arritjes së Datës së Operacioneve Komerciale, dështimi i GenCo-së për të ndjekur pjesëmarrjen e GenCo-së në Projektin Kosova e Re, në një mënyrë të arsyeshme dhe të kujdesshme, në përputhje me Praktikën Prudente të Shërbimeve Publike për një periudhë prej tridhjetë (30) Ditësh të njëpasnjëshme pa njoftuar paraprakisht dhe pa pëlqimin paraprak me shkrim të QK-së; me kusht që, sidoqoftë, nëse GenCo fillon marrjen e masave të duhura për të kuruar dështimin e tillë brenda tridhjetë të tillë (30) Ditëve, dhe më pas me zell vazhdon të kurojë dështimin e tillë, periudha e kurës do të zgjatet me nëntëdhjetë (90) Ditë shtesë;
- (f) ndodhja e ndonjë shkelje nga ana e QK-së për detyrimet e veta sipas Seksionit 23.13;
- (g) ndodhja e një Ngjarjeje të Mospërbushjes së Sponsorit HoldCo (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit) sipas Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit, duke përfshirë edhe kufizimin e bartjes së interesave të pronësisë siç përshkruhet në Nenin 4 të Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit;
- (h) dështimi i Sponsorit Sipëror për të përmbushur detyrimet e veta sipas Garancisë së Sponsorit Sipëror në përputhje me kushtet e saj; dhe

- (i) ndodhja e një Ngjarjeje të Mospërbushjes nga GenCo-ja (siç përcaktohet ose përshkruhet në çdo Marrëveshje relevante të Projektit) sipas ndonjë prej Marrëveshjeve të tjera të Projektit në të cilat GenCo është palë, duke përfshirë edhe ndodhjen e një Ngjarjeje të Mospërbushjes nga GenCo-ja që mund të çojë në ndërprerjen nga KOSTT-i të Marrëveshjes së Kycjes në pajtim me Seksionin 9 të saj, dhe ndodhja e një Ngjarjeje të Mospërbushjes nga GenCo-ja që mund të çojë në ndërprerjen nga QK-ja të Marrëveshjes së Qiradhënies në pajtim me Seksionin 4.1 të Kalendarit 5 (me përjashtim të masës që kjo është bartur tek KOSTT-i);

me kusht që, sidogoftë, asnjë ngjarje e tillë nuk do të jetë një Ngjarje e Mospërbushjes nga GenCo-ja, dhe GenCo do të lirohet nga performanca sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse është shkaktuar tërësisht ose në pjesë materiale nga:

- (i) një shkelje nga QK-ja ose një vonesë nga QK-ja sipas kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë çdo Ngjarje të Mospërbushjes nga QK-ja);
- (ii) Veprimi ose mosveprimi i një NP-je të Specifikuar; ose
- (iii) një Ngjarje e Forcës Madhore (përveç në rastin e një mospërbushjeje të pagesës sipas Seksionit 19.1(a)); dhe

me kusht që, më tej në masën që çdo detyrim i GenCo-së sipas kësaj Marrëveshjeje është gjithashtu një detyrim i KEK-së sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit, atëherë çdo kurim, shlyerje ose heqje dorë nga një shkelje e këtij detyrimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit do të përbëjë një kurë, zgjidhje ose heqje dorë sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse GenCo ka njoftuar paraprakisht për këtë kurim, shlyerje ose heqje dorë nga një detyrim i tillë sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit dhe nuk ka arritur në mënyrë të arsyeshme ta kundërshtojë një kurë, shlyerje apo heqje të tillë brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

GenCo mund të kurojë një Ngjarje të Mospërbushjes nga GenCo-ja duke shkaktuar që një Kontraktor i GenCo-së të kurojë Ngjarjen e tillë të Mospërbushjes nga GenCo-ja.

19.2 Ngjarjet e Mospërbushjes nga QK-ja

Secila nga të mëposhtmet do të përbëjë një Ngjarje të Mospërbushjes nga QK-ja (secila ngjarje e tillë është një "**Ngjarje e Mospërbushjes nga QK-ja**"):

- (a) shpërbërja në pajtim me ligjet e Kosovës e çdo NP-je të Specifikuar, përveç rasteve të bashkimit, riorganizimit, rindërtimit, siç mund të jetë rasti, ku QK-ja pa ndërprerje garanton performancën e subjektit ose subjekteve pasuese në të njëjtat terma dhe kushte si Garancia e Qeverisë, dhe të gjitha detyrimet përkatëse të NP-ve të Specifikuara sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, Marrëveshjes për Bartjen e Lokacionit, Marrëveshjes për Furnizim me Linjit, Marrëveshjes për Furnizim me Ujë, Marrëveshjes për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, ose Marrëveshjes së Kycjes, sipas rastit, të jenë të caktuara sipas ligjeve të Kosovës ose të supozuara nga ana kontraktuale, përmes novacioneve ose jo, nga një (1) ose më shumë subjekte, secili me kapacitetin udhëheqës dhe funksionin e duhur komercial për të përbushur detyrimet e veta;
- (b) çdo përfaqësim ose garanci e bërë nga QK-ja sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo përfaqësim ose garanci e bërë nga QK-ja sipas Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit dëshkohet se ka qenë i pasaktë në çdo aspekt material nga data e bërë ose riafirmuar, dhe një keqpërfaqim i tillë ka ose do të pritej me arsye që të ketë një efekt material negativ në GenCo ose Projektin Kosova e Re, dhe një defekt i tillë nuk është e mundur të kurohet ose nuk kurohet brenda dyzetepesë (45) Ditëve pas njoftimit me shkrim nga GenCo, i cili do të specifikojë keqinterpretimin në detaje të arsyeshme; me kusht që, sidogoftë nëse QK-ja fillon marrjen e masave të duhura për të kuruar defektin e tillë brenda fillimisht të dyzet e pesë (45) Ditëve, dhe më pas me zell vazhdon të ndjekë kurën e tillë, periudha e kurës do të zgjatet me nëntëdhjetë (90) Ditë shtesë për aq sa një defekt i tillë mund të kurohet brenda një periudhe të tillë kuruese të zgjatur;

- (c) dështimi nga ana e QK-së në çdo aspekt në respektimin ose përmbushjen e ndonjë detyrimi tjetër material të QK-së që përmbahet këtu dhe që QK-ja nuk ka kuruar brenda tridhjetë (30) Ditëve pas njoftimit me shkrim nga GenCo, ku specifikohet dështimi në detaje të arsyeshme dhe kërkohet që të përmirësohet; me kusht që, sidoqoftë, nëse QK-ja fillon marrjen e masave të duhura për të kuruar dështimin e tillë brenda tridhjetë të tillë (30) Ditëve, dhe më pas me zell vazhdon të kurojë dështimin e tillë, periudha e kurës do të zgjatet me nëntëdhjetë (90) Ditë shtesë;
- (d) dështimi nga QK-ja për të bërë ndonjë pagesë për çdo shumë që i takon GenCo-së, brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve pasi QK-ja ka marrë njoftimin me shkrim nga GenCo-ja se pagesa e tillë është e vonuar, dhe ky njoftim do të specifikojë dështimin e pagesës në detaje të arsyeshme; me kusht që, sidoqoftë, asnjë pagesë që është e detyruar si rezultat i zgjidhjes së një Kontesti të Pagesave, një Kontesti Teknik, apo ndonjë Kontesti tjetër, nuk do të konsiderohet si detyrim për qëllimet e këtij Seksioni 19.2(a) deri në pesëmbëdhjetë (15) Ditëve të Punës pas zgjidhjes së Kontestit të tillë;
- (e) shpronësimi, blerja e detyrueshme ose shtetëzimi nga QK-ja ose ndonjë Autoriteti Publik i Kosovës
- (i) çdo Interes i Pronësisë në GenCo ose Sponsorin HoldCo, ose
- (ii) çdo aset material apo e drejtë e GenCo-së ose Sponsorit HoldCo në lidhje me Projektin Kosova e Re (përveçse siç parashikohet nga Marrëveshjet e Projektit);
- (f) ndodhja e çdo Ndryshimi në Ligj që:
- (i) bën të paligjshme, të pazbatueshme, të pavlefshme ose të zhvlerësuar çdo ndërmarrje materiale të QK-së, KESCO-së ose ndonjë NP-je të Specifikuar sipas kësaj Marrëveshjeje, Garancisë së Qeverisë, Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, Marrëveshjes për Furnizim me Linjit, Marrëveshjes për Furnizim me Ujë, Marrëveshjes për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, Marrëveshjes së Kycjes ose çdo Marrëveshjeje tjetër të Projektit në të cilën QK, KESCO ose çdo NP e Specifikuar është palë, sipas rastit; ose
- (ii) e bën të paligjshme që GenCo të bëjë ose të marrë, ose që Huadhënësit, Sponsorit HoldCo ose Sponsorit Sipëror të marrë ndonjë pagesë (duke përfshirë interesin), ose që GenCo ose Sponsorit HoldCo të përmbushin ndonjë detyrim material ose të gëzojnë ose zbatojnë ndonjë të drejtë materiale sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë Marrëveshjeje të Projektit ose ndonjë Dokumenti të Financimit ose ndonjë Kontrate Ndërtimi/Mirëmbajtjeje, ose që Sponsorit HoldCo ose Sponsorit Sipëror të përmbushin ndonjë detyrim material ose të gëzojnë ose zbatojnë ndonjë të drejtë materiale sipas çdo Marrëveshjeje të Projektit në të cilën janë palë; ose
- (iii) ka një Efekt Material tek GenCo dhe GenCo nuk mbahet në një pozitë financiare neutrale pas ndodhjes së Efektit Material tek GenCo;
- (iv) vendos ndonjë kufizim ose limitim material (përtej atyre kufizimeve ose limitimeve që ekzistojnë në datën e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje) mbi aftësinë e Sponsorit HoldCo ose Sponsorit Sipëror ose Huadhënësve për të riatdhesuar çdo kapital, dividendë, shpërndarje, ose të ardhura ose pagesa të tjera nga GenCo (me kusht që shpërndarjet e tilla të mos lindin në lidhje me një shkelje të kësaj Marrëveshjeje),
- e cila në rastin e (i), (ii) ose (iii) më sipër, ka një efekt të vazhdueshëm për më shumë se gjashtëdhjetë (60) Ditë pa një aranzhim të arsyeshëm për të përjashtuar ose rimbursuar Personin e prekur nga efekti (përfshirë kostot) i Ndryshimeve të tilla në Ligj ose për të korrigjuar efektet (përfshirë kostot) e Ndryshimit në Ligj për palën e prekur;
- (g) ushtrimi nga ana e QK-së ose nga një Autoritet Publik i Kosovës i
- (i) çdo të drejte sipas Ligjit për Energjinë, 2016 (Nr. 05/L-081) ose Ligjeve të Kosovës për të

- vendosur detyrime të veçanta ndaj GenCo-së në përgjigje të një emergjence, nëse detyrimet e tilla të veçanta kanë një Efekt Material tek GenCo;
- (ii) përveç siç parashikohet ndryshe në Marrëveshjet e Projektit, çdo e drejtë sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, 2016 (Nr. 05/L-085) ose Ligjeve të Kosovës, për të vendosur ndaj GenCo-së detyrimin për të vënë kapacitet gjenerues ose energji në dispozicion të një furnizuesi nëse një detyrim i tillë ka një Efekt Material tek GenCo;
- (h) dështimi i QK-së për të fituar të drejtat e pronës së paluajtshme të specifikuar sipas nevojës në Raportin e Blerjes së Tokës në përputhje me Seksionin 3.5.1(c);
- (i) dështimi i Mihjes së KEK-ut ose i Qeverisë së Kosovës për të përmbushur Standardet e Zbatueshme në lidhje me pronësinë, zhvillimin (duke përfshirë edhe rivendosjen) dhe operimin e Fushës Jugore të Mihjes në Sibovc dhe Aseteve Minerare që
- (i) shkakton që Huadhënësit (i) të refuzojnë të bëjnë një pagesë të borxhit të zotuar, (ii) të përshpejtojnë detyrimet e shlyerjes së borxheve të GenCo-së, ose (iii) të refuzojnë t'i lejojnë GenCo-së të emetojë dividendë ose të bëjë shpërndarjet në ekuitet, secila në përputhje me kushtet e Dokumenteve të Financimit, ose
 - (ii) rezulton në ndonjë detyrim financiar material për GenCo sipas Marrëveshjeve të Projektit ose një gjobë ose penaltitë të shqiptuar nga QK-ja ose një Autoritet Publik (secila deri në atë masë që nuk rimbursohet nga QK-ja ose një NP e Specifikuar), ose ka një ndikim material negativ në aftësinë e GenCo-së për të prodhuar, dorëzuar dhe shitur kapacitetin dhe energjinë elektrike të Objektivit të TCKR-së siç parashikohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë;
- (j) një dështim nga ana e Mihjes së KEK-ut ose e Qeverisë së Kosovës për të përmbushur Kërkesat e Instrumentit të Asociuar të Bankës Botërore që
- (i) shkakton që Huadhënësit (i) të refuzojnë të bëjnë një pagesë të borxhit të zotuar, (ii) të përshpejtojnë detyrimet e shlyerjes së borxheve të GenCo-së, ose (iii) të refuzojnë t'i lejojnë GenCo-së të emetojë dividendë ose të bëjë shpërndarjet në ekuitet, secila në përputhje me kushtet e Dokumenteve të Financimit, ose
 - (ii) rezulton në ndonjë detyrim financiar material për GenCo sipas Marrëveshjeve të Projektit ose një gjobë ose penaltitë të shqiptuar nga QK-ja ose një Autoritet Publik (secila deri në atë masë që nuk rimbursohet nga QK-ja ose një NP e Specifikuar), ose ka një ndikim material negativ në aftësinë e GenCo-së për të prodhuar, dorëzuar dhe shitur kapacitetin dhe energjinë elektrike të Objektivit të TCKR-së siç parashikohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë;
- (k) dështimi i QK-së për të përmbushur Standardet e Zbatueshme në lidhje me çdo zhvendosje që lidhet me Zonën e Kycjes siç është përcaktuar në Seksionin 3.6.2 ose për të zhvilluar dhe zbatuar Planin e Veprimt për Zhvendosje, dhe një dështim i tillë
- (i) shkakton që Huadhënësit (i) të refuzojnë të bëjnë një pagesë të borxhit të zotuar, (ii) të përshpejtojnë detyrimet e shlyerjes së borxheve të GenCo-së, ose (iii) të refuzojnë t'i lejojnë GenCo-së të emetojë dividendë ose të bëjë shpërndarjet në ekuitet, secila në përputhje me kushtet e Dokumenteve të Financimit, ose
 - (ii) rezulton në ndonjë detyrim financiar material për GenCo sipas Marrëveshjeve të Projektit ose një gjobë ose penaltitë të shqiptuar nga QK-ja ose një Autoritet Publik (secila deri në atë masë që nuk rimbursohet nga QK-ja ose një NP e Specifikuar), ose ka një ndikim material negativ në aftësinë e GenCo-së për të prodhuar, dorëzuar dhe shitur kapacitetin dhe energjinë elektrike të Objektivit të TCKR-së siç parashikohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë;

- (l) ndodhja (pas marrjes në konsideratë të çdo periudhe kuruese të aplikueshme) e:
- (i) një Ngjarje të Mospërmbushjes nga Furnizuesi me Ujë (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Furnizim me Ujë);
 - (ii) një Ngjarje të Mospërmbushjes nga Mihja e KEK-ut (siç është përcaktuar në Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsit) sipas Marrëveshjes për Deponimin e Hirit dhe Gipsit;
 - (iii) një Ngjarje të Mospërmbushjes nga Mihja e KEK-ut (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Furnizim me Linjit) sipas Marrëveshjes për Furnizim me Linjit;
 - (iv) një Ngjarje të Mospërmbushjes nga KOSTT-i sipas Marrëveshjes së Kyçjes; ose
 - (v) një Ngjarje të Mospërmbushjes nga KEKR-ja (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, Marrëveshjes së Qiradhënies, Garancisë së Qeverisë, Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit dhe Marrëveshjes për Deponimin e Hirit dhe Gipsit; ose
 - (vi) një mospërmbushje nga ndonjë NP tjetër e Specifikuar që është palë në ndonjë Marrëveshje tjetër të Projektit sipas çdo Marrëveshjeje të Projektit; dhe
- (m) ndodhja e ndonjë shkelje në caktimin nga ana e QK-së të detyrimeve të veta sipas Seksionit 23.13; me kusht që, sidoqoftë, asnjë ngjarje e tillë nuk do të jetë një Ngjarje e Mospërmbushjes nga QK-ja, dhe QK-ja do të lirohet nga performanca sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse është shkaktuar tërësisht ose në pjesë materiale nga:
- (i) një shkelje nga GenCo ose një mospërmbushje nga GenCo sipas kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë çdo Ngjarje të Mospërmbushjes nga GenCo-ja) ose Veprim apo Mosveprim i GenCo-së;
 - (ii) një Ngjarje të Forcës Madhore (përveç në rastin e një mospërmbushje të pagesës sipas Seksionit 19.2(d)); dhe

me kusht që, më tej në masën që çdo detyrim i QK-së sipas kësaj Marrëveshjeje është gjithashtu një detyrim i QK-së sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit, atëherë çdo kurim, shlyerje ose heqje dorë nga një shkelje e këtij detyrimi sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit do të përbëjë një kurë, zgjidhje ose heqje dorë sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse GenCo-ja ka njoftuar paraprakisht për këtë kurim, shlyerje ose heqje dorë nga një detyrim i tillë sipas Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit dhe nuk ka arritur në mënyrë të arsyeshme ta kundërshtojë një kurë, shlyerje apo heqje të tillë brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

KEKR mund ta kuruar një Ngjarje të Mospërmbushjes nga QK-ja duke shkaktuar që një Kontraktor i QK-së ta kurojë këtë Ngjarje të Mospërmbushjes nga QK-ja.

Pavarësisht nga Seksioni 3.5.1 (a) ose ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë Marrëveshjeje të Projektit, përveç siç parashikohet në Seksionin 19.2(i) deri në Seksionin 19.2(k) të kësaj Marrëveshjeje (dhe të gjitha dispozitat përkatëse (në të gjitha Marrëveshjet e Projektit) që parashikojnë të drejtat dhe/ose mjetet juridike të GenCo-së në lidhje me Ngjarjet e tilla të Mospërmbushjes nga QK-ja ose në lidhje me mbrojtjen në dobi të GenCo-së në lidhje me ndonjë Veprim ose Mosveprim të ndonjë NP-je të Specifikuar), dështimi i QK-së për të qenë në pajtim, ose përndryshe për të ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me, Standardet e Zbatueshme ose Ligjet e Kosovës nuk do të jenë Ngjarje e Mospërmbushjes nga QK-ja dhe nuk do të ketë asnjë mjet juridik të GenCo-së në lidhje me to.

19.3 Njoftimi për Ndërprerje

- (a) Sipas Seksionit 19.3 (b), nëse ndodh dhe po vazhdon ndonjë Ngjarje e Mospërmbushjes nga GenCo-ja ose Ngjarje e Mospërmbushjes nga QK-ja, sipas rastit, Pala që nuk është në

mospërmbushje mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje duke dhënë një njoftim ("Njoftimi i Ndërprerjes") Palës së mospërmbushjes, dhe ky njoftim duhet të specifikojë në detaje të arsyeshme Ngjarjen e Mospërmbushjes nga GenCo-ja ose Ngjarjen e Mospërmbushjes nga QK-ja, sipas rastit, që ka shkaktuar Njoftimin e Ndërprerjes.

- (b) Kjo Marrëveshje do të ndërpritet në datën e specifikuar në Njoftimin për Ndërprerje, dhe kjo datë nuk duhet të jetë më herët se dita që është dhjetë (10) Ditë Pune pas datës në të cilën Njoftimi i Ndërprerjes i dorëzohet Palës tjetër ose më vonë se tridhjetë (30) Ditë pas datës së dorëzimit të tillë.

19.4 Ndërprerja për shkak Ngjarjes së Forcës Madhore Politike ose Ndryshimit në Ligj

Nëse ndodh një Ngjarje e Forcës Madhore Politike ose një Ndryshim në ligj, që në çdo rast ka vazhduar (duke përjashtuar efektet e tyre) pa ndërprerje dhe ka një ndikim material negativ tek GenCo për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh ose më shumë pas njoftimit të QK-së për një Ngjarje të tillë të Forcës Madhore Politike ose Ndryshimi në Ligj, atëherë secila Palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje; me kusht që, sidoqoftë, nëse QK-ja fillon marrjen e masave të duhura për të kuruar efektin e tillë brenda gjashtë (6) Muajve të tillë, dhe më pas me zell vazhdon të ndjekë kurën e tillë, periudha e kurës duhet të zgjatet me gjashtë (6) Muaj për aq kohë sa efekti i tillë mund të kurohet brenda një periudhe të tillë kuruese të zgjatur. Për ta ndërprerë këtë Marrëveshje, një Palë do të dorëzojë një njoftim të tillë, dhe njoftimi do të jetë efektiv tridhjetë (30) Ditë pas dorëzimit të një njoftimi të tillë tek Pala tjetër. Pas ndërprerjes të kësaj, do të zbatohen dispozitat e Nenit 20.

19.5 Detyrimet pas Njoftimit për Ndërprerje të Kontestuar

Palët do të vazhdojnë të kryejnë obligimet e tyre përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje në pritje të zgjidhjes përfundimtare të çdo Kontesti në lidhje me ose që rrjedh nga një Njoftim për Ndërprerje në pajtim me Seksionin 19.3 ose njoftimi për ndërprerje sipas Seksionit 19.4.

19.6 Mjetet e Tjera Juridike

- (a) Përveçse siç parashikohet Seksionin 19.6(b) dhe në varësi të Seksionit 18.1, ushtrimi i të drejtës së një Pale për ta ndërprerë këtë Marrëveshje, siç parashikohet këtu, nuk përjashton Palën e tillë nga ushtrimi i të drejtave të tjera ose mjeteve juridike që janë dhënë në këtë Marrëveshje ose janë të disponueshme sipas ligjit ose në ekuitet; me kusht që, sidoqoftë, asnjë palë do të ketë të drejtën për të ndërprerë apo trajtuar detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje si të mohuar, përveç në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje. Në varësi të dispozitave të Nenit 18 Seksionit 19.6(b) në lidhje me një ndërprerje, dhe me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, mjetet juridike janë kumulative dhe ushtrimi ose moszbatimi i një ose më shumë të drejtave ose mjeteve të tilla nga një Palë nuk do të kufizojë ose përjashtojë ushtrimin ose heqjen dorë nga të drejtat ose mjete të tjera nga një Palë e tillë.
- (b) Pavarësisht nga Seksioni 19.6 (a), mjetet juridike dhe kompensimet e parashikuara në Nenin 20 janë mjetet juridike ekskluzive në dispozicion të secilës palë në lidhje me çdo ndërprerje të kësaj Marrëveshjeje si pasojë e ngjarjeve të përshkuara në Nenin 20.
- (c) E REZERVUAR.

Neni 20

Të drejtat dhe Detyrimet pas Ndërprerjes; Kompensimi

20.1 Ngjarja e Mospërmbushjes nga GenCo-ja

Në rast se QK-ja e ndërpret këtë Marrëveshje në pajtim me Seksionin 19.3 si rezultat i një Ngjarjeje të Mospërmbushjes nga GenCo-ja që ndodh pas Datës së Bartjes, QK-ja (ose i emëruari i saj) do të duhet që të marrë të gjitha të drejtat, titullin dhe interesat e GenCo në dhe për Objektivin e TCKR-së. Objekti i TCKR-së do t'i bartet QK-së (ose të caktuarit të saj) në përputhje me dispozitat e bartjes të përcaktuara në Kalendarin 4, dhe QK-ja do t'i paguajë GenCo-së Çmimin e Blerjes të Mospërmbushjes nga GenCo-ja; me

kusht që, sidoqoftë, për aq sa Çmimi i Blerjes i Mospërmbushjes nga GenCo-ja është negativ, GenCo do t'ia paguajë QK-së shumën e tillë.

20.2 Ngjarja e Mospërmbushjes nga QK-ja

Në rast se GenCo e ndërpret këtë Marrëveshje në pajtim me Seksionin 19.3 si rezultat i një Ngjarjeje të Mospërmbushjes nga QK-ja që ndodh pas Datës së Bartjes, QK-ja (ose i emëruari i saj) do të duhet që të marrë të gjitha të drejtat, titullin dhe interesat e GenCo në dhe për Objektin e TCKR-së. Objekti i TCKR-së do t'i bartet QK-së (ose të caktuarit të saj) në përputhje me dispozitat e bartjes të përcaktuara në Kalendarin 4, dhe QK-ja do t'i paguajë GenCo-së Çmimin e Blerjes të Mospërmbushjes nga QK-ja; me kusht që, sidoqoftë, për aq sa Çmimi i Blerjes i Mospërmbushjes nga QK-ja është negativ, GenCo do t'ia paguajë QK-së shumën e tillë.

20.3 Ndërprerja pas Ngjarjes së Forcës Madhore Politike, Ndryshimit të Ligjit, Ngjarjes së Forcës Madhore të Ujit të Papërpunuar, ose Ndryshimit në Cilësinë e Ujit të Papërpunuar

Në rast se:

- (a) secila Palë e ndërpret këtë Marrëveshje në pajtim me Seksionin 19.4 si rezultat i një Ngjarjeje të Forcës Madhore Politike ose një Ndryshimi në Ligj, në çdo rast që ndodh pas Datës së Bartjes; ose
- (b) ndonjë nga:
 - (i) Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike ndërpritet pas Datës së Bartjes nga KEKR ose GenCo pas një Ngjarjeje të Forcës Madhore Politike, një Ndryshim në Ligj, një Ngjarjeje të Forcës Madhore të Ujit të Papërpunuar ose një Ndryshimi në Cilësinë e Ujit të Papërpunuar, në secilin rast sipas Nenit 24 (*Forca Madhore*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; ose
 - (ii) çdo Marrëveshje tjetër e Projektit ndërpritet në përputhje me kushtet e saj pas Datës së Bartjes pas një Ngjarjeje të Forcës Madhore Politike ose një Ndryshimi në Ligj,

QK-ja (ose i emëruari i saj) do të kërkohet që të marrë të gjitha të drejtat, titullin dhe interesat e GenCo-së në dhe për Objektin e TCKR-së. Objekti i TCKR-së do t'i bartet QK-së (ose të caktuarit të saj) në përputhje me dispozitat e bartjes të përcaktuara në Kalendarin 4, dhe QK-ja do t'ia paguajë GenCo-së Çmimin e Blerjes të Mospërmbushjes nga QK-ja; me kusht që, sidoqoftë, për aq sa Çmimi i Blerjes i Mospërmbushjes nga QK-ja është negativ, GenCo do t'ia paguajë QK-së shumën e tillë.

20.4 Ndërprerja pas Ngjarjes Tjetër të Forcës Madhore

Në rast se:

- (a) Marrëveshja për Blerjen e Energjisë Elektrike ndërpritet pas Datës së Bartjes nga KEKR ose GenCo pas një Ngjarjeje Tjetër të Forcës Madhore në pajtim me Seksionin 24.11 (*E drejta për Ndërprerje pas një Ngjarjeje Tjetër të Forcës Madhore*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; ose
- (b) njëra palë deklaron, pas Datës së Bartjes, një Ngjarje Tjetër të Blerjes së Forcës Madhore (siç është përcaktuar në Marrëveshjen për Furnizim me Linjit, Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, ose Marrëveshjen për Furnizim me Ujë, sipas rastit) në përputhje me Marrëveshjen për Furnizim me Linjit, Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, ose Marrëveshjen për Furnizim me Ujë, siç mund të jetë rasti,
- (c) E REZERVUAR

atëherë QK do të kërkohet që të marrë të gjitha të drejtat, titullin dhe interesat e GenCo-së në dhe për Objektin e TCKR-së. Objekti i TCKR-së do t'i bartet QK-së (ose të caktuarit të saj) në përputhje me dispozitat e bartjes të përcaktuara në Kalendarin 4, dhe QK-ja do t'ia paguajë GenCo-së Çmimin e Blerjes të

Forcës Tjetër Madhore; me kusht që, sidoqoftë, për aq sa Çmimi i Blerjes i Mospërmbushjes të Forcës Tjetër Madhore është negativ, GenCo do t'ia paguajë QK-së shumën e tillë.

20.5 Ndërprerja pas Zgjedhjes Në Lidhje me Sanimin Mjedisor

Pas Datës së Bartjes, nëse pas dorëzimit të Raportit të Sanimit të Plotë Mjedisor (siç është përcaktuar në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë):

- (a) KEKR zgjedh të ndërpresë Marrëveshjen për Blerje të Energjisë në pajtim me Seksionin 15.3.5 (*Përcaktimi Pas Raportit të Sanimit të Plotë Mjedisor*), Seksionin 15.3.6 (*Zbatimi i Sanimit Mjedisor*), ose Seksionin 15.3.7 (*Ndërprerja për shkak të Vazhimit të Kushtit Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik ose Rritjes së Kostos*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; ose
- (b) GenCo zgjedh ta ndërpresë Marrëveshjen për Blerje të Energjisë në pajtim me Seksionin 15.3.7 (*Ndërprerja për shkak të Vazhimit të Kushtit Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik ose Rritjes së Kostos*) të Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë;

atëherë QK do të kërkohet që të marrë të gjitha të drejtat, titullin dhe interesat e GenCo-së në dhe për Objektivin e TCKR-së. Objekti i TCKR-së do t'i bartet QK-së (ose të caktuarit të saj) në përputhje me dispozitat e bartjes të përcaktuara në Kalendarin 4, dhe QK-ja do t'ia paguajë GenCo-së Çmimin e Blerjes së Ndërprerjes Mjedisore; me kusht që, sidoqoftë, për aq sa Çmimi i Blerjes së Ndërprerjes Mjedisore është negativ, GenCo do t'ia paguajë QK-së shumën e tillë.

20.6 Skadimi i Afatit

Pas skadimit të afatit (përveçse në pajtim me çdo ndërprerje të parakohshme), QK-ja do të kërkohet që të marrë të gjitha të drejtat, titullin dhe interesat e GenCo-së në dhe për Objektivin e TCKR-së. Objekti i TCKR-së do t'i bartet QK-së (ose të caktuarit të saj) në përputhje me dispozitat e bartjes të përcaktuara në Kalendarin 4, dhe QK-ja do t'ia paguajë GenCo-së Çmimin e Blerjes në Fund të Afatit; me kusht që, sidoqoftë, për aq sa Çmimi i Blerjes në Fund të Afatit është negativ, GenCo do t'ia paguajë QK-së shumën e tillë.

20.7 Auditimi Përpara Skadimit të Afatit

Në çdo kohë brenda periudhës që është tetëmbëdhjetë (18) Muaj ose më pak përpara skadimit të afatit të parashikuar (përveçse sipas ndonjë ndërprerjeje të parakohshme), QK-ja mund t'ia kërkojë GenCo-së të ndërmarrë (i) një auditim paraprak mjedisor të Objektivit të TCKR-së në përputhje me Seksionin 6.1(b) të Kalendarit 4, (ii) një auditim paraprak të mirëmbajtjes në përputhje me Seksionin 5.1(b) të Kalendarit 4, (iii) një kontabilitet të kontributeve të financimit të bëra në Fondin për Zhvillim të Komunitetit, dhe (iv) një kontabilitet të mjeteve në Llogarinë e Rezervës së Shërbimit të Borxhit, Llogarinë e Rezervës së Kapitalit Punues, Fondin e Rezervës së Mirëmbajtjes Madhore dhe rezerva të tjera që u financuan nga pagesat nga KEKR-ja sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë. Në masën që përcaktimi i tillë paraprak tregon se që nga fillimi i Vitit të fundit të Marrëveshjes (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë), Çmimi i Blerjes në Fund të Afatit pritet të jetë negativ bazuar në përcaktimin e tillë paraprak, atëherë GenCo, me kostot e veta do t'ia sigurojë QK-së jo më vonë se fillimi i Vitit të fundit të Marrëveshjes (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) një letër kredie (i) nga një Bankë e Kualifikuar, (ii) sipas termave dhe kushteve të arsyeshme të pranueshme për GenCo, (iii) ë shumën agregate në Euro në dispozicion për tërheqje në bazë të kërkesës të barabartë me shumën e Çmimit negativ të Blerjes në Fund të Afatit.

20.8 Detyrimet në Pritje të Datës së Blerjes

Në pritje të bartjes së Objektivit të TCKR-së në përputhje me këtë Nen 20, GenCo do të vazhdojë, me përjashtim të rasteve kur vazhdimi i tillë do të krijonte rreziqe të paarsyeshme të lëndimit ose vdekjes për punonjësit e GenCo ose të Kontraktorit të GenCo-së, të okupojë Objektivin e TCKR-së në pritje të Datës së Blerjes dhe do të vazhdojë ta operojë Objektivin e TCKR-së në përputhje me Praktikën Prudente të Shërbimeve Publike dhe kursin e mëparshëm të operacioneve të zakonshme të GenCo-së dhe do të paguhet

secila prej Pagesave të Disponueshmërisë dhe Pagesave të Energjisë (siç është përcaktuar termi i tillë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) në përputhje me Marrëveshjen për Blerje të Energjisë, sikur të mos ishte ndërprerë Marrëveshja për Blerjen e Energjisë deri në kohën kur GenCo nuk është më i detyruar ta okupojë Objektin e TCKR-së.

20.9 E Drejta për Ndërprerje për Shkak të Dështimit të Arritjes së Datës së Bartjes; Kompensimi

20.9.1 E drejta për Ndërprerje

- (a) Pavarësisht nga çdo kusht tjetër i kësaj Marrëveshjeje, nëse GenCo e ndërpret Marrëveshjen për Bartjen e Lokacionit sipas Seksionit 5.4 (*Ndërprerje për Precedentin e Dështimit në Përmbushjen e Kushteve*), atëherë GenCo ose QK-ja do të kenë të drejtën ta ndërpresin këtë Marrëveshje duke njoftuar Palën tjetër.
- (b) Pavarësisht nga çdo kusht tjetër i kësaj Marrëveshjeje, nëse Gjenerimi i KEK-ut e ndërpret Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit sipas Seksionit 5.4 (*Ndërprerje për Precedentin e Dështimit në Përmbushjen e Kushteve*), atëherë QK-ja ose GenCo do të kenë të drejtën ta zgjidhin këtë Marrëveshje duke njoftuar Palën tjetër.

20.9.2 Pagesat në lidhje me Ndërprerjen e Hershme për Dështimin në Arritjen e Datës së Bartjes

- (a) Kostot e Zhvillimit - Ngjarje e Konsideruar e Kurdisjes së QK-së

Në rast se GenCo e ndërpret Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit në pajtim me Seksionin 5.4.1(a) (*Ndërprerja nga GenCo*) me rastin e ndodhjes së një Ngjarjeje të Konsideruar të Kurdisjes së QK-së, atëherë QK-ja do t'i paguajë GenCo-së shumën e të gjitha Kostove të Zhvillimit të shkaktuara, por në çdo rast jo më shumë sesa shuma e Kufirit të Kostove të Zhvillimit.

- (b) Kostot e Zhvillimit - Ngjarje e Konsideruar e Kurdisjes së QK-së

Në rast se Gjenerimi i KEK-ut e ndërpret Marrëveshjen për Bartjen e Lokacionit në pajtim me Seksionin 5.4.2(a) (*Ndërprerja nga Gjenerimi i KEK-ut*), me rastin e ndodhjes së një Ngjarjeje të Konsideruar të Kurdisjes së QK-së, atëherë QK-ja nuk do të jetë përgjegjëse t'i paguajë GenCo-së Kostot e Zhvillimit të shkaktuara dhe QK-ja mund të tërheqë nga Sigurimi i Financimit siç përcaktohet në dhe në përputhje me Marrëveshjen për Mbështetjen e Sponsorit.

- (c) Kostot e zhvillimit - Precedenti i Kushtit Pa Defekte

Në rast se:

- (i) GenCo ndërpret Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit në përputhje me Seksionin 5.4.1(a) (*Ndërprerja nga GenCo*) për shkak të dështimit të ndodhjes së Datës së Bartjes brenda Datës së Kërkuar të Bartjes (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit) dhe dështimi i tillë është vetëm për shkak të mospërmbushjes së ndonjë Precedenti të Kushtit Pa Defekte; ose
- (ii) Gjenerimi i KEK-ut e ndërpret Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit në përputhje me Seksionin 5.4.2(a) (*Ndërprerja nga Gjenerimi i KEK-ut*) për shkak të dështimit të ndodhjes së Datës së Bartjes brenda Datës së Kërkuar të Bartjes (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit) dhe dështimi i tillë është vetëm për shkak të mospërmbushjes së ndonjë Precedenti të Kushtit Pa Defekte,

atëherë QK-ja do t'i paguajë GenCo-së shumën e të gjitha Kostove të Zhvillimit të shkaktuara, por në çdo rast, jo më shumë se një shumë të barabartë me një të tretën (1/3) e Kufirit të Kostove të Zhvillimit.

- (d) Kostot e Zhvillimit - Të dyja, Ngjarje e Konsideruar e Kurdisjes së QK-së dhe Ngjarje e Konsideruar e Kurdisjes së GenCo-së

Në rast se ose GenCo ose Gjenerimi i KEK-ut e ndërpret Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit në

pajtim me Seksionin 5.4.3 (*Ndërprerja për Ndodhjen e Ngjarjes së Konsideruar të Kurdisjes së QK-së dhe Ngjarjes së Konsideruar të Kurdisjes së GenCo-së*) për shkak të ndodhjes së të dyjave (a) një ose më shumë Ngjarje të Konsideruara të Kurdisjes së QK-së dhe (b) një ose më shumë Ngjarje të Konsideruara të Kurdisjes së GenCo-së, atëherë QK-së nuk do t'i kërkohet që t'i paguajë GenCo-së Kostot e shkaktuara të Zhvillimit.

- (e) Në rast se QK i paguan GenCo-së pagesën e ndërprerjes së likuidimit në pajtim me këtë Seksion 20.9.2, GenCo do të dorëzojë, caktojë ose bartë në QK ose i caktuari i saj të gjithë të drejtat, titullin dhe interesin e vet në dhe për të gjitha regjistrat, shënimet dhe dokumentet e tjera që kanë të bëjnë ekskluzivisht me Projektin Kosova e Re që janë në zotërim të GenCo-së ose ndonjë prej Filialeve të tija, ose nën kontrollin e GenCo-së ose të ndonjë prej Filialeve të tija, dhe çdo pronë intelektuale ose interesa në pronësinë intelektuale që janë në pronësi ose të dhënë me qira nga GenCo ose në të cilat GenCo përndryshe mban një interes ligjor ose përfitues në lidhje me Projektin Kosova e Re, por vetëm në atë masë që prona e tillë intelektuale mund të bartet në përputhje me ligjin në fuqi dhe pa shkelur marrëveshjet e tjera të lidhura me të.
- (f) QK-ja do të bëjë që shumat e pakontestuara (me çdo Kontest të Pagesës që i nënshtrohet zgjidhjes siç parashikohet në këtë Marrëveshje) që i detyrohet GenCo-së në lidhje me një ndërprerje Para Datës së Bartjes që duhet të paguhet në Euro në një llogari bankare të GenCo-së të emëruar nga GenCo brenda dhjetë (10) Ditëve pas dorëzimit nga GenCo në QK të një fature për shumat që i detyrohen atij, së bashku me dokumentacionin mbështetës të arsyeshëm. Nëse çdo Tatim do të vendoset ose do të mbahet nga pagesat që do të bëhen nga QK tek GenCo në vijim në lidhje me një ndërprerje Para Datës së Bartjes, atëherë pagesat e tilla për GenCo do të rriten me një shumë të tillë që GenCo do të marrë të njëjtën shumë që do të kishte marrë sikur Tatimi i tillë të mos ishte vendosur ose mbajtur në burim.

20.10 Detyrimi për Ndërprerje pas Ndërprerjes së Marrëveshjeve të Projektit të Lidhura me Gjenerimin

- (a) Në rast se GenCo ndërpret një ose më shumë prej Marrëveshjes për Blerjen e Energjisë, Marrëveshjes së Kycjes, Marrëveshjes për Furnizim me Linjit, Marrëveshjes për Furnizim me Ujë ose Marrëveshjes për Deponimin e Hirit dhe Gipsit sipas kushteve të tyre para ose pas Datës së Bartjes, atëherë GenCo do të ushtrojë të drejtat e veta për ta ndërprerë këtë Marrëveshje sipas kushteve të Nenit 19. Pas ndërprerjes të kësaj, do të zbatohen dispozitat e zbatueshme të këtij Neni 20.
- (b) Në rast se KEKR ndërpret Marrëveshjen për Blerjen e Energjisë, KOSTT ndërpret Marrëveshjen e Kycjes, Mihja e KEK-ut ndërpret Marrëveshjen për Furnizim me Linjit ose Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, ose Furnizuesi i Ujit e ndërpret Marrëveshjen për Furnizimin me Ujë në përputhje me kushtet e saj para ose pas Datës së Bartjes, atëherë QK-ja do të ushtrojë të drejtat e saj për të ndërprerë këtë Marrëveshje sipas kushteve të Nenit 19. Pas ndërprerjes të kësaj, do të zbatohen dispozitat e zbatueshme të këtij Neni 20.

Neni 21

Forca Madhore

21.1 Forca Madhore

21.1.1 Përkufizimi i Forcës Madhore

Një "**Ngjarje e Forcës Madhore**" nënkupton çdo ngjarje ose rrethanë ose kombinim të ngjarjeve ose rrethanave (përfshirë efektet e saj) që është përtej kontrollit të arsyeshëm të një Pale dhe që, në ose pas Datës së Ekzekutimit, pengon ose vonon përmbyshjen nga kjo Palë (për qëllimet e këtij Neni 21, një "Palë e prekur") të detyrimeve të veta sipas ose në përputhje me këtë Marrëveshje; me kusht që, sidoqoftë,

ndalesa ose vonesa e tillë nuk mund të ishte parandaluar, kapërcyer ose të ndreqej tërësisht ose pjesërisht nga Pala e prekur përmes ushtrimit të kujdesit dhe vëmendjes së arsyeshme.

21.1.2 Ngjarjet që Shprehimisht Kualifikohen si Ngjarje të Forcës Madhore

Pa kufizim ndaj Seksionit 21.1.1, "**Ngjarjet e Forcës Madhore**" shprehimisht përfshijnë secilën nga ngjarjet dhe rrethanat e mëposhtme (përfshirë efektet e tyre), por vetëm në masën që secila përmbush kërkesat e parashtruara në Seksionin 21.1.1:

- (a) në lidhje me GenCo ose një Palë të GenCo-së sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit ose ndonjë Kontrate Ndërtimi/Mirëmbajtjeje ngjarjet ose rrethanat e mëposhtme që ndodhin brenda ose që përfshijnë drejtpërdrejt Kosovën (secila "**Ngjarje e Forcës Madhore Politike**"):
 - (i) çdo akt lufte (nëse është i deklaruar apo i padeklaruar), pushtimi, konflikti i armatosur ose akti i armikut të huaj, bllokada, embargoja, revolucioni, trazira, kryengritje, trazira civile ose akt apo fushata terrorizmi ose sabotimi politik;
 - (ii) Çdo Skadim i Pëlqimit;
 - (iii) me përjashtim të rasteve kur GenCo ushtron të drejtat që ka në lidhje me Seksionin 19.2(e), çdo veprim i ndonjë Autoriteti Publik që shkakton një humbje të përhershme ose të përkohshme që rezulton nga konfiskimi, komandimi ose sekuestrimi i të gjithës ose një pjese materiale të Lokacion, aseteve të GenCo-së ose Projektit Kosova e Re;
 - (iv) ndotje radioaktive ose rrezatim jonizues;
 - (v) çfarëdo Kushti Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik;
 - (vi) QK-ja ose ndonjë NP e Specifikuar është ose bëhet një Palë e Kufizuar;
 - (vii) çdo Ngjarje e Forcës Madhore Politike sipas një Marrëveshjeje të Projektit;
 - (viii) E REZERVUAR; ose
 - (ix) çdo grevë, punë për sundim, punë e ngadaltë ose veprim analog i sindikatave që është i motivuar politikisht;
- (b) në lidhje me GenCo ose një Palë të GenCo-së sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit ose ndonjë Kontrate Ndërtimi/Mirëmbajtjeje, çdo Ndryshim në Ligj;
- (c) në lidhje me GenCo ose një Palë të GenCo-së sipas kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit ose ndonjë Kontrate Ndërtimi/Mirëmbajtjeje, Ngjarje të Forcës Madhore të Ujit të Papërpunuar, ose një Ndryshimi në Cilësinë e Ujit të Papërpunuar;
- (d) ngjarje të tjera jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës së prekur ose, në rastin e GenCo, një Palë e prekur e GenCo-së ose, në rastin e QK-së, një Palë e prekur e QK-së (secila "**Ngjarje Tjetër e Forcës Madhore**"), duke përfshirë, por pa u kufizuar në:
 - (i) rrufeja, zjarri, tërmeti, cunami, përmytja, thatësira, stuhia, cikloni, tajfuni ose tornado;
 - (ii) çdo grevë, punë për sundim, punë e ngadaltë ose veprim analog i sindikatave që është i motivuar politikisht;
 - (iv) zjarri, shpërthimi ose kontaminimi kimik që nuk lidhen me një Kusht Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik; ose
 - (iv) çdo Ngjarje e Forcës Madhore të NP-së të Specifikuar ose;
 - (v) epidemi ose murtajë.

21.1.3 Ngjarjet që Shprehimisht Nuk Kualifikohen si Ngjarje të Forcës Madhore

Ngjarjet e Forcës Madhore shprehimisht nuk do të përfshijnë kushtet e mëposhtme, përveç dhe në atë masë që ngjarjet ose rrethanat e tilla ndodhin drejtpërsëdrejti si pasojë e një Ngjarjeje të Forcës Madhore:

- (e) përveç siç parashikohet në Seksionin 21.1.2(d)(iv), vonesa në përmbushjen e detyrimeve të çdo Kontraktori ose furnizuesi që rezulton në dështimin e Palës së prekur për të përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (b) defektet në pajisje;
- (c) mungesa e fondeve për shkak të ndonjë arsyeje komerciale, ekonomike ose financiare, duke përfshirë paaftësinë e një Pale për të bërë një fitim ose për të arritur një normë të kënaqshme kthimi;
- (d) rezultatet ose pasojat e ndonjë shkeljeje të Ligjeve të Kosovës nga një Palë, kushtet e ndonjë Pëlqimi ose të ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit;
- (e) konsumimi normal i materialeve dhe pajisjeve;
- (f) vetëm në lidhje me QK-në, një Ngjarje e Forcës Madhore Politike, Ndryshimi në Ligj, Ngjarje e Forcës Madhore të Ujit të Papërpunuar, ose Ndryshim në Cilësinë e Ujit të Papërpunuar.

21.2 Detyrimet e Njoftimit

- (a) Nëse , për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore, një Palë është tërësisht ose pjesërisht e paaftë për të përmbushur detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje, Pala e prekur:
 - (i) do të njoftojë Palën tjetër për Ngjarjen e Forcës Madhore sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se pesë (5) Ditë Pune pasi Pala e prekur të jetë në dijeni për Ngjarjen e Forcës Madhore, ose nëse Ngjarja e Forcës Madhore nuk lejon që një Palë të njoftojë Palën tjetër, njëzet e katër (24) orë pas rifillimit të çdo mjeti njoftimi ndërmjet GenCo-së dhe QK-së; dhe
 - (ii) do t'i japë Palës tjetër një njoftim të dytë, që përshkruan Ngjarjen e Forcës Madhore në detaje të arsyeshme dhe, në masën që mund të përcaktohet në kohën e njoftimit të tillë, duke dhënë një vlerësim paraprak të detyrimeve të prekura, një vlerësim paraprak të periudhës kohore në të cilën Pala e prekur nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrime të tilla dhe çështje të tjera të rëndësishme sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se shtatë (7) Ditë pas njoftimit fillestar për ngjarjen e Forcës Madhore nga Pala e prekur.
- (b) Kur është e përshtatshme ose kur kërkohet në mënyrë të arsyeshme për ta bërë këtë nga Pala tjetër, Pala e prekur do të njoftojë më tej Palën tjetër, duke përshkruar më plotësisht Ngjarjen e Forcës Madhore dhe shkakun ose shkaqet e saj, duke ofruar ose përditësuar informacionin në lidhje me përpjekjet e Palës së prekur për të shmangur dhe/ose zbutur efektin ose efektet e tyre, dhe vlerësimet, deri në masën e zbatueshme, të kohës që Pala e prekur pret në mënyrë të arsyeshme që të jetë e paaftë të kryejë ndonjë nga detyrimet e veta të prekura për shkak të Ngjarjes së Forcës Madhore.
- (c) Pala e prekur do të sigurojë njoftim për Palën tjetër:
 - (i) në lidhje me një Ngjarje të Forcës Madhore në vazhdim, për ndaljen e Ngjarjes së Forcës Madhore; dhe
 - (ii) për aftësinë e vet për të rifilluar përmbushjen e detyrimeve të veta sipas kësaj Marrëveshjeje,
 - (iii) sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se shtatë (7) Ditë pas paraqitjes së secilës nga klauzolat (i) dhe 21,2 C)(ii) më sipër.
- (d) Dështimi i Palës së prekur për t'i dhënë Palës tjetër njoftim me shkrim për një Ngjarje të Forcës

Madhore brenda periudhës pesë (5) Ditëve të Punës ose njëzetekatër (24) orëve që kërkohet sipas Seksionit 21.2(a), nuk do të pengojë Palën e prekur nga njoftimi i tillë në një kohë të mëvonshme; me kusht që, sidoqoftë, në këtë rast pala e prekur nuk do të lirohet sipas Seksionit 21.4 për ndonjë dështim ose vonesë në përputhje me detyrimet e veta sipas ose në përputhje me këtë Marrëveshje deri kur të jepet një njoftim i tillë. Nëse njoftimi i tillë jepet brenda periudhës prej pesë (5) Ditë Pune ose njëzetekatër (24) orësh të kërkuar nga Seksioni 21.2(a), Pala e prekur do të shfajësohet për dështimin apo vonesën e tillë sipas Seksionit 21.4 nga koha e fillimit të Ngjarjes relevante të Forcës Madhore.

21.3 Detyrimi për Zbutje

Pala e prekur do të përdorë të gjitha përpjekjet e arsyeshme (dhe do të sigurojë që Kontraktorët e vet të përdorin të gjitha përpjekjet e arsyeshme) për të zbutur efektet e një Ngjarjeje të Forcës Madhore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, pagesën e shumave të arsyeshme të parave nga ose në emër të Palës së prekur (ose Kontraktorit të tillë), dhe këto shuma janë të arsyeshme nën dritën e efikasitetit të mundshëm të masave zbutëse.

21.4 Dështimet ose Vonesat e Shkaktuara nga Forca Madhore

(a) Pas një Ngjarjeje të Forcës Madhore:

- (i) Pala e prekur nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë dështim ose vonesë në kryerjen e detyrimeve të veta (përveç detyrimit për të bërë një pagesë ose për të garantuar siguri) sipas ose në bazë të kësaj Marrëveshjeje gjatë ekzistencës së një Ngjarjeje të Forcës Madhore, por vetëm në masën që Pala e prekur ka përmbushur detyrimet e veta sipas Seksionit 21.3; dhe
- (ii) çdo afat i përmbushjes që Pala e prekur është e detyruar ta përmbushë në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të zgjatet ditë pas dite me numrin e ditëve gjatë të cilave Pala e prekur është penguar nga përmbushja si rezultat i Ngjarjes së Forcës Madhore, por vetëm në masën që Pala e prekur i ka përmbushur detyrimet e veta sipas Seksionit 21.3;

me kusht që, sidoqoftë, asnjë lehtësim, duke përfshirë zgjatjen e afatit të ekzekutimit, nuk do t'i jepet Palës së prekur në pajtim me këtë Seksion 21.4 në atë masë që dështimi apo vonesa e tillë do të ishte përjetuar sidoqoftë nga Pala e prekur, edhe sikur të mos ndodhte Ngjarja e Forcës Madhore.

(b) Pavarësisht nga sa më sipër, QK nuk do të ketë të drejtë të kërkojë për vete dhe nuk do të lirohet nga detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje me ndodhjen e një Ngjarjeje të Forcës Madhore Politike, një Ndryshim në Ligj, Ngjarjeje të Forcës Madhore të Ujit të Papërpunuar ose një Ndryshim në Cilësinë e Ujit të papërpunuar.

Neni 22

Zgjidhja e kontesteve

22.1 Njoftimi i Kontestit

Në rast se ndërmjet Palëve lind ndonjë Kontest, kundërthënie ose pretendim që rrjedh nga ose që ka të bëjë me këtë Marrëveshjen ose shkeljen, ndërprerjen ose vlefshmërinë e saj, Pala që dëshiron të deklarojë një Kontest do t'i dorëzojë Palës tjetër një njoftim me shkrim duke identifikuar çështjen e kontestuar në detaje të arsyeshme.

22.2 Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve

22.2.1 Zgjidhja Informale e Kontesteve nga Palët

Me marrjen nga një Palë të një njoftimi nga Pala tjetër për një Kontest sipas Seksionit 22.1 që identifikon Kontestin në detaje të arsyeshme, Palët do të përpiqen në mirëbesim për një periudhë prej njëzet (20) Ditësh nga data e dorëzimit të njoftimit të tillë që ta zgjidhin Kontestin e tilla nëpërmjet diskutimeve midis

përfaqësuesve të secilës Palë. Në rast se palët nuk janë në gjendje të arrijnë marrëveshje brenda një periudhe të tillë prej njëzet (20) Ditësh ose një periudhe më të gjatë, siç mund të bien dakord, atëherë Kontesti do të zgjidhet në përputhje me procedurat zyrtare të zgjidhjes së kontesteve të përshkruara në Seksionin 22.2.2.

22.2.2 Procedurat Formale të Zgjidhjes së Kontesteve - Forumi i Duhur

- (a) Në rast se Palët nuk janë në gjendje ta zgjidhin një Kontest me anë të diskutimeve informale sipas Seksionit 22.2.1 dhe ky Kontest është një Kontest Teknik ose një Kontest Pagesash, atëherë Kontesti do të zgjidhet me referimin tek një ekspert sipas Seksionit 22.3 (në rastin e një Kontesti Teknik) ose sipas Seksionit 22.4 (në rastin e Kontestit të Pagesës), siç mund të jetë rasti, në secilin rast subjekt sipas Seksionit 22.2.2(f).
- (b) Në rast se një Kontest mund të konsiderohet si një Kontest Pagesash dhe një Kontest Teknik, Kontesti do t'i referohet Seksionit 22.4 dhe eksperti i emëruar në bazë të kësaj përcakton, sipas Seksionit 22.4 (c), nëse kontesti i tillë mund të zgjidhet, në tërësi ose pjesërisht, si një Kontest Pagesash. Nëse eksperti përcakton se Kontesti mund të zgjidhet, i gjithë ose një pjesë e këtij Kontesti që mund të zgjidhet si Kontest i Pagesës do të zgjidhet sipas Seksionit 22.4 dhe pjesa e mbetur (nëse ka) do të referohet dhe do të zgjidhet sipas Seksionit 22.3.
- (c) Nëse Palët nuk mund të bien dakord në mënyrë të arsyeshme brenda pesë (5) Ditëve të Punës në lidhje me përcaktimin nëse një Kontest është një Kontest Teknik, përcaktimi nëse Kontesti është një Kontest Teknik do të zgjidhet sipas Seksionit 22.3.
- (d) Nëse ndonjëra Palë nuk e pranon rekomandimin e ekspertit në lidhje me një Kontest Teknik ose Kontest të Pagesës, mund ta referojë Kontestin për zgjidhje në përputhje me procedurat e përshkruara në Seksionin 22.5; me kusht që, sidoqoftë, nëse Pala e tillë nuk e ka referuar Kontestin për zgjidhje në përputhje me procedurat e përshkruara në Seksionin 22.5 brenda nëntëdhjetë (90) Ditëve pas dorëzimit të rekomandimit nga ana e ekspertit, rekomandimi i tillë do të bëhet një përcaktim detyrues për Palët në masën më të plotë të lejuar sipas ligjit. Nëse eksperti nuk ia ka dorëzuar rekomandimet e veta Palëve brenda afatit të parashikuar në Seksionin 22.3(f) (në rastin e Kontestit Teknik) ose në Seksionin 22.4(f) (në rastin e Kontestit të Pagesës) atëherë secila Palë mund ta referojë Kontestin për zgjidhjen në përputhje me procedurat e përshkruara në Seksionin 22.5.
- (e) Në rast se Palët nuk janë në gjendje ta zgjidhin një Kontest me anë të diskutimeve informale sipas Seksionit 22.2.1 dhe Kontesti e tillë nuk është një Kontest Teknik ose Kontest Pagesash, atëherë Kontesti do të zgjidhet sipas Seksionit 22.5.
- (f) Palët, nëpërmjet marrëveshjes së përbashkët, mund të zgjedhin të zgjidhin çdo kontest (duke përfshirë një Kontest Teknik dhe një Kontest të Pagesës) në përputhje me Seksionin 22.5.

22.3 Kontestet teknike

Çdo Kontest Teknik që i nënshtrohet këtij Seksioni 22.3 do të zgjidhet në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

- (a) Eksperti duhet të ketë demonstruar ekspertizë në fushën me të cilën ka lidhje ky Kontest Teknik dhe nuk mund të jetë agjent, punonjës ose Kontraktor ose një ish-agjent, punonjës ose Kontraktor i secilës Palë të përfshirë në të, dhe përndryshe nuk do të ketë interes në Kontestin Teknik.
- (b) Pala që fillon paraqitjen e Kontestit Teknik tek eksperti duhet ta njoftojë Palës tjetër me një njoftim për këtë gjë dhe të emërojë personin që propozon të jetë eksperti nga lista e ekspertëve të përcaktuar në Kalendarin 9 të mëposhtëm. Nëse palët nuk janë në gjendje të emërojnë një ekspert nga lista në Kalendarin 9 ose nuk mund të bien dakord për një ekspert nga lista në Kalendarin 9, ose nëse Kontesti Teknik përfshin çështje që kërkojnë një ekspert që nuk është i listuar në Kalendarin 9, Pala që fillon paraqitjen e Kontestit Teknik tek eksperti i siguron Palës tjetër

njoftimin për personin që propozon të jetë ekspert. Pala tjetër, brenda pesë (5) Ditëve të Punës nga marrja e njoftimit të tillë, njofton Palën iniciuese nëse personi i tillë është i pranueshëm. Nëse Pala që merr një njoftim të tillë nuk përgjigjet gjatë kësaj periudhe ose njofton Palën iniciuese se personi nuk është i pranueshëm, atëherë nëse eksperti i propozuar nga Pala tjetër është i listuar në Kalendarin 9, personi i tillë do të bëhet ekspert për qëllimin e zgjidhjes së Kontestit Teknik. Përndryshe, Palët, sa më shpejt të jetë e mundur, do të takohen dhe diskutojnë në mirëbesim për një periudhë prej pesë (5) Ditëve të Punës për të rënë dakord mbi një person që të jetë ekspert. Nëse palët nuk arrijnë të takohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore ose nuk janë në gjendje të bien dakord për një ekspert në fund të periudhës së tillë prej pesë (5) Ditëve të Punës, Pala që fillon dorëzimin e Kontestit Teknik do të kërkojë nga Qendra e ICC-së për Ekspertizë të caktojë ekspertin për procedurat ad hoc në pajtim me Rregullat për Emërimin e Ekspertëve dhe Neutraleve të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, me kërkesë që Qendra e Ekspertëve të ICC-së ta caktojë brenda pesë (5) Ditëve të Punës ose sa më shpejt të jetë e mundur pas kësaj, dhe personi i tillë i emëruar në këtë mënyrë është ekspert për qëllimet e zgjidhjes së Kontestit Teknik.

- (c) Brenda pesë (5) Ditëve të Punës pas marrjes së materialeve të shkruara të përshkruara në Seksionin 22.3(d) ose sa më shpejt të jetë e mundur pas kësaj, eksperti do të përcaktojë nëse Kontesti mund të zgjidhet si Kontest Teknik nëpërmjet përcaktimit të ekspertit të përcaktuar në këtë Seksion 22.3. Nëse eksperti përcakton se Kontesti nuk mund të arrihet me një zgjidhje të tillë, Kontesti do të zgjidhet sipas Seksionit 22.5.
- (d) Pala që fillon parashtrimin e Kontestit Teknik nga eksperti duhet të dorëzojë brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës pas caktimit të ekspertit, si për ekspertin ashtu edhe për Palën tjetër, materiale me shkrim që përcaktojnë:
 - (i) përshkrimin e vet të Kontestit Teknik në detaje të arsyeshme; dhe
 - (ii) një zgjidhje të propozuar të hollësishme me shkrim të Kontestit Teknik.
- (e) Brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës pas datës kur një Palë ka dorëzuar materialet e përshkruara në fjalinë e mësipërme, Pala tjetër do t'i paraqesë ekspertit dhe Palës iniciuese:
 - (i) përshkrimin e vet të Kontestit Teknik në detaje të arsyeshme; dhe
 - (ii) një zgjidhje të propozuar të hollësishme me shkrim të Kontestit Teknik.
- (f) Secila palë do të caktojë një Person të informuar për çështjet në Kontest që do të jetë në dispozicion të ekspertit për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të ofruar çdo informacion shtesë të kërkuar nga eksperti. Përveç një Personi të tillë, një Palë nuk do t'i kërkohet, por mund të japë deklaratat me gojë ose prezantime tek eksperti ose të vërë ndonjë individ të veçantë në dispozicion të ekspertit.
- (g) Eksperti do të ketë një periudhë prej dhjetë (10) Ditëve të Punës pas marrjes së kundër propozimit të Palës që nuk është iniciuese për të zgjedhur ose zgjidhjen e propozuar të Palës iniciuese ose të Palës jo-iniciuese si rezolutë përfundimtare dhe detyruese të këtij Kontesti Teknik që i nënshtrohet të drejtave të Palëve sipas Seksionit 22.2.2(e) dhe Seksionit 22.3(h).
- (h) Përveçse siç parashikohet në Seksionin 22.3(i) në lidhje me pagesën e shpenzimeve, procedurat sipas këtij Seksioni 22.3 nuk do të cenojnë asnjë Palë dhe çdo dëshmi e dhënë ose deklaratat e bëra gjatë këtij procesi nuk mund të përdoren kundër një Pale në çdo procedurë tjetër, duke përfshirë një procedurë arbitrazhi sipas Seksionit 22.5. Prosesi sipas këtij Seksioni 22.3 nuk do të konsiderohet si arbitrazh por si zgjidhjen e kontesteve dhe nuk do të zbatohen ligjet që lidhen me arbitrazhin komercial.
- (i) Kostot e angazhimit të një eksperti do të barten në mënyrë të barabartë nga Palët dhe secila Palë do të bartë kostot e veta në përgatitjen e materialeve për dhënien e prezantimeve tek eksperti.

22.4 Kontestet për Pagesat

Çdo Kontest për Pagesa që i nënshtrohet këtij Seksioni 22.4 do të zgjidhet në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

- (a) Eksperti duhet të ketë demonstruar ekspertizë në fushën me të cilën ka lidhje ky Kontest i Pagesës dhe nuk mund të jetë agjent, punonjës ose Kontraktor ose një ish-agjent, punonjës ose Kontraktor i secilës Palë të përfshirë në të, dhe përndryshe nuk do të ketë interes në Kontestin Teknik.
- (b) Pala që fillon paraqitjen e Kontestit të Pagesës tek eksperti duhet ta njoftojë Palën tjetër me një njoftim për këtë gjë dhe të emërojë personin që propozon të jetë eksperti nga lista e ekspertëve të përcaktuar në Kalendarin 9 të mëposhtëm. Nëse palët nuk janë në gjendje të emërojnë një ekspert nga lista në Kalendarin 9 ose nuk mund të bien dakord për një ekspert nga lista në Kalendarin 9, ose nëse Kontesti i Pagesës përfshin çështje që kërkojnë një ekspert që nuk është i listuar në Kalendarin 9, Pala që fillon paraqitjen e Kontestit të Pagesës tek eksperti i siguron Palën tjetër njoftimin për personin që propozon të jetë eksperti. Pala tjetër, brenda pesë (5) Ditëve të Punës nga marrja e njoftimit të tillë, njofton Palën iniciuese nëse personi i tillë është i pranueshëm. Nëse Pala që merr një njoftim të tillë nuk përgjigjet gjatë kësaj periudhe ose njofton Palën iniciuese se personi nuk është i pranueshëm, atëherë nëse eksperti i propozuar nga Pala tjetër është i listuar në Kalendarin 9, personi i tillë do të bëhet ekspert për qëllimin e zgjidhjes së Kontestit për Pagesa. Përndryshe, Palët, sa më shpejt të jetë e mundur, do të takohen dhe diskutojnë në mirëbesim për një periudhë prej pesë (5) Ditëve të Punës për të rënë dakord mbi një person që të jetë ekspert. Nëse palët nuk arrijnë të takohen brenda një periudhe të arsyeshme kohore ose nuk janë në gjendje të bien dakord për një ekspert në fund të periudhës së tillë prej pesë (5) Ditëve të Punës, Pala që fillon dorëzimin e Kontestit të Pagesës do të kërkojë nga Qendra e ICC-së për Ekspertizë të caktojë ekspertin për procedurat ad hoc në pajtim me Rregullat për Emërimin e Ekspertëve dhe Neutraleve të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, me kërkesë që Qendra e Ekspertëve të ICC-së ta caktojë brenda pesë (5) Ditëve të Punës ose sa më shpejt të jetë e mundur pas kësaj, dhe personi i tillë i emëruar në këtë mënyrë është ekspert për qëllimet e zgjidhjes së Kontestit të Pagesës.
- (c) Brenda pesë (5) Ditëve të Punës pas marrjes së materialeve të shkruara të përshkruara në Seksionin 22.4(d) ose sa më shpejt të jetë e mundur pas kësaj, eksperti do të përcaktojë nëse Kontesti i tillë mund të zgjidhet si Kontest i Pagesës sipas këtij Seksioni 22.4. Nëse eksperti përcakton se Kontesti nuk mund të arrihet me një zgjidhje të tillë, Kontesti do të zgjidhet sipas Seksionit 22.5; me kusht që, sidoqoftë, nëse Kontesti është referuar sipas këtij Seksioni 22.4, sipas Seksionit 22.2.2(b), Kontesti do të zgjidhet sipas Seksionit 22.3.
- (d) Pala që fillon parashtrimin e Kontestit të Pagesës nga eksperti duhet të dorëzojë brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës pas caktimit të ekspertit, si për ekspertin ashtu edhe për Palën tjetër, materiale me shkrim që përcaktojnë:
 - (i) përshkrimin e vet të Kontestit të Pagesës në detaje të arsyeshme; dhe
 - (ii) një zgjidhje të propozuar të hollësishme me shkrim të Kontestit të Pagesës.
- (e) Brenda dhjetë (10) Ditëve të Punës pas datës kur një Palë ka dorëzuar materialet e përshkruara në fjalinë e mësipërme, Pala tjetër do t'i paraqesë ekspertit dhe Palës iniciuese:
 - (i) përshkrimin e vet të Kontestit të Pagesës në detaje të arsyeshme; dhe
 - (ii) një zgjidhje të propozuar të hollësishme me shkrim të Kontestit të Pagesës.
- (f) Secila palë do të caktojë një Person të informuar për çështjet në Kontest që do të jetë në dispozicion të ekspertit për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të ofruar çdo informacion shtesë të kërkuar nga eksperti. Përveç një Personi të tillë, një Palë nuk do t'i kërkohet, por mund të japë deklarata me gojë ose prezantime tek eksperti ose të vërë ndonjë individ të veçantë në dispozicion të ekspertit.
- (g) Eksperti do të ketë një periudhë prej dhjetë (10) Ditëve të Punës pas marrjes së kundër propozimit

të Palës që nuk është iniciuese për të zgjedhur ose zgjidhjen e propozuar të Palës iniciuese ose të Palës jo-iniciuese si rezolutë përfundimtare dhe detyruese të këtij Kontesti për Pagesa që i nënshtrohet të drejtave të Palëve sipas Seksionit 22.2.2(e) dhe Seksionit 22.4(h).

- (h) Përveçse siç parashikohet në Seksionin 22.4(i) në lidhje me pagesën e shpenzimeve, procedurat sipas këtij Seksioni 22.4 nuk do të cenon asnjë Palë dhe çdo dëshmi e dhënë ose deklaratat e bëra gjatë këtij procesi nuk mund të përdoren kundër një Pale në çdo procedurë tjetër, duke përfshirë një procedurë arbitrazhi sipas Seksionit 22.5. Procesi sipas këtij Seksioni 22.4 nuk do të konsiderohet si arbitrazh por si zgjidhjen e kontesteve dhe nuk do të zbatohen ligjet që lidhen me arbitrazhin komercial.
- (i) Kostot e angazhimit të një eksperti do të barten në mënyrë të barabartë nga Palët dhe secila Palë do të bartë kostot e veta në përgatitjen e materialeve për dhënien e prezantimeve tek eksperti.

22.5 Arbitrazhi

- (a) Çdo Kontest që i nënshtrohet këtij Seksioni 22.5, sipas Seksionit 22.5 (c), duhet të zgjidhet përfundimisht në përputhje me Rregulloren e Procedurës për Procedurën e Arbitrazhit (" **Rregullat e ICSID-it** ") të ICSID-it të përcaktuara nga Konventa për Zgjidhjen e Kontestit e investimeve ndërmjet shteteve dhe shtetasve të shteteve të tjera (" **Konventa ICSID** "), dhe secila nga Palët në këtë mënyrë pranon juridiksionin e ICSID dhe arbitrazhin në bazë të saj. Secila Palë e kësaj Marrëveshjeje përcakton se transaksioni me të cilin lidhet kjo Marrëveshje është një "investim" brenda kuptimit të Konventës ICSID. Palët bien dakord që, ndonëse secili nga GenCo dhe QK-ja është shtetas dhe rezident i Kosovës, ndërsa ose GenCo ose QK-ja, siç mund të jetë rasti, kontrollohen nga shtetas të një Shteti tjetër Kontraktor (meqë ky term përdoret në Konventën ICSID) GenCo ose QK-ja, sipas rastit, do të trajtohen si shtetas i një Shteti tjetër Kontraktor (meqë ky term përdoret në Konventën ICSID) për qëllimet e Konventës ICSID.
- (b) Për aq sa çdo Palë në këtë Marrëveshje është një NP e Specifikuar (dhe deri në atë masë që NP-ja e tillë e specifikuar është Ndërmarrje Publike), përcaktohet se kjo Palë është agjenci e QK-së dhe se kjo Palë do të jetë të caktuar në ICSID nga QK-ja në përputhje me Nenin 25(1) të Konventës ICSID. Në pajtim me Nenin 25(3) të Konventës ICSID, QK-ja ka dhënë aprovimin e vet për pëlqimin e Palës së tillë në këtë Marrëveshjeje për arbitrazh sipas Konventës ICSID.
- (c) Në qoftë se kërkesat e juridiksionit të Nenit 25 të Konventës ICSID nuk janë plotësuar ose nëse për ndonjë arsye tjetër Kontesti nuk mund të zgjidhet në pajtim me Rregullat e ICSID-it, ky Kontest do të zgjidhet përfundimisht me arbitrazh sipas Rregullores së Pajtimit dhe Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë ("**Rregullat e ICC-së**").
- (d) Gjuha që do të përdoret në procedurën e arbitrazhit do të jetë gjuha angleze.
- (e) Përveç rasteve kur Palët e kanë rënë dakord ndryshe, numri i arbitrave do të jetë tre (3), me arbitrat e tillë që do të emërohen nga secila Palë, duke zgjedhur një (1) arbitër brenda:
 - (i) tridhjetë (30) Ditëve pas inicimit nga një Palë të procedurave të arbitrazhit sipas këtij Seksioni 22.5, për një arbitrazh sipas Konventës ICSID; ose
 - (ii) periudhës për zgjedhjen e arbitrit të përcaktuar në Rregullat e ICC-së,dhe dy (2) arbitrat e emëruar në këtë mënyrë, brenda tridhjetë (30) Sitësh pas zgjedhjes së arbitrit të dytë, zgjedhin arbitrin e tretë (3); me kusht që, sidoqoftë, në atë masë që më shumë se dy Palët marrin pjesë në arbitrazh, Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë do të caktohet si Autoritet Emërues për qëllime të përzgjedhjes së arbitrave në përputhje me Rregullat e ICC-së.
- (f) Asnjë arbitër i emëruar sipas këtij Seksioni 22.5 nuk do të jetë shtetas i juridiksionit të një Pale dhe asnjë arbitër i tillë nuk do të jetë aksionar, drejtor, punonjës, agjent ose Kontraktor ose ish-aksionar, drejtor, punonjës, agjent apo Kontraktor i një Pale.

- (g) Selia (vendi ligjor) i arbitrazhit është në Londër, Angli.
- (h) Palët bien dakord që mbledhja e provave, zbulimi para seancës dhe ekzaminimi i dëshmitarëve dhe ekspertëve të autorizuar sipas Rregullave 34 deri 36 të Rregullave të ICSID (ose Neni 20 i Rregullave të ICC-së nëse ICC-ja është organi i administrimit), do të interpretohet nga tribunali se i lejuar çdo Pale të kërkojë paraqitjen e dokumenteve dhe informatave të tjera që llogariten në mënyrë të arsyeshme të çojnë në zbulimin e provave që janë relevante për çdo kërkesë ose mbrojtje që ka të bëjë me Kontestin, duke përfshirë mjetet në vijim:
 - (i) marrjen në pyetje me shkrim;
 - (ii) kërkesat për paraqitjen e dokumenteve, përfshirë paraqitjen e informacionit elektronik të depozituar në një format të përshtatshëm elektronik në përputhje me rregullat e IBA-së; dhe
 - (iii) një numër të mjaftueshëm të depozitimeve gojore të përshtatshme për çështjen e kontestit, duke përfshirë depozitimimin e një përfaqësuesi të caktuar nga një subjekt si agjent i tij për të dëshmuar për çështje specifike në emër të vet;

dhe të lejojë Palën jo kërkuese që ta kundërshtojë një kërkesë të tillë, me ç'rast tribunali do të nxjerrë një vendim mbi një kërkesë të tillë.

- (i) Secila Palë do të përdorë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që këshilltarët, agjentët dhe kontraktorët e vet janë në dispozicion për çdo depozitim dhe mekanizma të tjerë zbulimi të urdhëruar nga tribunali siç parashikohet në Seksionin 22.5 (h).
- (j) Secila Palë do të jetë përgjegjëse për tarifën e veta juridike dhe kostot përkatëse në lidhje me ndonjë arbitrazh.
- (k) Vendimi i arbitrave është përfundimtar dhe i detyrueshëm për Palët dhe nuk mund të jetë subjekt i apelit.
- (l) Çdo palë mund të bëjë kërkesë për çdo gjykatë që ka juridiksion për të dhënë aktgjykim mbi vendimin e arbitrazhit. Me kërkesën e secilës prej Palëve, arbitrat do të përpiqen që një vendim i tillë i arbitrazhit të parashikohet në gjykatën më të lartë juridiksionale në Kosovë dhe në ndonjë gjykatë tjetër të kërkuar nga një Palë.
- (m) Vendimi i arbitrazhit do të bëhet dhe paguhet në euro dhe shpërblimi do të arkëtohet sipas Tatimit, përveç nëse shuma e paguar do të ishte subjekt i Tatimit nëse paguhet në kursin normal.
- (n) Palët heqin dorë nga të drejtat e tyre për të kërkuar ose për të rikuperuar, dhe arbitrat nuk duhet të japin dëme ndëshkuese, të shumëfishta ose të tjerë shembullore, qoftë ligjore ose zakonore (përveç në masën që dëmet e tilla i janë dhënë një pale të tretë dhe i nënshtrohen ndarjes ndërmjet Palëve, ose (ii) parashikohet shprehimisht të paguhet sipas termave dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje).

22.6 Kontestet e Lidhura

- (a) Tribunali i arbitrazhit mund të konsolidojë një arbitrazh që del nga ose që ka të bëjë me këtë Marrëveshje me çfarëdo arbitrazhi që del nga ose që ka të bëjë me një ose më shumë Marrëveshje të Projektit nëse lënda e kontesteve del nga ose lidhet me të njëjtat fakte ose transaksione. Arbitrazhi i tillë i konsoliduar do të përcaktohet nga tribunali i arbitrazhit i emëruar për procedurën e arbitrazhit që ka filluar i pari në kohë.
- (b) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Seksionit 22.1, 22.3 dhe 22.4, të drejtat e Palëve për të vazhduar me zgjidhjen e Kontesteve në bazë të Seksionit 22.1, 22.3 dhe 22.4 do të jenë të pavarura nga të drejtat e tyre ose të drejtat e subjekteve të lidhura për të vazhduar me Zgjidhjen e Kontesteve sipas ndonjë prej Marrëveshjeve të tjera të Projektit. Pavarësisht nga sa më lart apo ndonjë gjë tjetër në kundërshtim në këtë Marrëveshje, një përcaktim përfundimtar i një Kontesti sipas dhe në përputhje me ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit do të jetë një rezolutë

përfundimtare dhe detyruese për të njëjtën çështje që lidhet, *mutatis mutandis*, me detyrimet e QK-së ose GenCo-së në vijim.

22.7 Vazhdimi i Detyrimeve

Pendenca e një Kontesti nuk do të lirojë asnjë prej Palëve nga detyra e vet për të performuar sipas kësaj Marrëveshjeje dhe secila Palë do të vazhdojë të përmbushë detyrimet e veta dhe do të ketë të drejtën për të ushtruar të drejtat e veta sipas kësaj Marrëveshjeje në pritje të zgjidhjes së këtij Kontesti, pa kufizuar Seksionin 19.5.

22.8 Aktet Komerciale

QK-ja pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme pajtohet që ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja prej saj e kësaj Marrëveshjeje përbëjnë veprimet e veta private dhe komerciale.

22.9 Imuniteti Sovran; Juridiksioni

(a) QK-ja me këtë në mënyrë të përvokueshme dhe pa kushte:

- (i) pajtohet që nëse duhet të ngrihet ndonjë procedim kundër QK-së ose asetëve të veta, përveç Asetëve të Mbrojtura, në çdo juridiksion në lidhje me këtë Marrëveshje ose ndonjë nga transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje, asnjë pretendim për imunitet nga ky procedim nuk do të kërkohet nga ose në emër të QK-së në emër të vetvetes ose të ndonjë prej asetëve të veta (përveç Asetëve të Mbrojtura);
- (ii) heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që ajo ose ndonjë nga asetet e veta (përveç Asetëve të Mbrojtura) tani ka ose mund të ketë në të ardhmen në ndonjë juridiksion në lidhje me ndonjë procedim të tillë;
- (iii) bie dakord që ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja sipas kësaj Marrëveshjeje dhe çdo Marrëveshje tjetër të Projektit në të cilën është palë, përbën aktet e veta private dhe komerciale dhe heq dorë nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose në vijim ndaj vendit të ndonjë veprimi ose procedimi të parashtruar siç e lejon ky Seksion 22.9(a), dhe në mënyrë specifike heq dorë nga çdo kundërshtim që çdo veprim apo procedim e tillë është parashtruar në një forum të papërshtatshëm dhe pajtohet të mos mbrojë ose pretendojë të njëjtën gjë;
- (iv) jep pëlqimin në përgjithësi për juridiksionin, në lidhje me vetveten dhe të gjitha asetet dhe pasuritë e veta që ka tani ose mund të fitojë më pas (përveç Asetëve të Mbrojtura), nga çdo gjykatë kompetente për çdo veprim të parashtruar nga GenCo për të zbatuar çdo vendim të çdo arbitri të emëruar sipas kësaj Marrëveshjeje për të zgjidhur çdo Kontest ndërmjet Palëve. Pajtohet që shërbimi i procesit në çdo veprim apo procedim të tillë mund të kryhet në çfarëdo mënyre të lejuar nga ligji i zbatueshëm në gjykatën e lartpërmendur

(b) GenCo me këtë në mënyrë të përvokueshme dhe pa kushte:

- (v) jep pëlqimin në përgjithësi për juridiksionin, në lidhje me vetveten dhe të gjitha asetet dhe pasuritë e veta që ka tani ose mund të fitojë më pas, nga çdo gjykatë kompetente për çdo veprim të parashtruar nga QK-ja për të zbatuar çdo vendim të çdo arbitri të emëruar sipas kësaj Marrëveshjeje për të zgjidhur çdo Kontest ndërmjet Palëve;
- (ii) heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që ai ose ndonjë nga asetet e veta tani ka ose mund të ketë në të ardhmen në ndonjë juridiksion në lidhje me ndonjë procedim të tillë;
- (iii) heq dorë nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose në vijim ndaj vendit të ndonjë veprimi ose procedimi të parashtruar siç e lejon ky Seksion 22.9(b), dhe në mënyrë specifike heq dorë nga çdo kundërshtim që çdo veprim apo procedim e tillë është parashtruar në një forum të papërshtatshëm dhe pajtohet të mos mbrojë ose pretendojë të njëjtën gjë;

- (iv) pajtohet që shërbimi i procesit në çdo veprim apo procedim të tillë mund të kryhet në çfarëdo mënyre të lejuar nga ligji i zbatueshëm në gjykatën e lartpërmendur; dhe
- (v) heq dorë nga çfarëdo dhe të gjitha të drejtat që mund të ketë për të zbatuar ndonjë aktgjykim ose padi kundër Aseteve të Mbrojtura në gjykatat e çdo juridiksioni.

Neni 23
Të ndryshme

23.1 Njoftimet

(a) Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera të kërkuara ose të lejuara për t'u dhënë nga një Palë (duke përfshirë çdo faturë që kërkohen ose lejohen të dorëzohen) duhet të jenë me shkrim dhe secila e dorëzuar personalisht ose me korrier ose të dërgohet me faks ose me e-mail në adresën ose numrin e Palës tjetër të specifikuar më poshtë:

(i) Nëse është për GenCo-në:

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.
35-37 Avenue de la Liberté
L-1931 Luxembourg, Grand Duchy of Luxembourg
Në vëmendje të: Bordit të Menaxherëve
Tel: + (352) 28 86 78 00
Faks: + (352) 24 52 73 26
Email: CGK_CEO@contourglobal.com
CGK_GC@contourglobal.com

(ii) Nëse është për QK-në:

Qeveria e Kosovës
Rr. Nëna Terezë Nr. 36, Prishtinë, Kosovë
Prishtinë, Kosovë
Në vëmendje të: Ministër i Zhvillimit Ekonomik
Tel: [_____]
Faks: [_____]
Email: [_____]

dhe, në rast se njoftimi ose komunikimi tjetër është një Njoftimi i Posaçëm i Mospërbushjes për QK-në i lëshuar në pajtim me Marrëveshjen për Blerje të Energjisë, Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, Marrëveshjen për Furnizim me Ujë ose ndonjë Marrëveshje tjetër të Projektit, me një kopje për:

Ministria e Financave
Rr. Nëna Terezë Pn.
Ndërtesa e Qeverisë
Qeveria e Kosovës
Rr. Nëna Terezë Nr. 36, Prishtinë, Kosovë
Prishtinë, Kosovë
Në vëmendje të: Ministër i Zhvillimit Ekonomik
Tel: [_____]
Fax: [_____]
Email: [_____]

dhe, në rast se njoftimi ose komunikimi tjetër është një Njoftimi i Posaçëm i Mospërbushjes për QK-në i lëshuar në pajtim me Marrëveshjen për Blerje të Energjisë, Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, Marrëveshjen për Furnizim me Ujë ose ndonjë Marrëveshje tjetër të Projektit,

me një kopje për:

Prishtinë, Kosovë
Në vëmendje të: Ministër i Financave
Tel: [_____]
Faks: [_____]
Email: [_____]

me një kopje (e cila nuk do të përbëjë njoftim) për:

Hunton & Williams LLP
Riverfront Plaza, East Tower
951 East Byrd Street
Richmond, Virginia 23219-4047
Në vëmendje të: John J. Beardsworth, Jr.
Tel: +1-804-788-8637
Faks: +1-804-788-8218
E-mail: jbeardsworth@hunton.com

me kusht që, një Palë mund ta ndryshojë adresën në të cilën duhet t'i dërgohen njoftimet, duke i dhënë Palës tjetër njoftim me shkrim jo më vonë se tridhjetë (30) përpara, në përputhje me këtë Seksion 23.1 (a).

- (b) Asnjë njoftim ose komunikim tjetër nuk do të jetë efektiv deri sa të merret ose të konsiderohet e i marrë. Njoftimet ose komunikimet e tjera do të konsiderohen se janë marrë nga Pala pritëse:
- (i) kur dorëzohet nëse dorëzohet personalisht;
 - (ii) tre (3) Ditë të Punës pas dërgimit, nëse dërgohen nga një korrier ndërkombëtar;
 - (iii) me dërgimin e tyre, nëse janë dërguar me faks, në varësi të konfirmimit të një raporti të pandërprerë të transmisionit dhe me kusht që një kopje fizike të dërgohet jo më vonë se Dita e Punës në vijim tek marrësi nëpërmjet korrierit ndërkombëtar ose dërgesës personale; ose
 - (iv) me dërgimin e tyre, nëse janë dërguar me e-mail, me kusht që një kopje fizike të dërgohet jo më vonë se Dita e Punës në vijim tek marrësi me korrier ndërkombëtar ose dërgesë personale; me kusht që, sidoqoftë, Palët mund të bien dakord reciprokisht me shkrim se nuk ka asnjë kërkesë për dorëzimin e kopjeve fizike në lidhje me komunikimet të caktuara operative të përditshme apo të ngjashme.
- (c) Një Palë që dërgon një njoftim ose komunikim tjetër sipas Seksionit 23.1(a) do të përdorë përpjekje të arsyeshme komerciale për t'i dhënë Palës pritëse një përkthim të arsyeshëm të saktë në Shqip brenda pesë (5) Ditëve të Punës pas dërgimit të njoftimit ose komunikimit të tillë; me kusht që, sidoqoftë, një Palë nuk do t'i kërkojë një përkthim të ndonjë vizatimi teknik ose dokumenteve të ngjashme teknike ose inxhinierike. Në rast të ndonjë mospërputhje midis origjinalit anglisht dhe përkthimit në shqip të çdo njoftimi ose komunikimi tjetër, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë mbi versionin në shqip. Për shmangien e dyshimit, dështimi në dorëzimin e një përkthimi të një njoftimi ose komunikimi tjetër në përputhje me këtë Seksion 23.1 (c) nuk do të ndikojë në efektivitetin e njoftimit ose komunikimit tjetër të përcaktuar sipas Seksionit 23.1(b).
- (d) Në rast se një njoftim i dorëzuar nga GenCo tek QK-ja në pajtim me këtë Marrëveshje kërkon që QK-ja ose të japë një përgjigje (duke përfshirë çdo aprovim apo kundërshtim) brenda një periudhe të caktuar kohore, ose të konsiderohet ta ketë aprovuar ose të mos kundërshtojë ndërmarrjen e ndonjë veprimi nga GenCo, GenCo do të përfshijë në një njoftim të tillë një përshkrim të periudhës së përgjigjes dhe pasojat e dështimit të QK-së për t'u përgjigjur (përfshirë çdo aprovim

ose mos-kundërshtim).

23.2 Ndryshimet

Një ndryshim ose modifikim i kësaj Marrëveshjeje do të jetë efektiv ose i detyrueshëm për një Palë vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga një përfaqësues i autorizuar i duhur i secilës Palë; me kusht që, sidoqoftë, asnjë amendament i tillë nuk do të ndikojë në detyrimet e QK-së sipas kësaj Marrëveshjeje ose çdo Marrëveshjeje tjetër të Projektit, përveç nëse QK-ja është palë e marrëveshjes për ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje (ose versionit të ndryshuar dhe të riparuarit të kësaj Marrëveshjeje), ose përndryshe QK-ja ka dhënë pëlqimin për ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje; me kusht që, më tej, asnjë amendament i tillë që ndikon në dispozitat e Nenit 22, nuk do të ndikojë në detyrimet e Sponsorit HoldCo apo detyrimet e Sponsorit Sipëror sipas Marrëveshjes së Mbështetjes nga Sponsorit ose Garancisë së Sponsorit Sipëror, përveç nëse Sponsorit HoldCo ose Sponsorit Sipëror, sipas rastit, mund të jetë palë në marrëveshjen për ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje (ose versionin e ndryshuar dhe të riparuarit të kësaj Marrëveshjeje) ose Sponsorit HoldCo dhe Sponsorit Sipëror përndryshe kanë dhënë pëlqimin për ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje.

23.3 Mbijetesa

- (a) Me skadimin e kësaj Marrëveshjeje ose ndërprerjen e mëhershme të kësaj Marrëveshjeje, të gjitha marrëveshjet, detyrimet, përfaqësimet dhe garancitë e përmbajtura në këtë Marrëveshje do të ndërpriten dhe nuk do të jenë në fuqi ose efektive dhe Palët nuk do të kenë detyrime ose obligime të mëtejshme sipas kësaj Marrëveshjeje; me kusht që, sidoqoftë, mbijetojnë shprehimisht: (i) ato obligime dhe detyrime që kanë lindur para dhe mbeten të pacaktuara në datën e skadimit ose të ndërprerjes dhe (ii) ato obligime dhe detyrime që i mbijetojnë shprehimisht skadimit ose ndërprerjes së tillë sipas Seksionit 23.3(b).
- (b) Pavarësisht nga çdo gjë e përfshirë në këtë Marrëveshje për të kundërtën, dispozitat e Nenit 1 (*Përkufizimet, Interpretimi*), Seksionit 5.2 (*Ndalja e Operimit të Objektivit të TCKR-së*), Seksionit 8.2 (*Dëshmipërblimi për Standardet Mjedisore*), Seksionit 18.1 (*Kufizimi i Përgjegjësisë*), Nenit 20 (*Të Drejtat dhe Detyrimet Pas Ndërprerjes, Kompensimi*), Nenit 22 (*Zgjidhja e Kontesteve*), dhe Nenit 23 (*Të ndryshme*) do t'i mbijetojnë shprehimisht çdo ndërprerje ose skadimi të kësaj Marrëveshjeje.

23.4 Përfituesit Palë të Treta

Me përjashtim të të drejtave të shprehura shprehimisht në këtë Marrëveshje, kjo Marrëveshje është menduar vetëm për të mirën e Palëve dhe asgjë në këtë Marrëveshje nuk do të interpretohet për të krijuar ndonjë të drejtë për, detyrim ndaj, standardit të kujdesit apo ndonjë përgjegjësie ndaj çdo Personi që nuk është Palë.

23.5 Asnjë heqje dorë

Asnjë nga Palët, në përmbushjen ose pajtueshmërinë me ndonjë dispozitë të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të heqë dorë nga ndonjë përjashtim, përveç me pëlqimin me shkrim të Palës tjetër. Asnjë heqje dorë nga secila palë e ndonjë mospërmbushje nga ana e Palës tjetër në përmbushjen ose pajtueshmërinë me ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, nuk do të veprojë ose do të interpretohet si një heqje dorë nga çdo parazgjedhje tjetër ose e mëvonshme, qoftë e një karakteri të ngjashëm ose të ndryshëm.

23.6 Marrëdhënia e Palëve

- (a) Kjo Marrëveshje nuk interpretohet dhe as nuk do të interpretohet se krijon një shoqëri, sipërmarrje të përbashkët ose partneritet ndërmjet Palëve, as nuk do të imponojë ndonjë detyrim partneriteti ose përgjegjësi të ngjashme ndaj secilës Palë.
- (b) Asnjëra Palë nuk do të ketë asnjë të drejtë, fuqi ose autoritet për të lidhur ndonjë marrëveshje ose ndërmarrje për të vepruar në emër të, ose për të qenë agent ose përfaqësues i Palës tjetër, ose për ta detyruar ndryshe Palën tjetër, dhe asnjëra Palë nuk do ta mbajë veten para një palë të tretë se ka

të drejtë, fuqi apo autoritet të tillë.

23.7 Shpenzimet e Palëve

Përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe në Nenin 16 të kësaj Marrëveshjeje ose siç mund të bien dakord ndryshe në çdo Marrëveshje tjetër të Projektit, si ndërmjet Palëve në këtë Marrëveshje, të gjitha shpenzimet e bëra nga ose në emër të çdo Pale, duke përfshirë të gjitha tarifat dhe shpenzimet e agjentëve, përfaqësuesve, avokatëve dhe kontabilistëve të punësuar nga Palët në lidhje me përgatitjen e kësaj Marrëveshjeje dhe plotësimin e transaksioneve të parashikuara nga kjo Marrëveshje, do të përballohen vetëm nga Pala që do të kenë bërë shpenzime të tilla dhe Pala tjetër nuk do të ketë përgjegjësi në lidhje me këtë.

23.8 Pëlqimi

Nëse nuk parashihet ndryshe, kurdo që njëra Palë kërkon një pëlqim ose aprovim nga Pala tjetër, ky pëlqim ose aprovim duhet të bëhet me shkrim dhe nuk duhet të privohet, të kushtëzohet ose të shtyhet pa arsye.

23.9 Gjuha

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën angleze dhe versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë mbi çdo përkthim. Të gjitha njoftimet, certifikatat dhe dokumentet e tjera dhe komunikimet (përfshirë kopjet) të dhëna ose të bëra sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të jenë në gjuhën angleze.

23.10 Ligji Drejtues

Kjo Marrëveshje do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Nju Jorkut.

23.11 Statusi i Marrëveshjeve të Projektit

Kjo Marrëveshje, së bashku me Marrëveshjet e tjera të Projektit, përbën "Marrëveshjen" për qëllime të Ligjit për Partneritetin Publik Privat, 2011.

23.12 Plotësia

Kjo Marrëveshje do të jetë shprehja e plotë dhe përfundimtare e marrëveshjes midis Palëve për çështjet e përmbajtura këtu. Me përjashtim të Marrëveshjeve të tjera të Projektit dhe çdo marrëveshjeje apo komunikate tjetër të kërkuar në bazë të kësaj, shfuqizohen dhe tërhiqen të gjitha paraqitjet, marrëveshjet, ofertat me shkrim ose gojore dhe të çdo lloji ndërmjet Palëve në lidhje me Projektin Kosova e Re, para kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë Memorandumin e Mirëkuptimit.

23.13 Caktimi

- (a) Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje, GenCo mund t'i caktojë të gjitha të drejtat titullin dhe interesin e vet dhe t'i bartë dhe t'ia delegojë detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje tek CG Kosova. Për më tepër, GenCo mund të caktojë si kolateral interesin e vet në vijim për një Huadhënës ose ndonjë Person tjetër në lidhje me ushtrimin e të drejtave kolaterale të Huadhënësit. Përveçse siç lejohet shprehimisht nga ky Seksion 23.13(a), kjo Marrëveshje nuk do t'i caktohet nga GenCo ndonjë pale tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të QK-së.
- (b) Kjo Marrëveshje nuk do të caktohet nga QK-ja pa pëlqimin paraprak me shkrim të GenCo-së.
- (c) Kjo Marrëveshje do të lidhet dhe do të jetë në dobi të Palëve dhe çdo pasardhësi ose titullari që merr interesin e mëposhtëm sipas Seksionit 23.13(a) dhe Seksionit 23.13(b).
- (d) Çdo caktim në kundërshtim me këtë Seksion 23.13 është nul dhe i pavlefshëm.

23.14 Kontraktimi

- (a) Secila Palë mund të delegojë përgjegjësitë e veta sipas kësaj Marrëveshjeje tek një ose më shumë

Kontraktorë; me kusht që, sidoqoftë, asnjë delegim i tillë të mos e lirojë palën përkatëse nga detyrimet ose përgjegjësitë e veta sipas kësaj Marrëveshjeje. GenCo do të kërkojë në kontratë nga të gjithë Kontraktorët e GenCo-së që të kenë të gjitha aftësitë dhe kapacitetet e kërkuara për të kryer ose për të shkaktuar që të kryhet çdo detyrë që ata ndërmarrin në kohën e duhur dhe në mënyrë profesionale, duke përdorur parime të shëndosha inxhinierike, procedura të menaxhimit të projekteve, procedura mbikëqyrëse dhe në përgjithësi praktikat e pranueshme të industrisë.

- (b) Për aq sa një Palë i delegon përgjegjësitë e veta sipas kësaj Marrëveshjeje tek një ose më shumë Kontraktorë, Pala e tillë do të sigurojë që çdo Kontraktor i tillë, sipas kontratës së tij me këtë Palë, të përmbushë detyrimet e veta në përputhje me Standardet e Zbatueshme. Pala e tillë do t'i sigurojë Palës tjetër kopjet e të gjitha kontratave të tilla, dhe këto kontrata mund të redaktohen sipas nevojës për qëllime konfidencialiteti.

23.15 Konfidencialiteti

- (a) Sipas Seksionit 23.15 (d), kjo Marrëveshje dhe të gjitha informacionet e paraqitura në vijim ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të trajtohen si konfidenciale dhe, sipas Seksionit 23.15(c), këto informacione nuk do të zbulohen tërësisht ose pjesërisht nga secila Palë pa pëlqimin paraprak të Palës tjetër.
- (b) Ky detyrim nuk zbatohet për informacionin që (kur përdoret ose shpaloset) është bërë publik jo nëpërmjet shkeljes së kësaj Marrëveshjeje, ose ka qenë ose mund të ishte fituar ligjërisht nga Pala.
- (c) Pavarësisht nga dispozitat e Seksionit 23.15(a), asnjërës Palë nuk do t'i kërkohej të marrë pëlqimin paraprak të palës tjetër në lidhje me zbulimin e informacionit:
- (i) drejtorëve dhe punonjësve dhe anëtarëve të një Pale të tillë, me kusht që Pala e tillë të përdorë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që këto Filiale të mbajnë konfidencial informacionin e zbuluar me të njëjtat kushte që janë dhënë në këtë Seksion 23.15;
 - (ii) Personave të angazhuar profesionalisht nga ose në emër të kësaj Pale (duke përfshirë këshilltarët, konsulentët dhe siguruesit e vet), me kusht që, sidoqoftë, këtyre Personave do t'u kërkohej nga Pala e tillë të ndërmarrin masa për ta mbajtur konfidencial këtë informacion dhe që Pala e tillë do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të siguruar pajtueshmërinë me masën e tillë;
 - (iii) çdo departamenti qeveritar ose ndonjë agjencie qeveritare ose rregullatore që ka juridiksion mbi Palën e tillë, por vetëm në atë masë që kësaj Pale i kërkohej me ligj për të bërë një zbulim të tillë;
 - (iv) tek:
 - (A) çdo institucion huadhënie ose tjetër financiar, duke përfshirë edhe Grupin e Bankës Botërore, në lidhje me financimin ose rifinancimin e veprimeve të Palës së tillë , dhe në çdo rast, këshilltarët, konsulentët dhe siguruesit e tyre në lidhje me ndonjë financim ose rifinancim;
 - (B) çdo agjenci vlerësimi, dhe këshilltarët, konsulentët , dhe siguruesit e tyre;
 - (C) çdo investitor aktual dhe potencial në ekuitet, dhe në çdo rast këshilltarët, konsulentët dhe siguruesit e tyre; ose
 - (D) çdo i caktuar ose bartës i synuar dhe i besueshëm (dhe në çdo rast, këshilltarët, konsulentët dhe siguruesit e tyre) të të gjithë ose ndonjë pjese të të drejtave dhe interesave të Palës shpalosëse sipas kësaj Marrëveshjeje,

por (në secilin rast) vetëm në masën që kërkohej në lidhje me marrjen e financimit, rifinancimit, vlerësimin, investimin të ekuitetit të tillë ose në lidhje me caktimin e tillë të propozuar dhe varet nga pajtimi paraprak i atij Personi ose bartësi ose të caktuari të

synuar me këtë Palë që të jetë i lidhur nga dispozitat e konfidencialitetit në thelb të njëjta me ato të përmbajtura në këtë Seksion 23.15; ose

(vi) çdo ekspert ose arbitër i emëruar në përputhje dhe sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

- (d) Pavarësisht nga dispozitat e Seksionit 23.15(a), Palët pranojnë që (i) QK-ja mund ta shpalojë këtë Marrëveshje dhe ndonjë nga Marrëveshjet e tjera të Projektit për publikun në çdo kohë pas Datës së Bartjes (por vetëm në atë masë që shpaloja është e mandatuar nga ligjet e aplikueshme të Kosovës ose nga politika publike e QK-së dhe sigurohet që çdo informacion komercialisht i ndjeshëm të redaktohet në masën e lejuar ligjrisht) dhe (ii) Palët dhe Filialet e tyre mund të ndajnë çdo Marrëveshje të Projekti në përputhje me dispozitat e secilës Marrëveshje të tillë të Projektit. Me shpalojen nga Qeveria të kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë pjese të saj për publikun, kufizimet e përcaktuara në këtë Seksion 23.15 nuk do të zbatohen më për GenCo në lidhje me ndonjë informacion të tillë të publikuar.

23.16 Asnjë Përgjegjësi për Shqyrtim

Asnjë shqyrtim dhe aprovim nga një Palë për ndonjë marrëveshje, dokument, instrument, vizatim, specifikim ose dizajn të propozuar nga një Palë, as ndonjë inspektim të kryer nga një Palë sipas kësaj Marrëveshjeje, nuk do ta lirojë një Palë nga ndonjë përgjegjësi që do të kishte për neglizhencën e vet në përgatitjen e kësaj marrëveshjeje, dokumenti, instrumenti, vizatimi, specifikimi ose dizajni ose nga kryerja e punimeve të tilla ose mosrespektimi i ligjeve të aplikueshme të Kosovës në lidhje me to, ose për të përmbushur detyrimet e një Pale sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe Palë nuk do t'i nënshtrohet ndonjë Pale ose ndonjë Personi tjetër për shkak të shqyrtimit ose aprovimit të marrëveshjes, dokumentit, instrumentit, vizatimit, specifikimit ose dizajnit apo inspektimit të tillë.

23.17 Mjetet Juridike të Ekuitetit

Palët bien dakord që në masën më të plotë të lejuar sipas çdo ligji të zbatueshëm, një Palë do të ketë të drejtë për mjete juridike të ekuitetit ose tjetër sipas kësaj Marrëveshjeje.

23.18 Auditimi nga Grupi i Bankës Botërore

Secila Palë do t'i lejojë Bankës Botërore qasje të arsyeshme për të inspektuar llogaritë dhe shënimet e veta (dhe Filialet e veta) që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me prokurimin, parashtrirat ose propozimet, dhe performancën e kontratës që ka të bëjë me çdo Marrëveshje të Projektit në të cilën ajo (ose ndonjë nga Filialet e veta) është palë, dhe t'i ketë ato të audituara nga auditorët e emëruar nga Banka Botërore, me kusht që në rast të një inspektimi ose auditimi sipas kësaj dispozite, Banka Botërore para se ta bëjë këtë auditim duhet të dakordohet t'i mbajë llogaritë dhe të dhënat e audituara apo të inspektuara në mirëbesim në përputhje me procedurat, politikat dhe rregullat e saj të vendosura.

23.19 Homologët

Kjo Marrëveshje mund të ekzekutohet në dy (2) ose më shumë kopje origjinale dhe secila kopje e tillë mund të ekzekutohet nga secila Palë në homologë të veçantë, dhe secila prej këtyre kopjeve do të jenë origjinale kur ekzekutohen dhe dorëzohen nga Palët, por të gjitha së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtin instrument.

23.20 Sigurime të Mëtejshme

Palët do të ekzekutojnë çdo dokument të arsyeshëm dhe të nevojshëm për realizimin e qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

23.21 Shkëputshmëria

Nëse ndonjë term ose dispozitë e kësaj Marrëveshjeje përcaktohet nga një gjykatë ose një autoritet tjetër kompetent, se është e parregullt, e pavlefshme, e paligjshme, e pazbatueshme ose kundër politikës publike, (i) dispozitat e mbetura të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë dhe (ii)

palët në këtë rast do të takohen menjëherë dhe do të negociojnë një zëvendësues për dispozitën apo pjesë të tillë të prekura që, në masën më të madhe ligjrisht të lejueshme, do të zbatojnë qëllimin origjinal të Palëve.

23.22 Pavlefshmëria e Pjesshme

Paligjshmëria, pavlefshmëria ose pazbatueshmëria e ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje në tërësi ose pjesërisht sipas ligjit të çdo juridiksioni nuk do të ndikojë:

- (a) ligjshmërinë, vlefshmërinë, ose zbatueshmërinë e saj sipas ligjit të çdo juridiksioni tjetër; as
- (b) ligjshmërinë e çdo dispozite tjetër ose një pjese të saj.

23.23 Borxhi Shtesë

Përveç siç parashikohet në lidhje me zgjedhjen e GenCo-së për të përballuar kostot për shkak të një Ngjarjeje të Forcës Madhore dhe pa kufizuar ndonjë detyrim të GenCo-së sipas Marrëveshjeve të Projektit, GenCo nuk ka asnjë detyrim të bartë borxhin ose të kontribuojë ekuitet për ndonjë kosto përveç (i) kostove të bëra për shkak të mos-performancës së vet të pajustificuar sipas Marrëveshjeve të Projektit dhe (ii) kostot e aprovuara nga QK-ja për t'u përfshirë në tarifën e përcaktuar në Kalendarin 1 (*Tarifat*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë.

23.24 Afirmimi

- (a) As Sponsorit HoldCo, Sponsorit Sipëror, asnjë Filial i asnjërit, as GenCo nuk angazhohet, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një agjenti, në Praktikën e Korrupsionit, Praktikën Mashtruese, Praktikën Konspirative, Praktikën Shtërnguese ose Praktikën Penguese në garimin për këtë Marrëveshje, gjatë prokurimit ose ekzekutimit të ndonjë Marrëveshjeje të Projektit, ose përndryshe në lidhje me Projektin Kosova e Re.
- (b) GenCo premtot në emër të vet, dhe premtot në emër të Filialeve të veta, se nuk do të angazhohet, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një agjenti, në Praktikën e Korrupsionit, Praktikën Mashtruese, Praktikën Konspirative, Praktikën Shtërnguese ose Praktikën Penguese në garimin për këtë Marrëveshje, gjatë prokurimit ose ekzekutimit të ndonjë Marrëveshjeje të Projektit, ose përndryshe në lidhje me Projektin Kosova e Re.
- (c) Secili prej Sponsorit HoldCo, Sponsorit Sipëror, GenCo dhe secili nga Filialet e tyre i ka zbuluar plotësisht QK-së me shkrim të gjitha komisionet, brokerimet dhe tarifën e tjera dhe kompensimet e tjera (përveç kompensimit të paguar për punonjësit e Sponsorit HoldCo, Sponsorit Sipëror, Filialet e secilit, dhe GenCo për shërbimet e ofruara) të paguara ose të pagueshme për çdo Zyrtar të Huaj në lidhje me Projektin Kosova e Re, përveç Tarifave të Lejuara për Këshilltarin e QK-së. "Zyrtar i Huaj" do të thotë çdo zyrtar ose punonjës i Qeverisë së Republikës së Kosovës ose ndonjë departament, agjenci ose instrument i tij ose çdo person që vepron në kapacitet zyrtar për ose në emër të ndonjë qeverie, departamenti, agjencie apo instrumenti të tillë.
- (d) GenCo pranon përgjegjësi të plotë dhe obligim të rreptë për vete ose ndonjë Filial që bën ndonjë deklaratë të rreme, nuk bën zbulimin e plotë, keqparaqet faktet ose bën ndonjë veprim që ka gjasa të mposhtë qëllimin e përfaqësimeve dhe garancive të përfshira këtu dhe deklaratat e kërkuara me anë të kësaj në lidhje me Projektin Kosova e Re. GenCo bie dakord që çdo kontratë, pëlqim, aprovim, e drejtë, interes, privilegj ose ndonjë detyrim ose përfitim tjetër i fituar ose prokuruar siç është përmendur më lart, do të jetë i pavlefshëm dhe pa efekt ligjor në opsionin e QK-së, në pajtim me Nenin 20 të Marrëveshjes së Zbatimit, pa paragjykuar ndonjë të drejtë tjetër dhe mjete juridike në dispozicion të QK-së.

DUKE DËSHMUAR SA MË LART, Palët kanë ekzekutuar dhe dorëzuar këtë Marrëveshje në Prishtinë, Kosovë në datën e shkruar më lart.

Republika e Kosovës
e cila vepron përmes **Zyrë së Kryeministrit**

Emri: Ramush Haradinaj

Titulli: Kryeministër

Republika e Kosovës
e cila vepron përmes **Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik**

Titulli: Ministër i Zhvillimit Ekonomik

Nënshkruesi i ContourGlobal

Emri: Joseph C. Brandt

Titulli: KE, ContourGlobal

Nga: _____

Emri: _____

Titulli:

—

Kalendari
1
Stimujt dhe Koncesionet Fiskale

1. TVSH-ja ose TVSH-ja e ngarkesës së kundërt nuk do të aplikohet për aktivitetet e ndërtimit dhe zhvillimit që kanë të bëjnë me Projektin Kosova e Re.
2. Asnjë detyrim i importit, qofshin detyrime doganore, TVSH e importit apo të tjera, nuk do të vendoset mbi materialet dhe mallrat e importuara jo të përjashtuara në lidhje me të gjitha aktivitetet e ndërtimit dhe të zhvillimit të Projektit Kosova e Re.

Kalendari
2
Forma e Garancisë Qeveritare

GARANCIA E QEVERISË
NË LIDHJE ME PROJEKTIN KOSOVA E RE

KJO GARANCI E QEVERISË (kjo "**Garanci**") është lëshuar më _____, 20__ nga: (1)

Qeveria së Kosovës që vepron përmes Ministrisë së Financave ("**QK**"), në dobi të

(2) [_____] ("**GenCo**"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me zyrën e saj kryesore në Rr. Garibaldi, Nr. 3, 10000 Prishtinë, Kosovë, Kosovë.

Veçmas, QK-ja dhe GenCo janë të referuara më poshtë si "**Pala**" dhe, së bashku si "**Palët**".

RECITALE
T

- A. QK-ja ka për qëllim të përfshijë sektorin privat në një projekt të infrastrukturës nga linjiti në energji elektrike që përfshin zhvillimin, projektimin, ndërtimin, financimin, posedimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Objektivit të TCKR-së dhe rehabilitimin e Lokacionit (siç përcaktohet më poshtë) nga GenCo-ja ("**Projekti Kosova e Re**");
- B. QK-ja dhe GenCo po lidhin Marrëveshjen e Zbatimit të datës ose afër me datën e saj ("**Marrëveshja e Zbatimit**");
- C. KEKR dhe GenCo po lidhin Marrëveshjen për Blerje të Energjisë të datës ose afër me datën e saj ("**Marrëveshja për Blerje të Energjisë**");
- D. Furnizuesi me Ujë dhe GenCo po lidhin Marrëveshjen për Furnizim me Ujë të datës ose afër me datën e saj ("**Marrëveshja për Furnizim me Ujë**");
- E. Mihja e KEK-ut dhe GenCo po lidhin Marrëveshja për Deponimin e Hirit dhe Gipsit të datës ose afër me datën e saj ("**Marrëveshja për Deponimin e Hirit dhe Gipsit**");
- F. Mihja e KEK-ut dhe GenCo po lidhin Marrëveshjen për Furnizim me Linjit, të datës ose afër me datën e saj ("**Marrëveshja për Furnizim me Linjit**");
- G. Gjenerimi i KEK-ut dhe GenCo po lidhin një Marrëveshje për Bartjen e Lokacionit të datës ose afër me datën e saj ("**Marrëveshja e Bartjes së Lokacionit**");
- H. KOSTT dhe GenCo po lidhin Marrëveshjen e Kycjes të datës ose afër me datën e saj ("**Marrëveshja e Kycjes**"); dhe
- I. Është një term i Seksionit 9.1 të Marrëveshjes së Zbatimit që QK-ja do të ekzekutojë dhe dorëzojë këtë Garanci.

TANI, PRANDAJ, për dhe në konsideratë të premtimeve dhe marrëveshjeve të ndërsjella të përmbajtura në këtë dokument, dhe që synojnë të jenë detyruese ligjërish, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Garancia

1.1 Garancia

Duke pranuar se Projekti Kosova e Re ka rëndësi strategjike për Republikën e Kosovës, QK-ja me këtë mënyrë i garanton në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kushte GenCo-së për këtë term siç parashikohet në Seksionin 1.2:

- (a) përmbushjen e duhur dhe të përpiktë të të gjitha termave, kushteve dhe premtimeve të:
 - (i) Furnizuesit me Ujë sipas Marrëveshjes për Furnizim me Ujë;
 - (ii) Mihjes së KEK-ut sipas Marrëveshjes për Deponimin e Hirit dhe Gipsit dhe Marrëveshjes për Furnizim me Linjit;
 - (iv) Gjenerimit të KEK-ut sipas Marrëveshjes së Bartjes së Lokacionit;
 - (v) (iv) KOSTT-it sipas Marrëveshjes së Kycjes;
 - (v) KEKR-së sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; dhe
 - (vi) Çdo NP-je tjetër të Specifikuar sipas çdo Marrëveshjeje të Projektit në të cilën çdo NP e tillë e Specifikuar është palë,

dhe në secilin rast merr përsipër të prokurojë përmbushjen e detyrimeve përkatëse; dhe

- (b) pagesën e plotë dhe të shpejtë të:
 - (i) çdo shume që NKEK nuk paguan kur është e detyruar sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë;
 - (ii) çdo shume që Furnizuesi i Ujit nuk paguan kur është e detyruar sipas Marrëveshjes për Furnizim me Ujë, duke përfshirë dëmet e pagueshme sipas Seksionit 3.7 (*Dështimi i Furnizimit*) të Marrëveshjes për Furnizim me Ujë;
 - (iii) çdo shume që Mihja e KEK-ut nuk paguan kur është e detyruar sipas Marrëveshjes për Deponimin e Hirit dhe Gipsit ose Marrëveshjes për Furnizim me Linjit;
 - (iv) çdo shumë që Gjenerimi i KEK-ut nuk paguan kur është e detyruar sipas Marrëveshjes për Bartjen e Lokacionit;
 - (v) çdo shume që KOSTT-i nuk paguan kur është e detyruar sipas Marrëveshjes së Kycjes; dhe
 - (vi) çdo shumë që çdo NP e Specifikuar nuk paguan kur është e detyruar sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit në të cilën një NP e tillë e Specifikuar është palë,

(kolektivisht, "**Obligimet e garantuara**"); me kusht që, sidoqoftë, shumat në Kontest sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, Marrëveshjes për Furnizim me Ujë, Marrëveshjes për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, Marrëveshjes për Furnizim me Linjit, Marrëveshjes për Bartjen e Lokacionit, Marrëveshjes për Kycjen apo ndonjë Marrëveshjeje tjetër të Projektit do të konsiderohen që nuk janë të detyruara për qëllimet e kësaj Garancie deri pas zgjidhjes së çdo kontesti që lind në lidhje me shumat e tilla të pagueshme në përputhje me procedurat e zgjidhjes së kontesteve të parashikuara në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë, Marrëveshjen për Furnizim me Ujë, Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, Marrëveshjen për Furnizim me Linjit, Marrëveshjen për Bartjen e Lokacionit, Marrëveshjen e Kycjes ose Marrëveshje tjetër të zbatueshme të Projektit, sipas rastit, duke përfshirë periudhën për pagesë pas zgjidhjes së Kontestit të parashikuar në Seksionin 17.3.2 (*Procedurat e Zgjidhjes*) Marrëveshjes për Blerje të Energjisë dhe Seksionin 11.3.2 (*Procedurat e Zgjidhjes*) të Marrëveshjes për Furnizim me Ujë.

1.2 Hyrja në Fuqi; Afati

- (a) Efektiviteti i kësaj Garancie do të jetë subjekt, si Precedent i Kushtit të Bartjes së GenCo (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit), i aprovimit nga Kuvendi i Republikës së Kosovës të "Garancisë Shtetërore" të tillë dhe në masën e kërkuar sipas Ligjeve të Kosovës, duke përfshirë Ligjin për Borxhin Publik, 2009, dhe kjo Garanci nuk do të hyjë fuqi ose të ketë efekt deri në përmbushjen e kushteve të tilla.
- (b) Kjo garanci do të mbetet në fuqi të plotë dhe efektive nga dhe pas datës së efektivitetit të saj në përputhje me Seksionin 1.2(a) deri në skadimin ose ndërprerjen e Marrëveshjes së Zbatimit, dhe për aq kohë pas kësaj që ndonjë shumë i detyrohet GenCo-së nga NP-ja e Specifikuar e zbatueshme në lidhje me ndonjë Marrëveshje të Projektit në të cilën NP-ja e Specifikuar është palë është ose që mund të jetë e paguar.

1.3 Heqja e mbrojtjes

As detyrimet e QK-së që përfshihen këtu, as të drejtat, kompetencat dhe mjetet juridike që i janë dhënë GenCo-së në lidhje me çdo NP të Specifikuar që është palë në ndonjë Marrëveshje të Projektit, sipas rastit, në bazë të ligjit ose ndryshe, do të shkarkohet, zhdëmtohet ose cedohet ndryshe nga ndodhja nga koha në kohë e çdo ngjarjeje, çështjeje, veprimi ose mosveprimi, përfshirë sa më poshtë:

- (a) zgjatjen e kohës për pagesën e çdo shume të detyruar ose të kohës për përmbushjen e ndonjë prej premtimeve, kushteve ose marrëveshjeve të ndonjë Marrëveshjeje të Projektit në të cilën ndonjë NP e Specifikuar është palë;
- (b) çdo ndryshim në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë, Marrëveshjen për Furnizim me Ujë, Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsit, Marrëveshjen për Furnizim me Linjit, Marrëveshjen për Bartjen e Lokacionit ose Marrëveshjen e Kyçjes; me kusht që, sidoqoftë, nëse pëlqimi paraprak me shkrim i QK-së për ndryshimin e tillë është marrë, kjo Garanci nuk zbatohet për:
 - (i) çdo ndryshim në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë që rrit materialisht detyrimet e KEKR-së ose që zvogëlon materialisht detyrimet e GenCo-së sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë;
 - (ii) çdo ndryshim në Marrëveshjen për Furnizim me Ujë që rrit materialisht detyrimet e Furnizuesit të Ujit ose që zvogëlon materialisht detyrimet e GenCo-së sipas Marrëveshjes për Furnizim me Ujë;
 - (iii) çdo ndryshim në Marrëveshjen për Deponimin e Hirit dhe Gipsit ose në Marrëveshjen për Furnizim me Linjit që rrit materialisht detyrimet e Mihjes së KEK-ut ose që zvogëlon materialisht detyrimet e GenCo-së sipas Marrëveshjes për Deponimin e Hirit dhe Gipsit ose Marrëveshjes për Furnizim me Linjit;
 - (iv) çdo ndryshim në Marrëveshjen e Bartjes së Lokacionit që rrit materialisht detyrimet e Gjenerimit të KEK-ut ose që zvogëlon materialisht detyrimet e GenCo-së sipas Marrëveshjes së Bartjes së Lokacionit; ose
 - (v) çdo ndryshim në Marrëveshjen e Kyçjes që rrit materialisht detyrimet e KOSTT-it ose që zvogëlon materialisht detyrimet e GenCo-së sipas Marrëveshjes së Kyçjes;

me kusht që, më tej, për çdo ndryshim të tillë, aprovimi paraprak i subjektit të QK-së që është nënshkruar i marrëveshjes në fuqi nuk do të kërkohej nëse ky subjekt është një Ndërmarrje Publike.

- (c) dështimi, mosveprimi ose vonesa nga GenCo ose ndonjë NP e Specifikuar që është palë në Marrëveshjen e Projektit, sipas rastit, për të zbatuar, konstatuar ose ushtruar ndonjë të drejtë, kompetencë ose mjet juridik sipas ose në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së tillë të Projektit, duke përfshirë këtë Garanci dhe Marrëveshjen e Zbatimit;
- (d) falimentimi, paaftësia paguese ose ndonjë dështim tjetër ose paaftësi financiare e ndonjë NP-je të Specifikuar që është palë në një Marrëveshje të Projektit;
- (e) çdo dështim i QK-së ose i ndonjë NP-je të Specifikuar për të përmbushur kërkesat e ndonjë ligji, rregulloreje ose urdhri;
- (f) çdo caktim i ndonjë Marrëveshjeje të Projektit në të cilën ndonjë NP e Specifikuar është palë në përputhje me kushtet e saj;
- (g) shtimi, ose lirimi i pjesshëm ose i tërësishëm i cilitdo garantuesi ose pale tjetër, kryesisht ose në mënyrë të dytë përgjegjëse për përmbushjen e ndonjë prej premtimeve, kushteve ose marrëveshjeve të përcaktuara në çdo Marrëveshje Projekti, në të cilën çdo NP e Specifikuar është palë, ose ndonjë shtyrje, heqje dorë, ndryshim ose ndonjë veprim tjetër që mund të lirojë ose të krijojë një mbrojtje për një garantues (përveç performancës në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit);

- (h) çdo pavlefshmëri ose pazbatueshmëri e ndonjë Marrëveshjeje të Projekti në të cilën ndonjë NP e Specifikuar është palë, ose ndonjë nga dispozitat, termat ose kushtet e tyre përkatëse në bazë të mungesës së autoritetit të një NP-je të Specifikuar për të lidhur një marrëveshje të tillë ose mungesës së autoritetit të një nënshkruesi për të detyruar një NP të Specifikuar; ose
- (i) çdo riorganizim ose privatizim i ndonjë NP-je të Specifikuar që është palë në ndonjë Marrëveshje të Projektit me efektin që NP-ja e tillë e Specifikuar nuk është më e kontrolluar nga QK-ja.

1.4 Vazhdimi i Garancisë

Asnjë kërkesë e bërë nga GenCo në vijim nuk paragjykon ose kufizon të drejtat e GenCo-së për të bërë kërkesa të mëtejshme ose të tjera sipas kushteve të kësaj Garancie.

1.5 Siguria Shtesë

- (a) Kjo garanci duhet të jetë shtesë, dhe jo zëvendësim ose derogim i ndonjë sigurie tjetër që GenCo mund të mbajë në çdo kohë në lidhje me detyrimet e ndonjë NP-je të Specifikuar sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit në të cilën është palë.
- (b) GenCo mund ta zbatojë këtë Garanci, pavarësisht se mund të mbajë ndonjë garanci, bono, ose siguri të ose për ndonjë detyrim të ndonjë NP-je të Specifikuar sipas Marrëveshjes së Projektit në të cilën është palë, ose të ketë në dispozicion të tij ndonjë mjet tjetër juridik ose në ekuitet.

1.6 Kërkesa paraprake

- (a) Pavarësisht që kjo garanci është detyrim i pakushtëzuar i QK-së, GenCo nuk do të kërkojë pagesën ose përmbushjen, sipas rastit, për çdo Detyrim të Garantuar përveç dhe deri kur:
 - (i) GenCo do të ketë njoftuar QK-në për mos pagesën ose moszbatimin e Detyrimit të Garantuar siç kërkohet nga kushtet e Marrëveshjes përkatëse të Projektit dhe Seksioni 1.8; dhe
 - (ii) çdo periudhë e përcaktuar në Marrëveshjen përkatëse të Projektit, gjatë së cilës NP-ja e Specifikuar e aplikueshme ose QK-ja mund të shlyejë mosplotësimin ose mospërmbushjen e tillë, pa u paguar ose prokuruar kryerja e një detyrimi të tillë të garantuar nga NP-ja e Specifikuar ose QK-ja.
- (b) Sipas Seksionit 1.6(a), QK-ja do të bëjë pagesën ose do të sigurojë performancën brenda tridhjetë (30) Ditëve pas kërkesës për pagesë ose performancë, sipas rastit, në përputhje me Seksionin 1.8 dhe siç parashikohet ndryshe në tekstin e mëtejshëm.
- (c) Me përjashtim të rasteve të parashikuara në Seksionin 1.6(a), GenCo nuk do të jetë i detyruar përpara se të ndërmarrë hapa për të zbatuar këtë garanci, të ushtrojë ndonjë mjet tjetër juridik që mund të jetë në dispozicion sipas ose në lidhje me Marrëveshjen përkatëse të Projektit, ose të iniciojë ndonjë procedurë ose të marrë vendimin kundër NP-së të Specifikuar të aplikueshme.

1.7 Certifikimi

Çdo kërkesë për pagesë e bërë në përputhje me këtë Garanci duhet të shoqërohet nga një certifikatë e nënshkruar nga një zyrtar i autorizuar i GenCo-së ku thuhet se:

- (a) "[_____]" ("GenCo") vërteton për Republikën e Kosovës ("QK") që (A) GenCo e bën këtë kërkesë në QK për pagesë nga QK në një shumë të barabartë me € [●] në përputhje me Seksionin 1.1 të Garancisë datë [●] [●] 20__, nga QK-ja në favor të GenCo;

(B) (1) Marrëveshja e Zbatimit nuk është ndërprerë (përveçse në lidhje me ngjarjen ose rrethanat për të cilat kjo kërkesë është bërë) në përputhje me kushtet ose çështja për të cilën është bërë kërkesa i ka mbijetuar ndërprerjes, dhe (2) shuma e specifikuar më sipër është e detyrueshme dhe e pagueshme nga [NP-ja e Specifikuar e aplikueshme] sipas [Marrëveshjes së zbatueshme të Projektit]; (C) kërkesa me shkrim për pagesën nga QK-ja është dorëzuar në QK në ose pas datës së pagesës ose kryerjes së detyrave dhe njoftimi për mos-pagesën ose mospërmbushjen është dorëzuar në QK jo më pak se shtatë (7) Ditë para datës së këtij; dhe (D) shuma e tillë, në datën në fjalë, mbetet e papaguar, ose një performancë e tillë nuk është plotësuar në këtë datë."

1.8 Njoftimi dhe Pagesa

- (a) Nëse GenCo nuk do të ketë marrë të gjitha ose ndonjë pjesë të një Detyrimi të Garantuar në ose para datës së caktuar, do të njoftojë QK-në (me një kopje për Ministrinë e Financave) brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve të punës pas kësaj. Njoftimi i tillë duhet të deklarojë se ka kaluar afati i pagesës ose kryerja e një detyrimi të tillë të garantuar, që GenCo ka ushtruar të drejtat e tij në përputhje me Marrëveshjen përkatëse të Projektit, shumën e detyrimit të garantuar që mbetet i papaguar ose i papërmbushur, dhe se shuma e papaguar ose detyrimi i papërmbushur nuk është kontestuar në përputhje me Marrëveshjen e zbatueshme të Projektit, ose ndonjë kontest është zgjidhur në favor të GenCo-së.
- (b) Me përjashtim të rasteve të parashikuara në Seksionin 1.8, GenCo nuk do të jetë i detyruar përpara se të ndërmarrë hapa për të zbatuar këtë Garanci, të ushtrojë ndonjë mjet tjetër juridik që mund të jetë në dispozicion sipas ose në lidhje me Marrëveshjen përkatëse të Projektit, ose të marrë aktgjykim kundër NP-së të Specifikuar të aplikueshme.
- (c) E kushtëzuar me marrjen nga QK-ja të njoftimit siç parashikohet në Seksionin 1.8(a), pagesa nga QK për çdo Detyrim të Garantuar që paguhet nga QK sipas kësaj Garancie ose përmbushja e ndonjë Detyrimi të Garantuar që do të kryhet nga QK-ja sipas kësaj Garancie, duhet që në secilin rast të paguhet brenda tridhjetë (30) Ditëve pas njoftimit të dhënë në pajtim me Seksionin 1.8(a).

1.9 Kompensimi

Asnjë akt i ligjshëm i kryerjes ose mosveprimit të çfarëdo lloji ose në çdo kohë nga ana e GenCo-së, nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë dhe nuk do të pengojë të drejtat e GenCo-së për të zbatuar ndonjë të drejtë, kompetencë apo përfitim sipas kësaj Garancie dhe nuk ka kompensim, kërkesë, kundër-kërkesë, ose zvogëlim të ndonjë detyrimi, dhe ndonjë mbrojtje që QK-ja ka apo mund të ketë ndaj GenCo-së do të jetë në dispozicion të QK-së kundër GenCo-së në çfarëdo vendimi që ajo merr që të përmbushë këto detyrime ose për padinë apo veprimin e ngritur nga GenCo për të zbatuar çdo të drejtë, kompetencë apo përfitim sipas kësaj Garancie; me kusht që, sidoqoftë, pavarësisht nga sa më sipër, QK-ja do të përfitojë nga të gjitha të drejtat e kompensimit, kërkesës, kundër-kërkesës, zvogëlimit ose reduktimit të ndonjë detyrimi të pakontestuar të likuiduar të GenCo-së për QK-në sipas Marrëveshjes së Zbatimit ose për ndonjë NP të Specifikuar sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit.

1.10 Vartësia

Çdo e drejtë që QK-ja mund të ketë në çdo kohë për t'u dëmshpërblyer nga çdo NP e Specifikuar që është palë në një Marrëveshje të Projektit në lidhje me shumën e paguar nga QK-ja në përmbushjen e kësaj Garancie, do të jetë në vartësi të të drejtave të GenCo-së për të rikuperuar në mënyrë të plotë nga një NP e Specifikuar që është palë në një Marrëveshje Projekti, të gjitha shumën që mund të bëhen të detyruara në çdo kohë nga çdo NP e Specifikuar sipas Marrëveshjes së Projektit në të cilën është palë.

1.11 Arbitrazhi; Juridiksioni

1.11.1 Arbitrazhi

Palët bien dakord në mënyrë të përvokueshme që çdo kontest ose diferencë që lind nga, prej, në lidhje me ose rreth kësaj Garanci, duke përfshirë çdo Kontest ose diferencë në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Garancie ose të ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë

ekzistencën, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e marrëveshjeve të përfshira në këtë Seksion 1.11.1) ose nëse kjo garanci ose ndonjë dispozitë e saj (duke përfshirë marrëveshjet e përmbajtura në këtë Seksion 1.11.1) janë të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme, do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e Nenit 22 (*Zgjidhja e Kontesteve*) të Marrëveshjes së Zbatimit, të cilat si dispozita janë inkorporuar këtu me referencë, *mutatis mutandis*. Secila Palë në këtë mënyrë pranon juridiksionin e çdo gjykate kompetente për çdo veprim të paraqitur nga Pala tjetër sipas kësaj Garancie për të zbatuar çdo vendim të çdo gjykate të caktuar në mënyrë të rregullt për të zgjidhur çdo kontest mes Palëve.

1.11.2 Aktet Komerciale

QK-ja pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme pajtohet që ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja prej saj e kësaj Garancie përbëjnë veprimet e veta private dhe komerciale.

1.11.3 Imuniteti Sovran; Juridiksioni

- (a) QK-ja me këtë në mënyrë të përvokueshme dhe pa kushte:
- (i) pajtohet që nëse duhet të ngrihet ndonjë procedim kundër QK-së ose aseteve të veta, përveç Aseteve të Mbrojtura, në çdo juridiksion në lidhje me këtë Garanci ose ndonjë nga transaksionet e parashikuara nga kjo Garanci, asnjë pretendim për imunitet nga ky procedim nuk do të kërkohet nga ose në emër të QK-së në emër të vetvetes ose të ndonjë prej aseteve të veta (përveç Aseteve të Mbrojtura);
 - (ii) heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që ajo ose ndonjë nga asetet e veta (përveç Aseteve të Mbrojtura) tani ka ose mund të ketë në të ardhmen në ndonjë juridiksion në lidhje me ndonjë procedim të tillë;
 - (iii) bie dakord që ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja sipas kësaj Marrëveshjeje dhe çdo Marrëveshje tjetër të Projektit në të cilën është palë, përbën aktet e veta private dhe komerciale dhe heq dorë nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose në vijim ndaj vendit të ndonjë veprimi ose procedimi të parashtruar siç e lejon ky Seksion 1.11.3(a), dhe në mënyrë specifike heq dorë nga çdo kundërshtim që çdo veprim apo procedim e tillë është parashtruar në një forum të papërshtatshëm dhe pajtohet të mos mbrojë ose pretendojë të njëjtën gjë;
 - (iv) jep pëlqimin përgjithësisht në lidhje me zbatimin e çdo vendimi kundër saj në çdo procedim të tillë në çdo juridiksion për marrjen e ndonjë mase juridike ose çështjen e ndonjë procesi në lidhje me këtë procedim (bërjen, zbatimin ose ekzekutimin kundër ose në lidhje me çfarëdo aseti të saj (përveç Aseteve të Mbrojtura)) pavarësisht nga përdorimi ose përdorimi i synuar;
 - (v) jep pëlqimin në përgjithësi për juridiksionin e çdo gjykate kompetente në Kosovë, Shtetet e Bashkuara ose çdo juridiksion tjetër në të cilin janë vendosur asetet (përveç Aseteve të Mbrojtura) të ndonjë NP-je të Specifikuar për çdo veprim të paraqitur nga GenCo për të zbatuar çdo vendim të ndonjë gjykate të caktuar për të zgjidhur çdo kontest ndërmjet Palëve ((bërjen, zbatimin ose ekzekutimin kundër ose në lidhje me çfarëdo aseti të saj pavarësisht nga përdorimi ose përdorimi i synuar) dhe në mënyrë specifike heq dorë nga çdo kundërshtim që çdo një veprim apo procedurë e tillë është parashtruar në një forum të papërshtatshëm dhe pajtohet të mos mbrojë ose pretendojë këtë gjë; dhe
 - (iv) pajtohet që shërbimi i procesit në çdo veprim apo procedim të tillë mund të kryhet në çfarëdo mënyre të lejuar nga ligji i zbatueshëm në gjykatën e lartpërmendur.

- (b) GenCo heq dorë nga çfarëdo dhe të gjitha të drejtat që mund të ketë për të zbatuar ndonjë aktgjykim ose padi kundër Aseteve të Mbrojtura në gjykatat e çdo juridiksioni.

1.11.4 Tarifat dhe Shpenzimet

- (a) Sipas Seksionit 1.11.4(b), nëse një Kontest përcaktohet nga një tribunal i caktuar në mënyrë të rregullt për të zgjidhur çdo Kontest ndërmjet Palëve, Pala mbizotëruese (siç përcaktohet nga tribunali i tillë) ka të drejtë të marrë, dhe Pala jo-mbizotëruese do të paguajë, përveç të gjitha mjeteve të tjera juridike në të cilat Pala mund të ketë të drejtë, kostot dhe shpenzimet (duke përfshirë tarifatat ligjore) të arsyeshme të bëra nga Pala mbizotëruese gjatë kryerjes së Kontestit (siç përcaktohet nga tribunali i tillë).
- (b) Pavarësisht nga Seksioni 1.11.4(a), GenCo ka të drejtë të marrë, dhe QK do të paguajë, kostot dhe shpenzimet (përfshirë tarifatat ligjore) të bëra në mënyrë të arsyeshme nga GenCo për të zbatuar çdo vendim të ndonjë tribunali të caktuar rregullisht për të zgjidhur çdo Kontest në këtë Marrëveshje ndërmjet Palëve.

Neni 2

Asnjë heqje dorë; Mjetet Juridike Kumulative

2.1 Asnjë heqje dorë

Asnjë dështim ose vonesë nga GenCo për të ushtruar ndonjë të drejtë ose mjet juridik sipas kësaj Garancie nuk do të përbëjë një heqje dorë nga një e drejtë apo mjet i tillë. Asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte ose mjeti juridik nuk përjashton ndonjë ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tij, ose ushtrimin e ndonjë të drejte ose mjeti tjetër. Asnjë heqje dorë nga GenCo nuk do të jetë efektive nëse nuk është me shkrim.

2.2 Mjetet Juridike Kumulative

Të drejtat dhe mjetet juridike të GenCo të parashikuara nga kjo garanci janë kumulative dhe nuk janë përjashtuese të ndonjë të drejte ose mjeti juridik të parashikuar me ligj ose në ndonjë Marrëveshje të zbatueshme të Projektit.

Neni 3

Caktimi

3.1 Caktimi

- (a) GenCo mund të caktojë si kolateral interesin e vet në vijim për një Huadhënës, për çdo institucion financiar ose institucione që marrin pjesë në financimin e Projektit Kosova e Re, ose për çdo sigurues rreziku politik që kërkon caktimin e kësaj Garancie si kusht për lëshimin prej tij të policës së vet, ose për çdo Person në lidhje me ushtrimin e të drejtave të kolateralit të Huadhënësit. (b) Kjo Garanci nuk do t'i caktohet nga GenCo asnjë pale tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të QK-së.
- (b) Kjo Garanci nuk do të caktohet nga QK-ja pa pëlqimin paraprak me shkrim të GenCo-së.
- (c) Kjo Garanci do të lidhet dhe do të jetë në dobi të Palëve dhe çdo pasardhësi ose të caktuari që merr interesin e mëposhtëm sipas Seksionit 3.1(a) dhe Seksionin 3.1(b).
- (d) Çdo caktim në kundërshtim me këtë Seksion 3.1 është nul dhe i pavlefshëm.

Neni 4

Të ndryshme

4.1 Njoftimet

- (a) Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera të kërkuara ose të lejuara për t'u dhënë nga një Palë duhet të jenë me shkrim dhe secila e dorëzuar personalisht ose me korrier ose të dërgohet me faks ose me e-mail në adresën ose numrin e Palës tjetër të specifikuar më poshtë:

(i) Nëse për Ministrinë e Financave:

Ministria e
Financave

Rr. Nëna Terezë Pn. Ndërtesa e Qeverisë
Prishtinë,
Kosovë
Në vëmendje të:
Ministër i
Financave
Tel: [_____]
Faks: [_____
]
Email: [_____]

me një kopje (e cila nuk do të përbëjë njoftim) për:

Qeveria e Kosovës
Rr. Nëna Terezë Nr. 36,
Prishtinë, Kosovë
Prishtinë,
Kosovë
Në vëmendje të: Ministër i Zhvillimit Ekonomik
Tel: [_____]
Faks: [_____
]
Email: [_____]

me një kopje (e cila nuk do të përbëjë njoftim) për:

Hunton & Williams LLP
Riverfront Plaza, East Tower
951 East Byrd Street
Richmond, Virginia 23219-4047
Në vëmendje të: John J.
Beardsworth, Jr. Tel: +1-804-788-
8637
Faks: +1-804-788-
8218
E-mail: jbeardsworth@hunton.com

(ii) Nëse është për
GenCo-në:

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l.
35-37 Avenue de la Liberté
L-1931 Luxembourg, Grand Duchy of Luxembourg
Në vëmendje të: Bordit të Menaxherëve
Telefoni: + (352) 28 86 78 00
Faks: + (352) 24 52 73 26
E-mail: CGK_CEO@contourglobal.com
GK_GC@contourglobal.com

me kusht që, një Palë mund ta ndryshojë adresën në të cilën duhet t'i dërgohen njoftimet, duke i dhënë Palës tjetër njoftim me shkrim jo më vonë se tridhjetë (30) përpara, në përputhje me këtë Seksion 4.1 (a).

(b) Asnjë njoftim ose komunikim tjetër nuk do të jetë efektiv deri sa të merret ose të konsiderohet e i marrë. Njoftimet ose komunikimet e tjera do të konsiderohen se janë marrë nga Pala pritëse:

(i) kur dorëzohet nëse dorëzohet personalisht;

- (ii) tre (3) Ditë të Punës pas dërgimit, nëse dërgohen nga një korrier ndërkombëtar;
- (iii) me dërgimin e tyre, nëse janë dërguar me faks, në varësi të konfirmimit të një raporti të pandërprerë të transmisionit dhe me kusht që një kopje fizike të dërgohet jo më vonë se Dita e Punës në vijim tek marrësi nëpërmjet korrierit ndërkombëtar ose dërgesës personale; ose

- (iv) me dërgimin e tyre, nëse janë dërguar me e-mail, me kusht që një kopje fizike të dërgohet jo më vonë se Dita e Punës në vijim tek marrësi me korrier ndërkombëtar ose dërgesë personale; me kusht që, sidoqoftë, Palët mund të bien dakord reciprokisht me shkrim se nuk ka asnjë kërkesë për dorëzimin e kopjeve fizike në lidhje me komunikimet të caktuara operative të përditshme apo të ngjashme.
- (c) Një Palë që dërgon një njoftim ose komunikim tjetër sipas Seksionit 4.1(a) do të përdorë përpjekje të arsyeshme komerciale për t'i dhënë Palës pritëse një përkthim të arsyeshëm të saktë në gjuhën shqipe brenda pesë (5) Ditëve të Punës të dërgimit të njoftimit ose komunikimit tjetër në Anglisht; me kusht që, sidoqoftë, një Palë nuk do t'i kërkojë të sigurojë përkthim të ndonjë vizatimi teknik ose dokumenteve të ngjashme teknike ose inxhinierike. Në rast të ndonjë mospërputhje midis origjinalit anglisht dhe përkthimit në shqip të çdo njoftimi ose komunikimi tjetër, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë mbi versionin në shqip. Për shmangien e dyshimit, dështimi në dorëzimin e një përkthimi të një njoftimi ose komunikimi tjetër në përputhje me këtë Seksion 4.1 (c) nuk do të ndikojë në efektivitetin e njoftimit ose komunikimit tjetër të përcaktuar sipas Seksionit 4.1(b).

4.2 Ligji Drejtues

Kjo Garanci do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Nju Jorkut.

4.3

Shkëputshmëria

Nëse ndonjë term ose dispozitë e kësaj Garancie përcaktohet nga një gjykatë ose një autoritet tjetër kompetent, se është e parregullt, e pavlefshme, e paligjshme, e pazbatueshme ose kundër politikës publike, (i) dispozitat e mbetura të kësaj Garancie do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë dhe (ii) palët në këtë rast do të takohen menjëherë dhe do të negociojnë një zëvendësues për dispozitën apo pjesë të tillë të prekura që, në masën më të madhe ligjërish të lejueshme, do të zbatojnë qëllimin origjinal të Palëve.

4.4 Termat me Shkronjë të Madhe

Termat me shkronjë të madhe të përdorura por jo të përcaktuara në këtë Garanci do të kenë kuptimet e dhëna atyre në Marrëveshjen e Zbatimit, të cilat përfshijnë interpretimet e përcaktuara në Seksionin 1.2 të Marrëveshjes së Zbatimit.

DUKE DËSHMUAR SA MË LART, kjo Garanci është ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të QK-së në Prishtinë, Kosovë në datën e shkruar më lart.

Republika e Kosovës
e cila vepron përmes **Ministrisë së Financave**

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

[_____]

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Kalendari
3
Shuma e Kompensimit të Blerjes

Neni 1
Përkufizim
et

1.1
Përkufizime
t

Termat e mëposhtëm kanë kuptimin e mëposhtëm kur përdoren në këtë Kalendar 3 dhe në Marrëveshje.

“Data e Llogaritjes” - Dita në të cilën llogaritet çmimi i aplikueshëm i ndërprerjes, Dita e tillë është Dita që ndodh nëntëdhjetë (90) Ditë pas datës së aplikueshme të ndërprerjes.

Neni 2
Llogaritja e Çmimeve të
Bartjes

2.1
Llogaritja e Çmimeve të
Bartjes

Çmimi i blerjes për bartjen e Objektivit të TCKR-së në QK do të përfshijë në çdo rast, më përjashtim të Çmimit të Blerjes në Fund të Afatit (i) të gjitha *UnpaidDebt* dhe (ii) të gjitha *BreakFees* si pjesë e llogaritjes si më poshtë.

“**Çmimi i Blerjes i Mospërmbushjes nga GenCo-ja**” llogaritet si më poshtë:

UnpaidDebt *BreakFees* *AmountsOuts* tan *ding* *GOKAF*
 – *Insurance – Overhaul – Cleanup – CDF – RsrvAccts*

“**Çmimi i Blerjes i Mospërmbushjes nga QK-ja**” llogaritet si më poshtë:

GOKDfltEqtyAmt *AmountsOuts* tan *ding* *GOKAF – ExcludedUnpaidDebt*
UnpaidDebt *BreakFees*

 – *Insurance – Overhaul – Cleanup – CDF – RsrvAccts*

“**Çmimi i Blerjes për Forcë Tjetër Madhore**” llogaritet si më poshtë:

FMEqtyAmt *AmountsOuts* tan *ding* *GOKAF – ExcludedUnpaidDebt*
UnpaidDebt *BreakFees*
 – *Insurance – Overhaul – Cleanup – CDF – RsrvAccts*

“**Çmimi i Blerjes së Ndërprerjes së Mjedisit**” llogaritet si më poshtë:

- (a) nga dhe pas Datës së Operacioneve Komerciale, shuma që është e ndarë në mënyrë të barabartë midis shumës që do të paguhej për Çmimin e Blerjes të Forcës Tjetër madhore dhe Çmimin e Blerjes të Mospërmbushjes nga QK-ja; ose
- (b) nëse para datës së Operacioneve Komerciale, shuma e llogaritur si më poshtë:

UnpaidDebt *BreakFees* *Pr eCODEquity* *GOKAF* – *ExcludedUnpaidDebt*
 – *Insurance* – *Overhaul* – *Cleanup* – *CDF* – *RsrvAccts*

“Çmimi i Blerjes në Fund të Afatit” llogaritet si më poshtë:

€100 *AmountsOuts* tan *ding* *GOKAF*
– *Overhaul* – *Cleanup* – *CDF* – *RsrvAccts*

Në çdo rast kur:

UnpaidDebt

nënkupton shumën e plotë të të gjithë principalit dhe interesit të papaguar në bazë të Dokumenteve të Financimit të dorëzuara në QK në pajtim me Seksionin 3.4.1 të Marrëveshjes (i ndryshuar ose i zëvendësuar me Dokumentet e Financimit të Reja sipas çdo Rifinancimi të ndërmarrë në përputhje me Seksionin 3.4.1(c) të Marrëveshjes, duke përfshirë edhe në lidhje me Instrumentin e Kapitalit Punues);

BreakFees

do të thotë shuma e plotë e çdo pagese të parapagimit, kostot e kurdisjes, kostot e ndërprerjes së mbrojtjes ose pagesat e ngjashme që paguhet nga Huadhënësit në përputhje me Dokumentet e Financimit të dorëzuara në QK në pajtim me Seksionin 3.4.1 të Marrëveshjes (i ndryshuar ose i zëvendësuar me Dokumentet e Financimit të Reja sipas çdo Rifinancimi të ndërmarrë në përputhje me Seksionin 3.4.1(c) të Marrëveshjes, duke përfshirë edhe në lidhje me Instrumentin e Kapitalit Punues);

ExcludedUnpaidDebt

do të thotë çdo *UnpaidDebt* ose *BreakFees* që është i lidhur me shumat që janë Përfshirë Tarifore siç është përcaktuar në Kalendarin 1 (*Tarifa*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, ose që nuk është paguar nga GenCo kur është e nevojshme në përputhje me Dokumentet e Financimit për arsye të tjera nga një Ngjarje e Mospërmbushjes nga KEKR-ja siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë;

GOKDfltEqtyAmt

do të thotë shuma e përcaktuar në Tabelën e Ndërprerjes së Dakorduar në Kolonën F të fletës së "Tabelës së Ndërprerjes" (*Pagesa e Ndërprerjes e Mospërmbushjes nga QK-ja*) të Modelit Financiar të Rastit Bazë dhe në Rreshtin e zbatueshëm deri në datën kur kjo Marrëveshje është ndërprerë në përputhje me Seksionin 19.2 të kësaj Marrëveshjeje;

FMEqtyAmt

do të thotë shuma e përcaktuar në Tabelën e Ndërprerjes së Dakorduar në Kolonën E të fletës së "Tabelës së Ndërprerjes" (*Pagesa e Ndërprerjes për Forcë Madhore*) të Modelit Financiar të Rastit Bazë dhe në Rreshtin e zbatueshëm deri në datën kur kjo Marrëveshje ndërpritet në përputhje me Seksionin 24.11 *E drejta për Ndërprerje pas një Ngjarjeje Tjetër të Forcës Madhore*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë ose ndonjë Marrëveshje e Projektit ndërpritet në përputhje me kushtet e saj pas Datës së Bartjes pas një Ngjarjeje Tjetër të Forcës Madhore;

Insurance

nënkupton çdo të ardhur nga sigurimi që i detyrohet ose i paguhet GenCo-së (ose që do të ishte detyruar ose paguar në atë masë që GenCo kishte mbajtur sigurimin siç kërkohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) pas Ngjarjes së Forcës Madhore, dhe që nuk është shpenzuar nga GenCo për riparimin dhe restaurimin e Objektivit të TCKR-së ose që përdoret për të paguar principalin e papaguar ose kostot e tjera siç kërkohet në Dokumentet e Financimit;

Overhaul

nënkupton çdo reduktim të çmimit të blerjes pas një auditimi të mirëmbajtjes në përputhje me Seksionin 5.1(b) të Kalendarit 4, me Kalendarin 3 -

përfundim të masës në të cilën çdo send i identifikuar në auditimin e mirëmbajtjes është ose do të përmirësohet nga GenCo para Datës së Blerjes ose është subjekt i të ardhurave të sigurimit të paguara siç është paraqitur më sipër, (ii) për çdo send të identifikuar në auditimin mjedisor në përputhje me Seksionin 6.1(b) të Kalendarit 4, dhe (iii) në lidhje me çdo send që kërkon riparimin për shkak të ndodhjes së një Veprimi ose Mosveprimi të një NP-je të Specifikuar, Ngjarje të Forcës Madhore Politike, Ndryshimi në Ligj, Ngjarje të Forcës Madhore të Ujit të Papërpunuar ose Ndryshimi në Cilësinë e Ujit të Papërpunuar;

Cleanup

nënkupton çdo reduktim të çmimit të blerjes pas një auditimi mjedisor në përputhje me Seksionin 6.1(b) të Kalendarit 4, me përfundim të masës në të cilën çdo send i identifikuar në auditimin mjedisor është ose do të përmirësohet nga GenCo përpara Datës së Blerjes ose është subjekt i të ardhurave të sigurimit të pagueshme (ose që do të ishte paguar nëse GenCo kishte kryer detyrimet e veta në lidhje me sigurimet sipas Marrëveshjeve të Projektit) siç është përcaktuar më lart; me kusht që, sidoqoftë, për shmangien e dyshimit, nuk do të ketë reduktim të tillë për (i) Kushtet e Specifikuara Mjedisore/Arkeologjike (siç përcaktohen në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) ose Kushtet Ekzistuese Mjedisore/Arkeologjike; dhe (ii) çdo send që kërkon riparimin për shkak të ndodhjes së një Veprimi ose Mosveprimi të një NP-je të Specifikuar, Kushti Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik, Ngjarjes së Forcës Madhore Politike, Ndryshimit të Ligjit, Ngjarjes së Forcës Madhore të Ujit të Papërpunuar ose Ndryshimi në Cilësinë e Ujit të Papërpunuar;

CDF

do të thotë shuma e mbetur që Sponsorin HoldCo nuk ka kontribuar në përmbushjen e detyrimit të Fondit për Zhvillim të Komunitetit siç është përcaktuar në Nenin 6 të Marrëveshjes për Mbështetjen e Sponsorit, dhe shuma e mbetur që GenCo nuk ka kontribuar siç parashikohet në Seksionin 10.1 të Marrëveshjes së Zbatimit; me kusht që, sidoqoftë, shuma e CDF do të jetë zero nëse Marrëveshja e Zbatimit është ndërprerë për shkak të një Ngjarjeje të Mospërmbushjes nga QK-ja (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Zbatimit) përpara përvjetorit të gjashtë (6) të Datës së Bartjes.

RsrvAccts

do të thotë mjetet në Llogarinë e Rezervës së Shërbimit të Borxhit, Shumat e Kapitalit Punues, Fondi i Rezervës së Mirëmbajtjes Madhore dhe çdo rezervë tjetër që është financuar nga pagesat e bëra nga KEKR sipas Marrëveshjes për Blerje të Energjisë që nuk aplikohet për të zvogëluar shumat që i detyrohen në përputhje me Dokumentet e Financimit.

GOKAF

nënkupton të gjitha Tarifatat e Lejuara të Këshilltarit të QK-së që janë paguar nga ose në emër të GenCo dhe nuk janë rimbursuar si pjesë e pagesave të tarifave në përputhje me Kalendarin 1 (*Tarifatat*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë (duke përfshirë shumat e përfshira në çdo variabël tjetër të përcaktuar në këtë Seksion 2.1).

AmountsOutstanding

nënkupton shumat e detyruara neto (pa ndonjë numërim të dyfishtë të zbritjeve) dhe të pagueshme nga GenCo ose nga ndonjë palë tjetër sipas Marrëveshjeve të Projektit që ende nuk i janë paguar palës së cilës i detyrohet që nga Data e Blerjes.

PreCODEquity

nënkupton shumën e Kapitalit Tarifor (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë), por me një kthim të llogaritur duke përdorur Kalendarin 5 -

Normën vjetore të Kthimit të Ekuitetit (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) që nga fillimi i Periudhës së Ndërtimit deri në datën e ndërprerjes në pajtim me Kushtin Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik në pajtim me Nenin 15 (*Sanimi Mjedisor*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë.

2.2 Ndikimi i Shkeljes

Çdo shumë e kompensimit e llogaritur sipas këtij Kalendarit 3 do të llogaritet për të përjashtuar efektet e shkeljes së një Marrëveshjeje të Projektit nga QK-ja, KESCO ose ndonjë NP e Specifikuar në rast të pagesës së Çmimit të Blerjes të Mospërbushjes nga QK-ja dhe efektet e shkeljes së një Marrëveshjeje të Projektit nga GenCo në rast të pagesës së Çmimit të Blerjes të Mospërbushjes nga GenCo-ja.

Kalendari 4 Aranzhimet e Blerjes

Neni 1 Hyrje

1.1 Hyrje

Ky Kalendar 4 përshkruan procedurat që duhet të zbatohen kur Objekti i TCKR-së i bartet QK-së në pajtim me Nenin 20 të Marrëveshjes.

Neni 2 Përkufizimet

2.1 Përkufizimet

Termtat me shkronjë të madhe të përdorura por jo të përcaktuara në këtë Kalendar 4 do të kenë kuptimin që u është dhënë në trupin e Marrëveshjes. Kudo që paraqiten shprehjet e mëposhtme në këtë Kalendar 4, ato do të kenë kuptimet e mëposhtme.

“Kontabilistët” – Ka kuptimin e dhënë në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë.

“Kontratat e Caktuara” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 3.1(b).

“Blerje e Mbylljes” - Ka kuptimin e dhënë në Seksionin 8.1.

“Data e Blerjes” - Dita që ndodh gjashtëdhjetë (60) Ditë pas datës së ndërprerjes, ose nëse Dita e tillë nuk është Ditë Pune, në Ditën e ardhshme të Punës, ose datën e mëparshme ose të mëvonshme siç mund të jetë dakord midis GenCo dhe QK-së.

“Çmimi i Blerjes” - Shuma e pagueshme nga QK në lidhje me Blerjen siç është vërtetuar nga Kontabilistët në përputhje me Nenin 7 dhe duke qenë:

- (a) Çmimi i Blerjes i Mospërbushjes nga GenCo-ja, nëse Objekti i TCKR-së është duke u bartur në pajtim me Seksionin 20.1 të Marrëveshjes;
- (b) Çmimi i Blerjes i Mospërbushjes nga QK-ja, nëse Objekti i TCKR-së është duke u bartur në përputhje me Seksionet 20.2 ose 20.3 të Marrëveshjes;
- (c) Çmimi i Blerjes i Forcës Tjetër Madhore, nëse Objekti i TCKR-së është duke u bartur në pajtim me Seksionin 20.4 të Marrëveshjes; ose
- (d) Çmimi i Blerjes i Ndërprerjes Mjedisore, nëse Objekti i TCKR-së është duke u bartur sipas Seksionit 20.5 të Marrëveshjes.

“Kërkesat në Pritje të Sigurimit” - Kërkesa në pritje dhe të papaguara nga Data e Blerjes, dhe kërkesa që GenCo ka të drejtë të bëjë, por nuk i ka bërë në Datën e Blerjes, sipas çfarëdo police sigurimi që ka të bëjë me Objektin e TCKR-së, në çdo rast për sa kohë që kërkesat e tilla kanë të bëjnë me humbjen fizike ose dëmin që ndodh para Datës së Blerjes, përveç rastit kur Humbja ose dëmtimi është korrigjuar para Datës së Blerjes me koston e GenCo-së.

Neni 3 Fushëveprimi i Blerjes

3.1 Fushëveprimi i shitjes

- (a) Në Datën e Blerjes, GenCo do t'i caktojë QK-së ose të caktuarit të saj të gjitha të drejtat, titullin Kalendar 5 -

dhe interesin e tij në vijim dhe QK-ja ose i caktuari i saj do të ketë të drejtat për Objektivin e TCKR-së dhe si më poshtë:

- (i) Objekti i TCKR-së;
 - (ii) të gjitha regjistrat, shënimet dhe dokumentet e tjera që kanë të bëjnë ekskluzivisht me Objektivin e TCKR-së; (iii) Lokacionin; dhe
 - (iv) çdo pajisje, makineri, materiale, pasuri të paluajtshme, interesa në pasuri të paluajtshme, pronë intelektuale, interesa në pronën intelektuale ose në prona të tjera të çfarëdo lloji që janë në pronësi ose me qira nga GenCo ose në të cilat GenCo përndryshe mban një interes ligjor ose përfitues dhe janë përdorur nga GenCo për të gjeneruar energji elektrike, për të ndërmarrë punët e interkoneksionit, ose për të përmbushur detyrimet e veta sipas Marrëveshjeve të Projektit.
- (b) Përveç kësaj, në rast se ndodh një Blerje sipas këtij Kalendarit 4, atëherë në Datën e Blerjes GenCo do të dorëzojë, caktojë, përtërijë ose bartë (në përputhje me Seksionin 4.2) QK-së ose të caktuarit të saj të gjitha të drejtat, titullin dhe interesin për dhe në kontratat në vijim ("**Kontratat e Caktuara**"):
- (i) Kontratat e Ndërtimit/Mirëmbajtjes të ndryshme nga Kontrata e OM-së dhe Marrëveshja e Shërbimeve Administrative;
 - (ii) Marrëveshjet e Projektit të ndryshme nga Marrëveshja për Blerjen e Energjisë, Marrëveshja e Zbatimit, Marrëveshja për Mbështetjen e Sponsorit, Garancia Qeveritare dhe Garancia e Sponsorit Sipëror (për aq sa çdo marrëveshje e tillë është ende në fuqi dhe efektive);
 - (iii) çdo kontratë dhe Pëlqim për furnizimin e GenCo me Derivat të Naftës, Amoniak ose Gur Gëlqeror (secili siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) e prokuruar në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë,
 - (iv) të gjitha kontratat e tjera që kanë të bëjnë me funksionimin dhe mirëmbajtjen e Projektit Kosova e Re dhe të kërkuara në mënyrë të arsyeshme për funksionimin dhe mirëmbajtjen e Objektivit të TCKR-së dhe të prokuruar në përputhje me kushtet e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; me kusht që, sidoqoftë, në rast se Blerja lind si rezultat i ndonjë mospërmbushje nga GenCo, Sponsorit Sipëror, apo Sponsorit HoldCo sipas çdo Marrëveshje të Projektit, QK-ja do të ketë të drejtën të refuzojë caktimin e ndonjë marrëveshjeje të tillë,

në çdo rast, nga dhe pas Datës së Blerjes, sipas marrëveshjeve të arsyeshme dhe zakonore të përtëritjeve midis Palëve dhe palëve përkatëse të Marrëveshjeve të Projektit.

- (c) nuk do të kërkohej që GenCo të dorëzojë ose bartë sa vijon:
- (i) Kontratën e OM-së;
 - (ii) Marrëveshjen e Shërbimeve Administrative;
 - (iii) paratë e gatshme dhe në çdo llogari ose depozitë të mbajtur nga ai ose në emër të vet (ose nga Huadhënësit ose në emër të tyre);
 - (iv) borxhet komerciale dhe ato të arkëtueshme që mblidhen për GenCo përpara Datës së Blerjes, por të papaguara; dhe
 - (v) përfitimi i kërkesave të garancive, garancive, kushteve, dëmshpërblimeve dhe policave të sigurimit, pavarësisht nga ngjarjet që ndodhin ose rrethanat që lindin përpara Datës së Blerjes, përveç çdo kërkesë të papaguar të sigurimit dhe çdo kërkesë të papaguar sipas garancive, kushteve dhe dëmshpërblimeve, deri në masën që këto kanë të bëjnë me Humbjen fizike ose dëmtimin ose defektet në Objektivin e TCKR-së që ndodhin përpara Datës së Blerjes, por që mbeten të papaguara.

Neni 4 Termet dhe Kushtet e Blerjes

4.1 Garancitë

Asnjë garanci (e shprehur ose e nënkuptuar) në lidhje me gjendjen e pronës dhe asetëve të përmendura në Seksionin 3.1 nuk do të jepet në Datën e Blerjes; me kusht që, sidoqoftë, pa paragjykuar përgjithësinë e Seksionit 3.1, GenCo pranon t'i caktojë QK-së në Mbylljen e Blerjes përfitimet e çdo garancie të dhëna nga palët e treta në lidhje me çdo pronë ose aset të bartur që janë të vlefshme në Ditën pas Datës së Blerjes deri në masën që ofruesi i një garancie të tillë ose bie dakord për këtë caktim ose është i detyruar ligjërisht të pranojë një caktim të tillë dhe në atë masë që garancitë e tilla nuk përjashtohen sipas dispozitave të Seksionit 3.1(c)(v).

4.2 Shpërndarja e Detyrimeve

- (a) Përveç nëse parashikohet ndryshe në Marrëveshje, GenCo do të jetë përgjegjës për:
- (i) të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë në lidhje me Objektin e TCKR-së; dhe
 - (ii) përmbushjen e të gjitha detyrimeve sipas marrëveshjeve me palët e treta në lidhje me Objektin e TCKR-së
- që janë grumbulluar para Datës së Blerjes.
- (b) Përveç nëse parashikohet ndryshe në Marrëveshje, QK-ja do të jetë përgjegjëse për:
- (i) të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë në lidhje me funksionimin e Objektivit të TCKR-së; dhe
 - (ii) të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë në lidhje me të gjitha marrëveshjet me palët e treta që janë bartur në përputhje me këtë Kalendar 4,
- që janë grumbulluar nga dhe pas Datës së Blerjes.

Pas Datës së Blerjes, secili prej GenCo dhe GOK do të dëmshpërblejë dhe mbajë tjetrin plotësisht dhe efektivisht të dëmshpërblyer ndaj të gjitha detyrimeve, kërkesave, pretendimeve, veprimeve, procedurave, dëmeve, kostove dhe shpenzimeve që rrjedhin si rezultat i të gjitha detyrimeve dhe obligimeve të tilla që janë përgjegjësia e tyre përkatëse sipas Seksionit 4.2(a) dhe Seksionit 4.2(b), por në asnjë rast QK-ja ose GenCo ose ndonjë Palë e QK-së ose ndonjë Palë e GenCo nuk do të dëmshpërblehen në atë masë që humbjet janë shkaktuar nga neglizhenca e tyre ose sjellja e pahijshme me paramendim ose shkelja e kushteve të kësaj Marrëveshjeje ose ndonjë Marrëveshjeje të Projekti, dhe në asnjë rast QK-ja ose GenCo-ja ose ndonjë Palë e QK-së ose ndonjë Palë e GenCo-së nuk do të dëmshpërblehen për asnjë Humbje deri në masën që kjo Palë ka marrë tashmë të ardhura nga sigurimet ose të ardhurat nga një palë e tretë për këtë, ose ka marrë apo ka pasur të drejtë për pagesa nga QK-ja ose një NP e Specifikuar sipas një Marrëveshjeje tjetër të Projektit për të.

Detyrimet e dëmshpërblimit të çdo Pale në vijim do të zvogëlohen në shumën dhe në lidhje me çdo rikuperim të sigurimeve ose rikuperime të tjera të palëve të tretë nga një Palë e dëmshpërblyer për Humbjet e dëmshpërblyera sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse një palë bën pagesa në përputhje me detyrimet e veta të dëmshpërblimit në lidhje me shumat për të cilat një siguroes ose një palë tjetër e tretë mund të jetë ligjërisht përgjegjëse, kjo Palë do të konsiderohet, në masën e duhur, subrogati me ekuitet i Palës së dëmshpërblyer dhe/ose i caktuari kontraktual ose ligjor në lidhje me të drejtën për të ndjekur rikuperimin e shumave të tilla nga siguroesi ose pala e tretë, deri në masën e këtyre të drejtave.

Për shmangien e dyshimit, kushtet e kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohen për të zvogëluar, dëmtuar, mohuar, modifikuar ose zëvendësuar kushtet e çdo police të sigurimit të aplikueshme që gjithashtu siguron mbulim për Humbjet e dëmshpërblyera. Pavarësisht nga sa më sipër, zbatueshmëria e ndonjë police sigurimi ose dështimi i një siguroesi për të përmbushur detyrimet e veta në lidhje me Humbjen e dëmshpërblyer nuk do të justifikojë, shtyjë ose zvogëlojë detyrimet e Palës dëmshpërblyese në asnjë aspekt, as nuk do të justifikojnë mospërmbushjen e detyrimeve të dëmshpërblimit të Palës së tillë; sidoqoftë, në përcaktimin e detyrimeve përkatëse ndërmjet Palës dëmshpërblyese dhe çdo siguroesi, pas Kalendarit 5 -

pagesave të një Pale në përputhje me detyrimet e veta të dëmshpërblimit, si dhe në lidhje me çdo kontest ndërmjet Palës së tillë dëmshpërbllyese dhe siguruesit të tillë, sa i përket detyrimit të siguruesit për të rimbursuar Palën dëmshpërbllyese ose përndryshe të sigurojë mbulim për Humbje të dëmshpërbllyer, çdo sigurim i aplikueshëm (me përjashtim të të gjitha zbritjeve ose mbajtjeve të zbatueshme) do të konsiderohet primar ndaj detyrimeve të dëmshpërblimit të përcaktuar këtu, dhe detyrimet e dëmshpërblimit të përcaktuara këtu do të konsiderohen në mënyrë specifike si teprica nga çdo sigurim i tillë i aplikueshëm, por vetëm në masën e shumave të paguara në të vërtetë për të siguruarin sipas këtij sigurimi, dhe me kuptimin e mëtejshëm se Pala dëmshpërbllyese do të jetë në të gjitha rastet përgjegjëse për humbjen e dëmshpërbllyer, në masën e detyrimeve të veta të dëmshpërblimit, brenda çdo të zbritshme dhe mbajtje të aplikueshme të parashtruar në çdo sigurim të tillë të aplikueshëm.

- (c) Me përjashtim të rasteve të parashikuara në Marrëveshjet e Projektit, GenCo nuk do të ketë përgjegjësi dhe nuk do t'i ndahet ndonjë detyrim që ka lidhje me të gjitha Kushtet Mjedisore/Arkeologjike që ekzistojnë në Lokacion ose në ndonjë mënyrë tjetër në lidhje me Projektin Kosova e Re në Datën e Bartjes, duke përfshirë Kushtet e Specifikuara Mjedisore/Arkeologjike ose Kushtet Ekzistuese Mjedisore/Arkeologjike (siç janë përcaktuar secili në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë), duke u pranuar dhe është pajtuar që:
 - (i) çdo Kusht Mjedisor/Arkeologjik i zbuluar në Lokacion para datës tetëmbëdhjetë (18) Muaj pas Datës së Operacioneve Komerciale, do të supozohet se lidhet me kushtet që ekzistojnë në ose para Datës së Bartjes, dhe jo të ketë të bëjë me aktivitetet e GenCo-së, pa dëshmi se një Kusht i tillë Mjedisor/Arkeologjik është shkaktuar nga GenCo ose ndonjë Person nën kontrollin e GenCo-së.
 - (ii) pavarësisht nga çdo gjë në të kundërtën në Seksionin 4.2(c)(i), pas Datës së Operacioneve Komerciale, çdo Kusht Mjedisor në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo-së, në Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo-së ose në ndonjë deponi tjetër që mbahet nga GenCo, nëse ka, që është zbuluar dhe lidhet drejtpërdrejt me mbetjet që janë deponuar nga GenCo, do të supozohet të lidhen me aktivitetet e GenCo-së, dhe të mos lidhet me kushtet që ekzistojnë në ose para Datës së Bartjes; dhe
- (c) pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër që është e kundërta në ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit, (i) në asnjë rrethanë, GenCo ose ndonjë Person nën kontrollin e GenCo-së nuk mund të supozohet në çdo kohë që të ketë shkaktuar Kushte Arkeologjike në Lokacion (përfshirë Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo, Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo ose ndonjë deponi tjetër që mbahet nga GenCo), dhe (B) çdo Kusht i tillë Arkeologjik do të konsiderohet si një Kusht Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik pavarësisht nga data në të cilën është zbuluar ndonjë kusht i tillë.

4.3 Barrat

Çdo bartje tek QK-ja (ose i emëruari i saj) e Objektivit të TCKR-së do të jetë e lirë dhe e pastër nga të gjitha Barrat (përveç Barrave të Lejuara (GenCo)), përfshirë Barrat e vendosura në lidhje me kërkesat e sigurisë së Huadhënësit në lidhje me Objektivin e TCKR-së.

4.4 Modalitetet e Mbylljes

GenCo dhe QK bien dakord për të kryer bartjen ose dorëzimin e të drejtës, titullit dhe interesit të GenCo në dhe për Objektivin e TCKR-së dhe pagesën e Çmimit të Blerjes në mënyrë që të minimizohen kostot e transaksionit (duke përfshirë kostot e Palëve dhe kostot e transaksionit të palëve të treta) të një bartjeje ose dorëzimi të tillë.

Neni 5 Auditimi i Mirëmbajtjes

Kalendari 5 -

5.1 Ndërprerjet e Mirëmbajtjes

- (a) Brenda tridhjetë (30) Ditësh pas ndërprerjes së Marrëveshjes, GenCo do t'i japë QK-së raportin nga një inxhinier me reputacion dhe i kualifikuar, i cili është i pranueshëm për të dyja Palët (dhe në atë masë që Palët nuk mund të bien dakord, eksperti i emëruar nga Qendra Ndërkombëtare e ICC-së për Ekspertizë për procedurat ad hoc në përputhje me Rregullat e ICC-së për Ekspertizën për procedurat ad hoc) ose:
- (i) vërteton se nga data e raportit, Objekti i TCKR-së është në kushtet dhe gjendjen e riparimit dhe mirëmbajtjes të kërkuar nga Marrëveshjet e Projektit (duke përfshirë një inventar të përshtatshëm të pjesëve rezervë), së bashku me raportet e inspektimit, testet dhe të tjera të dhëna të mjaftueshme për të mbështetur konkluzionet e arritura në këtë raport; ose
 - (ii) në rast se nuk është kështu, duke ofruar një listë të mospërputhjeve dhe/ose mangësive në një gjendje të tillë (duke përfshirë çdo dëmtim madhor ose shkatërrim me humbje) dhe planin e rehabilitimit dhe vlerësimin e kostos së punës që kërkohet për të korrigjuar këto mospërputhje dhe mangësi sa më shpejt të jetë e mundur.
- (b) Nëse një raport i tillë përfshin një plan të sanimit, kostot e tyre (siç janë paraqitur në raportin e firmës konsulente, siç mund të përditësohen) për çdo dëmshpërblim që kërkohet të kryhet nga GenCo sipas Marrëveshjeve të Projektit, por nuk do të kryhet nga GenCo para Datës së Blerjes, do të zbritet nga çdo pagesë e detyruar ndaj GenCo-së në vijim, siç llogaritet në Kalendarin 3.
- (c) Kostot dhe shpenzimet e arsyeshme të auditimit të mirëmbajtjes mbulohen si më poshtë:
- (i) nëse Objekti i TCKR-së-së është duke u bartur sipas Seksionit 20.1 të Marrëveshjes, nga GenCo;
 - (ii) nëse Objekti i TCKR-së është duke u bartur sipas Seksionit 20.2 ose Seksionit 20.3 të Marrëveshjes, nga ana e QK-së; dhe
 - (iii) nëse Objekti i TCKR-së është duke u bartur në pajtim me Seksionin 20.4 ose Seksionin 20.5 të Marrëveshjes ose përndryshe, në mënyrë të barabartë ndërmjet Palëve.

Neni 6 Auditimi Mjedisor

6.1 Auditimi Mjedisor

- (a) Pa kufizuar të drejtën e QK-së për të kërkuar auditim sipas Seksionit 20.7 të kësaj Marrëveshjeje, brenda tridhjetë (30) Ditëve pas ndërprerjes të Marrëveshjes, GenCo do t'i ofrojë QK-së raportin e inspektimit nga një kompani e mirënjohur konsultuese mjedisore dhe e kënaqshme në formë të arsyeshme për të dyja Palët, (dhe në atë masë që Palët nuk mund të bien dakord, eksperti i emëruar nga Qendra Ndërkombëtare e ICC-së për Ekspertizë për procedurat ad hoc në përputhje me Rregullat e ICC-së për Ekspertizën për procedurat ad hoc) ose:
- (i) vërteton për QK-në se, që nga data e raportit, hetimi i saj nuk ka zbuluar Kushte Mjedisore/Arkeologjike të paraqitura tek, në ose nën Objektivin e TCKR-së, ose
 - (ii) nëse firma e tillë nuk mund të vërtetojë për shkak të pranisë së Kushteve Mjedisore/Arkeologjike, duke ofruar një listë që identifikon Kushtet Mjedisore/Arkeologjike të pranishme dhe shtrirjen e ndotjes në detaje të arsyeshme dhe kostot e vlerësuara për të sanuar në mënyrë efektive këtë kontaminim, dhe duke ofruar planin e reagimit sanues dhe mbulimin e çështjeve të tjera mjedisore, siç do të kërkojë QK-ja në formë të arsyeshme me shkrim;

Me kusht që, sidoqoftë, raporti i inspektimit mjedisor nuk do të përfshijë asnjë prej Kushteve të Specifikuara Mjedisore/Arkeologjike (siç përcaktohet në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë).

- (b) Nëse raporti i firmës konsulente përfshin një plan përgjigjeje sanuese, kostot e tij (siç janë Kalendarin 5 -

paraqitur në raportin e firmës konsulente, siç mund të përditësohen) për çdo dëshmipërblim që kërkohej të kryhet nga GenCo sipas Marrëveshjeve të Projektit, por nuk do të kryhet nga GenCo përpara Datës së Blerjes, do të zbriten nga çdo pagesë që i detyrohet GenCo-së në vijim, siç llogaritet në Kalendarin 3; me kusht që, sidoqoftë, për shmangien e dyshimit, nuk do të ketë reduktim të tillë për (i) Kushtet e Specifikuara Mjedisore/Arkeologjike (siç përcaktohen në Marrëveshjen për Blerje të Energjisë) ose Kushtet Ekzistuese Mjedisore/Arkeologjike; dhe (ii) çdo send që kërkon riparimin për shkak të ndodhjes së një Veprimi ose Mosveprimi të një NP-je të Specifikuar, Kushti Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik, Ngjarjes së Forcës Madhore Politike, Ndryshimit të Ligjit, Ngjarjes së Forcës Madhore të Ujit të Papërpunuar ose Ndryshimi në Cilësinë e Ujit të Papërpunuar. Kuptohet dhe dakordohet që ky Seksion 6.1(b) nuk do të zvogëlojë në asnjë mënyrë të drejtën e GenCo-së për dëshmipërblim sipas ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit në lidhje me kostot dhe detyrimet mjedisore.

- (c) Kostot dhe shpenzimet e arsyeshme të auditimit mjedisor janë si më poshtë:
- (i) nëse Objekti i TCKR-së-së është duke u bartur sipas Seksionit 20.1 të Marrëveshjes, nga GenCo;
 - (ii) nëse Objekti i TCKR-së është duke u bartur sipas Seksionit 20.2 ose Seksionit 20.3 të Marrëveshjes, nga ana e QK-së; dhe
 - (iii) nëse Objekti i TCKR-së është duke u bartur në pajtim me Seksionin 20.4 ose Seksionin 20.5 të Marrëveshjes ose përndryshe, në mënyrë të barabartë ndërmjet Palëve.

Neni 7

Llogaritja dhe Verifikimi i Çmimit të Blerjes; Kompensimi

7.1 Llogaritja dhe Verifikimi i Çmimit të Blerjes

- (a) GenCo do të dorëzojë një deklaratë për Kontabilistët brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve pas ndërprerjes të përcaktuar nga një përcaktim i përkohshëm i Çmimit të Blerjes që duhet të paguhet në lidhje me Blerjen.
- (b) Kontabilistët janë përgjegjës për shqyrtimin e përcaktimit të përkohshëm të Çmimit të Blerjes nga ana e GenCo-së dhe brenda pesëmbëdhjetë (15) Ditëve pas marrjes së një përcaktimi të tillë ose brenda një periudhe më të gjatë kohore që Kontabilistët kërkojnë në mënyrë të arsyeshme, lëshojnë një certifikatë për GenCo (me një kopje për QK-në) duke konfirmuar ose:
- (i) që Çmimi i Blerjes i përcaktuar aty është përcaktuar siç duhet; ose
 - (ii) nëse, sipas mendimit të tyre, nuk është përcaktuar siç duhet, përcaktimi i Çmimit të Blerjes nga vetë Kontabilistët.
- (c) Kontabilistët veprojnë si ekspertë dhe jo si arbitra. Kostot dhe shpenzimet e arsyeshme të Kontabilistëve do të mbulohen si më poshtë:
- (i) nëse Objekti i TCKR-së-së është duke u bartur sipas Seksionit 20.1 të Marrëveshjes, nga GenCo;
 - (ii) nëse Objekti i TCKR-së është duke u bartur sipas Seksioneve 20.2 ose 20.3 të Marrëveshjes, nga ana e QK-së; dhe
 - (iii) nëse Objekti i TCKR-së është duke u bartur në pajtim me Seksionin 20.4 ose Seksionin 20.5 të Marrëveshjes, në mënyrë të barabartë ndërmjet Palëve.
- (d) Kontabilistët kanë të drejtë të kenë qasje në ambientet e GenCo dhe në regjistrat, shënimet dhe dokumentet e tjera të GenCo-së për qëllimet e kryerjes së shqyrtimit të tyre, dhe me kërkesën e Kontabilistëve secila Palë do të sigurojë të gjitha dokumentet dhe informacionin, siç mund ta kërkojnë Kontabilistët për qëllimet e funksioneve të tyre sipas këtij Neni 7.

7.2 Kompensimi i Shumave të Tjera të Detyruara

- (a) Nëse GenCo, Sponsorit HoldCo ose Sponsorit Sipëror nuk paguajnë ndonjë shumë që i detyrohet QK-së ose ndonjë NP-je të Specifikuar sipas Marrëveshjes së Projektit, shuma e tillë do të zbritet nga Çmimi përkatës i Blerjes, duke përfshirë çdo shumë të pagueshme sipas Seksionit 3.3.7 (*Procesi i Pajtimit të Mbylljes*) të Kalendarit 1 (*Tarifa*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë ose sipas Seksionit 3.5 (*Procesi i Pajtimit të Mbylljes*) të Kalendarit 1 (*Metodologjia për Vendosjen e Çmimit të Linjtit*) të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit.
- (a) Nëse QK ose ndonjë NP e Specifikuar nuk paguan shumën që i detyrohet GenCo, Sponsorit HoldCo ose Sponsorit Sipëror sipas Marrëveshjes së Projektit, shuma e tillë do të zbritet nga Çmimi përkatës i Blerjes, duke përfshirë çdo shumë të pagueshme sipas Seksionit 3.3.7 (*Procesi i Pajtimit të Mbylljes*) të Kalendarit 1 (*Tarifa*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë ose sipas Seksionit 3.5 (*Procesi i Pajtimit të Mbylljes*) të Kalendarit 1 (*Metodologjia për Vendosjen e Çmimit të Linjtit*) të Marrëveshjes për Furnizim me Linjit.

Neni 8 Mbyllja e Blerjes

8.1 Mbyllja

Mbyllja e shitjes dhe bartja e Objektivit të TCKR-së ("**Mbyllja e Blerjes**") do të bëhet në Datën e Blerjes në vend të tillë në Kosovë dhe, në kohë të tillë që QK-ja mund të njoftojë në mënyrë të arsyeshme GenCo-në, dhe ky njoftim duhet të jepet jo më vonë se ora 10:00 e Ditës së pestë (5) të Punës para Datës së Blerjes.

8.2 Dorëzimet

Në Mbylljen e Blerjes, GenCo do të japë ose do t'i vërë në dispozicion QK-së ose të caktuarit të saj:

- (a) bartje, transferime, akte noteriale, caktime, novacione dhe dokumente të tjera (të vulosura ose të nënshkruara si akte nga GenCo dhe QK-ja, nëse kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga GenCo) së bashku me dokumentet përkatëse të titullit, siç mund të kërkojë QK-ja në mënyrë të arsyeshme që të zbatohet kërkesat e Seksionit 3.1 dhe t'i japë QK-së përfitim të plotë të pronës dhe pasurive të përmendura në të, dhe do të lejojë që QK-ja të hyjë dhe të marrë në posedim Objektivin e TCKR-së; dhe
- (b) posedimi i Objektivit të TCKR-së.

8.3 Pagesa e Çmimit të Blerjes

- (a) Sipas pajtueshmërisë nga GenCo me dispozitat e Seksionit 8.2, QK-ja do të bëjë që Çmimi i Blerjes të paguhet në Euro në çdo llogari bankare të nominuar nga GenCo (në Kosovë ose jashtë shtetit) së paku tre (3) Ditë Pune para në datën e propozuar për Mbylljen e Blerjes; me kusht që, sidoqoftë, QK-ja të mundet që në emër të GenCo-së të japë çdo pjesë të Çmimit të Blerjes deri në një shumë të barabartë me çdo *UnpaidDebt* dhe/ose *BreakFees* të llogaritur sipas Kalendarit 3 drejtpërdrejt për çdo Huadhënës ose palë tjetër të cilës i detyrohet një vlerë e tillë.
- (b) Nëse çdo Tatim do të vendoset ose do të mbahet nga pagesat që do të bëhen nga QK tek GenCo në vijim në lidhje me një bartje tek QK-ja, atëherë pagesat e tilla për GenCo do të rriten me një shumë të tillë që GenCo do të marrë të njëjtën shumë që do të kishte marrë sikur Tatimi i tillë të mos ishte vendosur ose mbajtur për Objektivin e TCKR-së.

Kalendari 5
Forma e Marrëveshjes së Qiradhënies

MARRËVESHJA E ZONËS SË KYÇJES
NË LIDHJE ME PROJEKTIN KOSOVA E RE

KJO MARRËVESHJE E QIRADHËNIES SË ZONËS SË KYÇJES (kjo "Marrëveshje") është lidhur më

_____, 20__ ("**Data e Ekzekutimit**") nga dhe ndërmjet:

- (1) Republikës së Kosovës që vepron përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ("**QK**"); dhe
- (2) [_____] ("**GenCo**"), një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar sipas ligjeve të Kosovës, me zyrën e saj kryesore në Rr. Garibaldi, Nr. 3, 10000 Prishtinë, Kosovë.

Veçmas, QK-ja dhe GenCo janë të referuara më poshtë si "**Pala**" dhe, së bashku si "**Palët**".

RECITALET

- A. QK-ja ka për qëllim të përfshijë sektorin privat në një projekt të infrastrukturës nga linjiti në energji elektrike që përfshin zhvillimin, projektimin, ndërtimin, financimin, posedimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e Objektivit të TCKR-së dhe rehabilitimin e Lokacionit (siç përcaktohet më poshtë) nga GenCo-ja ("**Projekti Kosova e Re**");
- B. QK-ja pritet të bëhet pronar i pronës së paluajtshme dhe i të drejtave në pronën e paluajtshme të përshkruar në Aneksin 1, ose që përndryshe do të identifikohet me blerjen e QK-së në përputhje me Seksionin 3.5 të Marrëveshjes së Zbatimit ("**Pronësia Fillestare**");
- C. QK-ja, herë pas here, në pajtim me Seksionin 3.5 të Marrëveshjes së Zbatimit, mund të fitojë pasuri të paluajtshme ose të drejta shtesë në pronën e paluajtshme ("**Pasuritë Shtesë**") të kërkuara nga GenCo për qëllime të ndërmarrjes së Punimeve të Kyçjes së GenCo-së; dhe
- D. QK dëshiron t'i japë me qira GenCo-së të gjithë Pronën Fillestare dhe Pronën Shtesë, dhe GenCo dëshiron të japë me qira të gjithë Pronën Fillestare dhe Pronën e Shtesë nga QK-ja, në përputhje me premtimet dhe kompetencat e nënkuptuara sipas Ligjeve të Kosovës dhe premtimet dhe kushtet e përcaktuara më poshtë;

TANI, PRANDAJ, për dhe në konsideratë të premtimeve dhe marrëveshjeve të ndërsjella të përmbajtura në këtë dokument, dhe që synojnë të jenë detyruese ligjërisht, Palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Qiradhënia; Qiraja

1.1 Qiradhënia; Qiraja

Duke marrë parasysh pagesën e qirasë prej një euro (1 euro) çdo vit nga GenCo për QK-në ("**Qiraja**"), QK-ja bie dakord t'i japë me qira GenCo-së dhe t'i japë posedimin e Pronës Fillestare që do të blihet në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Zbatimit dhe Pronën Shtesë që do të fitohen nga data përkatëse dhe në vazhdim të Afatit.

1.2 Afati i Qiradhënies

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi të plotë nga dhe pas Datës së Ekzekutimit deri në gjashtë (6) Muaj pas dekomisionimit të përhershëm të asetëve të kyçjes (periudha e tillë, "**Afati**").

1.3 Njohja e Qirasë së Vitit të Parë; Koha e Pagesave të Qirasë

- (a) Në ose para ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, Qiraja për Vitin e Parë është paguar nga GenCo tek QK, që është pranuar nga QK-ja me anë të ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje.

Kalendari 5 -

- (b) Qiraja për Vitet e mëvonshme do të paguhet në çdo përvjetor të kësaj Marrëveshjeje dhe mund të paguhet paraprakisht.

Neni 2 **Premtimet e GenCo-së**

2.1 Premtimet e GenCo-së

GenCo i premtun QK-së si vijon:

- (a) të paguajë Qiranë vjetore të rezervuar këtu;
- (b) të paguajë të gjitha tatimet, detyrimet dhe daljet, qoftë të vendosura, të ngarkuara, të tatuara dhe të vlerësuara tani ose në vijim, që janë të pagueshme në lidhje me Pronën Fillestare dhe Pronën Shtesë ose sipas përmirësimeve të ngritura mbi to, sipas rastit;
- (c) të përdorë Pronën Fillestare dhe Pronën Shtesë për qëllimet e ndërmarrjes së Punimeve të Kyçjes së GenCo-së, si dhe përdorime të tjera ndihmëse për to dhe përndryshe të lidhura me Projektin Kosova e Re, duke përfshirë:
- (i) rrënimin e ndërtesave ekzistuese dhe shërbimeve të tjera;
 - (ii) lirimimin e Pronës Fillestare dhe të Pronës Shtesë nga kulturat bujqësore, bimësia, bagëtitë dhe kafshët e tjera;
 - (iii) magazinimin e pajisjeve të ndërtimit dhe ruajtjen e gazit, eksplozivëve dhe materialeve të tjera të rrezikshme, siç lejohet nga Ligjet e Kosovës;
 - (iv) ndërtimin e ndërtesave, rrugëve, shtyllave, zonave të magazinimit dhe objekteve të tjera të përhershme ose të përkohshme;
 - (v) transportimin e pajisjeve ndërtimore, punëtorëve dhe materialeve;
 - (vi) gërmimet, mbushjet, kompaktimi, shpërthimet, përdorimin e çarësve hidraulikë, grumbullimin e fletëve, hapjen e hapësirave, punimet e kullimit, nivelimin, punimet e betonit, shtrëngimin, kapjen, testimin, punimet e montimit, përdorimin e pajisjeve të saldimit, vinçave, mjeteve pneumatike dhe hidraulike;
 - (vii) energjizimi i pajisjeve, vinçave, veglave pneumatike dhe hidraulike, (viii) energjizimi i pajisjeve elektrike;
 - (ix) të lejojë efektet e Seksioneve (i) deri (viii);
 - (x) të drejtën e përdorimit ose deponimit të ujit, shkëmbit, zhavorrit, mineraleve, drurit, argjilës, murrimit, rërës, gurit ose ndonjë burimi tjetër natyror, në secilin rast siç është e lejuar nga Ligjet e Kosovës; dhe
 - (xi) çdo përdorim tjetër që lejohet nga kushtet e Licencës për Gjenerim ose Ligjet e Kosovës;
- (d) përveç siç përshkruhet në Seksionin 2.1(b), do të ruajë dhe mbajë Pronën Fillestare dhe Pronën Shtesë dhe të gjitha përmirësimet dhe zhvillimet në të, si dhe çdo ndërtesë dhe shërbime të tjera (nëse ka) që mbeten pas ndërtimit sipas Seksionit 2.1(b) në gjendje të mirë dhe të banueshme, dhe do t'ia dorëzojë Pronën Fillestare dhe Pronën Shtesë në fund të Afatit në gjendje të përdorshme, duke përjashtuar konsumimin e arsyeshëm, por pa nevojën për të hequr ndonjë ndërtesë ose struktura të përhershme ose objekte të vendosura aty;
- (e) të jetë në pajtim me ligjet e Kosovës në lidhje me përdorimin e Pronës Fillestare dhe Pronës Shtesë; dhe
- (f) t'u lejojë bartësve të tokave fqinje që të lidhen me shërbimet në Pronën Fillestare dhe Pronën Shtesë për zhvillimin dhe gëzimin e një toke të tillë, deri në atë masë që lidhja, përdorimi ose kënaqësia nga toka e afërt nuk do ndikojë ose nuk ka arsye të arsyeshme të ndikojë në përdorimin

ose realizimin e të drejtave dhe përfitimeve ose kostove ose detyrimeve të GenCo-së në lidhje me Pronën Fillestare ose Pronën Shtesë (duke përfshirë rritjen e rrezikut ose kostos ose detyrimin ndaj GenCo-së ose çdo ceduesi të të drejtave sipas kësaj Marrëveshjeje për qasjen e pronarëve të tillë) të përshkruar në Seksionin 2.1(b).

Neni 3 Premtimet e QK-së

3.1 Premtimet e QK-së

QK-ja i premtton GenCo-së, që për sa kohë GenCo-ja paguan qiranë, rezervon dhe kryen dhe respekton premtimet dhe përcaktimet që përmbahen këtu, do të mbajë, në paqe dhe në heshtje, dhe do të gëzojë Pronën Fillestare dhe Pronën Shtesë gjatë Afatit pa ndonjë ndërprerje, shqetësim ose ngacmim nga ana e QK-së ose ndonjë Personi që pretendon me të drejtë sipas QK-së.

Neni 4 E drejta e Rivendosjes

4.1 E drejta e Rivendosjes

(a) Sipas Seksionit 4.1 (b), në rast se:

- (i) pagesa e Qirasë ose pagesa tjetër e detyruar ose ndonjë pjesë e saj do të jetë në vonesë për një periudhë prej nëntëdhjetë (90) Ditësh pas datës së caktuar; ose
- (ii) çdo shkelje, mospërmbushje ose mosrespektim nga GenCo e ndonjë prej premtimeve që përmban kjo Marrëveshje dhe që duhet të kryhet nga ana e vet dhe që është vëzhguar të ketë ndodhur,

atëherë QK-ja në cilëndo kohë mund të rivendosë në dhe mbi Pronën Fillestare dhe Pronën Shtesë ose ndonjë pjesë të saj dhe Afati i krijuar këtu do të ndërpritet.

(b) E drejta për të ndërprerë këtë qiradhënie dhe për të rivendosur mund të ushtrohet vetëm nga QK-ja, nëse QK-ja:

- (i) së pari ka shërbyer një njoftim zyrtar për GenCo-në duke e njoftuar GenCo-në për ndonjë nga shkeljet e specifikuar në Seksionin 4.1(a)(i) dhe 4.1(a)(ii), dhe duke kërkuar nga GenCo të korrigjojë këtë shkelje dhe GenCo ka dështuar ta korrigjojë shkeljen e tillë brenda nëntëdhjetë (90) Ditëve pas datës së dorëzimit të një njoftimi të tillë, periudha kjo që zgjatet deri në tridhjetë (30) Ditë të tjera derisa kjo mospërmbushje të kurohet për sa kohë që GenCo fillon veprimet për të kuruar këtë mospërmbushje dhe më pas vazhdimisht dhe me kujdes ndjek kurimin e mospërmbushjes së tillë; dhe
- (ii) ndërpret njëkohësisht Marrëveshjen e Zbatimit.

Neni 5 Dëmshpërblimi

5.1 Dëmshpërblimi

5.1.1 Dëmshpërblimi i QK-së

Përveç siç parashikohet në mënyrë specifike më poshtë ose diku tjetër në këtë Marrëveshje ose në Marrëveshjet e Projektit, QK-ja do të dëmshpërblejë dhe mbrojë GenCo-në dhe çdo Palë të GenCo-së, në çdo kohë pas Datës së Hyrjes në Fuqi, nga secila dhe të gjitha Humbjet e bartura ose të kërkuara për t'u paguar, në mënyrë direkte ose indirekte, nga, ose që kërkohet të vendosen ndaj, GenCo-së ose ndonjë Pale të GenCo-së:

- (a) për lëndime personale ose vdekje të personave ose dëmtim të pronës që lindin nga çdo neglizhencë ose sjellje e keqe e qëllimshme nga QK-ja ose ndonjë palë e QK-së në lidhje me këtë Marrëveshje;
- (b) në lidhje me ndonjë kërkesë ose veprim nga një palë e tretë që rezulton, që rrjedh nga ose ka të bëjë me shkeljen nga QK-ja të ndonjë ligji të Kosovës;
- (c) në lidhje me ndonjë kërkesë ose veprim nga një palë e tretë që rezulton, që rrjedh nga ose ka të bëjë shkeljen ose mospërmbushjen nga QK-ja të ndonjë prej kushteve ose përfaqësimeve dhe garancive të veta sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (d) për çdo detyrim tatimor të pagueshëm nga QK-ja sipas Nenit 1 dhe Nenit 5;
- (e) për çdo detyrim që rrjedh nga ose në lidhje me ndonjë kontratë në të cilën QK-ja është palë (përveç ndonjë kontrate në të cilën GenCo është gjithashtu palë) që kanë të bëjnë me pronësinë ose mirëmbajtjen e Pronës Fillestare ose Pronës Shtesë para Datës së Bartjes (ose, nëse GenCo fiton posedimin e ndonjë vendi të tillë pas Datës së Bartjes, data që GenCo fiton posedimin e një vendi të tillë);
- (f) që rezultojnë nga, lidhen me, ose që rrjedhin nga, çdo Kusht Mjedisor/Arkeologjik në lidhje me Pronën Fillestare ose Pronën Shtesë që ekziston në ose para Datës së Bartjes, përveç në atë masë që këto detyrime:
 - (i) rezultojnë, lidhen me, ose dalin nga çdo veprim i GenCo ose i ndonjë Filiali ose Personi nën kontrollin e GenCo, duke përfshirë në lidhje me fillimin (përfshirë para Datës së Bartjes, nëse ka) të aktiviteteve të GenCo-së në Pronën Fillestare ose Pronën Shtesë; ose
 - (ii) janë dëmshpërblyer nga QK-ja në pajtim me Seksionin 8.2 (*Dëmshpërblimi për Standardet Mjedisore*) të Marrëveshjes së Zbatimit ose kanë të bëjnë me kostot ose Humbjet e pagueshme ose që i janë paguar realisht GenCo-së në përputhje me Nenin 15 (*Sanimi Mjedisor*) të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë; dhe
- (g) që rezulton nga, lidhet me ose që rrjedh nga çdo Kusht Mjedisor/Arkeologjik që ekziston në Pronën Fillestare ose në Pronën Shtesë pas Datës së Bartjes, duke përfshirë çdo kusht të tillë që rezulton nga veprimi ose mosveprimi i QK-së ose ndonjë NP-je të Specifikuar, me përjashtim të rasteve kur detyrimet e tilla rezultojnë nga, ose kanë të bëjnë me ndonjë veprim të GenCo ose ndonjë Personi nën kontrollin e GenCo ose të një pale të tretë në atë masë që GenCo, duke vepruar në përputhje me Praktikën Prudente të Shërbimeve Publike, mund të kishte parandaluar Kushtin Mjedisor/Arkeologjik të shkaktuar nga një palë e tretë e tillë.

5.1.2 Dëmshpërblimi i GenCo-së

Përveç siç parashikohet në mënyrë specifike më poshtë ose diku tjetër në këtë Marrëveshje ose në Marrëveshjet e Projektit, GenCo-ja do të dëmshpërblejë dhe mbrojë QK-në, në çdo kohë pas Datës së Hyrjes në Fuqi, nga secila dhe të gjitha Humbjet e bartura ose të kërkuara për t'u paguar, në mënyrë direkte ose indirekte, nga, ose që kërkohet të vendosen ndaj QK-së ose ndonjë Pale të QK-së:

- (a) për lëndime personale ose vdekje të personave ose dëmtim të pronës që lindin nga çdo neglizhencë ose sjellje e keqe e qëllimshme nga GenCo ose ndonjë palë e GenCo-së në lidhje me këtë Marrëveshje;
- (b) në lidhje me ndonjë kërkesë ose veprim nga një palë e tretë që rezulton, që rrjedh nga ose ka të bëjë me shkeljen nga GenCo-ja të ndonjë ligji të Kosovës;
- (c) në lidhje me ndonjë kërkesë ose veprim nga një palë e tretë që rezulton, që rrjedh nga ose ka të bëjë shkeljen ose mospërmbushjen nga GenCo-ja të ndonjë prej kushteve ose përfaqësimeve dhe garancive të veta sipas kësaj Marrëveshjeje;
- (d) për çdo detyrim tatimor të pagueshëm nga GenCo sipas Nenit 5;

- (e) që rezulton nga, lidhet me ose që rrjedh nga çdo Kusht Mjedisor/Arkeologjik që ekziston në Pronën Fillestare ose në Pronën Shtesë pas Datës së Bartjes (ose, nëse GenCo fiton posedimin e ndonjë vendi të tillë pas Datës së Bartjes, data që GenCo fiton posedimin e një vendi të tillë), në masën që Kushti i tillë Mjedisor/Arkeologjik shkaktohet nga GenCo ose ndonjë Person nën kontrollin e GenCo ose një palë e tretë në atë masë që GenCo, duke vepruar në përputhje me Praktikën Prudente të Shërbimeve Publike, mund të kishte parandaluar Kushtin Mjedisor/Arkeologjik të shkaktuar nga një palë e tretë e tillë, dhe përveç në atë masë që detyrimet e tilla rezultojnë nga çdo Kusht Mjedisor/Arkeologjik që ekzistonte në ose para Datës së Bartjes ose rezultoi ose lidhej me ndonjë veprim apo mosveprim të ndonjë NP-je të Specifikuar ose të QK-së.

5.1.3 Përgjegjësia e Përbashkët

Në rastet kur lëndimi ose dëmtimi rezulton nga neglizhenca e përbashkët ose e njëkohshme, ose nga sjelljet e pahijshme të Palëve, secila Palë do të jetë përgjegjëse sipas këtij Neni 5 në përpjesëtim me shkallën relative të fajit.

5.1.4 Supozimet për Kushtet Mjedisore/Arkeologjike

- (a) Palët pranojnë dhe pajtohen se çdo Kusht Mjedisor/Arkeologjik i zbuluar në Lokacion para datës tetëmbëdhjetë (18) Muaj pas Datës së Operacioneve Komerciale, do të supozohet se lidhet me kushtet që ekzistojnë në ose para Datës së Bartjes, dhe jo të ketë të bëjë me aktivitetet e GenCo-së, pa dëshmi se një Kusht i tillë Mjedisor/Arkeologjik është shkaktuar nga GenCo ose ndonjë Person nën kontrollin e GenCo-së.
- (b) Pavarësisht nga çdo gjë në të kundërtën në Seksionin 5.1.4(a), Palët pranojnë dhe pajtohen që, pas Datës së Operacioneve Komerciale, çdo Kusht Mjedisor në Deponinë Ekskluzive të Hirit të GenCo-së, në Deponinë Ekskluzive të Gipsit të GenCo-së ose në ndonjë deponi tjetër që mbahet nga GenCo, nëse ka, që është zbuluar dhe lidhet drejtpërdrejt me mbetjet që janë deponuar nga GenCo, do të supozohet të lidhen me aktivitetet e GenCo-së, dhe të mos lidhet me kushtet që ekzistojnë në ose para Datës së Bartjes.
- (c) Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër që është e kundërta në ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit, (i) në asnjë rrethanë, GenCo ose ndonjë Person nën kontrollin e GenCo-së nuk mund të supozohet në çdo kohë që të ketë shkaktuar Kushte Arkeologjike në Lokacion, dhe (ii) çdo Kusht i tillë Arkeologjik do të konsiderohet si një Kusht Ekzistues Mjedisor/Arkeologjik pavarësisht nga data në të cilën është zbuluar ndonjë kusht i tillë.

5.2 Kufizimi i Dëmshpërblimit

Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje, në asnjë rast QK-ja ose GenCo ose ndonjë Palë e QK-së ose ndonjë Palë e GenCo-së nuk do të dëmshpërblehen në atë masë që Humbjet janë shkaktuar nga neglizhenca e tyre ose nga sjelljet e pahijshme ose shkelja e kushteve të kësaj Marrëveshjeje ose çdo Marrëveshje të Projektit, dhe në asnjë rast QK-ja ose GenCo-ja ose ndonjë Palë e QK-së ose ndonjë Palë e GenCo-së nuk do të dëmshpërblehen për asnjë Humbje deri në masën që kjo Palë ka marrë tashmë të ardhura nga sigurimet ose të ardhurat nga një palë e tretë për këtë, ose ka marrë apo ka pasur të drejtë për pagesa nga QK-ja ose një NP e Specifikuar sipas një Marrëveshjeje tjetër të Projektit për të.

Detyrimet e dëmshpërblimit të çdo Pale në vijim do të zvogëlohen në shumën dhe në lidhje me çdo rikuperim të sigurimeve ose rikuperime të tjera të palëve të tretë nga një Palë e dëmshpërblyer për Humbjet e dëmshpërblyera sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse një palë bën pagesa në përputhje me detyrimet e veta të dëmshpërblimit në lidhje me shumat për të cilat një sigures ose një palë tjetër e tretë mund të jetë ligjërisht përgjegjëse, kjo Palë do të konsiderohet, në masën e duhur, subrogati me ekuitet i Palës së dëmshpërblyer dhe/ose i caktuari kontraktual ose ligjor në lidhje me të drejtën për të ndjekur rikuperimin e shumave të tilla nga siguresi ose pala e tretë, deri në masën e këtyre të drejtave.

Për shmangien e dyshimit, kushtet e kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohen për të zvogëluar, dëmtuar, mohuar, modifikuar ose zëvendësuar kushtet e çdo police të sigurimit të aplikueshme që gjithashtu siguron mbulim për Humbjet e dëmshpërblyera. Pavarësisht nga sa më sipër, zbatueshmëria e ndonjë police sigurimi ose dështimi i një siguresi për të përmbushur detyrimet e veta në lidhje me Humbjen e dëmshpërblyer nuk do të justifikojë, shtyjë ose zvogëlojë detyrimet e Palës dëmshpërblyese në asnjë aspekt, as nuk do të justifikojnë mospërmbushjen e detyrimeve të dëmshpërblimit të Palës së tillë; sidoqoftë, në përcaktimin e detyrimeve përkatëse ndërmjet Palës dëmshpërblyese dhe çdo siguresi, pas pagesave të një Pale në përputhje me detyrimet e veta të dëmshpërblimit, si dhe në lidhje me çdo kontest ndërmjet Palës së tillë dëmshpërblyese dhe siguresit të tillë, sa i përket detyrimit të siguresit për të rimbursuar Palën dëmshpërblyese ose përndryshe të sigurojë mbulim për Humbje të dëmshpërblyer, çdo sigurim i aplikueshëm (me përjashtim të të gjitha zbritjeve ose mbajtjeve të zbatueshme) do të konsiderohet primar ndaj detyrimeve të dëmshpërblimit të përcaktuar këtu, dhe detyrimet e dëmshpërblimit të përcaktuara këtu do të konsiderohen në mënyrë specifike si teprica nga çdo sigurim i tillë i aplikueshëm, por vetëm në masën e shumave të paguara në të vërtetë për të siguruarin sipas këtij sigurimi, dhe me kuptimin e mëtejshëm se Pala dëmshpërblyese do të jetë në të gjitha rastet përgjegjëse për humbjen e dëmshpërblyer, në masën e detyrimeve të veta të dëmshpërblimit, më çdo të zbritshme dhe mbajtje të parashtruar në çdo sigurim të tillë të aplikueshëm.

5.3 Pohimi i Kërkesave për të Tejkaloar Shumën Minimale të Dëmshpërblimit

Secila palë do të jetë përgjegjëse e vetme dhe nuk do të ketë të drejtë të paraqesë ndonjë kërkesë për dëmshpërblim ndaj Palës tjetër sipas këtij Neni 5, për çdo Humbje që përndryshe do të ishte lëndë e dëmshpërblimit sipas kësaj Marrëveshjeje, derisa, sipas rastit, (i) të gjitha Humbjet e Palëve të GenCo-së ose të gjitha Humbjet e Sponsorit HoldCo ose të Palëve të Sponsorit HoldCo dhe të Sponsorit Sipëror ose të Palëve të Sponsorit Sipëror, në tërësi, në të gjitha Marrëveshjet e Projektit e tejkalojnë Shportën e Dëmshpërblimit të zbatueshëm për to, ose (ii) të gjitha Humbjet e QK-së ose të Palëve të QK-së dhe KEKR-së ose Palëve të KEKR-së dhe Gjenerimit të KEK-ut ose të Palëve të Gjenerimit të KEK-ut dhe të Mihjes së KEK-ut ose të Palëve të Mihjes së KEK-ut dhe të Furnizuesit të Ujit ose të Palëve të Furnizuesit të Ujit dhe të NP-ve të Specifikuara ose palëve të lidhura, në tërësi, në të gjitha Marrëveshjet e Projektit e tejkalojnë Shportën e Dëmshpërblimit në fuqi.

5.4 Mbrojtja e Kërkesave

5.4.1 Njoftimi i Kërkesave

- (a) Një Palë do ta njoftojë menjëherë Palën tjetër, me shkrim, për çdo Humbje ose procedurë në lidhje me të cilën Pala e tillë njoftuese ka ose mund të ketë të drejtën e dëmshpërblimit sipas këtij Neni 5 (një "Njoftim për Dëmshpërblim").
- (b) Vonesa ose dështimi i Palës së tillë të dëmshpërblyer për të siguruar një Njoftim për Dëmshpërblim për Palën tjetër, të kërkuar sipas këtij Seksioni 5.4, nuk do ta lirojë Palën dëmshpërblyese nga çdo detyrim dëmshpërblimi që mund t'i ketë ndaj Palës së dëmshpërblyer, përveç në atë masë që dështimi apo vonesa e tillë ka ndikuar në mënyrë materiale dhe negative në aftësinë e Palës dëmshpërblyese për të mbrojtur një veprim të tillë ose ka rritur shumën e Humbjes.
- (c) Pala, të cilës i dërgohet Njoftimi për Dëmshpërblim, duhet ta njohë Njoftimin për Dëmshpërblim, me shkrim, brenda shtatë (7) Ditëve të Punës pas marrjes së Njoftimit për Dëmshpërblim ("Njohja e Dëmshpërblimit").

5.4.2 Mbrojtja e Kërkesave

- (a) Pas marrjes së Njoftimit për Dëmshpërblim dhe me kusht që Njohja e Dëmshpërblimit të konfirmojë detyrimin e vet për të dëmshpërblyer një Palë të dëmshpërblyer në masën e kërkuar sipas këtij Neni 5, Pala dëmshpërblyese ka të drejtë, sipas zgjedhjes së vet, të drejtojë dhe kontrollojë mbrojtjen e një kërkesë, veprimi, padie ose procedure të tillë me shpenzimet e veta dhe me avokatin e përzgjedhur vetë, me aprovimin paraprak të Palës së dëmshpërblyer, dhe ky aprovim nuk duhet të mohohet, kushtëzohet, shtyhet ose refuzohet në mënyrë të paarsyeshme.

Nëse Pala dëmshpërblyese zgjedh të marrë dhe kontrollojë mbrojtjen e një kërkesë, padie, apo procedimi të tillë, ajo do të njoftojë Palën e dëmshpërblyer për këtë zgjedhje në Njohjen e Dëmshpërblimit.

- (b) Përveç nëse dhe derisa Pala dëmshpërblyese e pranon detyrimin e vet për të dëmshpërblyer Palën e dëmshpërblyer në masën e kërkuar sipas këtij Neni 5 në Njohjen e Dëmshpërblimit dhe merr kontrollin e mbrojtjes së kërkesës, padisë, veprimit ose procedimit, Pala e dëmshpërblyer do të ketë të drejtën, por jo detyrimin, të kundërshtojë, të mbrojë dhe padisë, me avokatin e përzgjedhjes së vet, çdo kërkesë, veprim, padi ose procedim nga ndonjë palë e tretë, të pretenduar ose pohuar kundër Palës së tillë në lidhje me, që rezulton nga, ose që rrjedh nga çdo çështje për të cilën ka të drejtë të dëmshpërblehet në bazë të kësaj, dhe kostot dhe shpenzimet e dokumentuara, të arsyeshme dhe të kujdesshme të tyre, do t'i nënshtrohen detyrimeve të dëmshpërblimit dhe do të rimbursohen menjëherë nga Pala dëmshpërblyese.
- (c) As Palë dëmshpërblyese dhe as Pala e dëmshpërblyer nuk kanë të drejtë të zgjidhin ndonjë kërkesë, veprim, padi ose procedim të tillë pa pëlqimin paraprak të palës tjetër (pëlqimi i tillë nuk duhet të mohohet, kushtëzohet, shtyhet ose refuzohet në mënyrë të paarsyeshme); me kusht që, sidoqoftë, pas dakordimit me shkrim për të dëmshpërblyer Palën e dëmshpërblyer, nëse Pala dëmshpërblyese merr edhe një zgjidhje të plotë dhe complete të çështjeve që përfshijnë Palën e dëmshpërblyer (duke përfshirë, pa kufizim, një lirim të plotë të Palës të dëmshpërblyer nga të gjitha përgjegjësitë ose obligimet e mëtejshme në lidhje me çdo pretendim të pohuar) dhe çdo aprovim të domosdoshëm gjyqësor të një zgjidhjeje, Pala dëmshpërblyese mund të zgjidhë çdo kërkesë pa pëlqimin e Palës së dëmshpërblyer.
- (d) Nëse Pala dëmshpërblyese zgjedh të marrë dhe kontrollojë mbrojtjen e kërkesës, veprimit, padisë, ose procedimit, Pala e dëmshpërblyer do t'i sigurojë Palës dëmshpërblyese informacione të tilla, siç mund të kërkohej në mënyrë të arsyeshme nga Pala dëmshpërblyese në lidhje me kërkesën, padinë ose procedimin, dhe duhet (në masën e duhur) ta mbajë Palën dëmshpërblyese plotësisht të informuar për çdo zhvillim material në kryerjen e padisë, veprimit, padisë ose procedimit.

5.4.3 Shpenzimet e Avokatit Mbrojtës

- (a) Pas marrjes së Njohjes së Dëmshpërblimit dhe marrjes së mbrojtjes nga Pala dëmshpërblyese, Pala e dëmshpërblyer ka të drejtë të punësojë avokatin e vet dhe avokati i tillë mund të marrë pjesë në një veprim të tillë, por tarifat dhe shpenzimet e një avokati të tillë do të jenë me shpenzimet e vetme të një Pale të tillë të dëmshpërblyer, kur dhe siç ndodhin, përveç nëse:
 - (i) punësimi i avokatit nga një Palë e tillë e dëmshpërblyer është autorizuar me shkrim nga Pala dëmshpërblyese dhe Pala dëmshpërblyese ka rënë dakord të paguajë tarifat dhe shpenzimet e avokatit të tillë;
 - (ii) Pala e dëmshpërblyer do të ketë konkluduar në mënyrë të arsyeshme dhe në mënyrë specifike do ta njoftojë Palën dëmshpërblyese se mund të ketë një konflikt interesi mes Palën dëmshpërblyese dhe Palës së dëmshpërblyer në kryerjen e mbrojtjes së një veprimi të tillë;
 - (iii) Pala dëmshpërblyese nuk do të ketë punësuar në fakt një avokat të pavarur të pranueshëm në mënyrë të arsyeshme për Palën e dëmshpërblyer për të marrë përsipër mbrojtjen e një veprimi të tillë, dhe do të jetë njoftuar nga Pala e dëmshpërblyer; ose
 - (iv) Pala e dëmshpërblyer do të ketë konkluduar në mënyrë të arsyeshme dhe në mënyrë specifike do ta njoftojë Palën dëmshpërblyese që mund të ketë mbrojtje specifike të disponueshme për të që janë të ndryshme nga ato që janë në dispozicion të Palës dëmshpërblyese ose që një kërkesë, veprim, padi ose procedim i tillë përfshin ose mund të ketë një efekt të dëmshëm material mbi Palën e dëmshpërblyer përtej fushëveprimit të kësaj Marrëveshjeje.
- (b) Nëse do të jenë të zbatueshëm Seksioni 5.4.3(a)(i), 5.4.3(a)(ii), 5.4.3(a)(iii) ose 5.4.3(a)(iv), atëherë Pala e dëmshpërblyer ka të drejtën të drejtojë mbrojtjen e një kërkesë, veprimi, padie ose

procedimi të tillë në emër të vet dhe pagesat e arsyeshme dhe të dokumentuara të avokatit të pavarur të mbajtur nga Pala e dëmshpërblyer përbëjnë shpenzime ligjore ose të tjera të dëmshpërblyera dhe të rimbursueshme.

Neni 6 Kosto

6.1 Kostot

GenCo do të mbulojë të gjitha kostot, tarifat, tatimet dhe shpenzimet për regjistrimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7 Arbitrazhi; Juridiksioni

7.1 Arbitrazhi

Palët bien dakord në mënyrë të përvokueshme që çdo kontest ose diferencë që lind nga, prej, në lidhje me ose rreth kësaj Garanci, duke përfshirë çdo Kontest ose diferencë në lidhje me ekzistencën, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose të ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje (duke përfshirë ekzistencën, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e marrëveshjeve të përfshira në këtë Seksion 7.1.1) ose nëse kjo Marrëveshje ose ndonjë dispozitë e saj (duke përfshirë marrëveshjet e përmbajtura në këtë Seksion 7.1.1) janë të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme, do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e Nenit 22 të Marrëveshjes së Zbatimit, të cilat si dispozita janë inkorporuar këtu me referencë, *mutatis mutandis*.

7.2 Aktet Komerciale

QK-ja pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme pajtohet që ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja prej saj e kësaj Marrëveshjeje përbëjnë veprimet e veta private dhe komerciale.

7.3 Imuniteti Sovran; Juridiksioni

(a) QK-ja me këtë në mënyrë të përvokueshme dhe pa kushte:

- (i) pajtohet që nëse duhet të ngrihet ndonjë procedim kundër QK-së ose aseteve të veta, përveç Aseteve të Mbrojtura, në çdo juridiksion në lidhje me këtë Marrëveshje ose ndonjë nga transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje, asnjë pretendim për imunitet nga ky procedim nuk do të kërkohet nga ose në emër të QK-së në emër të vetvetes ose të ndonjë prej aseteve të veta (përveç Aseteve të Mbrojtura);
- (ii) heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që ajo ose ndonjë nga asetet e veta (përveç Aseteve të Mbrojtura) tani ka ose mund të ketë në të ardhmen në ndonjë juridiksion në lidhje me ndonjë procedim të tillë;
- (iii) bie dakord që ekzekutimi, dorëzimi dhe përmbushja sipas kësaj Marrëveshjeje dhe çdo Marrëveshje tjetër të Projektit në të cilën është palë, përbën aktet e veta private dhe komerciale dhe heq dorë nga çdo kundërshtim që mund të ketë tani ose në vijim ndaj vendit të ndonjë veprimi ose procedimi të parashtruar siç e lejon ky Seksion 7.3(a), dhe në mënyrë specifike heq dorë nga çdo kundërshtim që çdo veprim apo procedim e tillë është parashtruar në një forum të papërshtatshëm dhe pajtohet të mos mbrojë ose pretendojë të njëjtën gjë;
- (iv) jep pëlqimin përgjithësisht në lidhje me zbatimin e çdo vendimi kundër saj në çdo procedim të tillë në çdo juridiksion për marrjen e ndonjë mase juridike ose çështjen e ndonjë procesi në lidhje me këtë procedim (bërjen, zbatimin ose ekzekutimin kundër ose në lidhje me çfarëdo aseti të saj (përveç Aseteve të Mbrojtura)) pavarësisht nga përdorimi ose përdorimi i synuar; dhe
- (v) pajtohet që shërbimi i procesit në çdo veprim apo procedim të tillë mund të kryhet në çfarëdo mënyre të lejuar nga ligji i zbatueshëm në gjykatën e lartpërmendur.

- (b) GenCo në mënyrë të përvokueshme dhe pa kushte:
- (v) jep pëlqimin në përgjithësi për juridiksionin, në lidhje me vetveten dhe të gjitha asetet dhe pasuritë e veta që posedon tani ose mund të fitojë më pas, nga çdo gjykatë kompetente Në Kosovë për çdo veprim të parashtruar nga QK-ja për të zbatuar çdo vendim të çdo arbitri të emëruar sipas kësaj Marrëveshjeje për të zgjidhur çdo Kontest ndërmjet Palëve (duke përfshirë marrjen, zbatimin ose ekzekutimin ndaj ose në lidhje me cilëndo nga asetet e veta, pavarësisht nga përdorimi ose përdorimi i synuar);
 - (ii) heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që ai ose ndonjë nga asetet e veta tani ka ose mund të ketë në të ardhmen në ndonjë juridiksion në lidhje me ndonjë procedim të tillë;
 - (iii) heq dorë nga çdo që mund të ketë tani ose në vijim ndaj vendit të ndonjë veprimi ose procedimi të parashtruar siç e lejon ky Seksion 7.3(b), dhe në mënyrë specifike heq dorë nga çdo kundërshtim që çdo veprim apo procedim e tillë është parashtruar në një forum të papërshtatshëm dhe pajtohet të mos mbrojë ose pretendojë të njëjtën gjë;
 - (iv) pajtohet që shërbimi i procesit në çdo veprim apo procedim të tillë mund të kryhet në çfarëdo mënyre të lejuar nga ligji i zbatueshëm në gjykatën e lartpërmendur; dhe
 - (v) heq dorë nga çfarëdo dhe të gjitha të drejtat që mund të ketë për të zbatuar ndonjë aktgjykim ose padi kundër Aseteve të Mbrojtura në gjykatat e çdo juridiksioni.

Neni 8

Asnjë heqje dorë; Mjetet Juridike Kumulative

8.1 Asnjë heqje dorë

Asnjë dështim ose vonesë nga GenCo për të ushtruar ndonjë të drejtë ose mjet juridik sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të përbëjë një heqje dorë nga një e drejtë apo mjet i tillë. Asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i ndonjë të drejte ose mjete juridik nuk përjashton ndonjë ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tij, ose ushtrimin e ndonjë të drejte ose mjete tjetër. Asnjë heqje dorë nga GenCo nuk do të jetë efektive nëse nuk është me shkrim.

8.2 Mjetet Juridike Kumulative

Të drejtat dhe mjetet juridike të GenCo të parashikuara nga kjo Marrëveshje janë kumulative dhe nuk janë përjashtuese të ndonjë të drejte ose mjete juridik të parashikuar me ligj.

Neni 9

Detyra

9.1 Caktimi

- (a) GenCo mund të caktojë si kolateral interesin e vet në vijim për një Huadhënës, për çdo institucion financiar ose institucione që marrin pjesë në financimin e Projektit Kosova e Re, ose për ndonjë prej bartësve ose të emëruesve të tyre në lidhje me ushtrimin ose zbatimin e të drejtave të tyre të kolateralit. GenCo do t'ia caktojë këtë Marrëveshje KOSTT-it në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Kyçjes dhe nuk do të ketë detyrime në vijim nga dhe pas datës së caktimit të tillë, përveç detyrimeve që lindin para datës së caktimit. Kjo Marrëveshje nuk do t'i caktohet nga GenCo asnjë pale tjetër pa pëlqimin paraprak me shkrim të QK-së.
- (b) Pavarësisht nga Seksioni 9.1(a), në rast se QK-ja fiton të gjitha të drejtat, titullin dhe interesat e GenCo në dhe për Objektivin e TCKR-së ose (i) në skadimin e afatit të Marrëveshjes së Zbatimit në pajtim me Seksionin 20.6 (*Skadimi i Afatit*) të Marrëveshjes së Zbatimit ose (ii) në përputhje me Nenin 20 (*Të Drejtat dhe Detyrimet Pas Ndërprerjes, Kompensimi*) të Marrëveshjes së Zbatimit pas ndërprerjes së Marrëveshjes së Zbatimit, GenCo, pa nevojën e ndonjë pëlqimi nga QK-ja ose çdo Person, do t'ia caktojë dhe rinovojë QK-së të gjithë të drejtën, titullin dhe interesin e vet në

këtë Marrëveshje (ose të emëruarit të QK-së, të përzgjedhur në përputhje me kushtet e Marrëveshjes së Zbatimit), dhe pala caktuese do të lirohet nga secili dhe të gjitha përgjegjësitë ose detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje që lindin pas datës së caktimit dhe novacioneve të tilla. Nëse GenCo e kërkon, QK-ja do të ekzekutojë, së bashku me GenCo, të gjitha marrëveshjet dhe dokumentet e arsyeshme dhe të zakonshme të nevojshme për zbatimin e caktimit dhe përtëritjes së kësaj Marrëveshjeje nga dhe pas datës së ndërprerjes të tillë. Nëse QK-ja nuk përmbush në mënyrë të arsyeshme këtë Seksion 9.1(b), GenCo do të ketë të drejtën ta ndërpresë këtë Marrëveshje duke i dhënë QK-së një njoftim. Bartja e aseteve nga GenCo-ja në pajtim me këtë Seksion 9.1(b) nuk do ta lirojë QK-në nga detyrimet e veta sipas ndonjë Marrëveshjeje të Projektit ose ndonjë Dokumenti të Financimit që ekziston që nga data e novacioneve, bartjes ose caktimit.

- (b) Kjo Marrëveshje nuk do të caktohet nga QK-ja pa pëlqimin paraprak me shkrim të GenCo.
- (d) Kjo Marrëveshje do të lidhet dhe do të jetë në dobi të Palëve dhe çdo pasardhësi ose titullari që merr interesin e mëposhtëm sipas Seksionit 9.1(a) dhe Seksionin 9.1(b).
- (e) Çdo caktim në kundërshtim me këtë Seksion 9.1 është nul dhe i pavlefshëm.

Neni 10 Të ndryshme

10.1 Njoftimet

(a) Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera të kërkuara ose të lejuara për t'u dhënë nga një Palë duhet të jenë me shkrim dhe secila e dorëzuar personalisht ose me korrier ose të dërgohet me faks ose me e-mail në adresën ose numrin e Palës tjetër të specifikuar më poshtë:

(i) Nëse është për QK-në:

Qeveria e Kosovës
Rr. Nëna Terezë Nr. 36, Prishtinë, Kosovë
Prishtinë, Kosovë
Në vëmendje të: Ministër i Zhvillimit Ekonomik

Tel: [_____]

] Faks: [_____]

] _____]

(ii) Nëse është për
GenCo-në:

Email: [_____]

ContourGlobal Terra 6 S.à r.l
35-37 Avenue de la Liberté
L-1931 Luxembourg, Grand Duchy of Luxembourg
Në vëmendje të: Bordit të Menaxherëve
Telefoni: + (352) 28 86 78 00
Faks: + (352) 28 86 78 00
E-mail: CGK_CEO@contourglobal.com
CGK_GC@contourglobal.com

me kusht që, një Palë mund ta ndryshojë adresën në të cilën duhet t'i dërgohen njoftimet, duke i dhënë Palës tjetër njoftim me shkrim jo më vonë se tridhjetë (30) përpara, në përputhje me këtë Seksion 10.1 (a).

- (b) Asnjë njoftim ose komunikim tjetër nuk do të jetë efektiv deri sa të merret ose të konsiderohet e i marrë. Njoftimet ose komunikimet e tjera do të konsiderohen se janë marrë nga Pala pritëse:
 - (i) kur dorëzohet nëse dorëzohet personalisht;
 - (ii) tre (3) Ditë të Punës pas dërgimit, nëse dërgohen nga një korrier ndërkombëtar;

- (iii) me dërgimin e tyre, nëse janë dërguar me faks, në varësi të konfirmimit të një raporti të pandërprerë të transmisionit dhe me kusht që një kopje fizike të dërgohet jo më vonë se Dita e Punës në vijim tek marrësi nëpërmjet korrierit ndërkombëtar ose dërgesës personale; ose
 - (iv) me dërgimin e tyre, nëse janë dërguar me e-mail, me kusht që një kopje fizike të dërgohet jo më vonë se Dita e Punës në vijim tek marrësi me korrier ndërkombëtar ose dërgesë personale; me kusht që, sidoqoftë, Palët mund të bien dakord reciprokisht me shkrim se nuk ka asnjë kërkesë për dorëzimin e kopjeve fizike në lidhje me komunikimet të caktuara operative të përditshme apo të ngjashme.
- (c) Një Palë që dërgon një njoftim ose komunikim tjetër sipas Seksionit 10.1(a) do të përdorë përpjekje të arsyeshme komerciale për t'i dhënë Palës pritëse një përkthim të arsyeshëm të saktë në gjuhën shqipe brenda pesë (5) Ditëve të Punës të dërgimit të njoftimit ose komunikimit tjetër në Anglisht; me kusht që, sidoqoftë, një Palë nuk do t'i kërkohej të sigurojë përkthim të ndonjë vizatimi teknik ose dokumenteve të ngjashme teknike ose inxhinierike. Në rast të ndonjë mospërputhje midis origjinalit anglisht dhe përkthimit në shqip të çdo njoftimi ose komunikimi tjetër, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë mbi versionin në shqip. Për shmangien e dyshimit, dështimi në dorëzimin e një përkthimi të një njoftimi ose komunikimi tjetër në përputhje me këtë Seksion 10.1 (c) nuk do të ndikojë në efektivitetin e njoftimit ose komunikimit tjetër të përcaktuar sipas Seksionit 10.1(b).
- (d) Në rast se një njoftim i dorëzuar nga GenCo tek QK-ja në pajtim me këtë Marrëveshje kërkon që QK-ja ose të japë një përgjigje (duke përfshirë çdo aprovim apo kundërshtim) brenda një periudhe të caktuar kohore, ose të konsiderohet ta ketë aprovuar ose të mos kundërshtojë ndërmarrjen e ndonjë veprimi nga GenCo, GenCo do të përfshijë në një njoftim të tillë një përshkrim të periudhës së përgjigjes dhe pasojat e dështimit të QK-së për t'u përgjigjur (përfshirë çdo aprovim ose mos-kundërshtim).

10.2 Ligji Drejtues

Kjo Marrëveshje do të qeveriset dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Nju Jorkut.

10.3 Shkëputshmëria

Nëse ndonjë term ose dispozitë e kësaj Marrëveshjeje përcaktohet nga një gjykatë ose një autoritet tjetër kompetent, se është e parregullt, e pavlefshme, e paligjshme, e pazbatueshme ose kundër politikës publike, (i) dispozitat e mbetura të kësaj Marrëveshjeje do të mbeten në fuqi dhe efekt të plotë dhe (ii) palët në këtë rast do të takohen menjëherë dhe do të negociojnë një zëvendësues për dispozitën apo pjesë të tillë të prekura që, në masën më të madhe ligjërish të lejueshme, do të zbatojnë qëllimin origjinal të Palëve.

10.4 Termat me Shkronjë të Madhe

Termat me shkronjë të madhe të përdorura por jo të përcaktuara në këtë Marrëveshje do të kenë kuptimin që u është dhënë në Marrëveshjen e Zbatimit.

DUKE DËSHMUAR SA MË LART, Palët kanë ekzekutuar dhe dorëzuar këtë Marrëveshje në Prishtinë, Kosovë në datën e shkruar më lart.

Republika e Kosovës
e cila vepron përmes **Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik**

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

[_____]

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Nga: _____

Emri: _____

Titulli: _____

Aneksi 1

E gjithë toka e identifikuar nga studimi i kryer sipas Marrëveshjes së Kycjes, siç përshkruhet në Seksionin 4 të saj.

Kalendari
6
Pëlqime të
Specifikuara

Pëlqimi	Autoritet i Lëshues
Licencë për gjenerimin e energjisë elektrike	ZRR
Leje ndërtimi (të gjitha fazat për ndërtimet e Kategorisë III)	MMPH
Autorizimi mjedisor	MMPH
Leje mjedisore	MMPH
Leje e integruar mjedisore	MMPH
Leje përdorimi	MMPH
Leja e ujit	MMPH

Kalendari 7
Forma e Certifikatës së Pajtueshmërisë

Kjo Certifikatë e Pajtueshmërisë, e datës _____, 20__ ("Data e Certifikimit"), dorëzohet në emër të _____, një [vendi i themelimit] [lloji i subjektit juridik] ("Këshilltar") për ContourGlobal, LP, një ortakëri e kufizuar e përjashtuar në Cayman Islands ("Kompania") në lidhje me angazhimin e këshilltarit nga ana e Republikës së Kosovës ("QK") në lidhje me Projektin Kosova e Re ("Projekti"). Termat me shkronjë të madhe të përdorura, por jo të përcaktuara ndryshe këtu do të kenë kuptimet e dhëna atyre në Marrëveshjen e Zbatimit të datës _____ dhe lidhur mes QK-së, e cila vepron përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe _____ ("Marrëveshja") (një kopje e së cilës i është dhënë Këshilltarit):

I nënshkruari, duke qenë një përfaqësues i autorizuar i Këshilltarit, vërteton në emër të Këshilltarit dhe në datën e Certifikimit që:

1. Këshilltari është i njohur dhe i kupton kërkesat dhe ndalimet e Aktit të Praktikave të Huaja Korruptive të Shteteve të Bashkuara të vitit 1977 (i ndryshuar), Aktit të Korrupsionit në Mbretërinë e Bashkuar 2010 dhe Ligjet kundër Ryshfetit.
2. Këshilltari ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë në pajtueshmëri të plotë me Aktin e Praktikave të Huaja Korruptive të Shteteve të Bashkuara të vitit 1977 (i ndryshuar), Aktin e Korrupsionit në Mbretërinë e Bashkuar 2010 dhe Ligjet kundër Ryshfetit.
3. Këshilltari do të sigurojë që çdo drejtues, punonjës, filial, agjent ose përfaqësues që ndihmojnë ose angazhohen nga Këshilltari në lidhje me Projektin janë dhe do të vazhdojnë të jenë në pajtueshmëri të plotë me Ligjet kundër Ryshfetit në lidhje me çdo aktivitet të ndërmarrë dhe shërbime të ofruara në lidhje me Projektin.
4. Këshilltari, nuk ka dhënë dhe nuk do të japë, dhe do të sigurojë që çdo drejtues, punonjës, filial, agjent ose përfaqësues që ndihmojnë ose angazhohen nga Këshilltari në lidhje me Projektin nuk kanë dhënë dhe nuk do të japin ose do të ofrojnë, premtojnë, ofrojnë ose të autorizojnë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, pagesën, paratë ose ndonjë gjë me vlerë për:
 - a. çdo Zyrtar të Huaj për qëllimet e (i) ndikimit në ndonjë veprim apo vendim të një Zyrtari të tillë të Huaj, në cilësinë e tij zyrtare, duke e shtyrë një Zyrtar të tillë të Huaj të kryejë ose të mos kryejë ndonjë veprim në kundërshtim me detyrën e ligjshme të këtij zyrtari, ose për sigurimin e çfarëdo përparësie të papërshtatshme; ose (ii) nxitjes së një Zyrtari të tillë të Huaj që të përdorë influencën e tij me një qeveri të huaj ose instrumentet e saj për të ndikuar ose influencuar në ndonjë akt apo vendim të qeverisë ose instrumentit të tillë, me synimin për të ndihmuar Këshilltarin ose Shoqërinë në marrjen ose mbajtjen e biznesit për, ose me, ose për ta drejtuar biznesin, tek Këshilltari ose Shoqëria, sipas rastit; dhe
 - b. çdo palë e tretë për qëllimet (i) E përcaktuara në paragrafin (a) më lart; ose (ii) për të siguruar ndonjë avantazh të papërshtatshëm për Projektin.

"Zyrtar i Huaj" do të thotë çdo zyrtar ose punonjës i Qeverisë së Republikës së Kosovës ose ndonjë departament, agjenci ose instrument i tij ose çdo person që vepron në kapacitet zyrtar për ose në emër të ndonjë qeverie, departamenti, agjencie apo instrumenti të tillë.

DUKE DËSHMUAR SA MË LART, i nënshkruari ka ekzekutuar dhe dorëzuar këtë Certifikatë të pajtueshmërisë në emër të Këshilltarit sipas datës së përcaktuar më lart.

[KËSHILLT
AR]

Nga: _____
Emri:
Titulli
:

Kalendari
8
Forma e Certifikatës së
Pagesës

Kjo Certifikatë e Pagesës, e datës _____, 20__ ("Data e Certifikimit"), dorëzohet në emër të [Këshilltarit], një [vendi i themelimit] [lloji i subjektit juridik] ("Këshilltari") për ContourGlobal, LP, një ortakëri e kufizuar e përjashtuar në Cayman Islands ("Kompania") në lidhje me angazhimin e Këshilltarit nga ana e Republikës së Kosovës ("QK") në lidhje me Projektin Kosova e Re ("Projekti"). Termat me shkronjë të madhe të përdorura, por jo të përcaktuara ndryshe këtu do të kenë kuptimet e dhëna atyre në Marrëveshjen e Zbatimit të datës _____ dhe lidhur mes QK-së, e cila vepron përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe ContourGlobal Kosovo LLC ("Marrëveshja") (një kopje e së cilës i është dhënë Këshilltarit):

Këshilltari përfaqëson QK-në në pajtim me marrëveshjet e drejtpërdrejta ndërmjet QK-së dhe Këshilltarit. Nuk ka marrëdhënie mes Këshilltarit dhe Kompanisë, por Kompania ka rënë dakord me QK-në për të paguar tarifa të caktuara të këshilltarit dhe kjo Certifikatë e Pagesës është dorëzuar sipas kësaj.

I nënshkruari, duke qenë një përfaqësues i autorizuar i Këshilltarit, vërteton në emër të Këshilltarit dhe në datën e Certifikimit që:

1. sipas njohurive të veta, pas kërkimit të duhur, asnjë pjesë e shumës së faturuar këtu nuk është siguruar ose do të sigurohet, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për:
 - (a) ndonjë Zyrtar të Huaj në kundërshtim me Aktin e Praktikave të Huaja Korruptive të Shteteve të Bashkuara të vitit 1977 (i ndryshuar), Aktin e Korrupsionit në Mbretërinë e Bashkuar 2010 dhe Ligjet kundër Ryshfetit, ose ndonjë kërkesë pajtueshmërie sipas Seksionit 23.24 (*Afirmimi*) të Marrëveshjes ose qëllimet e
 - (i) ndikimit në ndonjë veprim apo vendim të një Zyrtari të tillë të Huaj, në cilësinë e tij zyrtare, duke e shtyrë një Zyrtar të tillë të Huaj të kryejë ose të mos kryejë ndonjë veprim në kundërshtim me detyrën e ligjshme të këtij zyrtari; ose
 - (ii) nxitjes së një Zyrtari të tillë të Huaj që të përdorë influencën e tij me një qeveri të huaj ose instrumentet e saj për të ndikuar ose influencuar në ndonjë akt apo vendim të qeverisë ose instrumentit të tillë, me synimin për të ndihmuar Këshilltarin ose Shoqërinë në marrjen ose mbajtjen e biznesit për, ose me, ose për ta drejtuar biznesin, tek Këshilltari ose Shoqëria, sipas rastit; ose
 - (b) ndonjë shkelje të palës së tretë në lidhje me Aktin e Praktikave të Huaja Korruptive të Shteteve të Bashkuara të vitit 1977 (i ndryshuar), Aktin e Korrupsionit në Mbretërinë e Bashkuar 2010 dhe Ligjet kundër Ryshfetit, ose ndonjë kërkesë pajtueshmërie sipas Seksionit 23.24 (*Afirmimi*) të Marrëveshjes, ose për qëllimet e përcaktuara në paragrafin (a) më sipër në lidhje me Projektin.

2. sipas njohurive të tij, asnjë pjesë e shumës së faturuar këtu nuk është shkaktuar në përfaqësimin e QK-së ose një NP-je të Specifikuar në lidhje me një kontest sipas ndonjë prej Marrëveshjeve të Projektit.

"Zyrtar i Huaj" do të thotë çdo zyrtar ose punonjës i Qeverisë së Republikës së Kosovës ose ndonjë departament, agjenci ose instrument i tij ose çdo person që vepron në kapacitet zyrtar për ose në emër të ndonjë qeverie, departamenti, agjencie apo instrumenti të tillë.

DUKE DËSHMUAR SA MË LART, i nënshkruari ka ekzekutuar dhe dorëzuar këtë Certifikatë Pagesë të Mihjes së KEK-ut sipas datës së përcaktuar më lart.

[KËSHILLTAR]

Kalendari 8 Nga: _____

Emri:
Titulli
:

Kalendari
9
Lista e
Ekspertëve

1. Ekspertët e Kontestit Teknik:

Siç mund të dakordohet nga Palët herë pas here.

2. Ekspertët e Kontestit të Pagesave:

Siç mund të dakordohet nga Palët herë pas here.

Kalendari
10
LISTA E
Konsulentëve

1. Inxhinieri i Pavarur i Emëruar nga QK-ja:
Siç mund të dakordohet nga Palët herë pas here.

2. Konsulenti i Pavarur i MS-së:

Siç mund të dakordohet nga Palët herë pas here.